

# Dhiata e Vjetër

Manuali i Mësuesit për Doktrinën e Ungjillit



# Dhiata e Vjetër

---

Manuali i Mësuesit për Doktrinën e Ungjillit

Botuar nga  
Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme  
Solt-Lejk-Siti, Juta

## **Komente dhe Sugjerime**

Komentet dhe sugjerimet tuaja rreth këtij manuali do të vlerësohen. Ju lutemi, paraqitini ato tek:

Curriculum Planning

50 E. North Temple St., Rm. 2420

Salt Lake City, UT 84150-3220

USA

Postë elektronike: [cur-development@ldschurch.org](mailto:cur-development@ldschurch.org)

Ju lutemi shkruani emrin, adresën, lagjen dhe kunjin tuaj. Sigurohuni që të jepni titullin e manualit. Më pas jepni komentet dhe sugjerimet tuaja rreth pikave të forta të manualit dhe drejtimeve të përmirësimit të mundshëm.

© 1996, 2001 nga Intellectual Reserve, Inc.

I rezervohen të gjitha të drejtat

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Miraturar për anglisht: 1/01

Miraturar për përkthim: 1/01

Përkthim i *Old Testament: Gospel Doctrine Teacher's Manual*

Albanian

35570 101

# Përmbajtja

Numri dhe Titulli i Mësimit	Faqe
Ndihma për Mësuesin	V
1 “Kjo Është Vepra Ime dhe Lavdia Ime” (Moisiu 1)	1
2 “Ti u Zgjodhe Përpara se të Lindeshe” (Abraham 3; Moisiu 4:1–4)	6
3 Krijimi (Moisiu 1:27–42; 2–3)	10
4 “Për Shkak të Shkeljes Sime Sytë e Mi u Hapën” (Moisiu 4; 5:1–15; 6:48–62)	13
5 “Në Rast se Bën Mirë, Ti do të Pranolesh” (Moisiu 5–7)	18
6 “Noeu . . . Ndërtoi një Arkë për Shpëtimin e Shtëpisë së Tij” (Moisiu 8:19–30; Zanafilla 6–9; 11:1–9)	24
7 Besëlidhja e Abrahamit (Abraham 1:1–4; 2:1–11; Zanafilla 12:1–8; 17:1–9)	28
8 Të Jetuarit me Drejtësi në një Botë të Ligë (Zanafilla 13–14; 18–19)	33
9 “Perëndia do ta Sigurojë Vetë Qengjin për Sakrificën” (Abraham 1; Zanafilla 15–17; 21–22)	37
10 Bekimet e Parëbirnisë; Martesa në Besëlidhje (Zanafilla 24–29)	41
11 “Si Mund ta Bëj Unë Këtë të Keqe të Madhe?” (Zanafilla 34; 37–39)	47
12 “Frytdhënës në Vendin e Pikëllimit Tim” (Zanafilla 40–45)	52
13 Skllavëria, Pashka dhe Eksodi (Eksodi 1–3; 5–6; 11–14)	56
14 “Do të Jeni Thesari Im i Veçantë” (Eksodi 15–20; 32–34)	62
15 “Të Shikosh te Perëndia dhe Jeto” (Numrat 11–14; 21:1–9)	68
16 “Nuk Mund të Shkel Urdhrin e Zotit” (Numrat 22–24; 31:1–16)	73
17 “Ki Kujdes të Mos Harrosh” (Ligji i Përtërirë 6; 8; 11; 32)	77
18 “Ji i Fortë dhe Trim” (Jozueut 1–6; 23–24)	82
19 Mbretërimi i Gjyqtarëve (Gjyqtarët 2; 4; 6–7; 13–16)	87
20 “Gjithë . . . Qyteti . . . e Di . . . që Ti Je një Grua e Virtytshme” (Ruthi; 1 Samuelit 1)	92
21 Perëndia do të Nderojë Ata që e Nderojnë Atë (1 Samuelit 2–3; 8)	96
22 “Zoti Shikon Zemrën” (1 Samuelit 9–11; 13; 15–17)	101
23 “Zoti Qoftë Dëshmitar Midis Teje dhe Meje për Gjithnjë” (1 Samuelit 18–20; 23–24)	107
24 “Krijë tek Unë një Zemër të Pastër” (2 Samuelit 11–12; Psalmeve 51)	111



25	“Çdo Gjë që Merr Frymë le të Lëvdojë Zotin” (Psalmeve)	117
26	Mbreti Salomon: Burrë Mençurie, Burrë Marrëzie (1 Mbretërve 3; 5–11)	123
27	Ndikimi i Udhëheqësve të Ligj dhe i Atyre të Drejtë (1 Mbretërve 12–14; 2 Kronikave 17; 20)	128
28	“Mbas Zjarrit . . . një Zë, si një Shushuritje e Ëmbël” (1 Mbretërve 17–19)	134
29	“Mori . . . Mantelin e Elias” (2 Mbretërve 2; 5–6)	139
30	“Ejani në Shtëpinë e Zotit” (2 Kronikave 29–30; 32; 34)	143
31	“Lum Ai Njeri që Ka Gjetur Diturinë” (Fjalët e Urta dhe Predikuesit)	150
32	“E Di që Shpëtimtari Im Jeton” (Jobit 1–2; 13; 19; 27; 42)	156
33	Ndarja e Ungjillit me Botën (Jona 1–4; Mikea 2; 4–7)	161
34	“Do të Fejohesh me Mua në Drejtësi” (Osea 1–3; 11; 13–14)	165
35	Perëndia ua Tregon Sekretet Profetëve të Tij (Amos 3; 7–9; Joel 2–3)	169
36	Lavdia e Sionit do të Jetë një Mbrojtje (Isaia 1–6)	174
37	“Ke Bërë Gjëra të Mrekullueshme” (Isaia 22; 24–26; 28–30)	178
38	“Përveç Meje nuk Ka Shpëtimtar Tjetër” (Isaia 40–49)	182
39	“Sa të Bukura . . . mbi Malet” (Isaia 50–53)	186
40	“Zgjero Vendin e Çadrës Sate” (Isaia 54–56; 63–65)	189
41	“Sot po të Bëj . . . një Shtyllë të Hekurt” (Jeremia 1–2; 15; 20; 26; 36–38)	193
42	“Do ta Shkruaj mbi Zemrën e Tyre” (Jeremia 16; 23; 29; 31)	197
43	Barinjtë e Izraelit (Ezekiel 18; 34; 37)	200
44	“Çdo Qenie e Gjallë do të Jetojë Kudo që Arrin Lumi” (Ezekiel 43–44; 47)	206
45	“Në Qoftë se Duhet të Vdes, do të Vdes” (Daniel 1; 3; 6; Esterit 3–5; 7–8)	210
46	“Një Mbretëri, që nuk do të Shkatërrohet Kurrë” (Daniel 2)	215
47	“Të Ngrihemi dhe t’i Vihemi Ndërtimit” (Ezdras 1–8; Nehemias 1–2; 4; 6; 8)	219
48	“Dita e Madhe dhe e Llahtarshme e Zotit” (Zakaria 10–14; Malakia)	225

# Ndihma për Mësuesin

---

Presidenti Gordon B. Hinkli ka thënë: “Shpresoj që për ju [studimi i shkrimeve të shenjta] do të bëhet diçka shumë më e këndshme se një detyrë; që, përkundrazi, do t’ju ndihmojë të krijoni një dashuri të thellë për fjalën e Perëndisë. Ju premtoj se, ndërsa lexoni, mendja juaj do të ndriçohet dhe shpirti juaj do të lartësohet” (“The Light within You”, *Ensign*, maj 1995, f. 99).

Si mësues i Doktrinës së Ungjillit, ju keni mundësinë të ndihmoni anëtarët e klasës tuaj që të mësojnë ta duan Dhiatën e Vjetër dhe të gjejnë ndriçimin që premtoi Presidenti Hinkli. Ndërsa jepni mësim, ju do të jeni duke ndjekur shembullin e Shpëtimtarit, që i deshi shkrimet e shenjta dhe i përdori ato për t’u dhënë mësim dishepujve të Tij.

Pikërisht pasi Jezusi u ringjall, Ai i përdori shkrimet e shenjta për t’u mësuar të vërteta të fuqishme dy dishepujve. Një dishepull që quhej Kleopa, dhe shoku i tij po ecnin përgjatë rrugës për në Emaus, duke diskutuar lajmin që sapo kishin dëgjuar se trupi i Jezusit nuk qe më në varr. Ndërsa po ecnin, atyre iu bashkua Jezusi, por ata nuk e njohën. Ai i pyeti se për çfarë po flisnin dhe përse qenë të trishtuar dhe ata i treguan për Kryqëzimin e për Ringjalljen. Kur Jezusi dëgjoi këtë, Ai “u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij” (Lluka 24:27).

Kleopa dhe shoku i tij i kërkuan Shpëtimtarit që të qëndronte me ta dhe, kur u ulën për të ngrënë, e njohën Atë si Zotin e ringjallur. Ai pastaj u zhduk prej syve të tyre dhe ata i thanë njëri-tjetrit: “Po a nuk na digjej zemra përbrenda, kur ai na fliste udhës dhe na hapte Shkrimet?” (Lluka 24:32).

Shkrimet e shenjta që i bënë të digjeshin zemrat e dishepujve qenë nga librat e Moisiut dhe të profetëve – shkrimet që ne i njohim si Dhiata e Vjetër. Ndërsa ju jepni mësim të njëjtat të vërteta të shenjta, Fryma e Shenjtë do t’i dëshmojë për vërtetësinë e tyre klasës suaj ashtu si bëri për Kleopan dhe shokun e tij.

Studimi i Dhiatës së Vjetër duhet të forcojë dëshmitë e anëtarëve të klasës për Shpëtimtarin dhe zotimin e tyre për të jetuar ungjillin e Tij. Kur udhëhiqen nga Shpirti në studimin e tyre, anëtarët e klasës duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë bashkë me Jobin: “Unë e di që Shpëtimtari im jeton dhe që në fund do të ngrihet mbi tokë” (Jobi 19:25).

---

## Mësimdhënia me Anë të Shpirtit

Kur përgatiteni për orën mësimore të Doktrinës së Ungjillit, është e rëndësishme që ju të kërkonti frymëzim dhe udhëheqje nga Shpirti i Zotit. “Dhe Shpirti do t’ju jepet me anë të lutjes së besimit”, tha Zoti, “dhe nëse nuk e merrni Shpirtin, ju s’duhet të jepni mësim” (DeB 42:14). Kujtoni që Fryma e Shenjtë është mësuesi në klasën tuaj.

Mënyra se si e kërkonti Shpirtin është nëpërmjet lutjes, agjërimit, studimit të përditshëm të shkrimeve të shenjta dhe bindjes ndaj urdhërimeve. Ndërsa përgatiteni për orën mësimore, lutuni që Shpirti t’ju ndihmojë të kuptoni shkrimet e shenjta dhe nevojat e anëtarëve të klasës. Shpirti mund t’ju ndihmojë

gjithashtu, të planifikoni mënyra kuptimplote për të diskutuar shkrimet e shenjta dhe për t'i zbatuar ato në jetën tonë tani (1 Nefi 19:23). Me ndihmën e Shpirtit, ju do të bëheni një mjet i efektshëm në duart e Zotit për t'ua mësuar fjalën e Tij fëmijëve të Tij.

Më poshtë jepen disa sugjerime se si ta ftoni Shpirtin në klasën tuaj:

1. Ftoni anëtarët e klasës të bëjnë lutje përpara dhe pas mësimit. Gjatë mësimit, lutuni në zemrën tuaj që Shpirti t'ju udhëheqë, të hapë zemrat e anëtarëve të klasës dhe t'u dëshmojë e t'i frymëzojë.
2. Përdorni shkrimet e shenjta (shih "Përqendrimi te Shkrimet e Shenjta" më poshtë).
3. Jepni dëshmi kurdoherë që Shpirti ju nxit, jo thjesht në fund të mësimit. Jepni dëshmi për Shpëtimtarin. Ftojini shpesh anëtarët e klasës që të japin dëshmitë e tyre.
4. Përdorni himne, këngë të Fillores dhe muzikë tjetër të shenjtë për të përgatitur zemrat e anëtarëve të klasës që të ndiejnë Shpirtin.
5. Shprehni dashuri për anëtarët e klasës, për të tjerët dhe për Atin Qiellor e Jezu Krishtin.
6. Tregoni ide, ndjenja dhe përvoja që lidhen me parimet në mësim. I ftoni anëtarët e klasës që të bëjnë të njëjtën gjë. Anëtarët e klasës mund të tregojnë gjithashtu se si i kanë zbatuar ose dhënë mësim ato që janë diskutuar në mësimet e mëparshme.

---

#### **Përqendrimi te Shkrimet e Shenjta**

Përgatitja për orën e mësimit të Doktrinës së Ungjillit kërkon studim të zellshëm e plot lutje të shkrimeve të shenjta. Zoti urdhëroi: "Mos kërko të shpallësh fjalën time, por së pari ta fitosh fjalën time". Ndërsa e fitoni fjalën e Tij nëpërmjet studimit të shkrimit të shenjtë, Zoti premton se "gjuha jote do të zgjidhet; atëherë, nëse dëshiron, ti do të kesh Shpirtin tim dhe fjalën time, po, fuqinë e Perëndisë për të bindur njerëzit" (DeB 11:21).

Ky manual është një mjet për t'ju ndihmuar që të jepni mësim shkrimet e shenjta. Nxitini anëtarët e klasës që t'i sjellin shkrimet e tyre të shenjta në klasë çdo javë. Referojuni fragmenteve nga Përkthimi i Biblës prej Jozef Smithit që përfshihen tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta.

Gjatë mësimit, mbajini diskutimet të përqendruara te shkrimet e shenjta. Jini të matur në përdorimin prej jush të shpjegimeve dhe burimeve të tjera të informacionit që nuk janë nga shkrimi i shenjtë. Anëtarëve të klasës duhet t'u jepet mësim që të kërkojnë dije dhe frymëzim nga shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme.

Çdo anëtar i të klasës duhet t'i jepet një kopje e *Old Testament Class Member Study Guide [Udhëzuesit Studimor për Anëtarin e Klasës së Dhiatës së Vjetër]* (34592). Ky libërth jep përmbledhje dhe pyetje që do t'i ndihmojnë anëtarët e klasës që t'i kuptojnë shkrimet e shenjta, të meditojnë mbi mënyrën se si t'i zbatojnë ato dhe të përgatiten për diskutim në klasë. Nxitini prindërit që ta përdorin udhëzuesin studimor në studimin familjar të shkrimit të shenjtë.

---

#### **Formati i Mësimit**

Ky manual është shkruar për orë mësimore të Doktrinës së Ungjillit për të rinj e të rritur dhe duhet të përdoret një herë në çdo katër vjet. Mësimet janë hartuar

që të përmbajnë më shumë informacion se sa ju ndoshta do të jeni në gjendje të jepni mësim në një orë mësimore. Kërkoni Shpirtin e Zotit në përzgjedhjen e rrëfimeve nga shkrimet, të pyetjeve e të aktiviteteve që plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës.

Secili mësim përfshin seksionet në vijim:

1. *Qëllimi.* Paraqitja e qëllimit ju siguron një ide kryesore ku të përqendroheni ndërsa përgatisni dhe zhvilloni mësimin.
2. *Përgatitja.* Pjesa e parë e këtij seksioni përmbledh rrëfimet nga shkrimi i shenjtë në skicën e mësimin. Disa mësim sugjerojnë lexim shtesë që do t'ju japë juve kuptueshmëri më të madhe. Në shumë mësim, ky seksion përfshin gjithashtu përgatitje të tjera të sugjeruara, të tilla si materiale që mund të dëshironi të sillni në klasë.
3. *Aktivitet vëmendjeje.* Ky seksion përbëhet nga një aktivitet i thjeshtë, mësim me objekt apo pyetje për të ndihmuar anëtarët e klasës që të përgatiten për të mësuar, për të marrë pjesë dhe për të ndier ndikimin e Shpirtit. Qoftë nëse përdorni një aktivitet vëmendjeje të manualit apo një aktivitet tuajin, është e rëndësishme të përqendroni vëmendjen e anëtarëve të klasës në fillim të mësimin. Aktiviteti duhet të jetë i shkurtër.
4. *Diskutimi dhe zbatimi i shkrimit të shenjtë.* Kjo është pjesa kryesore e mësimin. Studiojini me lutje rrëfimet e shkrimit të shenjtë që të mund t'i jepni mësim dhe t'i diskutoni me efektshmëri. Përdorni sugjerimet në "Ndihma për Mësimdhënien e Shkrimeve të Shenjta" (më poshtë) për të ndryshuar mënyrën se si jepni mësim dhe për të mbajtur interesin e anëtarëve të klasës.
5. *Përfundim.* Ky seksion ju ndihmon të përmbledhni mësimin dhe t'i nxisni anëtarët e klasës që t'i jetojnë parimet që keni diskutuar. Ai ju kujton gjithashtu që të jepni dëshmi. Sigurohuni që të lini kohë të mjaftueshme për ta përfunduar çdo mësim.
6. *Ide mësimdhënieje shtesë.* Ky seksion përfshin të vërteta të tjera nga rrëfimet e shkrimit të shenjtë, metoda alternative të mësimdhënies, aktivitete dhe sugjerime të tjera që i shtohen skicës së mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni disa prej këtyre ideve si pjesë të mësimin.

---

**Ndihma për  
Mësimdhënien e  
Shkrimeve të Shenjta**

Përdorni sugjerimet në vijim për t'i dhënë mësim rrëfimet nga shkrimi i shenjtë më me efektshmëri dhe me më shumë larmi:

1. Ndihmojini anëtarët e klasës që të kuptojnë se çfarë japin mësim shkrimet e shenjta mbi Jezun Krishtin, Jehovain e Dhiatës së Vjetër, lindja, misioni në vdekshmëri, Ardhja e Dytë dhe mbretërimi mijëvjeçar i të Cilit janë profetizuar në Dhiatën e Vjetër.
2. U kërkoni anëtarëve të klasës që të mendojnë dhe të flasin rreth mënyrave të veçanta se si një fragment nga shkrimi i shenjtë mund të zbatohet në jetën e tyre.
3. Përveç doktrinës, theksoni historitë në Dhiatën e Vjetër, veçanërisht historitë e besimit, duke siguruar që anëtarët e klasës t'i kuptojnë ato dhe të diskutojnë rreth mënyrave se si t'i zbatojnë ato.
4. I bëni anëtarët e klasës që të kërkojnë fjalë, fraza ose ide që përsëriten shpesh në një fragment shkrimi të shenjtë ose që kanë një domethënie të veçantë për ta.



5. Shkruani në dërrasë disa fraza, fjalë kyç ose pyetje që lidhen me rrëfimin nga shkrimi i shenjtë. Pastaj lexoni ose përmbledhni rrëfimin. Ndërsa anëtarët e klasës dëgjojnë frazat, fjalët kyç, ose u përgjigjen pyetjeve, ndaluni dhe diskutoni ato.
6. Gjatë gjithë Librit të Mormonit, fraza “dhe kështu ne shikojmë” përdoret për të paraqitur një përmbledhje të parimeve të dhëna mësim. Pasi të diskutoni për një fragment shkrimi të shenjtë, kërkoni anëtarëve të klasës që të përfundojnë fjalinë “dhe kështu ne shikojmë” me qëllim që të shpjegojnë parimin e ungjillit që po jepet mësim.
7. Kërkoni dhe diskutoni rreth simboleve që përdoren gjatë gjithë Dhiatës së Vjetër. Për shembull, nusja dhe Dhëndri përfaqësojnë Izraelin dhe Shpëtimtarin.
8. Vini re se si njerëzit ose ngjarjet në shkrimet e shenjta mund të krahasohen me njëri-tjetrin. Për shembull, ju mund të krahasoni Kainin me Abelin dhe Enokun (Moisiu 5–7); Davidin dhe Bath-Sheban (2 Samuelit 11) me Jozefin e Egjiptit dhe gruan e Potifarit (Zanafilla 39:7–13); ose profetin Elia me Mbretin e lig Ashab (1 Mbretërve 16:29–33; 17–19).
9. Drejtoni një teatër të lexuesve, duke i bërë anëtarët e klasës që të lexojnë fjalët e njerëzve të ndryshëm në shkrimet e shenjta.
10. Ndajeni klasën në dy ose më shumë grupe të vogla. Pasi të këqyrni një rrëfim shkrimi të shenjtë, bëjeni secilin grup që të shkruajë parimet e dhëna mësim në rrëfim. Pastaj vëri grupet të diskutojnë me radhë se si këto parime zbatohen në jetën e tyre.
11. Ftojini anëtarët e klasës që të sjellin nga një laps për të shenjuar vargje domethënëse [në shkrimet e tyre] ndërsa diskutoni për to.

---

### **Nxitja e Diskutimit në Klasë**

Ju normalisht nuk duhet të jepni leksione, por duhet të përpiqeni t’i ndihmoni anëtarët e klasës që të marrin pjesë në mënyrë kuptimplote në diskutimin e shkrimeve të shenjta. Ndërsa anëtarët e klasës marrin pjesë, ata mësojnë më me efektshmëri mbi shkrimet e shenjta dhe kuptojnë më mirë se si të zbatojnë parimet e ungjillit. Kërkoni udhëheqjen e Shpirtit për të vendosur se cilat pyetje të bëni, si t’i organizoni ato dhe se si t’i zhvilloni ato. Diskutimet në klasë duhet të përqendrohen te çështjet që i ndihmojnë anëtarët të vijnë te Krishti dhe të jetojnë si dishepuj të Tij. Ridrejtojini diskutimet që nuk i përmbushin këto qëllime.

Referencat e shkrimeve të shenjta jepen për t’ju ndihmuar ju dhe anëtarët e klasës që të gjejnë përgjigje për shumicën e pyetjeve në shkrimet e shenjta. Përgjigjet për disa pyetje do të vijnë nga përvojat e anëtarëve të klasës.

Zhvillimi i të gjithë materialit mësimor është më pak i rëndësishëm sesa ndihma ndaj anëtarëve të klasës që të kuptojnë më mirë shkrimet e shenjta dhe të zotohen për dishepullim në rritje. Nëse anëtarët e klasës po mësojnë nga një diskutim i mirë, shpesh është e dobishme ta lejoni atë të vazhdojë në vend që të përpiqeni ta trajtoni të gjithë materialin mësimor.

Përdorni orientimet e mëposhtme për të nxitur diskutimin e klasës:

1. Bëni një pyetje dhe pastaj jepni një referencë shkrimi të shenjtë që anëtarët e klasës të mund të gjejnë përgjigjen.

2. Bëni pyetje që kërkojnë mendim dhe diskutim, në vend të përgjigjeve “po” ose “jo”. Pyetjet që fillojnë me *përse, si, kush, çfarë, kur* dhe *ku* janë zakonisht më të efektshmet për të nxitur diskutim.
3. Nxitini anëtarët e klasës që të shprehin ndjenjat e tyre mbi atë që po mësojnë nga shkrimet e shenjta. Nxitini ata gjithashtu, që të ndajnë përvoja të cilat tregojnë se si parimet e shkrimit të shenjtë mund të zbatohen në jetë. Bëni komente pozitive për kontributin e tyre.
4. Jini të ndjeshëm ndaj nevojave të secilit anëtar të klasës. Edhe pse të gjithë anëtarët e klasës duhet të nxiten që të marrin pjesë në diskutimet e klasës, disa mund të ngurrojnë të përgjigjen. Ju mund të dëshironi që të flisni veçmas me ta për të mësuar se si ndihen lidhur me leximin me zë të lartë ose me pjesëmarrjen në klasë. Jini të kujdesshëm që të mos u drejtoheni anëtarëve të klasës që mund të vihen në siklet.
5. Nxitini anëtarët e klasës që të përgatiten për orën mësimore duke studiuar rrëfimin e caktuar nga shkrimi i shenjtë dhe *Old Testament Class Member Study Guide [Udhëzuesi Studimor për Anëtarin e Klasës së Dhiatës së Vjetër]* (34592). Ata do të jenë më shumë në gjendje që të marrin pjesë në diskutime nëse janë të përgatitur. Sugjeroni që anëtarët e klasës të diskutojnë për rrëfimet nga shkrimi i shenjtë dhe mësimet me familjet e tyre.



# “Kjo Është Vepra Ime dhe Lavdia Ime”

Mësimi

# 1

Moisiu 1

## Qëllimi

Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë se 1) ne jemi fëmijë të Perëndisë, 2) ne mund t’u rezistojmë tundimeve të Satanit dhe 3) vepra dhe lavdia e Perëndisë është të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta jonë e përjetshme.

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese nga Perla me Vlerë të Madhe:
  - a. Moisiu 1:1–11. Moisiu sheh Perëndinë dhe flet ballë për ballë me të. Moisiu mëson se ai është bir i Perëndisë në ngjashmërinë e të Vetëmlindurit të Atit. Vini re: Anëtarët e klasës duhet të kuptojnë se Jehovahi, jo Ati Qiellor, iu shfaq Moisiut në këtë vegim. Jehovahi ishte Jezu Krishti i jetës para lindjes dhe Perëndia i Dhiatës së Vjetër. Ai është një me Atin e Tij në qëllim dhe e përfaqëson Atë në fuqi dhe autoritet. Fjalët e Tij janë ato të Atit dhe, nganjëherë, ashtu si te Moisiu 1:6, Ai flet në vetë të parë për Atin.
  - b. Moisiu 1:12–23. Satani i del përballë Moisiut; Moisiu e përzë atë.
  - c. Moisiu 1:24–39. Perëndia shfaqet sërish dhe jep mësim për veprën dhe lavdinë e Tij.
2. Studiojeni mësimin dhe vendosni se si të jepni mësim rrëfimet nga shkrimi i shenjtë. Meqë do të jetë e vështirë të bëni çdo pyetje ose të trajtoni çdo pikë në mësim, me lutje përzgjidhni ato që do të plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës. Juve mund t’ju nevojitet t’i përshtasni disa pyetje që t’u shkojnë për shtat rrethanave të pjesëtarëve të klasës.
3. Siguroni një kopje të *Old Testament Class Member Study Guide [Udhëzuesit Studimor për Anëtarin e Klasës së Dhiatës së Vjetër]* (34592) për secilin person në klasën tuaj. (Lagjja duhet t’i ketë porositur këta udhëzues studimi si pjesë të porosisë së programit mësimor vjetor; një anëtar i peshkopatës duhet t’ia japë ato presidencës së Shkollës të së Dielës.)
4. Nëse do të përdorni aktivitetin e dytë të vëmendjes, siguroni një letër ose një qese cohe dhe vendosni në të disa artikuj nga jeta e përditshme, të tillë si një gur, një krehër dhe një laps.

## Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit Paraqitje e Dhiatës së Vjetër

Dhiata e Vjetër është një rrëfim i marrëdhënieve të Perëndisë me popullin e Tij të besëlidhur që nga koha e Krijimit deri në disa qindra vite përpara lindjes së Shpëtimtarit. Dhiata e Vjetër jep shembuj të fuqishëm të besnikërisë dhe bindjes. Ajo tregon gjithashtu pasojat e harrimit, mosbindjes ose kundërshtimit ndaj Perëndisë. Profecitë e saj japin dëshmi për lindjen e Mesias, sakrificën shëlbuese, ardhjen e dytë dhe mbretërimin mijëvjeçar.

Përveç Dhiatës së Vjetër, ky kurs përfshin librat e Moisiut dhe të Abrahamit nga Perla me Vlerë të Madhe. Këta libra japin shtesa dhe sqarime të rëndësishme për një pjesë të materialit në librin e Zanafillës. Libri i Moisiut është një pjesë e shkëputur nga Përkthimi i Biblës prej Jozef Smithit. Libri i Abrahamit është një përkthim që Profeti Jozef Smith e bëri nga një papirus egjiptian. Për informacion të mëtejshëm mbi Përkthimin e Biblës prej Jozef Smithit, shih “Përkthimi i Joseph

Smith-it", Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, faqe 149. Vini re gjithashtu se, pas Udhëzuesit për Shkrimet e Shenjta, përfshihen përzgjedhje nga Përkthimi prej Jozef Smithit.

**Aktivitet Vëmendjeje** Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.

1. Kërkojuni pjesëtarëve të klasës që të shohin te Moisiu 1:6, 20–22, 39 që të dallojnë të vërteta të rëndësishme që zbulohen. Përgjigjet mund të jenë të ndryshme. Shpjegoni se ky mësim do të përqendrohet te tri të vërteta që renditen te "Qëllimi" në faqen 1.
2. Zgjidhni dy anëtarë të klasës dhe dorëzoni atyre qesen që përmban disa artikuj nga jeta e përditshme (shih "Përgatitja", faqe 1). Thuajuni pjesëmarrësve se ata do të luajnë një lojë, por mos jepni udhëzime ose të shpjegoni synimin e lojës. Kërkojuni pjesëmarrësve të hapin qesen dhe të fillojnë të luajnë. Ata do të presin që përmbajtja e qeses të shpjegojë lojën. Megjithatë, përmbajtja nuk e jep këtë informacion dhe pjesëmarrësit do të vrasin mendjen se çfarë pritet që të bëjnë ata.

Vini në dukje se, që të kuptohet një lojë, ne duhet të kuptojmë synimin ose qëllimin e saj. Ngjashëm, për të kuptuar jetën tonë në tokë, ne duhet të kuptojmë synimin ose qëllimin e jetës sonë. Moisiu 1 na ndihmon ta kuptojmë këtë duke iu përgjigjur tri pyetjeve të rëndësishme:

Cilët jemi ne?

Si mund ta mposhtim ndikimin e kundërshtarit?

Cila është vepra dhe lavdia e Perëndisë?

**Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë**

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë. Në një kohë të përshtatshme gjatë mësimin, shpërndani *Old Testament Class Member Study Guide [Udhëzuesin Studimor për Anëtarin e Klasës së Dhiatës së Vjetër]* (34592) dhe nxitini anëtarët e klasës që ta përdorin atë për të ndihmuar studimin e tyre personal dhe familjar të shkrimit të shenjtë.

### **1. Perëndia jep mësim se Moisiu është një bir i Perëndisë.**

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 1:1–11.

- Çfarë mësoi Moisiu rreth Perëndisë nga përvoja e përshkruar te Moisiu 1:1–7? Çfarë mësoi Moisiu për veten? (Ju mund të dëshironi t'i bëni anëtarët e klasës që të shënojnë numrin e herëve që Perëndia i referohet Moisiut si "biri im" në këto vargje.)
- Çfarë do të thotë që Moisiu u krijua "në ngjashmërinë" e Shpëtimtarit? (Moisiu 1:6). Çfarë ndryshimi mund të sjellë në jetën tonë të dimë se jemi fëmijët e Perëndisë, krijuar në ngjashmërinë e Birit të Tij?

Plaku Dallin H. Oaks dha mësim: "Merrni parasysh fuqinë e idesë që jepet mësim në këngën tonë të dashur 'Fëmi i Per'ndis' Jam'. . . . Këtu është



përgjigja për një nga pyetjet e mëdha të jetës: ‘Kush jam unë?’ Unë jam një fëmijë i Perëndisë me prejardhje shpirtërore nga prindër qiellorë. Ajo prejardhje përcakton potencialin tonë të përjetshëm. Ajo ide e fuqishme është një mjet i fortë kundër depresionit. Ajo mund të forcojë secilin prej nesh që të bëjë zgjedhjet e drejta dhe të kërkojë më të mirën që është brenda nesh. Fut në mendjen e një . . . njeriu idenë e fuqishme se ai ose ajo është një fëmijë i Perëndisë dhe ti ke dhënë vetërespekt e motivim për të vepruar kundër problemeve të jetës” (në Conference Report, tetor 1995, f. 31; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 25).

- Duke e quajtur vazhdimisht Moisiun “biri im” dhe duke thënë se ai qe krijuar “në ngjashmërinë e të Vetëmlindurit tim”, Perëndia i dha besim në vetvete Moisiut dhe një kuptueshmëri për vlerën e tij. Si mundet që ndjekja e këtij parimi të na ndihmojë ne si prindër? Si mund të forcojë martesat? Si mund të forcojë miqësitë?

Sugjeroni se në një botë ku kritika dhe komentet negative e poshtëruese duket se mbizotërojnë, ne duhet të ndjekim shembullin e Zotit dhe të themi gjëra që i ndihmojnë të tjerët ta shohin veten si fëmijë të Perëndisë që kanë dinjtet dhe vlerë.

- Rëndësia dhe potenciali i përjetshëm i Moisiut theksohen te Moisiu 1:1–7. Megjithatë, pasi prania e Perëndisë u largua prej tij, Moisiu tha: “Tani, për këtë shkak, unë e di se njeriu është një hiç” (Moisiu 1:10). Në çfarë kuptimi të dy konceptet janë të vërteta? (Perëndia është pafundësisht më i mençur dhe më i fuqishëm se burrat e gratë e vdekshme. Ne jemi një hiç pa Të. Megjithatë, si fëmijët e Tij, ne kemi potencialin që të bëhemi si Ai.)

## 2. Satani i del përballë Moisiut; Moisiu e përzë atë.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 1:12–23.

- Çfarë i dha urdhër Satani Moisiut që të bënte kur erdhi? (Shih Moisiu 1:12.) Si mendoni ju, përse Satani e quajti Moisiun “biri i njeriut”? (Satani dëshironte që Moisiu të besonte se ai *nuk* ishte bir i Perëndisë.) Përse Satani dëshiron që ne të dyshojmë ose të shpërfillim se jemi fëmijë të Perëndisë? Si përpiqet ai që ta bëjë këtë?
- Si u përgjigj Moisiu kur Satani e quajti atë “biri i njeriut”? (Shih Moisiu 1:13.) Si mundet që një dëshmi e fuqishme se ne jemi bij e bija të Perëndisë të na ndihmojë që t’i rezistojmë tundimit?
- Sa herë i tha Moisiu Satanit që të largohej? (Shih Moisiu 1:16, 18, 20, 21.) Çfarë na mëson kjo mbi rezistencën ndaj përpjekjeve të Satanit?
- Si mori forcë Moisiu për t’u rezistuar tundimeve të Satanit? (Shih Moisiu 1:18, 20–21.) Si e largoi Moisiu Satanin? Si mund të na forcojë lutja që t’i rezistojmë tundimit? Çfarë mund të bëjmë tjetër që të marrim këtë fuqi?

## 3. Perëndia shfaqet sërish dhe jep mësim për veprën dhe lavdinë e Tij.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 1:24–39.

- Pasi Satani u largua, Moisiu vuri re sërish lavdinë e Perëndisë dhe iu tregua një vegim tjetër i tokës dhe i banorëve të saj (Moisiu 1:24–28). Cilat ishin dy pyetjet që bëri Moisiu kur iu tregua ky vegim? (Shih Moisiu 1:30.) Çfarë përgjigjesh dha Perëndia? (Shih Moisiu 1:31–32, 39.)

- Edhe pse Perëndia ka krijuar botë dhe njerëz që janë të panumërueshme për ne, Ai e siguroi Moisiun se i njeh të gjithë (Moisiu 1:35). Si keni arritur të ndieni se Ati Qiellor dhe Jezu Krishti ju njohin ju personalisht dhe ju duan? (Ju mund të dëshironi të jepni dëshmi të një kohe kur keni ndier dashurinë dhe shqetësimin e Tyre për ju.)
- Vepra dhe lavdia e Perëndisë është “të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Çfarë është pavdekësia? Kush do ta marrë pavdekësinë? Çfarë është jeta e përjetshme? Kush do ta marrë jetën e përjetshme?

Plaku Xhejms E. Faust tha: “Ka një dallim midis pavdekësisë, ose ekzistencës së përjetshme, dhe jetës së përjetshme, që është të kesh një vend në prani të Perëndisë. Nëpërmjet hirit të Jezu Krishtit, pavdekësia vjen për të gjithë . . . të drejtë ose të padrejtë, të mirë ose të këqinj. Megjithatë, jeta e përjetshme është ‘më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë’ (DeB 14:7). Ne e marrim këtë dhuratë të madhe, sipas Zotit, ‘nëse i zbatojmë urdhërimet e [Tij] e durojmë deri në fund’. Nëse durojmë kështu, premtimi është ‘ti do të kesh jetë të përjetshme’ (DeB 14:7)” (në Conference Report, tetor 1988, f. 14; ose *Ensign*, nëntor 1988, f. 12).

- Pse është e rëndësishme që ne të dimë se çfarë është vepra dhe lavdia e Perëndisë? Cilat janë disa mënyra të veçanta se si mund ta ndihmojmë Atë në këtë veper të madhe?

Presidenti Gordon B. Hinkli ka thënë: “Ne jemi këtu për ta ndihmuar Atin tonë në veprën e Tij e lavdinë e Tij, që ‘të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut’ (Moisiu 1:39). Detyrimi juaj është po aq serioz në fushën tuaj të përgjegjësisë sa është detyrimi im në fushën time. Asnjë thirrje në këtë kishë nuk ka pasoja të vogla ose të pakta. Të gjithë ne, në përpjekje për të përmbushur detyrën tonë, prekim jetën e të tjerëve. Të gjithëve ne, në përgjegjësitë tona përkatëse, Zoti na ka thënë: . . . ‘Dhe duke i bërë këto gjëra, ti do t’u bësh të mirën më të madhe bashkëqenieve të tua dhe do të nxisësh lavdinë e atij që është Zoti yt’ (DeB 81:4)” (në Conference Report, prill 1995, f. 94; ose *Ensign*, maj 1995, f. 71; shih edhe DeB 81:5–6).

## Përfundim

Moisiu 1 jep mësim doktrinën e fuqishme se ne jemi bij e bija të Perëndisë. I ftoni anëtarët e klasës që të meditojnë mbi domethënien e kësaj të vërtete. Dëshmoni se Ati ynë Qiellor e njeh dhe e do secilin prej nesh. Nxitini anëtarët e klasës që t’u shprehin familjeve ndjenjat e tyre mbi atë që kanë mësuar nga Moisiu 1.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. “Moisiu u la vetëm” (Moisiu 1:9)

- Mund të ketë kohë kur ne “[lihem] vetëm” ashtu si u la Moisiu – kohë kur nuk e ndiejmë fuqishëm Shpirtin ose kur kemi shumë sprova. Çfarë mund të mësojmë nga Moisiu 1 që të na ndihmojë të përballojmë këto kohë? (Përgjigjet mund të përfshijnë: Vështirësi të tilla mund të mos jenë në saje të ndonjë keq-bërjeje nga ana jonë; Perëndia nuk na braktis plotësisht, siç tregohet në vargun 15; dhe shpesh ne marrim forcë të madhe nga përballimi i sfidave tona, duke iu drejtuar Perëndisë dhe duke rritur besimin tonë.)

## 2. Të gjithë jemi fëmijë të Perëndisë

- Moisiu mori vegimin që është shënuar te Moisiu 1 përpara se të udhëhiqte fëmijët e Izraelit për të dalë nga Egjipti. Si mendoni ju se e ndihmoi ky vegim atë në këtë përpjekje, veçanërisht kur u shkurajua nga rebelimi i vazhdueshëm dhe mungesa e besimit të popullit. Si mund ta ndihmojë një mësues ose një udhëheqës dija se të gjithë jemi fëmijë të Perëndisë? Si mund të na ndihmojë kjo dije në marrëdhëniet me pjesëtarët e familjes, miqtë dhe të tjerët?

## 3. Përkthimi i Biblës prej Jozef Smithit

Nëse është e disponueshme *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224), ju mund të dëshironi të shfaqni “The Power of the Joseph Smith Translation” [“Fuqia e Përkthimit prej Jozef Smithit], një segment pesëminutësh, si pjesë të mësimit. Kujtojini anëtarët e klasës se libri i Moisiut është një pjesë e shkëputur nga Përkthimi i Biblës prej Jozef Smithit.

# “Ti u Zgjodhe Përpara se të Lindeshe”

Abraham 3; Moisiu 4:1–4

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë doktrinën e parachugurimit dhe përgjegjësinë e tyre vetjake për të ndihmuar që të ndërtohet mbretëria e Perëndisë dhe për të sjellë shpirta te Krishti.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese nga Perla me Vlerë të Madhe dhe Doktrina e Besëlidhjet:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Abraham 3:11–12, 22–23; Doktrina e Besëlidhje 138:53–57. Abrahami flet ballë për ballë me Zotin dhe mëson se në jetën para lindjes shumë shpirta “fisnikë dhe të mëdhenj” u parachuguruan për misionet e tyre në vdekshmëri (Abraham 3:11–12, 22–23). Presidenti Jozef F. Smith mëson më shumë mbi “at[a] fisnikë dhe të mëdhenj” në një vegim të vizitës së Shpëtimtarit në botën e shpirtave përpara Ringjalljes së Tij (DeB 138:53–57).</li> <li>b. Abraham 3:24–28; Moisiu 4:1–4. Abrahamit dhe Moisiut iu tregua në vegim se Jezu Krishti ishte zgjedhur në Këshillin në Qiell që të ishte Shpëtimtari ynë dhe se ne zgjodhëm ta ndiqnim Atë. Atyre iu tregua gjithashtu se Luciferi (Satani) dhe shpirtat që e ndoqën atë, u flakën nga qielli.</li> </ol> </li> <li>2. Lexim shtesë: Isaia 14:12–15; Zbulesa 12:7–9; Alma 13:3–5; Doktrina e Besëlidhje 29:36–39; dhe pjesa tjetër e Abrahamit 3 dhe e Doktrinës e Besëlidhjeve 138.</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b> Aktivitet Vëmendjeje	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vinë në dukje se shkrimet e shenjta bëhen më kuptimplote për ne kur i zbatojmë mësimet e tyre në jetën tonë. Për ta bërë këtë, shpesh ne duhet ta vëm veten në vendin e profetëve të lashtë dhe të pasuesve të tyre. Megjithatë, tek Abrahami 3:22–28 neve nuk na duhet ta vëm veten në vendin e dikujt tjetër, sepse këto vargje janë mbi ngjarje të rëndësishme në të cilat ne morëm pjesë. Këto ngjarje ndodhën gjatë jetës sonë para lindjes.</li> <li>2. Vizatoni 11 vende bosh në dërrasë për të përfaqësuar 11 germa në fjalën <i>parashugurim</i>. Shpjegoni se fjala e përfaqësuar nga këto vende bosh lidhet me jetën para lindjes.             <p>Jepuni anëtarëve të klasës 11 mundësi që të gjejnë se cilat germa formojnë fjalën. Kur ata të gjejnë një germë të saktë, shkruajeni atë në vendin ose vendet përkatëse. Kur ata të gjejnë një germë që nuk përdoret në fjalë, shkruajeni atë diku tjetër në dërrasë që të parandaloni pandehma të përsëritura.</p> <p>Kur anëtarët e klasës të kenë plotësuar të gjitha vendet bosh ose ta kenë gjetur fjalën, ndihmojini ata të përkufizojnë kuptimin e saj. (Parashugurimi është shugurimi nga Perëndia në jetën para lindjes i fëmijëve të Tij shpirtërorë për të përmbushur misione të caktuara gjatë jetës së tyre në vdekshmëri.) Shpjegoni se ky mësim është mbi jetën para lindjes, kur shumë shpirta u parachuguruan për të bërë gjëra të rëndësishme për Atin Qiellor.</p> </li> </ol>

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Abrahami mëson se në jetën para lindjes shumë shpirta u parashuguruan për misionet e tyre në vdekshmëri.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Abraham 3:11–12, 22–23 dhe Doktrina e Besëlidhje 138:53–57.

- Në vegimin e shënuar tek Abrahami 3, Zoti i tregoi Abrahamit Këshillin në Qiell që u mbajt përpara se të krijohet toka. (Vini re se profetët e ditëve të mëvonshme kanë treguar se Këshilli në Qiell që një seri mbledhjesh në vend të një mbledhjeje të vetme.) Kush që i pranishëm në këtë këshill? (Ati Qiellor dhe fëmijët e Tij shpirtërorë.) Çfarë mësojmë rreth këtij këshilli nga Abrahami 3:22–23?
- Cilët janë “fisnikë[t] dhe të mëdhenj[të]” e përshkruar tek Abrahami 3:22–23? (Profetët dhe udhëheqës të tjerë të Kishës.) Shpjegoni se në vitin 1918, Presidenti Jozef F. Smith pa “fisnikë[t] dhe të mëdhenj[të]” në një vegim të botës së shpirtave. Cilët pa Presidenti Smith? (Shih DeB 138:53; shih edhe idenë e dytë për mësimdhënie shtesë.)
- Çfarë do të thotë se Abrahami “u zgjodh përpara se të linde[j]”? (Shih Abraham 3:23. Ai u parashugurua që të ishte profet.) Çfarë do të thotë të jesh i parashuguruar? (Shih përkufizimin në aktivitetin e dytë të vëmendjes.) Për çfarë u parashuguruan që të bënin njerëzit e përmendur te Doktrina e Besëlidhjet 138:53? (Shih DeB 138:53–56.)
- A garantoj parashugurimi se Abrahami, Jozef Smithi dhe të tjerët do të bëheshin profetë? Cila është marrëdhënia midis parashugurimit dhe lirisë së zgjedhjes? (Edhe pse një njeri parashugurohet në një thirrje, ajo thirrje varet nga denjësia e njeriut dhe gatishmëria për ta pranuar atë.)
- Përveç parashugurimit të profetëve në thirrjet e tyre, Perëndia parashuguroi shumë “të tjerë shpirta të zgjedhur” që të ndihmojnë për ndërtimin e mbretërisë së Tij në mënyra të ndryshme. Për çfarë mund të jemi parashuguruar ne që të bëjmë? (Shih DeB 138:56.)

Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim:

“Perëndia ju ka mbajtur në stolin e rezervave për t’ju shfaqur në ditët e fundit përpara ardhjes së dytë të Zotit. Disa njerëz do të largohen nga Kisha; por mbretëria e Perëndisë do të mbetet e pacënuar për të mirëpritur kthimin e kreut të saj – madje Jezu Krishtit. Ndërsa brezi ynë do të jetë i krahasueshëm në ligësi me ditët e Noeut, kur Zoti e pastroi tokën me anë të përmbytjes, ka një ndryshim të madh këtë herë. Ai është që Perëndia i ka ruajtur për pjesën e fundit disa prej bijve të Tij më të fuqishëm, që do të ndihmojnë për ta mbartur triumfalisht mbretërinë. . . .

. . . Mos u gaboni për këtë – ju jeni një brez i shënuar. Asnjëherë nuk është pritur më shumë prej besnikëve në një periudhë kaq të shkurtër kohe sa ç’pritur prej nesh” (*The Teachings of Ezra Taft Benson* [1988], f. 104–105).

- Si mund të jemi të sigurt se po i përmbushim thirrjet tona të parashuguruara? (Përgjigjet mund të përfshijnë duke jetuar ungjillin, duke studiuar bekimet tona patriarkale dhe duke kërkuar zbuluesë personale. Kujtoni anëtarët e klasës



se, që të përmbushim këto thirrje, ne duhet të jemi të gatshëm dhe të denjë. (Shih edhe DeB 58:27–28.)

## 2. Jezu Krishti u zgjodh në Këshillin në Qiell që të jetë Shpëtimtari ynë; ne zgjodhëm ta ndjekim Atë. Luciferi (Satani) dhe shpirtrat që e ndoqën atë, u flakën nga qielli.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Abraham 3:24–28 dhe Moisiu 4:1–4.

- Shpjegoni se në Këshillin në Qiell, Ati Qiellor paraqiti planin e Tij të shpëtimit dhe zgjodhi një Shpëtimtar për ne. Cilët qenë dy shpirtrat që u ofruan të jenë Shpëtimtari ynë? (Shih Abraham 3:27; Moisiu 4:1–2.) Si ndryshonin ofertat e tyre? (Jezusi donte të ndiqte planin e Atit Qiellor dhe t’ia jepte Atij lavdinë. Luciferi donte të ndiqte planin e vet dhe ta merrte lavdinë për vete.) Përse Ati Qiellor zgjodhi Jezu Krishtin që të jetë Shëlbuesi ynë? (Shih Moisiu 4:2–3.)
- Cilin zgjodhëm të ndjekim ne në Këshillin në Qiell? Si e dimë ne se zgjodhëm të ndiqnim Jezu Krishtin? (Ne jemi lindur në tokë për të marrë trupa fizikë.)
- Çfarë duan të thonë termat *gjendje e parë* dhe *gjendje e dytë* tek Abrahami 3:26? (*Gjendja e parë* i referohet jetës para lindjes dhe *gjendja e dytë* i referohet jetës sonë tokësore. Ne e ruajtëm gjendjen tonë të parë duke zgjedhur të ndjekim Jezu Krishtin në vend të Luciferit.) Çfarë bekimi morëm secili prej nesh sepse e ruajtëm gjendjen tonë të parë? (Mundësinë që të lindemi në tokë.) Çfarë bekimi do të marrim nëse e ruajmë gjendjen tonë të dytë? (Shih Abraham 3:26.) Si mund ta ruajmë gjendjen tonë të dytë?
- Çfarë i ndodhi Luciferit (Satanit) dhe atyre që zgjodhën ta ndjekin atë? (Ata u flakën nga qielli dhe iu mohua mundësia që të kenë trupa fizikë. Shih Moisiu 4:3; Abraham 3:28; Zbulesa 12:7–9; DeB 29:36–37.)
- Çfarë po bëjnë tani Satani dhe pasuesit e tij? (Ata ende po përpiqen të shkatërronjë lirinë tonë të zgjedhjes. Ata janë në tokë sot si shpirtra të ligj që na tundojnë të mëkatojmë. Shih Moisiu 4:4.) Cilat janë disa mënyra se si Satani dhe pasuesit e tij përpiqen të kufizojnë ose shkatërrojnë lirinë tonë të zgjedhjes? Çfarë mund të bëjmë ne që t’i dallojmë dhe t’u rezistojmë përpjekjeve të tyre?
- Si ju ndihmon kur e dini që zgjodhët të ndiqni Jezu Krishtin në Këshillin në Qiell? Nxitini anëtarët e klasës që të vazhdojnë të marrin vendime që ta ndjekin Krishtin, ashtu siç bënë në ekzistencën para lindjes.

### Përfundim

Jepni dëshmi për Jezu Krishtin dhe rolin e Tij si Shpëtimtari ynë i parashuguar. Shprehni mirëbesimin tuaj tek aftësia e anëtarëve të klasës për të përmbushur misionet e tyre të parashuguruara për të ndihmuar në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.

### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

#### 1. “Dhe ne do t’i provojmë me këtë”

- Abraham 3:24–25 përcakton një nga qëllimet kryesore për të cilat Jezu Krishti, nën drejtimin e Atit Qiellor, krijoi tokën. Përse u krijua toka? Si ju ndihmon të dini që zgjodhët të vini në tokë duke e ditur se do të provoheshit këtu?

## 2. “Të mëdhenjtë dhe të fuqishmit”

- Në vegimin e tij të shënuar te Doktrina e Besëlidhje 138, Presidenti Jozef F. Smith pa gjithashtu disa prej “të mëdhenjve dhe të fuqishmëve” që kishin lindur në tokë përpara se të lindej Krishti. Cilët pa Presidenti Smith? (Shih DeB 138:38–49. Ju mund të dëshironi t’i rendisni këta emra në dërrasë. Vini në dukje se anëtarët e klasës do të mësojnë mbi shumicën e këtyre personave gjatë vitit të ardhshëm në Shkollën e së Dielës.)

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të ndiejnë mirënjohje që Perëndia i krijoi të gjitha gjërat për dobinë tonë dhe që ne jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Tij.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese nga Perla me Vlerë të Madhe:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Moisiu 1:27–42. Moisiu sheh një vegim të krijimeve të Perëndisë dhe urdhërohet të shkruajë një rrëfim të krijimit të tokës.</li> <li>b. Moisiu 2:1–25; 3:1–14. Moisiu mëson se Perëndia është krijuesi i të gjitha gjërave.</li> <li>c. Moisiu 2:26–31; 3:7, 15–25. Moisiu mëson se burrat dhe gratë janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.</li> </ol> </li> <li>2. Lexim shtesë: Abraham 4–5; Zanafilla 1–2.</li> <li>3. Nëse përdorni aktivitetin e dytë të vëmendjes, sillni plastelinë ose shkumës.</li> <li>4. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi të përdorni disa prej tyre si pjesë të mësimit:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. “Sipas Shëmbëlltyrës së Perëndisë”, një fragment treminutësh nga <i>Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]</i> (53224).</li> <li>b. Figura Krijimi – Qeniet e Gjalla (62483; Paketa e Figurave Artistike të Ungjillit 100).</li> </ol> </li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b> Aktivitet Vëmendjeje	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kërkojuni anëtarëve të klasës që të marrin parasysh se sa informacion do të jepnin nëse do të përpiqeshin t’i përgjigjeshin njëres prej pyetjeve vijuese për një fëmijë të moshës parashkollore: Si qëndron në ajër një aeroplan? Si funksionon një aparat televizori? Si rriten bimët? Shumica prej nesh do të merrnin parasysh kuptueshmërinë e një fëmije të moshës parashkollore dhe do të jepnin vetëm koncepte të përgjithshme, duke i lënë hollësitë derisa fëmija të bëhet më i pjekur.             <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si ngjajnë këta shembuj me zbulesat e Zotit mbi Krijimin? (Zoti ka zbuluar vetëm atë pjesë të së vërtetës së përvetshme që mendjet tona të vdekshme mund të kuptojnë dhe që na duhet të dimë për të arritur shpëtimin.)</li> </ul> <p>Ky mësim do të diskutojë të vërtetat që Zoti ka zbuluar rreth Krijimit.</p> </li> <li>2. Kërkojini një pjesëtar të klasës që të dalë vullnetar për të bërë ose vizatuar një kafshë të vogël duke përdorur plastelinë ose shkumës (lini vetëm një ose dy minuta). Pastaj diskutoni për faktin që, ndërsa ne mund të krijojmë modelin e një gjëje të gjallë, vetëm Perëndia mund të krijojë jetën. Ky mësim do të diskutojë mrekullinë e madhe të krijimit prej Perëndisë të tokës dhe të gjithçkaje që jeton në të.</li> </ol>

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Moisiu sheh një vegim të krijimeve të Perëndisë.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 1:27–42.

- Cili e shkroi rrëfimin e Krijimit të Zanafilla? (Shih Moisiu 1:40; 2:1.) Përse e shkroi Moisiu këtë rrëfim? (Shih Moisiu 1:40–41.) Çfarë mund të mësojmë nga Moisiu 1:27–39 rreth fuqisë së Perëndisë? Çfarë mund të mësojmë rreth dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij?
- Si ndryshojnë nga njëri-tjetri rrëfimet e Krijimit që gjenden te Zanafilla, Moisiu dhe Abrahami? (Abrahami dhe Moisiu panë në vegim organizimin e kësaj toke dhe pastaj i shënuan vegimet e tyre. Secili përfshiu hollësi paksa të ndryshme. Rrëfimi të Zanafilla fillimisht u shkrua nga Moisiu, por një pjesë e plotësisë së rrëfimit të tij humbi. Kjo plotësi rivendoset te libri i Moisiut.)

### 2. Moisiu mëson se Perëndia i krijoi të gjitha gjërat.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 2:1–25; 3:1–14.

- Kush e krijoi tokën? (Shih Moisiu 1:32; 2:1; shih edhe Gjoni 1:1–3, :14; Hebrejve 1:1–2; Mosia 3:8; DeB 14:9.) Përse është e rëndësishme që ne ta dimë se cili është Krijuesi?
- Çfarë ka zbuluar Perëndia rreth qëllimit të Krijimit? (Shih Moisiu 1:39; Abraham 3:24–25; shih edhe 1 Nefi 17:36; 2 Nefi 2:11–15. Qëllimi i Krijimit është të sigurojë një vend ku fëmijët shpirtërorë të Atit Qiellor të mund të marrin një trup fizik dhe të testohen apo të provohen për të parë nëse ata do t'i binden Atij kur të jenë larg pranisë së Tij. Ata që janë besnikë, do të marrin jetë të përjetshme. Ju mund të dëshironi të vini në dukje që, edhe pse një rrëfim i Krijimit është i përfshirë në librin e Zanafillës, qëllimet dhe rëndësia e Krijimit shpjegohen vetëm në zbulesën e ditëve të mëvonshme.)
- Në çfarë mënyrash jeta në tokë na përgatit për jetën e përjetshme? (Përgjigjet mund të përfshijnë: Ne marrim trupa fizikë, mësojmë të përdorim lirinë tonë të zgjedhjes, fitojmë njohuri, kemi familje, marrim ordianca dhe bëjmë besëlidhje.)
- Çfarë tha Perëndia mbi rezultatet e Krijimit? (Shih Moisiu 2:4, 10, 12, 18, 21, 25, 31; 3:2. Tetë herë në rrëfimin e shkurtër të Krijimit, Perëndia deklaroi se vepra e Tij ishte e mirë.) Cilat prej krijimeve të Perëndisë janë veçanërisht të bukura për ju? Përse do të kishim dobi duke vënë re bukuritë e krijimit më me kujdes çdo ditë?
- A u krijua toka nga hiçi? (Shih Abraham 3:24; 4:1.)

Profeti Jozef Smith tha: “Fjala krijoi ka ardhur nga fjala [hebreje] *baurau* që nuk do të thotë të krijosh nga hiçi; ajo do të thotë të organizosh; njëlloj si një njeri do të organizonte materialet dhe do të ndërtonte një anije. Kështu që, ne nxjerrim përfundimin se Perëndia kishte materiale për ta organizuar botën nga kaosi – lënda kaotike” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përzgj. Joseph Fielding Smith [1976], f. 350–351).

- Në ç'mënyrë rrëfimi i Krijimit ndikon te ndjenjat tuaja ndaj Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit? Në ç'mënyrë krijimet "japin dëshmi" për Perëndinë? (Shih Moisiu 6:63; Alma 30:44.) Si mund të tregojmë ne mirënjohje për dhuratën e Krijimit?

### 3. Moisiu mëson se burrat dhe gratë janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 2:26–31; 3:7, 15–25.

- Sipas shëmbëlltyrës së kujt jemi krijuar ne? (Shih Moisiu 2:26–27.)  
Presidenca e Parë ka thënë: "Të gjithë burrat e gratë janë në ngjashmërinë e Atit dhe Nënës universale dhe janë me kuptimin e vërtetë të fjalës bij e bija të Hyjnisë" ("The Origin of Man", *Improvement Era*, nëntor 1909, f. 78).
- Si e bekon jetën tonë dija se jemi krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë? Si duhet t'i ndikojë kjo marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë?
- Çfarë na mësojnë fjalët e Enokut te Moisiu 7:30 rreth kujdesit të veçantë të Perëndisë për secilin prej nesh? Çfarë na mësojnë ato rreth Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit?
- Si mendoni ju, çfarë donte të thoshte Zoti kur na tha të kemi sundim mbi krijimet e Tij në këtë tokë? (Shih Moisiu 2:26. Ne duhet të respektojmë tokën dhe të kujdesemi për krijimet e Perëndisë.) Si mund ta përmbushim më mirë përgjegjësinë tonë për të pasur sundim mbi krijimet?

Përfundim

Jepni dëshmi për të vërtetën e parimeve që keni dhënë mësim. Ftojini anëtarët e klasës që të ndajnë ndjenjat e tyre rreth Krijimit.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësim. Ju mund të dëshironi ta përdorni atë si pjesë të mësim.

#### Kohëzgjatja e Krijimit

Gjatësia e kohës e kërkuar për Krijimin nuk dihet. Termi *ditë* në rrëfimin e shkriimit të shenjtë për Krijimin nuk përfaqëson një periudhë 24-orëshe. Fjala hebreje *yom* mund të përkthehet si "ditë", "kohë", ose "periudhë". Apostulli Pjetër tha se "për Zotin një ditë është si një mijë vjet" (2 Pjetrit 3:8; shih edhe Abraham 3:4).



# “Për Shkak të Shkeljes Sime Sytë e Mi u Hapën”

Mësimi

## 4

Moisiu 4; 5:1–15; 6:48–62

---

**Qëllimi** Të ndihmojë secilin anëtar të klasës që ta kuptojë se Rënia ishte një pjesë e domosdoshme e planit të Atit Qiellor për ne.

---

**Përgatitja**


1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Moisiu 4; 5:10–11; 6:48–49, 55–56. Satani vjen në Kopshtin e Edenit dhe kërkon të mashtrojë Evën. Eva dhe Adami hëngrën nga fruti i pemës së njohjes të së mirës dhe së ligës (4:5–12). Meqë ranë, Adami dhe Eva u flakën nga kopshti (4:13–31). Adami dhe Eva më vonë gëzohen në bekimet e Rënies (5:10–11). Enoku jep mësim mbi pasojat e Rënies (6:48–49, 55–56).
  - b. Moisiu 5:14–15; 6:50–54, 57–62. Për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, të vdekshmit shpëtohen nga vdekja fizike nëpërmjet Ringjalljes dhe mund të shpëtohen prej vdekjes shpirtërore nëpërmjet besimit, pendimit, pagëzimit, dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe bindjes ndaj urdhërimeve.
  - c. Moisiu 5:1–9, 12. Adami dhe Eva fillojnë jetën si të vdekshëm. Ata kanë fëmijë dhe u mësojnë atyre të vërtetat që kanë mësuar (5:1–4, 12). Adami ofron flijime në ngjashmëri me flijimin e të Vetëmlindurit (Moisiu 5:5–9).
2. Lexim shtesë: Zanafilla 2–3; 1 Korintasve 15:20–22; 2 Nefi 2:5–30; 9:3–10; Helamani 14:15–18; Doktrina e Besëlidhje 19:15–19; 29:34–44; Nenet e Besimit 1:2; “Rënie e Adamit dhe e Evës”, Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, faqe 160.
3. Ju mund të dëshironi t’i kërkoni një anëtar të klasës që të përgatitet të përmbledhë rrëfimin e Rënies së Adamit dhe Evës (Moisiu 4:6–31) dhe një anëtar tjetër të klasës që të përgatitet të përmbledhë rrëfimin e Adamit që ofron flijime (Moisiu 5:5–9).
4. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi t’i përdorni ato si pjesë të mësimin:
  - a. “Rënia”, një fragment gjashtëminutësh nga *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224).
  - b. Figura Adami dhe Eva (62461; Paketa e Figurave Artistike të Ungjillit 101).

---

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje** Vizatoni në dërrasë ilustrimin në faqen 14. Thuajuni anëtarëve të klasës se Plaku Brus R. Mek-Konki tha se shpëtimi ynë është bërë i mundur për shkak të “tre ngjarjeve hyjnore – tri shtyllat e përjetësisë” (*A New Witness for the Articles of Faith* [1985], f. 81). Pastaj bëni pyetjen e mëposhtme:

- Cilat janë disa ngjarje që janë mjaft të rëndësishme sa të jenë “shtyllat e përjetësisë” që bëjnë të mundur shpëtimin? (Plaku Mek-Konki tha se këto shtylla janë Krijimi, Rënia dhe Shlyerja, të cilat janë të gjitha pjesë e planit të Perëndisë për shpëtimin tonë. Shkruani fjalët *Krijimi, Rënia* dhe *Shlyerja* në tri shtyllat në dërrasë.)



Shpjegoni se ky mësim na ndihmon të kuptojmë se si Rënia ishte një pjesë e domosdoshme e planit të Atit Qiellor për të bërë që të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme (Moisiu 1:39).

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Rënia e Adamit dhe e Evës dhe pasojat e saj mbi ta dhe mbi ne

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 4; 5:10–11; 6:48–49, 55–56.

Në Kopshtin e Edenit, Perëndia i urdhëroi Adamin dhe Evën që “të [ishin] të frytshëm dhe [të shumëzoheshin] e [të mbushnin] tokën” (Moisiu 2:28). Ai i urdhëroi ata gjithashtu, që të mos hanin frutin e pemës së njohjes të së mirës dhe të së ligës (Moisiu 3:17). Për sa kohë nuk do të hanin nga fruti i ndaluar, ata do të mbeteshin në kopsht dhe nuk do të vdisnin. Por ata gjithashtu, nuk do të ishin në gjendje t’i bindeshin urdhërimit për t’u shumuar (Moisiu 5:11; 2 Nefi 2:23). Ati Qiellor u dha atyre lirinë e zgjedhjes për të zgjedhur midis dy urdhërimeve.

Rishikoni shkurtimisht rrëfimin e Rënies së Adamit dhe Evës nga Moisiu 4:6–31, ose vini anëtarin e caktuar të klasës që ta bëjë këtë.

- Cilat ishin rezultatet e Rënies për Adamin dhe Evën – dhe për ne? (Shih Moisiu 4:22–29; 5:10–11; 6:48–49, 55–56; 2 Nefi 2:22–23; 9:6; Zanafilla 3:16–23.) Ju mund të dëshironi t’i rendisni disa nga këto rezultate në dërrasë. Vini në dukje se shumë prej këtyre të vërtetave mbi Rënien janë rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith dhe nuk njihen gjerësisht në botë.
  - a. Adami dhe Eva qenë në gjendje që të kishin fëmijë, gjë që na lejoi ne të vijmë në tokë e të marrim trupa të vdekshëm (Moisiu 5:11; 6:48; 2 Nefi 2:23, 25).
  - b. Ne provojmë vdekjen fizike, ose ndarjen e trupit fizik nga shpirti (Moisiu 4:25; 6:48; 2 Nefi 9:6).
  - c. Ne provojmë vdekjen shpirtërore, ose ndarjen nga prania e Perëndisë (Moisiu 4:29; 6:49; 2 Nefi 9:6).
  - ç. Ne jemi pjesëmarrës të mjerimit dhe të dëshpërimit (Moisiu 6:48; Zanafilla 3:16–17).
  - d. Ne jemi të aftë për të mëkatuar (Moisiu 6:49, 55; 2 Nefi 2:22–23).

- dh. Toka mallkohet, duke bërë që ne të na nevojitet të punojmë (Moisiu 4:23–25; Zanafilla 3:17–19).
- e. Ne mund të mësojmë të dallojmë të mirën dhe të keqen (Moisiu 4:28; 6:55–56; 2 Nefi 2:23; Zanafilla 3:22).
- ë. Ne mund të kemi gëzim në vdekshmëri (Moisiu 5:10; 2 Nefi 2:23, 25).
- f. Ne mund të njohim gëzimin e shëlbimit tonë (Moisiu 5:11).
- g. Ne mund të marrim jetë të përjetshme (Moisiu 5:11).

Ndërsa diskutoni për këto pasoja të Rënies, theksoni se si Rënia është e dobishme për ne. Zbulesa e ditëve të mëvonshme sqaron se edhe përpara Krijimit, Ati Qiellor kishte si qëllim që jeta jonë në tokë të ishte një kohë testimi e prove, që ne të mund të bëheshim më shumë si Ai (Abraham 3:24–26). Kjo kërkonte që ne të jemi të vdekshëm, të aftë të mësojmë të zgjedhim midis të mirës dhe të keqes, gjë që u bë e mundur nëpërmjet Rënies.

- Si mund të na ndihmojë një kuptueshmëri e saktë e Rënies gjatë vdekshmërisë?
- Përse është e rëndësishme të kuptojmë se Perëndia e parashikoi Rënien dhe se ajo ishte një pjesë e domosdoshme e planit të Tij për shpëtimin tonë?
- Satani shpresonte se duke e bërë Adamin dhe Evën që të hanin nga fruti i ndaluar, ai do ta pengonte planin e Perëndisë (Moisiu 4:6). Çfarë na mëson rrëfimi i Rënies mbi aftësinë e Satanit për të penguar qëllimet e Perëndisë? (Shih DeB 3:1–2.)

## 2. Shlyerja e Jezu Krishtit na shpëton nga vdekja fizike dhe shpirtërore.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 5:14–15; 6:50–54, 57–62.

Rënia e Adamit dhe e Evës solli në botë vdekjen fizike dhe shpirtërore. Vdekja fizike është ndarja e trupit dhe e shpirtit që ndodh në fund të jetës sonë të vdekshme. Vdekja shpirtërore është ndarja nga prania e Perëndisë, që ndodhi kur Adami dhe Eva u flakën nga kopshti. Shpjegoni se ne nuk mund ta mposhtim vetë vdekjen. Për atë arsye, Ati Qiellor dërgoi Birin e Tij të Vetëmlindur për të na shëlbuar nga vdekja nëpërmjet sakrificës së Tij shlyese (Alma 22:14).

- Kur profetët japin mësim mbi Rënien e Adamit dhe të Evës, ata shpesh japin mësim gjithashtu mbi Shlyerjen e Jezu Krishtit (Moisiu 5:10–15; 6:48–62; 2 Nefi 9:6–10). Përse është e rëndësishme të jepet mësim për Shlyerjen së bashku me Rënien? (Rënia e bëri të domosdoshme Shlyerjen në planin e Perëndisë për shpëtimin tonë. Dhënia mësim për Shlyerjen bashkë me Rënien na ndihmon të kuptojmë se si shëlbimi nga vdekja fizike dhe shpirtërore.)

Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Plani i shëlbimit duhet të fillojë me rrëfimin e rënies së Adamit. Me fjalët e Moronit: ‘Nga Adami erdhi rënia e njeriut. Dhe për shkak të rënies së njeriut, erdhi Jezu Krishti, . . . dhe për shkak të Jezu Krishtit, erdhi shëlbimi i njeriut’ (Mormoni 9:12). Po ashtu si një njeri nuk dëshiron vërtet ushqim derisa të jetë i uritur, po ashtu ai nuk e dëshiron shpëtimin e Krishtit derisa ta dijë se përse ka nevojë për Krishtin. Asnjë nuk e di mjaftueshëm dhe siç duhet se përse ka nevojë për Krishtin derisa të kuptojë e të pranojë doktrinën e Rënies dhe pasojat e saj mbi të gjithë njerëzimin” (në Conference Report, prill 1987, f. 106; ose *Ensign*, maj 1987, f. 85).

- Si shpëtohem nga vdekja fizike? (Shih 1 Korintasve 15:20–22; 2 Nefi 2:8; 9:6. Nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne do të ringjallemi.)

- Si mund të shpëtohem nga vdekja shpirtërore? (Shih Moisiu 5:14–15; 6:50–52, 59; Helamani 14:15–18; DeB 19:15–19. Për shkak të Shlyerjes, ne mund të bëhemi të pastër e të denjë që të banojmë me Perëndinë me anë të besimit të Jezu Krishti, pendimit, pagëzimit, dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe bindjes ndaj urdhërimeve.)

Profeti Jakob i Librit të Mormonit u gëzua në shëlbimin nga vdekja që vjen nëpërmjet sakrificës shlyese të Shpëtimtarit (2 Nefi 9:10). Ju mund të dëshironi që ta lexoni këtë fragment dhe të ndani dëshminë tuaj e disa nga ndjenjat tuaja rreth bekimeve që marrim me anë të Shlyerjes. I ftoni anëtarët e klasës që të bëjnë të njëjtën gjë.

### 3. Adami dhe Eva fillojnë jetën si të vdekshëm, lindin fëmijë, u mësojnë atyre ungjillin dhe e adhurojnë e i binden Perëndisë.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 5:1–9, 12.

- Çfarë bënë Adami dhe Eva pasi u flakën nga Kopshti i Edenit? (Shih Moisiu 5:1–5, 12.) Në çfarë mënyrash jeta e Adamit dhe e Evës ishte si jeta jonë sot? Çfarë mund të mësojmë nga Moisiu 5:1–9, 12 rreth qëllimeve të jetës sonë të vdekshme?
- Rishikoni rrëfimin në Moisiu 5:5–9, ose vini anëtarin e caktuar të klasës që ta bëjë këtë. Çfarë urdhërimi i dha Zotit Adamit? (Shih Moisiu 5:5.) Përse Adami ofroi flijime edhe pse nuk e dinte arsyen pse po e bënte? (Shih Moisiu 5:6.)

Profeti Jozef Smith tha: “Çfarëdo që kërkon Perëndia është e drejtë, . . . edhe pse ne mund të mos e kuptojmë arsyen për këtë deri shumë kohë pasi ngjarjet të dalin në dritë” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përzgj. Joseph Fielding Smith [1976], f. 256).

- Përse është e rëndësishme që t’u bindemi urdhërimeve të Zotit edhe kur nuk i kuptojmë të gjitha arsyet e tyre? Si jeni bekuar për mbajtjen e një urdhërimi që nuk e kuptoni plotësisht?
- Cili ishte qëllimi i flijimeve që ofroi Adami? (Shih Moisiu 5:7–9. Ato ishin një ngjashmëri, ose ngjasim, i flijimit që Ati Qiellor do të bënte me Birin e Tij të Vetëmlindur. Ofrimi i flijimeve të tilla ishte një kujtues për Adamin dhe pasardhësit e tij se të gjithë të vdekshmit mund të shëlbohen nga Rënia nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit.) Çfarë kujtuesish të kësaj doktrine na janë dhënë neve? Si mund ta tregojmë mirënjohjen tonë për Rënien dhe Shlyerjen?

#### Përfundim

Rilexoni dëshminë e Evës për bekimet e Rënies (Moisiu 5:11). Shprehni mirënjohje për veprimet e Adamit dhe të Evës, për Rënien dhe për Shlyerjen e Jezu Krishtit.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

##### 1. Ngrënia e frutit të ndaluar nuk ishte mëkat

Për të ndihmuar në shpjegimin se Adami dhe Eva nuk mëkatuan kur hëngrën frutin e ndaluar, lexoni thënien në vijim nga Plaku Dallin H. Ouks:

“Ishte Eva që shkeli së pari kufizimet e Edenit me qëllim që të fillonin kushtet e vdekshmërisë. Veprimi i saj, pavarësisht nga natyra, ishte nga pikëpamja e

urdhërimeve një shkelje, por nga pikëpamja e përjetësisë një domosdoshmëri e lavdishme për të hapur derën drejt jetës së përjetshme. Adami tregoi urtësinë e tij duke bërë të njëjtën gjë. . . .

. . . Ne festojmë veprimin e Evës dhe nderojmë urtësinë e guximin e saj në episodin e shkëlqyer që quhet Rënie. . . . Plaku Jozef Filding Smith tha: ‘Unë kurrë nuk flas për pjesën që mori Eva në këtë rënie si një mëkat, as nuk e akuzoj Adamin për mëkat. . . . Kjo që një shkelje e ligjit, por jo një mëkat.’ . . .

Ky dallim i sugjeruar midis një *mëkati* dhe një *shkeljeje* na kujton formulimin e kujdesshëm në nenin e dytë të besimit: “Ne besojmë se njerëzit do të ndëshkohen për vetë *mëkatet* e tyre dhe jo për *shkeljen* e Adamit” (janë shtuar germat e pjerrëta). Kjo gjithashtu i bën jehonë një dallimi familjar në ligj. Disa veprime, si vrasja, janë krime, sepse janë në thelb të gabuara. Veprime të tjera, si ngarja e makinës pa patentë, janë krime vetëm sepse janë ligjërisht të ndaluara. Sipas këtyre dallimeve, veprimi që prodhoi Rënien nuk ishte një mëkat – në thelb i gabuar – por një shkelje – veprim i gabuar sepse ishte i ndaluar nga ana e urdhërimeve. Këto fjalë nuk përdoren gjithmonë për të treguar diçka të ndryshme, por ky dallim duket kuptimplotë në rrethanat e Rënies” (në Conference Report, tetor 1993, f. 98; ose *Ensign*, nëntor 1993, f. 73).

## 2. Dallimi midis *pasojave të Rënies dhe përgjegjësisë për të*

Të gjithë pasardhësit e Adamit dhe të Evës trashëguan *pasojat* e Rënies, përfshirë vdekjen fizike dhe shpirtërore, por jo *përgjegjësinë* për Rënien. Neni i dytë i besimit na mëson se “njerëzit do të ndëshkohen për vetë *mëkatet* e tyre dhe jo për *shkeljen* e Adamit”. Shih edhe Moroni 8:5–23.

## 3. “Dëshira jote do të drejtohet ndaj burrit tënd”

Thëniet e mëposhtme mund të ndihmojnë anëtarët e klasës të kuptojnë thënien e Zotit për Evën kur tha: “Dëshira jote do të drejtohet ndaj burrit tënd e ai do të sundojë mbi ty” (Moisiu 4:22).

Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Unë kam një pyetje për fjalën [do të] *sundojë*. Ajo jep një përshtypje të gabuar. Unë do të parapëlqejja të përdorja fjalën [do të] *kryesojë* sepse kjo është ajo që bën ai. Një bashkëshort i drejtë kryeson mbi bashkëshorten dhe familjen e tij” (“The Blessings and Responsibilities of Womanhood”, *Ensign*, mars 1976, f. 72).

Plaku M. Rasëll Ballard tha: “Perëndia ka zbuluar me anë të profetëve të tij, se burrat duhet të marrin priftërinë, të bëhen etër dhe me butësi e dashuri të kulluar e zemërçelur duhet të udhëheqin e të ushqejnë shpirtërisht familjet e tyre në drejtësi ashtu si Shpëtimtari udhëheq Kishën (shih Efesianëve 5:23)” (“Equality through Diversity”, *Ensign*, nëntor 1993, f. 90).

# “Në Rast se Bën Mirë, Ti do të Pranolesh”

Moisiu 5–7

**Qëllimi** Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë se zgjedhjet për të ndjekur Jezu Krishtin çojnë te liria, lumturia dhe jeta e përjetshme, ndërsa zgjedhjet për të ndjekur Satanin çojnë te mjerimi dhe robëria.

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese nga Perla me Vlerë të Madhe:
  - a. Moisiu 5:16–41. Kaini e do Satanin më shumë se Perëndinë dhe i bindet urdhrin të Satanit për t’i bërë një ofertë Zotit (5:16–19). Zoti nuk e pranon ofertën e Kainit dhe e urdhëron Kainin të pendohet (5:20–25). Kaini besëlidhet me Satanin dhe e vret Abelin (5:26–33). Zoti e mallkon Kainin dhe Kaini dëbohet nga prania e Zotit (5:34–41).
  - b. Moisiu 6:26–63. Enoku, një nip i brezit të katërt i Adamit, thirret nga Zoti për t’u predikuar njerëzve pendim (Moisiu 6:26–36). Enoku i bindet urdhrin të Zotit dhe u jep mësim njerëzve (6:37–63).
  - c. Moisiu 7:13, 17–21, 23–47, 68–69. Besimi i Enokut ishte kaq i madh sa që malet lëvizin, lumenjtë ndërrojnë rrjedhën dhe të gjitha kombet kanë shumë frikë (7:13, 17). Zoti dhe Enoku vajtojnë për ligësinë e njerëzve mbi tokë (7:23–47). Njerëzit në qytetin e Enokut janë të një zemre dhe të një mendjeje me Zotin dhe i gjithë qyteti merret në qiell (7:18–21, 68–69).
2. Lexim shtesë: Moisiu 5:42–55; 6:10–23; 7:14–16, 59–64; 2 Nefi 2:25–27; Zanafilla 4:1–16.

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje** Përpara orës së mësimin, shkruani krah për krah në dërrasë dy grupet vijuese të deklarimeve:

Grupi 1	Grupi 2
“Kush është Zoti, që unë duhet ta njoh atë?”	“Ai është Perëndia im dhe Perëndia juaj.”
“Jam i lirë.”	“Përse këshilloheni me vetveten dhe e mohoni Perëndinë e qiellit?”
“Mos jam unë rojtari i vëllait tim?”	“Ju jeni vëllezërit e mi.”

Thuajuni anëtarëve të klasës se deklaratimet në këto dy lista u bënë nga dy burra për të cilët ata do të mësojnë gjatë mësimin. Pyetini anëtarët e klasës se çfarë mund të përcaktojnë për secilin burrë në bazë të grupit të tij të deklaratimeve. (Ju mund të



dëshironi t'i bëni anëtarët e klasës që të mblidhen në grupe të vogla për të diskutuar mbi deklarinimet. Pasi grupet të kenë diskutuar mbi deklarinimet për pesë ose gjashtë minuta, bëni një person nga secili grup që të përmbledhë diskutimin e grupit për pjesën tjetër të anëtarëve të klasës.)

Pasi anëtarët e klasës të jenë përgjigjur, shpjegoni se deklarinimet në grupin e parë u bënë nga Kaini, që zgjodhi të ndiqte Satanin. Deklarinimet në grupin e dytë u bënë nga Enoku, që zgjodhi të ndiqte Zotin. Deklarinimet e secilit burrë pasqyrojnë qëndrimin e tij ndaj Perëndisë.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Kaini besëlidhet me Satanin, vret Abelin dhe mallkohet nga Zoti.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 5:16–41.

- Adami dhe Eva shpresuan se biri i tyre Kaini do të ndiqte Zotin, ashtu siç bënë ata. Por Kaini “nuk [u]a vuri veshin” prindërve të tij e Zotit dhe pyeti: “Kush është Zoti, që unë duhet ta njoh atë?” (Moisiu 5:16). Çfarë tregon kjo pyetje për qëndrimin e Kainit ndaj Perëndisë? Çfarë duhet të bëjmë ne që të arrijmë të njohim Perëndinë? (Shih Alma 22:17–18.)

- Përse Kaini i bëri një ofertë Zotit? (Shih Moisiu 5:18.) Çfarë ofroi Kaini? (Shih Moisiu 5:19.) Përse Zoti e pranoi ofertën e Abelit, por nuk e pranoi ofertën e Kainit? (Shih Moisiu 5:5, 20–23. Zoti i kishte urdhëruar Adamin dhe Evën, dhe fëmijët e tyre që të ofronin të parëlindurit e tufave të tyre. Abeli u bind, por Kaini ua vuri veshin fjalëve të Satanit dhe ofroi fruta të tokës.) Përse ishte e rëndësishme që të bëheshin oferta në mënyrën se si Zoti kishte urdhëruar?

Profeti Jozef Smith dha mësim: “Abeli i ofroi Perëndisë një flijim që u pranua dhe që ishte të parëlindurit e kopesë. Kaini ofroi frutat e tokës dhe nuk u pranua, sepse nuk mundi ta bënte me besim. . . . Derdhja e gjakut të të Vetëmlindurit për të shlyer për njeriun . . . ishte plani i shëlbimit; . . . dhe meqenëse flijimi u krijua si një simbol me anë të së cilit njeriu të mund të dallonte Flijimin e madh që kishte përgatitur Perëndia, ofrimi i një flijimi në kundërshtim me këtë, nuk mund të bëhet me besim, . . . ; si pasojë Kaini nuk mund të kishte besim; dhe çdo gjë që nuk bëhet me besim, është mëkat” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përzgj. Joseph Fielding Smith [1976], f. 58).

- Si reagoi Kaini kur Zoti nuk e pranoi flijimin e tij dhe e thirri në pendim? (Shih Moisiu 5:21, 26.) Përse ndonjëherë është e vështirë për ne që të thirremi në pendim? Si mund të zhvillojmë zemra më të pendueshme?
- Pasi vrau vëllain e tij Abelin, Kaini tha: “Jam i lirë” (Moisiu 5:33). Si mendoni ju, nga çfarë besonte se ishte i lirë Kaini? Në ç’mënyrë mosbindja ndaj urdhërimeve të Perëndisë në fakt e pakëson lirinë tonë? Në ç’mënyrë bindja e rrit lirinë tonë?
- Si u përgjigj Kaini kur Zoti e pyeti se ku ishte Abeli? (Shih Moisiu 5:34.) Çfarë do të thotë të jemi rojtari i vëllait tonë? (Shih 1 Gjoni 3:11, 17–18.) Në çfarë mënyrash mund të veprojmë ne si rojtarët e vëllezërve dhe të motrave tona?

Peshkopi Robert L. Simpson tha: “Bota sot ju thotë ta lini rehat mikun tuaj. Ai ka të drejtën që të vijë e të shkojë si t’i pëlqejë. Bota ju thotë se përpjekja për ta

bindur që të vijë në kishë apo në mbledhje priftërie ose që të heqë dorë nga një zakon i keq, mund të çojë në irritim dhe tension të tepruar; por sërish, unë përsëris fjalën e Zotit: Ju jeni rojtari i vëllait tuaj dhe, kur të jeni kthyer në besim, ju keni detyrimin të forconi vëllezërit tuaj” (në Conference Report, tetor 1971, f. 114; ose *Ensign*, dhjetor 1971, f. 103).

- Çfarë i ndodhi Kainit si rezultat i zgjedhjes që të ndiqte Satanin në vend të Perëndisë? (Shih Moisiu 5:23–25, 36–41.) Në ç’mënyrë zgjedhjet e Kainit ndikuan pasardhësit e tij si edhe veten? (Shih Moisiu 5:41–43, 49–52, 55.) Në ç’mënyrë zgjedhjet tona të drejta ose të padrejta mund të ndikojnë pjesëtarët e familjeve tona?

## 2. Enoku u predikon njerëzve pendim.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 6:26–63.

- Si reagoi Enoku kur u thirr nga Zoti për t’u predikuar njerëzve pendim? (Shih Moisiu 6:31.) Çfarë i premtoi Zoti Enokut nëse do të shkonte siç u urdhërua? (Shih Moisiu 6:32–34.) Çfarë mund të mësojmë nga historia e Enokut mbi mënyrën se si i zgjedh Zoti udhëheqësit e Tij? (Shih edhe 1 Samuelit 16:7.) Çfarë mund të mësojmë nga Enoku mbi shërbimin për Zotin edhe kur nuk ndihemi të aftë?
- Si mendoni ju, përse njerëzit u fyen kur Enoku filloi të predikonte pendim? (Shih Moisiu 6:37; shih edhe 1 Nefi 16:2; Mosia 13:7.) Përse ata vazhduan ta dëgjojnë megjithëse u fyen? (Shih Moisiu 6:38–39. Në fillim ata qenë thjesht kureshtarë, por pastaj e kuptuan se ai ishte një njeri i Perëndisë.) Si mund të marrim një dëshmi se profeti i gjallë është një njeri i Perëndisë? Si mundet që kjo dëshmi të na ndihmojë ta ndjekim profetin edhe kur mësimet e tij janë jo të famshme?
- Cilat doktrina të ungjillit dha mësim Enoku kur i thirri njerëzit për pendim? (Shih Moisiu 6:47–63. Nëse diskutuat për këto vargje në mësimin 4, mund të mos keni nevojë t’i këqyrni sërish.)
- Zoti na ka bërë “vetëveprues” (Moisiu 6:56). Çfarë do të thotë kjo? (Ne kemi fuqinë për të zgjedhur.) Përse liria e zgjedhjes është e domosdoshme në planin e Perëndisë për shpëtimin tonë? (Neve na nevojitet liria e zgjedhjes në mënyrë që të jemi përgjegjës për zgjedhjet tona.) Cilat janë pasojat e zgjedhjes për të ndjekur Satanin? Cilat janë pasojat e zgjedhjes për të ndjekur Zotin? (Shih 2 Nefi 2:25–27.)

## 3. Njerëzit në qytetin e Enokut janë të një zemre dhe të një mendjeje me Zotin dhe i gjithë qyteti merret në qiell.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 7:13, 17–21, 23–47, 68–69.

- Çfarë mrekullish kreu Zoti për shkak të besimit të madh të Enokut? (Shih Moisiu 7:13.) Çfarë mrekullish kryen Zoti në kohën tonë për shkak të besimit të njerëzve?
- Si u bekuan njerëzit që dëgjuan fjalët e Enokut dhe u penduan për mëkatet e tyre? (Shih Moisiu 7:17–18.) Përse qyteti i tyre u quajt Sion? (Shih Moisiu 7:18.) Çfarë do të thotë të qenit “të një zemre dhe të një mendjeje”? Çfarë mund të bëjmë ne që të bëhemi të një zemre dhe të një mendjeje me Zotin, në familjet tona, në Kishë?

- Çfarë i ndodhi në fund Enokut dhe popullit të qytetit të tij? (Shih Moisiu 7:19–21, 69.)
- Te Moisiu 7:28, Enoku pa Zotin të qante. Përse po qante Zoti? Përse Enoku pyeti për të qarin e Zotit? (Shih Moisiu 7:29–31.) Si u përgjigj Zoti? (Shih Moisiu 7:32–33, 36–37.) Si ndiheni për Zotin, kur lexoni këto vargje?
- Kur Enoku pa ligësinë e njerëzve, ai gjithashtu qau (Moisiu 7:41, 44). Si e ngushëlloi Zoti Enokun? (Shih Moisiu 7:44–47.)

Ju mund të dëshironi t’u thoni anëtarëve të klasës se mësimet e ardhshme diskutojnë rivendosjen e Sionit në ditët e mëvonshme (përfshirë një Jerusalem të Ri), Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit dhe mbretërimin e Tij mijëvjeçar mbi tokë, të cilët Enoku i pa në vegim (Moisiu 7:62–65).

## Përfundim

Vini në dukje se Kaini zgjodhi të ndiqte Satanin dhe t’u mësonte praktikën e tij të liga fëmijëve dhe pasuesve të tij. Si rezultat, pasardhësit e Kainit u rritën në ligësi dhe u mallkuan nga Perëndia për mëkatësinë e tyre. Përkundrazi, Enoku zgjodhi të ndiqte Zotin. Si rezultat i zgjedhjes së Enokut për të qenë i bindur dhe për t’iu mësuar ungjillin të gjithëve që do të dëgjonin, një qytet i tërë u bë kaq i drejtë sa që ata u morën nga toka për të banuar me Perëndinë.

Dëshmoni se zgjedhjet që bëjmë për të ndjekur Jezun Krishtin, do të na ndihmojnë t’i afrohem Atij dhe do të na çojnë te liria, lumturia dhe jeta e përjetshme.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Mbajtja e dokumenteve familjare

- Përse ishte e rëndësishme që Adami, Eva dhe pasardhësit e tyre të mbanin një libër kujtimesh dhe një gjenealogji? (Shih Moisiu 6:5–8, 45–46.) Përse është e rëndësishme që ne sot të mbajmë dokumente të tilla? Si ju kanë ndihmuar rrëfimet e shkruara të jetës së paraardhësve tuaj? Si do të mund t’i ndihmonte pjesëtarët e familjes suaj një rrëfim i shkruar i jetës dhe besimit tuaj?
- Si mundet që shkrimet e shenjta të konsiderohen dokumente familjare? Si mund t’i përdorin prindërit dhe mësuesit me efektshmëri shkrimet e shenjta për t’u dhënë mësim fëmijëve?


### 2. Krahasimi i Enokut dhe Kainit

Në dërrasë vizatoni dy palë shkallë, një që ngjitet dhe një që zbret (shih ilustrimin në faqe 22). Etiketoheni shkallën që ngjitet *Qëndrime që na çojnë te Perëndia* dhe shkruani emrin e Enokut te shkallarja e parë. Etiketoheni shkallën që zbret *Qëndrime që na çojnë te shkatërrimi* dhe shkruani emrin e Kainit te shkallarja e parë.

I bëni anëtarët e klasës që të lexojnë vargun e parë të treguar te shkallaret e Enokut (Moisiu 7:59) dhe vargun e parë të treguar te shkallaret e Kainit (Moisiu 5:16). Pastaj shkruani disa fjalë kyç në shkallaret përkatëse në dërrasë. Përsëriteni për shkallaret e mbetura. Kur të jenë lexuar të gjitha vargjet, etiketoheni fundin e shkallareve të Enokut *Banimi me Perëndinë* dhe etiketoheni fundin e shkallareve të Kainit *Shkatërrimi shpirtëror*. Diskutoni për mënyrën se si fjalët dhe veprimet e

Enokut e ndihmuan atë t'i afrohej Perëndisë, ndërsa fjalët dhe veprimet e Kainit e çuan atë më pranë Satanit.

- Në çfarë mënyrash mund të ndjekim shembullin e Enokut dhe t'i afrohemi Perëndisë?



### 3. "Lyeji sytë e tu . . . dhe ti do të shohësh" (Moisiu 6:35)

Jezu Krishti, njëherë shëroi një të verbër duke i lyer me baltë sytë e burrit (Gjoni 9:1–7). Enoku, i cili nuk ishte ende i pjekur shpirtërisht dhe kështu shpirtërisht i verbër për disa gjëra, gjithashtu u urdhërua t'i "lye[nte] sytë e [tij] me baltë e [t'i lante] ato" (Moisiu 6:35).

- Çfarë pa Enoku kur e bëri këtë? (Shih Moisiu 6:36.) Çfarë na mëson veprimi simbolik i larjes së baltës?
- Çfarë mund të bëjmë ne që t'i hapim sytë më plotësisht për gjërat e Perëndisë? Si mund ta përmirësojmë studimin tonë të shkrimeve të shenjta që të mund të shohim thesaret që janë në to?

### 4. Njerëzit e dashur që largohen nga rruga e drejtë

- Edhe pse Adami dhe Eva u mësuan fëmijëve të tyre ungjillin (Moisiu 5:12), Kaini dhe të tjerë zgjodhën të mos jetonin drejtësisht. Çfarë mund të bëjmë

ne që të ndihmojmë veten për të duruar dhembjen kur njerëzit e dashur shkojnë në rrugë të gabuar? Çfarë mund të bëjmë që t'i ndihmojmë këta njerëz të dashur?

Plaku Riçard G. Skot këshilloi:

“Shumë prej jush janë zemërplatur, sepse një bir apo bijë, një bashkëshort apo bashkëshorte, është larguar nga drejtësia për të ndjekur të ligën. Mesazhi im është për ju.

Jeta juaj është e mbushur me ankth, dhimbje dhe, nganjëherë, me dëshpërim. Unë do t'ju them se si mund të ngushëlloheni nga Zoti.

Së pari, ju duhet të dalloni dy parime themelore:

1. Ndërsa janë shumë gjëra që mund të bëni për të ndihmuar një njeri të dashur në nevojë, ka disa gjëra që duhen bërë nga Zoti.
2. Gjithashtu, asnjë përmirësim i qëndrueshëm nuk mund të ndodhë pa ushtrimin e drejtë të lirisë së zgjedhjes. Mos u përpiqni ta nëpërkëmbni lirinë e zgjedhjes. Vetë Zoti nuk do ta bënte atë. Bindja me detyrim nuk prodhon bekime (shih DeB 58:26–33).

Unë do të sugjeroja shtatë mënyra se si mund të ndihmoni.

E para, dashuri pa kufizime. . . . E dyta, mos i shfajësoni shkeljet, por i jepni çdo shpresë e mbështetje shkelësit. . . . E treta, jepni mësim të vërtetën. . . . E katërta, falni ndershmërisht aq shpesh sa të jetë e nevojshme. . . . E pesta, lutuni me mirëbesim. ‘Shumë fuqi ka lutja e të drejtit kur bëhet me gjithë shpirt’ (Jakobi [Bibël] 5:16). . . .

E gjashta, mbani këndvështrimin e duhur. . . . Kur gjërat që mund të bëni realisht për të ndihmuar janë bërë, lëreni çështjen në duart e Zotit dhe mos u shqetësoni më. Mos u ndieni fajtor, sepse nuk mund të bëni më shumë. Mos harxhoni energjinë tuaj me shqetësime të padobishme. . . . Me kohë, do të ndieni përshtypje dhe do ta dini se si të jepni ndihmë të mëtejshme. Ju do të gjeni më shumë paqe e lumturi, nuk do t'i lini pas dore të tjerët që kanë nevojë për ju, dhe do të jeni në gjendje të jepni ndihmë më të madhe për shkak të atij këndvështrimi të përjetshëm. . . .

*Një sugjerim i fundit – Mos hiqni dorë kurrë nga një njeri i dashur, kurrë!”* (në Conference Report, prill 1988, f. 69–71; ose *Ensign*, maj 1988, f. 60–61).

# “Noeu . . . Ndërtoi një Arkë për Shpëtimin e Shtëpisë së Tij”

*Moisiu 8:19–30; Zanafilla 6–9; 11:1–9*

## Qëllimi

Të ndihmojë anëtarët e klasës që të dëshirojnë të jetojnë denjësisht dhe të shmangin të ligat e botës.

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:

- a. Moisiu 8:19–30; Zanafilla 6:5–22; 7:1–10. Noeu predikon ungjillin, por njerëzit nuk dëgjojnë (Moisiu 8:19–25). Për shkak të ligësisë së njerëzve, Zoti shpall se do të shkatërrojë të gjithë mishin nga toka (Moisiu 8:26–30; Zanafilla 6:5–13). Zoti e urdhëron Noeun të ndërtojë një arkë dhe të fusë në të familjen e tij dhe dy qenie nga çdo gjallesë (Zanafilla 6:14–22; 7:1–10).
- b. Zanafilla 7:11–24; 8; 9:8–17. Bie shi për 40 ditë dhe 40 netë (Zanafilla 7:11–12). Vdesin të gjithë njerëzit dhe krijesat që nuk janë në arkë, dhe ujërat mbulojnë tokën për 150 ditë (Zanafilla 7:13–24). Kur ujërat u tërhoqën, Noeu, familja e tij dhe kafshët e lënë arkën (Zanafilla 8:1–19) dhe Noeu i ofron fli Zotit (Zanafilla 8:20–22). Zoti cakton besëlidhjen e Tij me Noeun dhe vë ylberin si shenjë të besëlidhjes (Zanafilla 9:8–17; vini re se Përkthimi prej Jozef Smithit i vargut 15 tregon se besëlidhja që midis Perëndisë dhe Noeut, jo midis Perëndisë dhe çdo gjëje të gjallë).
- c. Zanafilla 11:1–9. Disa breza pas përmbytjes, njerëzit përpiqen të ndërtojnë një kullë për në qiell (kullën e Babelit). Zoti e ngatërron gjuhën e tyre që ata të mos mund ta kuptonin njëri-tjetrin dhe i shpërndan mbi tërë faqen e dheut.

2. Lexim shtesë: Hebrenjve 11:7; Moisiu 7:32–36.

3. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi të përdorni disa prej tyre si pjesë të mësimin:

- a. Figurat Ndërtimi i Arkës (62053; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 102); Noeu dhe Arka me Kafshë (62305; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 103); dhe Krijimi – Qeniet e Gjalla (62483; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 100).

## Sugjerime për

### Zhvillimin e Mësimin

#### Aktivitet Vëmendjeje

Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.

1. Nëse vendi juaj i mësimin është i madh mjaftueshëm, kërkojuni disa anëtarëve të klasës të qëndrojnë në një vijë të drejtë, me fytyrë nga klasa, me krahët të shtrira dhe me majat e gishtave që prekin majat e gishtave të njerëzve ngjitur me ta. Shpjegoni se duhen rreth 85 anëtarë të klasës që të qëndrojnë në këtë mënyrë për të bërë një varg me të njëjtën gjatësi sa arka që ndërtoi Noeu.
2. Paraqisni diagramin në fund të mësimin për të ndihmuar anëtarët e klasës që të përfytyrojnë madhësinë e arkës së Noeut në krahasim me anije që mund të jenë më të njohura.



Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Njerëzit nuk e pranojnë thirrjen e Noeut për pendim; Noeu ndërton një arkë.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Moisiu 8:19–30 dhe Zanafilla 6:5–22; 7:1–10. (Nëse anëtarët e klasës kanë pyetje në lidhje me kafshët “e pastra” dhe “jo të pastra”, ju mund të dëshironi t’i drejtoni ata te Levitiku 11:1–31.)

- Si ishte bota kur Zoti e thirri Noeun që të predikonte ungjillin? (Shih Moisiu 8:20–22.) Çfarë ngjashmëri mund të shihni midis njerëzve të kohës së Noeut dhe njerëzve të kohës sonë? Si do të mund ta kishin shmangur shkatërrimin njerëzit e kohës së Noeut? (Shih Moisiu 8:23–24.) Si mund të na ndihmojë dëgjimi dhe ndjekja e profetëve që të shmangim shkatërrimin shpirtëror dhe fizik?
- Përse e ndërtoi arkën Noeu? (Shih Hebrenjve 11:7.) Udhëheqësit e Kishës e kanë këshilluar secilin prej nesh që “të ndërtojë një arkë vetjake” (W. Don Ladd, në Conference Report, tetor 1994, f. 36; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 29). Çfarë mund të bëjmë ne që të mbrojmë shpirtërisht veten dhe familjet tona? Cilat urdhërime e ndieni se janë posaçërisht të rëndësishme për të na mbrojtur sot? (Ju mund të dëshiron të përdorni broshurën *Për Forcën e Rinisë* [34285] në diskutimin tuaj.)
- Çfarë mund të bëjmë ne që të jemi të përgatitur nga ana materiale në rast katastrofe ose nevojë tjetër? (Shih citimet më poshtë dhe citatin nga Plaku L. Tom Peri në faqe 55.) Përse shumë prej nesh e zvarrisin bërjen e përgatitjeve të nevojshme? Si mund të bëhemi më të zotuar për t’u përgatitur tani?

Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Zbulesa për të prodhuar dhe magazinuar ushqim mund të jetë po aq thelbësore për mirëqenien tonë fizike sot sa ishte hipja në arkë për njerëzit në kohën e Noeut” (në Conference Report, tetor 1987, f. 61; ose *Ensign*, nëntor 1987, f. 49).

Plaku W. Don Lad dha mësim: “Kur të fillojë të bjerë shi, është shumë vonë për të filluar ndërtimin e arkës. . . . Neve . . . na duhet t’i dëgjojmë zëdhënësit e Zotit. Neve na duhet të vazhdojmë të shkojmë qetësisht përpara dhe të përgatitemi për atë që do të vijë me siguri. Nuk na duhet të kemi panik ose frikë sepse, nëse jemi të përgatitur, shpirtërisht dhe fizikisht, ne dhe familjet tona do t’i mbijetojmë çfarëdo përmbytjeje. Arkat tona do të pluskojnë në detin e besimit nëse veprat tona kanë qenë përgatitja me qëndrueshmëri dhe siguri për të ardhmen” (në Conference Report, tetor 1994, f. 37; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 29).

- Çfarë cilësish shfaqti Noeu me ndërtimin e arkës? (Përgjigjet mund të përfshijnë besimin, bindjen dhe punën e rëndë.) Si mund t’i forcojmë ne këto cilësi te vetja?

Presidenti Spenser W. Kimball shpjegoi se, kur Noeu ndërtoi arkën, “nuk kishte prova të shiut dhe përmbytjes. . . . Paralajmërimet e tij u konsideruan të paarsyeshme. . . . Sa budallallëk që të ndërtoje një arkë në tokë të thatë dhe me diellin që shkëlqente e jetën që rridhte si zakonisht! Por koha mbaroi. Arka u përfundua. Përmbytjet erdhën. Të pabindurit dhe rebelët u mbytën. Mrekullia e arkës pasoi besimin e shfaqur në ndërtimin e saj” (*Faith Precedes the Miracle*, [1972], f. 5–6).

### 2. Zoti e pastron tokën me një përmbytje.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 7:11–24; 8; dhe 9:8–17.

- Çfarë ndodhi kur erdhi përmytja? (Shih Zanafilla 7:23.) Çfarë “arkash” kemi ne sot që mund të na ndihmojnë të shpëtojmë nga e liga që na rrethon? (Ju mund të dëshironi t’i rendisni përgjigjet në dërrasë dhe t’i ftoni anëtarët e klasës që të tregojnë se si i kanë ndihmuar ata këto “arka” që të mbrohen. Përgjigje të mundshme përfshijnë shtëpitë dhe familjet tona, miqtë, tempujt, seminarin, mbledhjet e Kishës, lutjen, shkrimet e shenjta dhe profetët e gjallë.) Si mund t’i ndihmojmë të tjerët që të gjejnë strehim në këto “arka”?
- Pasi shiu pushoi, përse Noeu lëshoi një pëllumb nga arka? (Shih Zanafilla 8:8.) Çfarë ndodhi dy herët e para që ai lëshoi pëllumbin? (Shih Zanafilla 8:8–11.) Çfarë ndodhi herën e tretë? (Shih Zanafilla 8:12.)
- Cila ishte gjëja e parë që bëri Noeu pasi doli nga arka? (Shih Zanafilla 8:20; shih edhe Përkthimin prej Jozef Smithit, Zanafilla 9:4 tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta.) Si mund ta tregojmë mirënjohjen tonë ndaj Zotit kur Ai na ndihmon të kapërcejmë një situatë të vështirë?
- Çfarë vendosi në qiell Perëndia pasi përmytja mbaroi? (Shih Zanafilla 9:13.) Çfarë tha Perëndia se do të përfaqësonte ylberi? (Shih Zanafilla 9:12–13, 16–17.) Çfarë besëlidhje bëri Perëndia me Noeun? (Shih Zanafilla 9:8–11, 15; shih edhe Përkthimi prej Jozef Smithit, Zanafilla 9:21–22, 24 tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta.)

### 3. Njerëzit ndërtojnë kullën e Babelit.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 11:1–9.

- Përse pasardhësit e Noeut vendosën të ndërtonin një kullë? (Shih Zanafilla 11:4.) Si mendoni ju, çfarë donin të përmbushnin ata duke i “[bërë] një emër” vetes? Cili është ndryshimi midis bërjes së një emri për veten dhe marrjes mbi vete të emrit të Krishtit? Çfarë përgjegjësish marrim mbi vete kur mbajmë emrin e Krishtit? (Shih Mosia 18:8–10.)
- Çfarë erdhi si rezultat i përpjekjes për të ndërtuar një kullë për në qiell? (Shih Zanafilla 11:5–9.) Përse ne nuk mund ta arrijmë vetë qiellin ose me anë të mënyrave njerëzore? Cila është mënyra e Zotit se si ne të arrijmë qiellin?

Përfundim

Shpjegoni se njerëzit që ndërtuan kullën e Babelit, u ndëshkuan sepse u përpoqën të arrijnë qiellin me mënyrat e botës. Përkundrazi, Noeu dhe familja e tij u shpëtuan nga përmytja sepse ata jetuan sipas urdhërimeve të Perëndisë.

Dëshmoni se mënyra e vetme se si ne të arrijmë qiellin – që të kthehemi e të jetojmë me Atin tonë Qiellor – është nëpërmjet ungjillit të Jezu Krishtit. Ne duhet të jetojmë drejtësisht, ashtu si bëri Noeu, duke pasur besim në Krisht, duke u penduar për mëkatet tona, duke marrë ordinancat e shenjta dhe duke duruar deri në fund të jetës sonë. Nëse i bëjmë këto gjëra, do të ngrihemi mbi të ligën dhe do të jemi të aftë të kthehemi në praninë e Perëndisë.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

#### 1. Enoku sheh ditët e Noeut në një vegim


Enoku, stër-stërgjyshi i Noeut, pa në një vegim ligësinë e brezit të Noeut dhe përmytjen që erdhi si pasojë (Moisiu 7:41–52). Enoku që i pikëlluar për shkak

të kësaj ligësie dhe i kërkoi Zotit që të kishte mëshirë për Noeun dhe fëmijët e tij. Zoti i premtoi Enokut se nuk do ta shkatërronte më kurrë sërish botën me anë të përmbytjes (Moisiu 7:51). Zoti i premtoi gjithashtu Enokut se Noeu do të ishte pasardhës i tij dhe kështu, fara e Enokut do të vazhdonte në tokë edhe pas përmbytjes (Moisiu 7:52; 8:2, 6, 8–9). Zoti e përtëriu këtë besëlidhje me Noeun pas përmbytjes (Zanafilla 9:8–17; vini re se Përkthimi prej Jozef Smithit i vargjeve 9 dhe 11 i referohet besëlidhjes së Zotit me Enokun; shih edhe Përkthimi prej Jozef Smithit, Zanafilla 9:21–25 tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta).

## 2. Zoti i ruan të drejtët

Ashtu si Noeu dhe familja e tij u shpëtuan nga përmbytja për shkak të drejtësisë së tyre, Zoti i mbrojti gjithashtu, njerëzit e drejtë në kohën e kullës së Babelit. Diskutoni shkurtime për historinë e Jaredit dhe të vëllait të tij, siç gjendet tek Ethëri 1:1–5, 33–37, dhe arsyen përse gjuha e tyre nuk u ngatërrua.

### Përmasa Krahasuese të Anijeve të Ndryshme (shih aktivitetin e vëmendjes)



*Abraham 1:1–4; 2:1–11; Zanafilla 12:1–8; 17:1–9*

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë bekimet dhe përgjegjësitë e besëlidhjes së Abrahamit.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje vargjet Abraham 1:1–4; 2:1–11; Zanafilla 12:1–8; 17:1–9. Abrahami kërkon të jetë i drejtë dhe të jetojë i denjë për bekimet e Perëndisë. Perëndia bën besëlidhje me Abrahamin, duke i premtuar se do të ketë pasardhës të shumtë që do të marrin një tokë të premtimit dhe bekimet e priftërisë e ungjillin.</li> <li>2. Lexim shtesë: Zanafilla 15; Doktrina e Besëlidhje 132:19–24; 29–32; “Besëlidhje e Abrahamit”, Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, f. 14.</li> <li>3. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi t’i përdorni ato si pjesë të mësimi: <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Fotografi misionarësh (62611) dhe të një tempulli të vendit.</li> </ol> </li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b> <b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë është një bekim patriarkal?          Presidenca e Parë ka thënë: “Bekimet patriarkale [janë] një deklaram i frymëzuar i prejardhjes së marrësit dhe gjithashtu, kur nxitet kështu me anë të Shpirtit, një deklaram i frymëzuar dhe profetik i misionit të jetës së marrësit, bashkë me bekime, paralajmërime dhe këshillime të tilla siç mund të nxitet që të japë patriarku. . . . Realizimi i të gjitha bekimeve të premtuara kushtëzohet nga besnikëria ndaj ungjillit të Zotit tonë” (letër drejtuar presidentëve të kunjeve, 28 qershor 1957; cituar në Bruce R. McConkie, <i>Mormon Doctrine</i>, bot. 2-të [1966], f. 558).</li> <li>• Sa prej jush e keni marrë bekimin tuaj patriarkal? Çfarë do të thotë të kemi patriarkun që të na deklarojë prejardhjen tonë në një bekim? (Kur një patriark deklaroi prejardhjen tonë, ai na zbuloi se ne jemi pasardhës të profetit Abraham nëpërmjet Efraimit, Manasit, apo një tjetri prej pasardhësve të Abrahamit.)</li> </ul> <p>Shpjegoni se ky mësim diskuton bekimet që mund të marrim dhe përgjegjësitë që kemi si pasardhës të Abrahamit.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Perëndia bën besëlidhje me Abrahamin.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Abraham 1:1–4; 2:1–11; dhe Zanafilla 12:1–8; 17:1–9.</p>

- Kur Abrahami ishte i ri, ai dëshironte të ishte i drejtë dhe të jetonte i denjë për bekimet e Perëndisë. Sipas Abrahamit 1:2–4, çfarë bekimesh dëshironte Abrahami?
- Perëndia e drejtoi Abrahamin dhe familjen e tij që të linin shtëpinë e tyre në Ur dhe të udhëtonin te një tokë që ata e quajtën Haran (Abraham 2:1–4). Atje Abrahami u lut dhe mori një vegim në të cilin Perëndia bëri besëlidhje që ta bekonte atë dhe pasardhësit e tij. Kjo quhet besëlidhja e Abrahamit. Çfarë bekimesh i premtoi Perëndia Abrahamit në këtë besëlidhje? (Shih Abraham 2:6–11; Zanafilla 12:1–8; 17:1–9. Ju mund të dëshironi të vini në dukje se Abrahamit iu desh të priste shumë vite përpara se të përmbusheshin disa nga këto bekime të premtuara dhe ato ende po përmbushen sot.)

Tabela vijuese mund t’ju ndihmojë të përmbledhni bekimet e besëlidhjes së Abrahamit. Ju mund të dëshironi të vini në dërrasë një tabelë të shkurtuar, duke lënë vend për të shtuar një pjesë me titull “Përgjegjësitë” siç tregohet në faqen 30:

Bekime dhe Përgjegjësi të Besëlidhjes së Abrahamit			
Bekime Tokësore:	Një tokë e premtimit ku të jetonin (Abraham 2:6, 19; Zanafilla 12:7; 17:8)	Shumë pasardhës (Abraham 2:9–10; Zanafilla 12:2–3; 17:2, 4–6)	Ungjillin e Jezu Krishtit dhe priftërinë për Abrahamin dhe pasardhësit e tij (Abraham 2:9–11; Zanafilla 17:7)
Ngjashmëritë e Përjetshme:	Mbretëria çelestiale (DeB 88:17–20)	Martesa e përjetshme dhe rritja e përjetshme (DeB 132:19–22)	Ekzaltimi dhe jeta e përjetshme (DeB 132:23–24)

## 2. Ne jemi trashëgimtarë për bekimet dhe përgjegjësitë e besëlidhjes së Abrahamit.

Shpjegoni se të gjithë anëtarët e Kishës janë “fara e Abrahamit”, që do të thotë se ne jemi pasardhësit e tij. Plaku Jozef Filding Smith tha: “Pjesa më e madhe e atyre që bëhen anëtarë të Kishës, janë me kuptimin e plotë të fjalës pasardhës të Abrahamit nëpërmjet Efraimit, birit të Jozefit. Ata që nuk janë me kuptimin e plotë të fjalës pasardhës të Abrahamit dhe të Izraelit, duhet të bëhen të tillë dhe, kur pagëzohen e konfirmohen, ata shartohen në pemë dhe kanë të drejtën për të gjitha të drejtat e privilegjet si trashëgimtarë” (“How One May Become of the House of Israel”, *Improvement Era*, tetor 1923, f. 1149).

- Si fara e Abrahamit, anëtarët e Kishës janë trashëgimtarë të bekimeve dhe përgjegjësi të besëlidhjes së Abrahamit. Si bëhemi ne trashëgimtarë të kësaj besëlidhjeje? (Kur pagëzohemi në Kishë, premtimi i *shpëtimit* i besëlidhjes së Abrahamit përtërihet me ne. Kur vulosemi në tempull, premtimi i *ekzaltimit* i besëlidhjes së Abrahamit përtërihet me ne. Për të marrë bekimet e besëlidhjes, duhet të përmbushim përgjegjësitë e lidhura me to dhe të jetojmë denjësisht.)

Plaku Brus R. Mek-Konki shpjegoi:

“Abrahami mori së pari ungjillin me anë të pagëzimit (që është besëlidhja e shpëtimit); pastaj atij iu dha priftëria më e lartë dhe ai hyri në martesë çelestiale

(që është besëlidhja e ekzaltimit), duke marrë kështu sigurimin se ai do të kishte rritje të përjetshme; së fundi ai mori një premtim se të gjitha këto bekime do t'u ofroheshin të gjithë pasardhësve të tij të vdekshëm. (Abraham 2:6–11; DeB 132:29–50.) I përfshirë në premtimet hyjnore për Abrahamin, ishte sigurimi se Krishti do të vinte nëpërmjet pasardhësve të tij dhe sigurimi se pasardhësit e Abrahamit do të merrnin disa toka të zgjedhura e të premtuara si një trashëgimi e përjetshme. (Abraham 2; Zanafilla 17; 22:15–18; Galatasve 3.)

Të gjitha këto premtime të mbledhura bashkë quhen *besëlidhja e Abrahamit*. Kjo besëlidhje u përtëri me Isakun (Zanafilla 24:60; 26:1–4, 24) dhe sërish me Jakobin. (Zanafilla 28; 35:9–13; 48:3–4.) *Ato pjesë të saj që i përkasin ekzaltimit dhe rritjes së përjetshme personale, përtërihen me secilin anëtar të shtëpisë së Izraelit që hyn në rendin e martesës celestiale; nëpërmjet atij rendi palët pjesëmarrëse bëhen trashëgimtarë të të gjitha bekimeve të Abrahamit, Isakut dhe Jakobit. (DeB 132; Romakëve 9:4; Galatasve 3; 4.)” (Mormon Doctrine, bot. 2-të [1966], f. 13).*

- Çfarë bekimesh mund të marrim me anë të besëlidhjes së Abrahamit? (Ne mund të marrim të gjitha bekimet që mori Abrahami, siç u shikua në tabelën paraprirëse. Këto bekime përfshijnë ungjillin, priftërinë, ekzaltimin dhe marrëdhënie të përjetshme familjare.)
- Cilat janë përgjegjësitë tona si trashëgimtarë të besëlidhjes së Abrahamit? (Shih Abraham 2:9, 11; Zanafilla 18:19. Ne duhet të ndihmojmë të gjithë fëmijët e Perëndisë, të gjallë e të vdekur, që të marrin bekimet e plota të ungjillit. Ne gjithashtu duhet t'u bindemi urdhërimeve të Perëndisë.)

Nëse e keni shkruar tabelën e faqes 29 në dërrasë, shtoni një pjesë në fund të tabelës, duke renditur përgjegjësitë tona si vijon:

Përgjegjësitë:	Të ndihmojmë të gjithë fëmijët e Perëndisë që të marrin bekimet e plota të ungjillit (Abraham 2:9, 11)	T'u bindemi urdhërimeve të Perëndisë (Zanafilla 18:19)
----------------	--	--

- Si mund t'i ndihmojmë të tjerët që të marrin ungjillin? (Duke bërë punë misionare, duke kryer ordinarca tempulli për të vdekurit dhe duke qenë shembuj të drejtësisë. Ju mund të dëshironi të paraqisni fotografi të një tempulli dhe të misionarëve.)

Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Përgjegjësia e farës së Abrahamit, që jemi ne, është të jemi misionarë që ‘ta mbajnë këtë shërbesë dhe Priftëri për të gjitha kombet’ (Abraham 2:9)” (në Conference Report, prill 1987, f. 107; ose *Ensign*, maj 1987, f. 85).

Plaku Bojd K. Paker bëri krahasimin në vijim që të theksonte përgjegjësinë tonë për të ndarë ungjillin me të tjerët:

Përfytyroni se peshkopi ynë na ka caktuar të planifikojmë një piknik për anëtarët e lagjes. Do të jetë aktiviteti më i mirë në historinë e lagjes dhe ne nuk duhet ta vrasim mendjen për shpenzimet. Ne rezervojmë një terren të bukur pikniku në vend. Do ta kemi të gjithë atë për vete.



Dita vjen dhe çdo gjë është e përsosur. Tavolinat shtrohen dhe banketi është mbresëlënës. Pastaj, tamam sapo është thënë bekimi, një makinë e vjetër hyn tek terreni i piknikut dhe ndalon duke spërkatur. Një burrë i shqetësuar ngre kofanon e makinës dhe një çurg avulli del jashtë. Disa fëmijë zbresin nga makina. Një nënë e shqetësuar çon një kuti te një tavolinë aty pranë. Ajo vë disa ushqime të mbetura mbi tavolinë, duke u përpjekur që ato të duken si një vakt ushqimor për fëmijët e saj të uritur. Por nuk ka mjaftueshëm.

Pastaj, një nga vajzat e vogla sheh tavolinën tonë. Ajo e tërheq vëllanë e saj të vogël te ne dhe e fut kokën midis teje dhe meje. Ne bëjmë mënjanë. Vajza e vogël thotë: “Shikoje atë; vras mendjen se çfarë shije ka”.

Çfarë do të bënim? A do t’i shpërfillnim njerëzit ose t’u kërkonim të mos flisnin? A do t’i përcillnim te tavolina e tyre dhe t’u jepnim disa prej ushqimeve që vërtet nuk na duhen? Apo do t’i ftonim të vinin e të bashkoheshin me ne, të uleshin mes nesh e të merrnin pjesë në banket dhe të na lejonin t’i ndihmonim për ta rregulluar makinën, si dhe do t’u jepnim diçka për udhëtimin e tyre?

Plaku Paker pyet: “A do të kishte gëzim më të pastër sesa të shihnim se sa shumë mund t’u jepnim që të hanin ata fëmijë të uritur? A do të mund të kishte më shumë kënaqësi sesa të ndërprisnim festimin tonë për t’i ndihmuar [ata] që të rregullonin makinën e tyre? . . .

. . . Ka njerëz nëpër botë dhe rreth nesh – fqinjët tanë, miqtë tanë, disa në vetë familjet tona – të cilët, duke folur nga ana shpirtërore, janë të paushqyer. Disa prej tyre po vdesin urie! Nëse e mbajmë të gjithë këtë për vete, nuk është e pangjashme me të paturin e një banketi përpara atyre që janë të uritur” (në Conference Report, prill 1984, f. 59–61; ose *Ensign*, maj 1984, f. 41–42).

- Çfarë na mëson kjo ngjashmëri mbi përgjegjësinë tonë për të ndihmuar të tjerët që të marrin bekimet e ungujllit? (Ne jemi bekuar me plotësinë e ungujllit, banketi më i madh që ka njohur ndonjëherë bota [DeB 58:8–12]. Perëndia pret që ne ta ndajmë këtë bekim me të tjerët, si të gjallë edhe të vdekur.)
- Në ç’mënyrë deklarimi i prejardhjes në bekimin tonë patriarkal është si një thirrje për të përmbushur përgjegjësitë tona si trashëgimtarë të besëlidhjes së Abrahamit? (Duke deklaruar se ne jemi fara e Abrahamit, bekimi ynë patriarkal rithekson privilegjin tonë për të marrë bekimet e besëlidhjes së Abrahamit dhe detyrimin tonë për të përmbushur përgjegjësitë e saj.)

Përfundim

Jepni dëshmi për bekimet e besëlidhjes së Abrahamit. Nxitini anëtarët e klasës që t’i përmbushin përgjegjësitë e tyre si trashëgimtarë të kësaj besëlidhjeje.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi ta përdorni atë si pjesë të mësimin.

### Sfida e të jetuarit në botë

Shpjegoni se izraelitët e lashtë rrethoheshin nga shumë kombe, njerëzit e të cilëve nuk besonin te Perëndia i vërtetë. Këto kombe përfshinin asirasit, babilonasit, egjiptianët dhe të tjerë.

- Si mendoni ju, përse Zoti e vendosi popullin e Tij të besëlidhur në mes të botës së lashtë në vend të një vendi ku do të mund të liheshin vetëm? (Shih Ligji i

Përtërirë 4:6–8. Ai dëshironte që ata të jepnin shembull për të tjerët dhe të përmbushnin besëlidhjen e Abrahamit për të bekuar të gjitha kombet.)

Shpjegoni se shumë ndodhi në Dhiatën e Vjetër tregojnë suksesin ose dështimin e njerëzve të Zotit për t'i mbajtur besëlidhjet e tyre dhe për t'i ndikuar të tjerët drejt drejtësisë. Abrahami, Jozefi, Danieli, Esteri dhe shumë të tjerë qenë ndikime të drejta. Sansoni, Ashabi, fëmijët e Izraelit duke u endur në vendin e shkretë dhe të tjerë, e lejuan botën që t'i ndikonte ata.

Ashtu si bëri me Izraelin e lashtë, Zoti na ka vendosur ne, njerëzit e Tij të besëlidhur të ditëve të mëvonshme, në mes të botës. Sfidë jonë është të ndikojmë botën në mënyra të drejta në vend që ta lejojmë botën që të na ndikojë ne në mënyra të padrejta.

# Të Jetuarit me Drejtësi në një Botë të Ligë

Mësimi

## 8

Zanafilla 13–14; 18–19

Qëllimi	Të forcojë vendosmërinë e çdo anëtari të klasës që të mbahet fort te standardet e drejta gjatë kohëve të ligësisë në rritje.
Përgatitja	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese. Vini re: Zanafilla 17:5 tregon për Zotin që i ndryshon emrin Abramit në Abraham. Emri <i>Abraham</i> përdoret gjatë gjithë këtij mësimi.<ol style="list-style-type: none"><li>a. Zanafilla 13. Pasi jetojnë në Egjipt për një farë kohe për shkak të zisë së bukës në tokën e Kanaanit, Abrahami dhe familja e tij kthehen në Kanaan. Abrahami vendoset në Hebron dhe nipi i tij, Loti, vendoset pranë Sodomës.</li><li>b. Zanafilla 14:1–2, 8–24. Loti zihet rob gjatë betejave të mbretërve dhe shpëtohet nga Abrahami (14:1–2, 8–16). Abrahami i paguan të dhjeta Melkisedekut dhe kundërshton të pranojë prenë e luftës nga mbreti i Sodomës (14:17–24).</li><li>c. Zanafilla 18:16–33; 19:1–29. Zoti shpall se do të shkatërrojë Sodomën dhe Gomorën për shkak të ligësisë së njerëzve (18:16–22). Abrahami i përgjërohet Zotit që t'i kursejë qytetet nëse mund të gjejë njerëz të drejtë që jetojnë atje (18:23–33). Loti dhe familja e tij urdhërohen ta lënë Sodomën (19:1–23; vini re se Përkthimi prej Jozef Smithit, Zanafilla 19:11–13 tregon se Loti <i>nuk</i> ua ofroi bijat e tij burrave të Sodomës; përkundrazi, ai u përpoq t'i mbronte bijat e tij nga burrat). Zoti i shkatërron Sodomën dhe Gomorën (19:24–29).</li></ol></li><li>2. Lexim shtesë: Zanafilla 12; Përkthimi prej Jozef Smithit, Zanafilla 14:25–40; 19:9–15 tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta.</li><li>3. Nëse do të përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni në klasë një gazetë të kohëve të fundit.</li></ol>
Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	Tregojini klasës një gazetë të kohëve të fundit. Pa qëndruar në lajme të veçanta, komentoni mbi atë se si jemi të rrethuar nga ndikime mëkatore. Shpjegoni se ky mësim është mbi rëndësinë e të qenit të drejtë edhe kur ligësia është gjithkund rreth nesh.
Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Abrahami e familja e tij vendosen në Hebron dhe Loti e familja e tij vendosen pranë Sodomës.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 13.</p> <p>Ju mund të dëshironi të jepni një përmbledhje të shkurtër të udhëtimeve të Abrahamit deri në këtë pikë të jetës së tij. Ai ishte rritur në Ur të kaldeasve, pastaj u udhëhoq nga Zoti që të vendosej në Haran (Zanafilla 11:31; Abraham 2:1–5). Zoti</p>

më vonë e udhëhoqi atë nga Harani për në tokën e Kanaanit dhe premtoi: “Unë do t’ja jap këtë vend pasardhësve të tu” (Zanafilla 12:7). Për shkak të një zie buke në Kanaan, Abrahami dhe familja e tij shkuan në Egjipt (Zanafilla 12:10). Zanafilla 13 fillon me Abrahamin dhe familjen e tij që kthehen nga Egjipti në Kanaan.

- Përse Abrahami e Loti e familjet e tyre nuk mund të jetonin së bashku kur u kthyen në Kanaan nga Egjipti? (Shih Zanafilla 13:5–7.) Çfarë mësojmë rreth Abrahamit nga komentet e tij te Zanafilla 13:8–9? Si mund të ndjekim shembullin e Abrahamit kur kemi konflikte me pjesëtarë të familjes ose të tjerë?
- Ku zgjodhi të jetonte Loti? (Shih Zanafilla 13:10–12.) Vini në dukje se njerëzit e Sodomës ishin jashtëzakonisht të ligj (Zanafilla 13:13), por përsëri Loti zgjodhi të jetonte pranë tyre. Çfarë e bëri tokën pranë Sodomës tërheqëse për Lotin? (Shih Zanafilla 13:10. Ajo ishte “e tëra e ujitur” dhe e bukur.)
- Në fillim Loti “banoi . . . në qytetet e fushës”, jashtë Sodomës, por ai arriti “të ngrejë çadrat e tij deri në Sodomë” (Zanafilla 13:12). Më vonë ai jetoi në vetë qytetin e Sodomës (Zanafilla 14:12). Çfarë gjërash mund të bëjmë që janë shpirtërisht të barasvlershme me ngritjen e çadrave tona deri në Sodomë? (Ne mund të lidhemi me gjëra të liga në vend që t’i shmangim ato, ose mund t’i lejojmë vetes që të kryejmë mëkate të vogla pa menduar se ato mund të çojnë në mëkate më të mëdha.) Si mund ta ndryshojmë sjelljen tonë përpara se problemet ose mëkatet e vogla të bëhen të mëdha?
- Ashtu si Loti, njerëzit e Mbretit Beniamin në Librin e Mormonit gjithashtu i ngritën çadrat të orientuara nga një drejtim i veçantë. Çfarë kishin përballë tendat e tyre? (Shih Mosia 2:6.) Si mund t’i orientojmë shtëpitë tona më shumë për nga tempulli dhe jo për nga vendet e botës?

## **2. Abrahami shpëton Lotin, i paguan të dhjeta Melkisedekut dhe kundërshton të pranorë prene e luftës nga mbreti i Sodomës.**

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 14:1–2, 8–24.

- Ndërsa Loti jetonte në Sodomë, mbretërit e disa qytet-shteteve, përfshirë Sodomën dhe Gomorën, filluan të luftonin me njëri-tjetrin (Zanafilla 14:1–2, 8–9). Çfarë i ndodhi Lotit gjatë kësaj lufte? (Shih Zanafilla 14:10–12.) Si e ndihmoi Abrahami Lotin pasi Loti u zu rob? (Shih Zanafilla 14:13–16.)
- Me cilin u takua Abrahami pasi shpëtoi Lotin? (Shih Zanafilla 14:17–18.) Cili ishte Melkisedeku? (Shih Zanafilla 14:18; shih edhe DeB 107:1–2.) Çfarë i dha Abrahami Melkisedekut? (Shih Zanafilla 14:20; shih edhe Përkthimin prej Jozef Smithit, Zanafilla 14:36–40 tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta.)
- Përse Abrahami kundërshtoi të pranonte qoftë edhe një fije si shpërblim nga mbreti i Sodomës? (Shih Zanafilla 14:21–24. Ai nuk dëshironte të merrte asgjë nga një mbret mëkatar.) Çfarë do të mund të konsiderohej një “fije” imoraliteti në botën e sotme? Çfarë do të ishte një “fije” pandershmërie? Në ç’mënyrë ne nganjëherë ulim standardet në masën e mëkatimit që jemi të gatshëm të pranorë në zbavitjen që kërkojmë? Përse është e rëndësishme që të përpiqemi të mos lejojmë as edhe një pjesë të vogël të mënyrave të botës në jetën tonë? (Shih 2 Nefi 28:20–21.)
- Çfarë mund të mësojmë mbi zotimin e Abrahamit ndaj Zotit duke krahasuar reagimet e tij ndaj Melkisedekut dhe ndaj mbretit të Sodomës?

### 3. Zoti i shkatërron Sodomën dhe Gomorën.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 18:16–33; 19:1–29.

- Për shkak të ligësisë së njerëzve në Sodomë dhe Gomorë, Zoti planifikoi që t'i shkatërronte qytetet (Zanafilla 18:20–21). Çfarë i kërkoi Abrahami Zotit pasi mësoi për këtë plan? (Shih Zanafilla 18:23–32.) Çfarë mund të mësojmë nga fakti se Zoti që i gatshëm t'i kursente qytetet nëse do të mund të gjendeshin njerëz të drejtë brenda tyre?
- Përse Loti u udhëzua që ta linte Sodomën? (Shih Zanafilla 19:12–13, 15.) Si reagon dhëndurët e Lotit kur ai i nxiti që të largoheshin? (Shih Zanafilla 19:14.) Përse disa njerëz kundërshtojnë të largohen nga ndikimet e këqija edhe kur janë të vetëdijshëm për rrezikun?
- Çfarë këshille dhanë engjëjt kur Loti dhe familja e tij u larguan nga qyteti? (Shih Zanafilla 19:17.) Vini në dukje se Shpëtimtari u ka dhënë këshillë të ngjashme pasuesve të Tij (Lluka 9:62; 17:29–32; DeB 133:14–15). Çfarë përfaqëson "[të parit] prapa"? (Ngurrim për të hequr dorë nga çfarë na kërkohet; një zotim jo të plotë për të ndjekur Krishtin.) Si mundemi ne nganjëherë "[të shohim] prapa"?
- Çfarë i ndodhi gruas së Lotit kur ajo u kthye për të parë Sodomën? (Shih Zanafilla 19:26.) Çfarë mund të na mësojë historia e gruas së Lotit mbi pendimin? (Që të pendohemi, ne duhet të ndryshojmë zemrën tonë dhe sjelljen tonë. Për ta bërë këtë nganjëherë duhet të zgjedhim një mjedis të ri dhe shoqëri të reja.)
- Çfarë humbi Loti meqë "[ngriti] çadrat e tij deri në Sodomë"? Çfarë rrezikojmë të humbasim kur e vëmë veten në gjendje ku e dimë se do të tundohej? Si ndikohemi kur e lemë veten të rrethohemi nga e liga, edhe nëse nuk po marrim pjesë drejtpërsëdrejti në veprime mëkatore?
- Çfarë sugjeron Zanafilla 19:29, cila ishte arsyeja pse Loti u kursye kur Sodoma dhe Gomora u shkatërruan? (Zoti kujtoi drejtësinë e Abrahamit.) Si mundet që sjellja jonë e drejtë t'u sjellë dobi të tjerëve?

Presidenti Spenser W. Kimball tha: "Bota jonë tani është shumë e ngjashme me atë që ishte në kohën e profetit nefit, i cili tha: ' . . . Po të mos ishte për lutjet e të drejtëve . . . ju do të vizitoheshit, madje, që tani me shkatërrim të plotë. . . .' (Alma 10:22.) Sigurisht, ka shumë shumë të drejtë dhe besnikë që jetojnë të gjitha urdhërimet dhe jeta e lutjet e të cilëve e mbrojnë botën nga shkatërrimi" (në Conference Report, prill 1971, f. 7; ose *Ensign*, qershor 1971, f. 16).

#### Përfundim

Dëshmoni për rëndësinë e mbajtjes së vetes të lirë nga mëkati, edhe kur mëkati është gjithkund rreth nesh. Nxitini anëtarët e klasës që të përpiqen fort që të jenë një ndikim i drejtë në botë në vend që të lejojnë gjërat e botës që t'i ndikojnë ata.

Ju mund të dëshironi të përfundoni me deklarin vijues nga Plaku M. Rasëll Ballard:

"Në Kishë, ne shpesh themi dyvargëshin: 'Jini në botë, por jo të botës'. Ndërsa vërejmë shfaqjet televizive që i bëjnë blasfeminë, dhunën dhe pabesinë të duken të zakonshme dhe madje joshëse, shpesh urojmë që të mund ta kyçnim botën jashtë në ndonjë farë mënyre dhe t'i veçonim familjet tona nga e gjithë kjo. . . .

Ndoshta duhet ta shpallim dyvargëshin e sipërpërmendur si dy paralajmërime të veçanta. Së pari '*Jini në botë*'. Përfshihuni; informohuni. Përpiquni të jeni

mirëkuptues e tolerantë dhe të vlerësoni larminë. Bëni kontribute kuptimplote në shoqëri nëpërmjet shërbimit dhe përfshirjes. Së dyti, 'por jo të botës'. Mos ndiqni shtigje të gabuara ose të ndryshoni standardet për të përfshirë apo pranuar atë çfarë nuk është e drejtë. . . .

Ne anëtarët e Kishës duhet të ndikojmë më shumë nga sa ndikohemi. Ne duhet të ndalim baticën e mëkatit dhe të së ligës në vend që të përfshihemi në mënyrë pasive nga ajo. Secili prej nesh duhet të ndihmojë për ta zgjidhur problemin në vend që ta shmangim ose ta shpërfillim atë" (në Conference Report, prill 1989, f. 100–101; ose *Ensign*, maj 1989, f. 80).

---

**Ide Mësimdhënieje  
Shtesë**

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

**1. Mëkatet e Sodomës dhe të Gomorës**

Siç sugjerohet te Zanafilla 19:4–11 dhe te Përkthimi prej Jozef Smithit i Zanafillës 19:9–15, njerëzit e Sodomës dhe të Gomorës u përfshinë në mëkate seksuale të rënda. Por këto mëkate, ndonëse të rënda, nuk qenë mëkatet e vetme për të cilat u shkatërruan qytetet. Bëni një anëtar të klasës që të lexojë me zë të lartë Ezekieli 16:49–50 dhe diskutoni me klasën rreth mëkateve të tjera për të cilat ishin fajtorë njerëzit në Sodomë dhe Gomorë. Ndihmohuni anëtarët e klasës që të kuptojnë se ne mund të shkatërrohemi nga mëkate në dukje të vogla po ashtu si nga të mëdhatë.

**2. Udhëheqja me anë të shembullit**

Për të ilustruar një mënyrë se si shenjtorët e ditëve të mëvonshme mund të jenë një ndikim për mirë në vend që të ndikohen nga bota, ju mund të dëshironi të shfaqni "Udhëheqja me anë të Shembullit", një fragment shtatëminutësh nga *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224). Në këtë fragment, shembulli i drejtë i një të reje ndihmon një shoqe që të kthehet në besimin e ungjillit të Jezu Krishtit.



# “Perëndia do ta Sigurojë Vetë Qengjin për Sakrificën”

Abraham 1; Zanafilla 15–17; 21–22

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë më mirë sakrificën e Atit Qiellor kur ofroi Birin e Tij, ndërsa mësojnë për gatishmërinë e Abrahamit për të sakrifikuar Isakun.
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese. Shënim: Zanafilla 17 tregon për Zotin që ndërroi emrin e Abramit në Abraham dhe të Sarajt në Sara (shih vargjet 5, 15). Emrat <i>Abraham</i> dhe <i>Sara</i> përdoren gjatë gjithë këtij mësimi.</p> <p>a. Abraham 1:1, 5–20. Kur është i ri, Abrahami përndiqet nga priftërinjtë e rremë të Faraonit. Ata përpiqen ta sakrifikojnë, por ai shpëtohet nga Jehovai.</p> <p>b. Zanafilla 15–17; 21. Më vonë në jetën e tij, Abrahami dëshiron dhe i premtohen pasardhës (15:1–6). Sara i jep Agarin Abrahamit si gruan e tij; Agari lind Ismaelin (16:1–16). Perëndia flet përsëri për besëlidhjen e Tij me Abrahamin, duke premtuar se ai do të jetë babai i një shumice kombesh (17:1–14; shih mësimin 7). Njoftohet lindja e Isakut, nëpërmjet të cilit do të vazhdonte besëlidhja (Zanafilla 17:16–22). Sara lind Isakun (21:1–12).</p> <p>c. Zanafilla 22. Perëndia urdhëron Abrahamin që të sakrifikojë Isakun (22:1–2). Abrahami përgatitet që të sakrifikojë Isakun, por Perëndia siguron një dash që të sakrifikohet në vend të tij (22:3–19).</p> <p>2. Lexim shtesë: Hebrejve 11:8–19; Jakobi [Bibël] 2:21–23; Jakobi [LiM] 4:5; Doktrina e Besëlidhje 132:34–36.</p> <p>3. Nëse përdorni aktivitetin e dytë të vëmendjes, të paktën një javë përpara këtij mësimi, kërkoni disa anëtarëve të klasës që të përgatiten të tregojnë për një kohë kur u bekuan sepse qenë të gatshëm që të sakrifikonin.</p> <p>4. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi të përdorni disa prej tyre si pjesë të mëimit:</p> <p>a. Figurat Një Engjëll Shpëton Abrahamin (62607; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 104) dhe Abrahami Çon Isakun të Sakrifikohet (62054; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 105).</p>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mëimit</b> Aktivitet Vëmendjeje	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.</p> <p>1. Kërkoni anëtarëve të klasës që të mendojnë për një njeri që e duan shumë ose një pronësi që e vlerësojnë shumë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si do të ndiheshit nëse Perëndia do t’ju kërkonte të hiqnit dorë, apo ta sakrifikonit, këtë njeri apo zotërim? Çfarë do të bënit?</li> </ul> <p>2. Ftoni disa anëtarë të klasës që të tregojnë për një kohë kur u bekuan sepse qenë të gatshëm që të sakrifikonin.</p>

Pas cilitdo prej këtyre aktiviteteve, shpjegoni se Perëndia e urdhëroi Abrahamin që të sakrifikonte birin e tij Isakun, të cilin Abrahami e donte shumë. Edhe pse Abrahamit në fund nuk iu kërkua ta bënte këtë sakrificë, gatishmëria e tij për ta bërë “iu llogarit për drejtësi” (DeB 132:36). Për shkak të drejtësisë së Abrahamit, ai dhe pasardhësit e tij u bekuan shumë.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### **1. Abrahami thajse sakrifikohet nga priftërinjtë e rremë të Faraonit.**

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Abraham 1:1, 5–20. Një pjesë e këtij mësimi përqendrohet tek urdhri i Perëndisë që Abrahami të sakrifikonte Isakun. Për të ndihmuar anëtarët e klasës që të kuptojnë domethënien e këtij urdhri dhe thellësinë e besimit të Abrahamit, mësimi fillon me një diskutim të shkurtër rreth përvojës së Abrahamit kur ai, në moshë të re, pothuajse u sakrifikua nga një prift i rremë i Faraonit.

- Si ishin kushtet në Kaldea kur Abrahami jetoj atje? (Shih Abraham 1:1, 5–8.) Çfarë u përpoqën t’i bënin Abrahamit priftërinjtë e rremë të Faraonit? (Shih Abraham 1:7, 12.) Si shpëtoi Abrahami nga këta priftërinj të rremë? (Shih Abraham 1:15–16, 20.)
- Si mund ta ketë ndihmuar Abrahamin përvoja në altarin e priftërinjve të rremë që të përgatitej për sprovat të ardhshme? Si mund të na ndihmojnë sprovat tona që të përgatitemi për vështirësi të ardhshme?

### **2. Abrahami ka fëmijë nëpërmjet Agarit dhe Sarës.**

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 15–17; 21.

- Çfarë premtimi i dha Zoti Abrahamit në lidhje me fëmijët? (Shih Zanafilla 15:1–6.) Përse Sara i dha Abrahamit Agarin si gruan e tij? (Shih Zanafilla 16:1–3; DeB 132:34–35.) Çfarë premtimi i dha Zoti Agarit? (Shih Zanafilla 16:10–11.)
- Çfarë i zbuloi Perëndia Abrahamit te Zanafilla 17:15–16, 19, 21? Si u përgjigj Abrahami? (Shih Zanafilla 17:17. Vini re që, ndërsa Varianti i Mbretit Jakob të Biblës thotë se Abrahami “qeshi” kur dëgjoi se Sara do të lindte një djalë, një përkthim alternativ i fjalës hebreje është “gëzoi”. Përkthimi i Biblës prej Jozef Smithit thotë se Abrahami “u gëzua” nga lajmi.)
- Çfarë mund të na mësojë zbulesa se Abrahami dhe Sara do të kishin një bir mbi atë se si Perëndia i përmbush premtimet e Tij? (Perëndia do t’i përmbushë premtimet e Tij, ndonëse jo domosdoshmërisht në mënyrën ose kohën kur mund ta presim ne. Vini në dukje se Abrahamit dhe shumë të tjerëve në shkrimet e shenjta iu desh të prisnin besnikërisht për shumë vite përpara se t’u jepeshin bekimet e premtuara.)
- Si ndryshonin premtimet që bëri Perëndia në lidhje me Isakun nga ato në lidhje me Ismaelin? (Shih Zanafilla 17:19–21.)

### 3. Perëndia urdhëron Abrahamin që të sakrifikojë Isakun.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 22.

- Përse Perëndia i kërkoi Abrahamit që të sakrifikonte Isakun? (Shih Zanafilla 22:1. Përse kjo duhet të ketë qenë një provë e vështirë për Abrahamin? (Jo vetëm që Isaku ishte biri i tij, por Perëndia kishte premtuar se besëlidhja me Abrahamin do të vazhdonte nëpërmjet Isakut dhe pasardhësve të tij [Zanafilla 17:19]. Një arsye tjetër se përse kjo duhet të ketë qenë e vështirë është sepse në moshë të re, vetë Abrahamin thuajse e sakrifikuan priftërinjtë e rremë të Faraonit [Abraham 1:1, 5–20].)
- Si iu përgjigj Abrahami urdhrorit të Perëndisë për të sakrifikuar Isakun? (Shih Zanafilla 22:2–3.) Çfarë mund të mësojmë nga Abrahami mbi besimin dhe bindjen? (Shih Hebrenjve 11:17–19; Jakobi [Bibël] 2:21–23.)
- Si iu përgjigj Isaku kësaj situatë? (Shih Zanafilla 22:3–10. Nuk ka të dhëna që Isaku kundërshtoi qëllimin e Abrahamit që ta sakrifikonte atë.)

Plaku Dallin H. Ouks shpjegoi: “Kur erdhën te vendi i urdhëruar, Abrahami ndërtoi një altar dhe vendosi dru mbi të. Pastaj, Bibla thotë: ‘Abrahami . . . e lidhi Isakun, birin e tij, dhe e vendosi mbi altar sipër druve’ (Zanafilla 22:9). Çfarë mendoi Isaku kur Abrahami bëri një gjë kaq të çuditshme? Bibla nuk përmend rezistencë ose kundërshtim. Heshtja e Isakut mund të shpjegohet vetëm me mirëbesimin dhe bindjen e tij ndaj të atit” (në Conference Report, tetor 1992, f. 51; ose *Ensign*, nëntor 1992, f. 37).

- Gatishmëria e Abrahamit për të sakrifikuar Isakun ishte një ngjasim i gatishmërisë së Atit Qiellor për të sakrifikuar Birin e Tij të Vetëmlindur (Jakobi [LiM] 4:5; Zanafilla 22:8, 13). Cilat janë disa ngjashmëri midis përvojës së Abrahamit dhe asaj të Atit Qiellor? Cili është dallimi më i madh?
- Në çfarë mënyre mund të krahasohemi ne me Isakun? Nëse Isaku na përfaqëson ne, cilin përfaqëson dashi në kaçube? Si ju ndihmojnë këto krahasime që ta kuptoni më mirë dashurinë e Atit Qiellor për ju kur sakrifikoi Birin e Tij?

Plaku Dallin H. Ouks tha: “Kjo histori . . . tregon mirësinë e Perëndisë kur mbrojti Isakun dhe siguroi zëvendësim kështu që atij të mos t’i duhej të vdiste. Për shkak të mëkateve tona dhe vdekshmërisë sonë, ne, ashtu si Isaku, jemi të dënuar të vdesim. Kur gjithë shpresa tjetër shuhet, Ati ynë në Qiell siguron Qengjin e Perëndisë dhe ne shpëtohem nga sakrificat e Tij” (në Conference Report, tetor 1992, f. 51; ose *Ensign*, nëntor 1992, f. 37).

- Çfarë provoi Abrahami nëpërmjet këtij testimi? (Shih Zanafilla 22:11–12.) Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë për situata të tjera, nga shkrimi i shenjtë ose personale, kur individë janë vënë në provë si një mundësi për të provuar besnikërinë e tyre. Kërkojuni gjithashtu anëtarëve të klasës që të tregojnë për gëzimin dhe bekimet të cilat kanë ardhur nëpërmjet vërtetimit se janë besnikë.
- Përse Isakut i referohet tek Zanafilla 22:16 si biri i vetëm i Abrahamit? (Isaku ishte biri nëpërmjet të cilit do të vazhdonte besëlidhja. Kjo referencë thekson gjithashtu, paralelizmin midis Isakut dhe Shpëtimtarit tonë, Birit të

Vetëmlindur të Atit.) Çfarë bekimesh iu siguruan Abrahamit për shkak të besnikërisë së tij? (Shih Zanafilla 22:15–18.) Çfarë bekimesh na premtohen neve me anë të besëlidhjes së Abrahamit? (Shih mësimin 7.) Cilat janë përgjegjësitë tona si trashëgimtarë të besëlidhjes së Abrahamit?

## Përfundim

Shprehni vlerësimin tuaj për shembullin e besimit dhe të bindjes së dhënë nga Abrahami. Dëshmoni se gatishmëria e Abrahamit për të sakrifikuar Isakun ishte një ngjasim me gatishmërinë e Atit Qiellor për të sakrifikuar Birin e Tij të Vetëmlindur. Ftojini anëtarët e klasës që të ndajnë ndjenjat e tyre mbi Shlyerjen dhe dashurinë e madhe që Ati Qiellor dhe Jezu Krishti kanë për ne.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Nxjerrja e mësimave nga sprovat

- Presidenti Hug B. Braun tha se Perëndia e urdhëroi Abrahamin që të sakrifikonte Isakun sepse “Abrahamit i duhej të mësonte diçka mbi Abrahamin” (në Truman G. Madsen, *The Highest in Us* [1978], f. 49). Çfarë mund të ketë mësuar Abrahami për veten e tij nga kjo përvojë? Çfarë keni mësuar ju nga sprovat tuaja?
- Zoti zbuloi që ne duhet të provohemi “madje si Abrahami” (DeB 101:4). Si mendoni ju, përse është e domosdoshme kjo? (Shih DeB 101:5, 35–38; 122:5–7.) Çfarë mund të bëjmë ne tani që të përgatitemi për sakrificat që Zoti mund të na kërkojë që të bëjmë?

### 2. Ndërtimi i një marrëdhënieje të fortë me Perëndinë

Abraham 1 dhe Abraham 2 përshkruan marrëdhëniet që patën Abrahami dhe ati i tij me Perëndinë. Ati i Abrahamit u kthye te Perëndia në kohë shqetësimesh, por iu kthye adhurimit të idhujve kur gjërat po shkonin mirë në jetën e tij (Abraham 1:5, 30; 2:5). Abrahami, nga ana tjetër, e kërkoi Perëndinë vazhdimisht (Abraham 1:2, 4; 2:12).

- Si mund ta kërkojmë Perëndinë, duke e bërë marrëdhënien tonë me Të të vazhdueshme dhe jo rastësore? Si mund ta bëjmë zotimin tonë ndaj Perëndisë më të qëndrueshëm, që ne ta kërkojmë Atë në kohë paqeje dhe rehatie po ashtu si në kohë sprove?

# Bekimet e Parëbirnisë; Martesa në Besëlidhje

Mësimi  
**10**

Zanafilla 24–29

---

**Qëllimi** Të forcojë dëshirat e anëtarëve të klasës që të jetojnë të denjë për bekimet e tyre të parëbirnisë dhe për martesën e përjetshme.

---

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Zanafilla 24. Abrahami thekson rëndësinë e martesës në besëlidhje (martesës së përjetshme) nëpërmjet përzgjedhjes së një bashkëshorteje të denjë për Isakun.
  - b. Zanafilla 25:20–34. Rebeka merr një zbulësë lidhur me bijtë e saj binjakë të palindur ende (25:22–23). Kur këta bij rriten, Esau i shet parëbirninë e tij Jakobit (25:29–34).
  - c. Zanafilla 26–29. Isakut dhe pasardhësve të tij u premtohen bekimet e besëlidhjes së Abrahamit (26:1–5). Esau martohet jashtë besëlidhjes dhe u sjell hidhërim prindërve të tij (26:34–35). Isaku e bekon Jakobin që të sundojë mbi popuj dhe kombe (27:1–46). Isaku shqipton mbi Jakobin bekimet e besëlidhjes së Abrahamit dhe e dërgon larg që të gjejë një bashkëshorte të denjë (28:1–10). Jakobi martohet me Lean dhe Rakelën në besëlidhje (29:1–30).
2. Nëse përdorni aktivitetin e parë të vëmendjes, sillni një tas ose qese të vogël me kokoshka të pjekura ose një copë fruti.
3. Nëse po u jepni mësim adoleshentëve ose të rinjve në moshë madhore beqarë, merrni parasysh përdorimin e idesë së dytë shtesë të mësimdhënies: “Martesa e drejtë fillon me takimet e drejta”.
4. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi të përdorni disa prej tyre si pjesë të mësimi:
  - a. “Martesa në Besëlidhje”, një fragment katërminutësh nga *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224).
  - b. Figurën Rebeka te Pusi (62160).

---

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi** Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.

**Aktivitet Vëmendjeje**

1. Paraqitni një tas ose qese me kokoshka ose një copë fruti, pastaj bëjuni anëtarëve të klasës pyetjen vijuese:
  - Nëse do t’ju duhej të zgjidhni midis një tasi kokoshkash (ose një cope fruti) pikërisht tani dhe premtimit për kokoshka (ose fruta) pa fund më vonë, pasi të keni mbjellë, kultivuar dhe mbledhur misrat (ose frutin) çfarë do të zgjidhni? Përse?

Shpjegoni se shpesh ne përballemi me zgjedhje midis gjërave që mund t’i kemi lehtas tani, dhe gjërave për të cilat duhet të punojmë e të presim. Nga njëherë, zgjedhim atë që do të sillte kënaqje (kënaqësi ose përmbushje) të menjëhershme, edhe nëse zgjedhja për të punuar e për të pritur në fund do

të jepte bekim më të madh. Zgjedhja për të pasur kokoshka (ose frut) tani apo më vonë nuk është një vendim i rëndësishëm. Megjithatë, ne përballemi me zgjedhje të tjera në jetë – të tilla si vendimet mbi atë se me cilin/cilën dhe kur të martohemi – ku zgjedhja për kënaqje të menjëhershme mund të na mohonte bekime të lavdishme e të qëndrueshme.

2. Bëjuni anëtarëve të klasës pyetjen vijuese:

- A keni shpenzuar ndonjëherë pará ose kohë për të siguruar diçka, për të zbuluar vetëm se nuk ia vlente ajo çka keni shpenzuar për të?

Ftoni disa anëtarë të klasës që të tregojnë për një rast kur paguan me tepëri për diçka që mendonin se e dëshironin (ju mund të dëshironi të tregoni një përvojë tuajën).

Shpjegoni se e njëjta gjë mund të ndodhë shpirtërisht. Duke bërë zgjedhje jo të drejta, ne mund të shkëmbejmë bekime të përjetshme me gjëra me vlerë shumë më të vogël. Megjithatë, duke jetuar drejtësisht, ne mund të marrim të gjitha bekimet që Ati Qiellor ka përgatitur për ne.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Abrahami thekson rëndësinë e martesës në besëlidhje (martesës së përjetshme).

Jepni mësim dhe diskutoni për kapitullin Zanafilla 24. Ndërsa diskutoni rëndësinë e martesës së përjetshme, jini të ndjeshëm ndaj ndjenjave të anëtarëve të klasës që nuk janë martuar në tempull, ose prindërit e të cilëve nuk janë martuar në tempull.

- Përse Abrahami qe kaq këmbëngulës që Isaku të martohet me një grua nga fisi i tij dhe jo nga kanaanejtë, në tokën e të cilëve jetonin Abrahami dhe Isaku? (Abrahami dëshironte që Isaku të martohet me dikë që kishte besimin e tij, kështu që ai të mund të martohet në besëlidhje. Kjo qe e domosdoshme që bekimet e besëlidhjes së Abrahamit të mund t'u jepeshin pasardhësve të Abrahamit.) Përse është e rëndësishme që ne të martohemi në besëlidhje? (Nëse është e nevojshme, shpjegoni se në kohën tonë, frazat *martesë në besëlidhje*, *martesë e përjetshme* dhe *martesë në tempull* shpesh përdoren në vend të njëra-tjetrës.)
- Për sa kohë martesë në besëlidhje ka qenë një urdhërim nga Perëndia? (Ajo është një ordinancë e përjetshme që ka qenë urdhri i Zotit në të gjitha kohët kur plotësia e ungjillit ka qenë në tokë. Adami dhe Eva ishin të parët në këtë tokë që hynë në këtë ordinancë.)
- Abrahami dërgoi shërbëtorin e tij që të gjente një grua për Isakun (Zanafilla 24:4). Çfarë ju lë mbresa rreth shërbëtorit të Abrahamit? (Shih Zanafilla 24. Përgjigjet mund të ndryshojnë por mund të përfshijnë se ai qe i besuar, mbajtës i fjalës, plot lutje dhe besnik. Edhe pas një udhëtimi të gjatë, ai nuk hëngri derisa të mbaronte porosinë që i dha Abrahami. Dhe në vend që të qëndronte për një festim 10-ditor, ai dëshironte ta merrte Rebekën dhe të kthehej menjëherë te Abrahami.) Çfarë mund të mësojmë nga shërbëtori i Abrahamit për të na ndihmuar që të përmbushim më mirë përgjegjësitë që Zoti na ka dhënë?



- Si mundi ta dallonte shërbëtori i Abrahamit se Rebeka do të ishte një grua e mirë për Isakun? (Shih Zanafilla 24:15–20, 58. Rebeka qe e sjellshme dhe e gatshme që të ndihmonte të tjerët, siç u tregua kur ajo mbushi ujë për shërbëtorin e Abrahamit dhe devetë e tij. Ju mund të dëshironi të vini në dukje se një deve mund të pijë deri në 114 litra ujë në një ditë, kështu që Rebekës iu desh të mbushte goxha ujë që të ngopte 10 deve. Rebeka qe e gatshme gjithashtu ta linte familjen e saj që të martohej me Isakun, ndoshta sepse kishte besim të madh dhe e dinte se qe vullneti i Zotit që ajo të martohej me Isakun.)
- Çfarë cilësish dëshironi te bashkëshorti apo bashkëshortja? Përse cilësitë shpirtërore janë më të rëndësishme sesa paraqitja fizike? Çfarë cilësish duhet të zhvillojë secili prej nesh (qoftë nëse jemi tashmë të martuar ose jo) që do të na bënin një bashkëshort apo bashkëshorte të mirë?
- Kur duhet të fillojë të përgatitet një individ për martesë të përjetshme? Cilat janë disa gjëra që mund të bëjnë fëmijët dhe të rinjtë që të përgatiten për martesë të përjetshme? Si mund t'i ndihmojnë prindërit dhe të rritur të tjerë fëmijët dhe të rinjtë që të përgatiten për t'u martuar në tempull?

Presidenti Hauard W. Hanter tha: “Le të planifikojmë dhe t'u mësojmë e të përgjerojemi që fëmijët tanë të martohen në shtëpinë e Zotit. Le të ripohojmë më fuqishëm se kurdoherë që e kemi bërë në të shkuarën, se ka rëndësi se ku martoheni dhe se cili autoritet ju shpall bashkëshort e bashkëshorte” (në Conference Report, tetor 1994, f. 118; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 88).

## 2. Esau i shet parëbirninë e tij Jakobit.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 25:20–34.

- Çfarë zbulose mori Rebeka në lidhje me dy bijtë e saj binjakë të palindur ende? (Shih Zanafilla 25:22–23.) Përse thënia e Zotit se “më i madhi do t'i shërbejë më të voglit” qe një zbulosë e pazakontë? (Parëbirnia kalohej zakonisht nga babai tek biri më i madh. Marrja e kësaj parëbirnie do të thoshte se biri më i madh do të trashëgonte pjesë të dyfishtë nga pasuria e familjes dhe, nga ana tjetër, ai do të kryesonte familjen dhe do të kujdesej për nënën e motrat pas vdekjes së babait. Thënia se “më i madhi do t'i shërbejë më të voglit” në zbulosën e Zotit për Rebekën do të thoshte se, në këtë rast, biri më i vogël do të merrte parëbirninë dhe pasardhësit e tij do të ishin populli i besëlidhjes.)
- Si ndihej Esau, biri më i madh, në lidhje me parëbirninë e tij për besëlidhjen që ishte bërë midis gjyshit të tij Abrahamit dhe Zotit? (Shih Zanafilla 25:29–34. Gatishmëria e Esaut për të hequr dorë nga parëbirnia për të kënaqur urinë e tij të përkohshme fizike tregon se sa pak e vlerësonte ai parëbirninë.)
- Si anëtarë të Kishës, ne kemi të drejtën për një parëbirni shpirtërore nga prindërit tanë qiellorë. Çfarë bekimesh përfshihen në parëbirninë tonë? (Përgjigjet mund të përfshijnë priftërinë, bekimet e tempullit, ordinancat, zbulosën dhe mundësinë për ekzaltim.)
- Në ç'mënyrë ndikon vendi ku martohemi aftësinë tonë për të marrë bekimet e parëbirnisë tonë? (Ne hymë në pjesën e besëlidhjes së Abrahamit që lidhet me ekzaltimin dhe rritjen e përjetshme, duke bërë e mbajtur besëlidhjet e indau-mentit në tempull dhe të martesës së përjetshme.)

- Në ç'mënyrë fjalët dhe veprimet tona tregojnë vlerën që i japim parabirnisë tonë? Në ç'mënyrë disa nga ne mund të bëjnë gabime të ngjashme me të Esaut, duke zgjedhur gjëra që japin kënaqësi të menjëhershme, në vend të gjërave që kanë vlerë të përjetshme?
- Në përcaktimin e trashëgimitarit për besëlidhjen, Zoti zgjodhi Isakun kundrejt vëllait të tij më të madh Ismaelit (Galatasve 4:22–23), Jakobin kundrejt vëllait të tij më të madh Esaut, Jozefin kundrejt vëllait të tij më të madh Rubenit (1 Kronikave 5:1–2) dhe Efraimin kundrejt vëllait të tij më të madh Manasit (Zanafilla 48:17–20). Çfarë sugjeron kjo mbi mënyrën se si kualifikohemi për thirrjet dhe bekimet e Perëndisë?

### 3. Jakobi martohet me Lean dhe Rakelën në besëlidhje dhe besëlidhja e Abrahamit vazhdon nëpërmjet tij.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 26–29.

- Çfarë na tregon mbi përparësitë e tij zgjedhja e grave prej Esaut? (Shih Zanafilla 26:34–35; 28:6–9.) Çfarë mund të mësojmë për Jakobin nga përpjekja e tij për t'u martuar në besëlidhje? (Shih Zanafilla 28:1–5; 29:1–28. Një gjë që mund të mësojmë është se martesë në besëlidhje qe shumë e rëndësishme për Jakobin. Ai bëri një udhëtim të gjatë që të gjente një grua besnike me të cilën të martohej. Ai pastaj punoi për Labanin për shtatë vite përpara se të martohej me Rakelën dhe vazhdoi të punonte për të më pas.) Si mund të tregojmë se martesë në besëlidhje është e rëndësishme për ne?

Presidenti Gordon B. Hinkli tregoi për një familje që u bashkua me Kishën në Australi dhe që pastaj shitën gjithë zotërimet e tyre që të mund të udhëtonin për në Zelandën e Re dhe të vuloseshin si familje. Babai i kësaj familjeje tha: "Ne nuk mund ta përballonim vajtjen [në tempull]. Zotërimet tona të botës përbëheshin nga një makinë e vjetër, mobiljet tona dhe enët tona. I thashë familjes sime: 'Ne nuk mund t'ia lejojmë vetes që mos të shkojmë. Në se Zoti do të më japë forcë, unë mund të punoj dhe të fitoj mjaft para për një makinë, mobilje dhe enë të tjera, por nëse do të humbas këta të dashurit e mi, unë do të jem vërtet i varfër si në këtë jetë edhe në përjetësi'" (*Be Thou an Example* [1981], f. 138).

- Pasi dy njerëz martohen në tempull, çfarë duhet të bëjnë që të sigurojnë që të kenë një martesë vërtet të përjetshme? Në ç'mënyrë bashkëshorti e bashkëshortja mund të mbajnë e të përmirësojnë marrëdhënien e martesës në mënyrë që besëlidhjet dhe bekimet e premtuara në tempull të përmbushen? (Ju mund të dëshironi të ftoni disa anëtarë të klasës që të tregojnë një shembull të diçkaje që bën bashkëshorti/ja e tyre apo ndonjë prind për të sjellë një shpirt çelstial në martesë.)

#### Përfundim

Theksoni rëndësinë e të qenit të martuar në besëlidhje dhe të jetuarit të denjë për bekimet e parëbirnisë. Nxjitini anëtarët e klasës që të bëjnë zgjedhje të mençura dhe të mos i shkëmbejnë bekimet e përjetshme me kënaqësi ose përmbushje të përkohshme.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

## 1. Rebeka u zgjodh si grua për Isakun

Shkruani secilin prej citimeve vijuese nga Zanafilla 24 në copa të veçanta letre dhe jepuni një ose më shumë secilit anëtar të klasës. Bëjini anëtarët e klasës që t'i përdorin shkrimet e tyre të shenjta për të gjetur se cili i bëri deklaratimet dhe në cilat vargje janë shënuar deklaratimet. Kur anëtarët e klasës të kenë mbaruar, diskutoni mbi deklaratimet dhe rrethanat ku u bënë. Vini në dukje rëndësinë e martesës në besëlidhje, besnikërinë e shërbëtorit të Abrahamit dhe cilësitë e Rebekës që e bënë atë një zgjedhje të mirë për një shoqe të përjetshme.

- a. "Ti nuk do t'i marrësh për grua djalit tim asnjë prej bijave të Kanaanejve."
- b. "Do të shkosh në vendin tim dhe te fisi im për të marrë një grua për djalin tim."
- c. "Zoti, Perëndia i qiellit . . . do të dërgojë engjëllin e tij para teje."
- ç. "Nga kjo unë do të kuptoj që ti ke treguar dashmirësi ndaj zotërisë tim."
- d. "Do të mbush ujë edhe për devetë e tua, deri sa të ngopen me ujë."
- dh. "Unë jam bijë e Bethuelit, i biri i Milkahut, që ajo i lindi në Nahor."
- e. "Qoftë i bekuar Zoti, Perëndia [që] më çoi në shtëpinë e vëllezërve të zotërisë tim."
- ë. "Dhe që do të më thotë: 'Pi sa ke nevojë dhe do të marr ujë edhe për devetë e tua', le të jetë gruaja që Zoti i ka caktuar djalit të zotërisë tim."
- f. "Dhe tani në rast se doni të silleni me dashmirësi dhe besnikëri ndaj zotërisë tim, duhet të ma thoni; në rast se jo, ma thoni njëllonj."
- g. "Ja, Rebeka është këtu para teje, merre me vete, shko dhe ajo të bëhet gruaja e birit të zotërisë tënd, ashtu siç ka thënë Zoti."
- gj. "Po, do të shkoj."
- h. "Motra jonë, ti u bëfsh nëna e mijëra mizëri njerëzish."

Përgjigjet: a-Abrahami (v. 3); b-Abrahami (v. 4); c-Abrahami (v. 7); ç-shërbëtori (v. 14); d-Rebeka (v. 19); dh-Rebeka (v. 24); e-shërbëtori (v. 27); ë-shërbëtori (v. 44); f-shërbëtori (v. 49); g-Labani dhe Bethueli (v. 51); gj-Rebeka (v. 58); h-familja e Rebekës (v. 60).

## 2. "Martesa e drejtë fillon me takimet e drejta"

- Që të dy, Isaku dhe Jakobi, u udhëzuan nga etërit e tyre që të martoheshin me gra të besimit të tyre. Esau u solli hidhërim prindërve të tij duke u martuar me gra që nuk besonin në Perëndinë e Abrahamit. Përse është e rëndësishme të martohemi me persona të besimit tonë?

Presidenti Spenser W. Kimball dha këtë këshillë: "Pali u tha korintasve: 'Mos hyni në një zgjedhje bashkë me të pabesët . . . ' Ndoshta Pali dëshironte që ata ta kuptonin se ndryshimet fetare janë ndryshime themelore. Ndryshimet fetare përfshijnë fusha më të gjera konflikti. Besnikëria ndaj Kishës dhe besnikëria ndaj familjes përplasen. Jeta e fëmijëve shpesh shqetësohet. Joanëtari mund të jetë po aq i shkëlqyer, i trajnuar mirë e tërheqës dhe ai ose ajo mund të ketë personalitetin më të këndshëm, por, pa një besim të përbashkët, martesën e presin telashet. Ka disa përjashtime, por rastet e rregullta janë të ashpra e të trishtuara" (*The Miracle of Forgiveness* [1969], f. 240).

- Çfarë mund të bëni që të ndihmoni për t'u siguruar se personi me të cilin po martoheni është dikush me të cilin mund të keni një martesë të përjetshme? Si do të ndikojnë shokët dhe miqtë tuaj të tanishëm në pjesën tjetër të jetës suaj dhe përjetësinë?

Presidenti Kimball vazhdoi: “Qartas, martesë e drejtë fillon me takimet e drejta. Një njeri përgjithësisht martohet me dikë nga ata me të cilët . . . shoqërohet. Prandaj, ky paralajmërim vjen me theksim të madh. Mos përdorni rastin të takoheni me joanëtarë, ose anëtarë që janë të pa trajnuar dhe pa besim. Një vajzë mund të thotë: ‘Oh, nuk kam ndër mend të martohem me këtë njeri. Është thjesht një takim “zbavitjeje”.’ Por njeriu nuk mund t’ia lejojë vetes që t’i ndodhë të bjerë në dashuri me dikë që mund të mos e pranojë kurrë ungjillin. Vërtet, një përqindje e vogël së fundi janë pagëzuar pasi janë martuar me anëtarë të Kishës. . . . Ata janë pakica jonë e bekuar. . . . Por shumica nuk u bashkuan me Kishën dhe . . . fërkimet, acarimi dhe divorci që rezultati i shumë prej martesave të tyre” (*The Miracle of Forgiveness*, f. 241–242).

### 3. Perëndia u jep zbulesë grave ashtu si dhe burrave

Rrëfimet e shkrimit të shenjtë për zbulesë tregojnë më së shumti ndërveprimet e Perëndisë me udhëheqës të priftërisë, që ishin burra. Megjithatë, Zanafilla 25:22–23 përmban një rrëfim të Perëndisë që i jep zbulesë një gruaje.

Në lidhje me lutjen e Rebekës, Plaku Brus R. Mek-Konki tha: “A mund të marr si model paraardhësen tonë të përbashkët, Rebekën, për atë që mund të bëjnë sot bijat e saj në Kishë? . . . Kur Rebeka që e shqetësuar dhe kishte nevojë për udhëheqje hyjnore, ajo vetë iu lut Zotit dhe Ai i foli asaj si përgjigje. Zoti u jep zbulesë grave që i luten Atij me besim” (në Conference Report, Tahiti Area Conference 1976, f. 16).

- Në ç’mënyrë burrat dhe gratë mund të përgatiten njësoj për të marrë zbulesë personale?

### 4. Vegimi i Jakobit për një shkallë që arrin në qiell

- Ndërsa Jakobi po udhëtonte nga Kanaani për në tokën e fisit të tij që të gjente një grua dhe t’i shpëtonte inatit të Esaut, ai ndaloi që të pushonte natën dhe pa një ëndërr të mrekullueshme (Zanafilla 28:10–19). Çfarë pa Jakobi në këtë ëndërr? Çfarë bekimesh i premtoi atij Zoti? (Shih Zanafilla 28:13–15. Këto janë bekimet e besëlidhjes së Abrahamit, të ripërtëritura me Jakobin në këtë vegim; shih mësimin 7.) Çfarë simbolizon shkalla?

Plaku Marion G. Romni tha për këtë ëndërr: “Jakobi e kuptoi se besëlidhjet që bëri me Zotin . . . ishin këmbëshkallët e shkallës që ai vetë duhej të ngjiste që të mund të siguronte bekimet e premtuara – bekime që do t’i jepnin atij të drejtën për të hyrë në qiell dhe për t’u shoqëruar me Zotin” (“Temples—The Gates to Heaven”, *Ensign*, mars 1971, f. 16).

# “Si Mund ta Bëj Unë Këtë të Keqe të Madhe?”

Zanafilla 34; 37–39

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që 1) të mësojnë se si t'i bëjnë të gjitha përvojat e rrethanat të vepronjë së bashku për të mirën e tyre dhe 2) të forcojnë zotimin e tyre për t'iu bindur standardit të Zotit për moralin seksual.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Zanafilla 37. Jozefi, biri i njëmbëdhjetë i Jakobit, urrehet nga vëllezërit e tij dhe shitet në skllavëri.</li> <li>b. Zanafilla 39. Jozefi përparon si skllav, por akuzohet për imoralitet dhe dërgohet në burg (39:1–20). Drejtori i burgut i jep përgjegjësi Jozefit mbi të gjithë të burgosurit e tjerë (39:21–23).</li> <li>c. Zanafilla 34:1–12; 35:22; 38:1–30. Mëkati i imoralitetit ka pasoja negative mbi familjen e Jakobit – Dinën, bijën e tij (34:1–12); Rubenin, birin e tij më të madh (35:22); dhe Judën, një tjetër prej bijve të tij (38:1–30).</li> </ol> </li> <li>2. Lexim shtesë: Zanafilla 34:13–31.</li> <li>3. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi të përdorni disa prej tyre si pjesë të mësimi:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Figurat Jozefi Shitet nga Vëllezërit e Tij (62525; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 109) dhe Jozefi i Reziston Gruas së Potifarit (62548; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 110).</li> </ol> </li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Kërkojini klasës të përmendë disa filma, shfaqje televizive, libra ose revista të përhapura aktualisht në zonën tuaj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë standardesh të moralit seksual paraqiten nga këto mjete të famshme mediatike? Si ndryshojnë këto standarde nga standardet e Zotit siç na mësohen në shkrimet e shenjta dhe nga udhëheqësit e Kishës?</li> </ul> <p>Shpjegoni se sjellja morale e shoqërisë shpesh ndryshon nga standardet morale që ka vendosur Zoti. Ndërsa standardet e shoqërisë mund të ndryshojnë, standardet e Zotit janë të pandryshueshme.</p> <p>Ky mësim diskuton përvojat e një burri që ndoqi standardin e Zotit për moralin dhe të burrave të tjerë që nuk e bënë këtë. Mësimi diskuton gjithashtu mbi pasojat e ndjekjes ose mosndjekjes së standardit të Zotit.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Jozefi shitet në skllavëri nga vëllezërit e tij.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 37.</p>

Jakobi u martua me Lean dhe Rakelën, bijat e vëllait të nënës së tij, Labanit, dhe gjithashtu u martua me shërbyeset e tyre, Zilpah dhe Bilhah. Gratë e Jakobit i lindën atij dymbëdhjetë bij, që u bënë fillimi i dymbëdhjetë fiseve të Israelit (Zoti ia ndryshoi emrin Jakobit në Israel; shih Zanafilla 32:28). Biri i njëmbëdhjetë i Jakobit qe Jozefi; si biri më i madh i Jakobit dhe Rakelës, Jozefi mori parëbirninë kur Rubeni biri më i madh i Jakobit dhe Leas, e humbi atë si pasojë e mëkatimit (1 Kronikave 5:1–2).

- Përse vëllezërit e Jozefit ishin xhelozë për të? (Shih Zanafilla 37:3–8.) Si reagoni ju kur pjesëtarë të familjes suaj ju fyejnë ose marrin trajtim më të mirë sesa ju? Si mund të kapërcejmë ndjenjat e xhelozisë ose inatit kundrejt pjesëtarëve të familjes ose miqve?
- Si u përgjigj Jozefi kur babai i tij i kërkoi të shkonte në Sikem e të shihte se si po ia kalonin vëllezërit e tij? (Shih Zanafilla 37:13–14. Vini re se Sikemi qe rreth 72 kilometra larg.) Çfarë bëri Jozefi kur nuk mundi t’i gjente vëllezërit e tij në Sikem? (Shih Zanafilla 37:15–17. Vini re se Dothani qe të paktën edhe 19 kilometra të tjera larg.) Çfarë mund të mësojmë mbi Jozefin e ri nga ky tregim? (Përgjigjet mund të përfshijnë se ai qe i bindur ndaj atit të tij dhe këmbëngulës për të bërë atë që i ati i kishte kërkuar.)
- Çfarë komplotuan të bënë vëllezërit e Jozefit kur Jozefi erdhi në fushat ku ata po kullosnin bagëtinë? (Shih Zanafilla 37:12–18.) Si ndryshonin arsyet e Rubenit për t’i shpëtuar jetën Jozefit nga ato të Judës? (Shih Zanafilla 37:21–22, 26–27.) Çfarë bënë përfundimisht vëllezërit me Jozefin në vend që ta vrisnin atë? (Shih Zanafilla 37:28, 31–33.)

## 2. Jozefi kundërshton të “kryej[ë] një mëkat kundër Perëndisë”.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 39.

- Si e bekoj Zoti Jozefin pasi e shitën si skllav? (Shih Zanafilla 39:1–4.) Përse Potifari, një oficer i pasur i Faraonit, vendosi kaq shumë mirëbesim te Jozefi, një skllav? (Shih Zanafilla 39:5–6.)
- Çfarë bëri Jozefi kur gruaja e Potifarit u përpoq ta tundonte atë që të bënte gabim? (Shih Zanafilla 39:11–12. Vini në dukje se Jozefi menjëherë e largoi veten nga ajo situatë.) Si mund të ndjekim shembullin e Jozefit kur tundohemi?
- Çfarë shfajësimesh mund të kishte përdorur Jozefi nëse dëshironte t’u jepej tundimeve të gruas së Potifarit? Çfarë shfajësimesh japin njerëzit sot për t’u përpjekur që të justifikojnë shkeljet morale? Përse këto shfajësime nuk janë justifikime të vlefshme?
- Si u ndëshkua Jozefi sepse qe i virtytshëm kur atij iu afrua gruaja e Potifarit? (Shih Zanafilla 39:12–20. Ai kaloi nga të qenit kryeadministrator i shtëpisë së Potifarit në të qenit i burgosur.) Në botë sot, si i trajtojnë disa njerëz të tjerët që janë të virtytshëm? (Përgjigjet mund të ndryshojnë. Njerëzit që janë të virtytshëm nganjëherë i tallin dhe i përjashtojnë shoqërisht, por shpesh ata i respektojnë.) Ju mund të dëshironi të diskutoni mbi trysninë e botës për të qenë të pamoralshëm me të cilën përballet rinia e sotme dhe se si rinia mund t’i rezistojë kësaj trysnie.



- Shkrimet e shenjta theksojnë se ndërsa Jozefi qe në burg, Zoti qe me të (Zanafilla 39:21–23). Çfarë zbulon kjo mbi Jozefin? (Ai vazhdoi në besim në vend që të vinte në pyetje apo ta fajësonte Perëndinë për burgimin që erdhi nga të qenit i virtytshëm.) Çfarë mund të mësojmë nga Jozefi mbi shndërrimin e përvojave dhe rrethanave të këqia në të mira? (Ju mund të dëshironi të lexoni Romakëve 8:28 gjatë këtij diskutimi.)

Plaku Hartman Rektor i Riu shpjegoi: “Aftësia për të shndërruar gjithçka në diçka të mirë duket të jetë një karakteristikë e perëndishme. Ati ynë Qiellor duket gjithmonë i aftë që ta bëjë këtë. Gjithçka, sado e tmerrshme, bëhet një fitore për Zotin. Jozefi, edhe pse një skllav dhe që plotësisht nuk e meritonte fatin e tij, megjithatë mbeti besnik ndaj Zotit dhe vazhdoi të jetonte urdhërimet si dhe krijoi diçka shumë të mirë prej rrethanave të tij poshtëruese. Njerëz të tillë nuk mund të mposhten” (në Conference Report, tetor 1972, f. 170; ose *Ensign*, janar 1973, f. 130).

### 3. Sikemi, Rubeni dhe Juda kryejnë mëkate të rënda morale.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 34:1–12; 35:22; dhe Zanafilla 38:1–30. Mos diskutoni gjatë për mëkatet e këtyre burrave; përdorini ata si dallim ndaj besnikërisë së Jozefit.

- Nxirrni në pah se jo të gjithë pjesëtarët e familjes dhe të njohurit e Jozefit qenë po aq të guximshëm sa Jozefi në përballje me tundimin. Si reagan Sikemi, Rubeni dhe Juda ndaj tundimit seksual?
- Vini re gjuhën te Zanafilla 34:3 që përshkruan ndjenjat e Sikemit për Dinën: “Dhe shpirti i tij u lidh me Dinën . . . ai e dashuroi vajzën”. Përse ky përshkrim është i papajtueshëm me veprimet e Sikemit? (Nëse Sikemi do ta kishte dashur vërtet Dinën, ai nuk do ta kishte ndotur atë. Ndihmojini anëtarët e klasës që të kuptojnë se njerëzit shpesh përdorin shfajësimin “Ne duhemi” për të justifikuar veprime të pamoralshme, por njerëzit që e duan vërtet njëri-tjetrin nuk do t’i shkaktojnë faje dhe vuajtje njëri-tjetrit për të kënaqur pasione dhe dëshira fizike. Sjellja që e bën të vështirë të luturit, i bën njerëzit të padenjë për të hyrë në tempull, ose prish familjet, nuk shtyhet nga dashuria.)
- Kur Jakobi bekoj secilin prej bijve të tij në fund të jetës së tij, ai iu referua shkeljes morale të Rubenit dhe e përshkroi Rubenin si “i rrëmbyer si uji” (Zanafilla 49:3–4). Në ç’ mënyrë ky është një krahasim i saktë? Çfarë i tha Jakobi Rubenit se do të vinte si rezultat i të qenit të tij “i rrëmbyer si uji”?
- Krahasoni çmimin që pagoi Jozefi për të qenë i virtytshëm me çmimin që pagoi Rubeni për të qenë i pamoralshëm. Çfarë humbi Rubeni për shkak të imoralitetit të tij? (Shih 1 Kronikave 5:1–2.) Cilat janë pasojat shpirtërore dhe fizike të mëkatit seksual sot? Përse Zoti i vë kaq rëndësi të qenit moralisht i/e pastër?
- Udhëheqësit e Kishës kanë dhënë mësim vazhdimisht se bindja ndaj urdhërimeve të Perëndisë është liri e vërtetë. Si e shohim këtë në jetën e Jozefit? Në ç’ mënyrë mosbindja dha si rezultat më pak liri për Sikemin, Rubenin dhe Judën? Në ç’ mënyrë zgjedhja për të mbajtur urdhërimet na bën më të lirë sesa zgjedhja që t’i shkelim ato? (Shih Gjoni 8:31–36.)

Dëshmoni se, me ndihmën e Zotit, të gjitha përvojat e rrethanat tona mund të veprojnë së bashku për të mirën tonë. Dëshmoni gjithashtu vlerën e të mbeturit moralisht të pastër në mendim dhe në veprim. Nxitini anëtarët e klasës që të vlerësojnë filmat, revistat e mjetet e tjera mediatike dhe të përdorin vetëm ato që ndjekin standardin e Zotit për moralin seksual. Nxitini anëtarët e klasës që të jenë po aq të zotuar sa qe Jozefi për t'iu bindur ligjit të dëlirësisë.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Betheli – shtëpia e Perëndisë

- Ndërsa Jakobi po udhëtonte nga Kanaani për në tokën e fisit të tij, ai ndaloi që të pushonte natën dhe pati një ëndërr të mrekullueshme të një shkalle që ngjitej deri në qiell (Zanafilla 28:10–19; shih idenë e katërt shtesë për mësimdhënie në mësimin 10). Jakobi e quajti këtë vend *Bethel*, që do të thotë “shtëpia e Perëndisë” (Zanafilla 28:19). Cili vend ka të njëjtin emër sot? (Tempulli, që quhet shtëpia e Zotit.)

Plaku Marion G. Romni deklaroi: “Tempujt janë për ne të gjithë ajo çfarë ishte Betheli për Jakobin” (“Temples—The Gates to Heaven”, *Ensign*, mars 1971, f. 16).

- Te Zanafilla 35:1–15, Jakobi e çoi përsëri familjen e tij te ky vend i shenjtë. Çfarë i kërkoi Jakobi të bënte familjes së tij që të përgatiteshin për t’u kthyer në Bethel, te “Shtëpia e Perëndisë”? (Shih Zanafilla 35:2.) Si krahasohen këto gjëra me përgatitjet që bëjmë për të shkuar në shtëpinë e Zotit? Çfarë “perëndi[sh të] huaja” mund të jenë mes nesh?

Presidenti Spenser W. Kimball tha:

“Zoti na ka bekuar ne si popull me një begati të pakrahasueshme me kohët e shkuara. Burimet që janë vënë nën pushtetin tonë, janë të mira dhe të domosdoshme për punën tonë këtu në tokë. Por kam frikë se shumëve prej nesh u janë dhënë me bollëk tufa dhe kope, dhe toka, dhe hangarë, dhe pasuri dhe kanë filluar t’i adhurojnë ato si perëndi të rreme, dhe ato kanë pushtet mbi ne. A kemi më shumë prej këtyre gjërave të mira sesa besimi ynë mund të durojë? . . .

Megjithë kënaqësinë tonë në përkufizimin e vetvetes si modernë dhe prirjen tonë për të menduar se zotërojmë një dijeni mbi botën që asnjë popull në të shkuarën nuk e ka pasur – me gjithë këto gjëra, ne jemi, në përgjithësi, një popull idhujtar – një gjendje tepër e neveritshme për Zotin” (“The False Gods We Worship”, *Ensign*, qershor 1976, f. 4, 6).

- Në ç’mënyrë mundemi ne të “[heqim] . . . perënditë [tona të] huaja, [të] pastroh[emi]” dhe të jemi të denjë për të frekuentuar tempullin? (Shih Zanafilla 35:2; Psalmeve 24:3–4; 2 Korintasve 7:1; Moroni 10:30, 32.)

### 2. Jakobi dhe Esau ribashkohen

- Kur po kthehej në tokën e Kanaanit, Jakobi e dinte se do të takohej sërish me vëllanë e tij Esaun (Zanafilla 32:3–23; 33:1–17). Përse Jakobi kishte frikë të takohej me Esaun? (Shih Zanafilla 32:11.) Si u përgatit Jakobi që të takohej me

Esaun? (Shih Zanafilla 32:13–20.) Si reagoi Esau ndaj Jakobit kur u takuan sërisht? (Shih Zanafilla 33:4, 8–11.) Çfarë mund të mësojmë nga Jakobi dhe Esau mbi zgjidhjen e konflikteve familjare?

### 3. Konkubinat në kohët e Dhiatës së Vjetër

Te Zanafilla 35:22, Bilhahut, njëres prej shërbyeseve të Raketës, i referohet si konkubina e Jakobit. Plaku Brus R. Mek-Konki dha shpjegimin vijues për përdorimin e termit *konkubinë* në Dhiatën e Vjetër:

“Gjatë gjithë historisë së marrëdhënieve të Perëndisë me popullin e Tij, përfshirë ato me shtëpinë e Israelit, konkubinat ishin bashkëshorte të ligjshme të martuara me bashkëshortët e tyre në besëlidhjen e re dhe të përhershme të martesës. . . . Në lashtësi ato konsideroheshin të ishin *bashkëshorte dytësore*, që domethënë, bashkëshorte që nuk kishin të njëjtën pozitë në sistemin e kastave që ekzistonte në atë kohë, si ato bashkëshorte që nuk quheshin konkubina” (*Mormon Doctrine*, bot. 2-të [1966], f. 154).

<b>Qëllimi</b>	Për të ndihmuar anëtarët e klasës të kuptojnë që, nëse jemi besnikë e të bindur, Perëndia do t’i shenjtërojë hidhërimet tona për të mirë.
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <p>a. Zanafilla 40–41. Në burg, Jozefi shpjegon saktë ëndrrat e shërbëtorëve të Faraonit. Ai pastaj interpreton ëndrrat e Faraonit mbi lopët dhe kallinjtë. Jozefi bëhet sundimtar mbi gjithë Egjiptin nën Faraonin dhe përgatit popullin për zinë e ardhshme të bukës.</p> <p>b. Zanafilla 42–45. Jakobi dërgon dy herë bijtë e tij që të blejnë grurë në Egjipt. Jozefi u shfaqet vëllezërve të tij e i fal ata dhe ata gëzohen së bashku.</p> <p>2. Lexim shtesë: 2 Nefi 2:2; Doktrina e Besëlidhje 64:8–11; 22:5–9.</p> <p>3. Ju mund të dëshironi t’i kërkonit një anëtar të klasës që të përgatitet për të paraqitur një përmbledhje të shkurtër të Zanafillës 42–43.</p>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b> Aktivitet Vëmendjeje	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.</p> <p>Kërkojuni anëtarëve të klasës që të përfytyrojnë sikur kanë vdekur e kanë hyrë në botën e shpirtave dhe tani po rishikojnë përvojat e tyre në vdekshmëri. Shpjegoni se do të bëni katër pyetje për t’i ndihmuar të mendojnë mbi mënyrën se si vështirësitë kanë ndikuar në jetën e tyre. Pasi t’i keni bërë që të katërta pyetjet, ftojini anëtarët e klasës që të komentojnë për cilëndo pyetje që dëshirojnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilat ishin disa nga sprovat me të cilat u përballët në jetën e vdekshme?</li> <li>• Çfarë mësimesh keni nxjerrë nga sprovat e jetës?</li> <li>• Nëse do të mund ta jetonit sërish jetën tuaj, çfarë do të ndryshonit nga mënyra se si u përballët me sprovat tuaja?</li> <li>• Si do të mund të kishit nxjerrë më shumë dobi nga përvojat e jetës?</li> </ul> <p>Shpjegoni se ky mësim është mbi Jozefin, birin e Jakobit, dhe mbi mënyrën se si ai qe besnik dhe i bindur edhe gjatë sprovave të mëdha.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Jozefi shpjegon ëndrrat e kupëmbajtësit, të bukëpjekësit dhe të Faraonit. Faraoni e bën Jozefin sundimtar mbi të gjithë Egjiptin.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 40–41.</p> <p>Vëri anëtarët e klasës të rishikojnë mësimin e mëparshëm duke përmendur disa nga sfidat që Jozefi përjetoi në pjesën e hershme të jetës së tij (Zanafilla 37; 39). Ju</p>

mund të dëshironi t'i rendisni përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë. Përgjigjet mund të përfshijnë:

- a. Atë e urrenin vëllezërit e tij (Zanafilla 37:4).
  - b. Vëllezërit e tij komplotuan për ta vrrarë atë pastaj e shitën si skllav në vend të kësaj (Zanafilla 37:18–28).
  - c. Atë e futën në burg padrejtësisht pasi kishte kundërshtuar të bënte keq (Zanafilla 39:20).
- Si iu përgjigj Jozefi sprovave të tij? Si e bekoi Zoti Jozefin për të qenit i drejtë edhe në kohët e sprovës?
  - Me Jozefin u bashkuan në burg kupëmbajtësi dhe bukëpjekësi i Faraonit, të cilët, që të dy, panë ëndrra që nuk i kuptonin. Kur Jozefi shpjegoi ëndrrën e kupëmbajtësit, çfarë i kërkoi ai kupëmbajtësit në këmbim? (Shih Zanafilla 40:14–15.) Çfarë ndodhi kur kupëmbajtësi u lirua nga burgu? (Shih Zanafilla 40:21, 23.) Përse qe kjo një sprovë tjetër për Jozefin? (Shih Zanafilla 41:1, 14. Ai mbeti në burg për dy vite të tjera.)
  - Përse Jozefi së fundi u nxor nga burgu? (Shih Zanafilla 41:1, 8–15.) Cila ishte përgjigjja e Jozefit kur Faraoni tha se kishte dëgjuar që Jozefi mund të shpjegonte ëndrrat? (Shih Zanafilla 41:16.) Si mund t'ia japim Zotit meritën e duhur për talentet dhe dhuntitë tona? (Ne mund t'i përdorim ato për të përlëvduar Perëndinë e për të bekuar të tjerët, jo për lavdinë tonë vetjake.)
  - Çfarë pa në ëndërr Faraoni? (Shih Zanafilla 41:1–7, 17–24.) Cili ishte shpjegimi i ëndrrës së Faraonit? (Shih Zanafilla 41:25–32.) Pasi Jozefi dha shpjegimin, çfarë sugjeroi ai që të bënte Faraoni? (Shih Zanafilla 41:33–36; shih edhe idenë e dytë shtesë për mësimdhënie.) Si iu përgjigj Faraoni sugjerimeve të Jozefit për t'u përgatitur për një zi buke? (Shih Zanafilla 41:37–43.)

## 2. Jakobi u shfaqet vëllezërve të tij dhe i fal ata.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Zanafilla 42–45. Ju mund të dëshironi që një anëtar i caktuar i klasës të përmbledhë shkurt Zanafillën 42–43.

- Përse erdhën në Egjipt herën e parë vëllezërit e Jozefit? (Shih Zanafilla 42:1–3.) Përse u kthyen ata në Egjipt herën e dytë? (Shih Zanafilla 42:33–34; 43:2.) Përse Jakobi ngurroi ta linte Beniaminin të shkonte në Egjipt me vëllezërit e tij? (Shih Zanafilla 42:36, 38.) Përse së fundi ai ra dakord që ta linte të shkonte Beniaminin? (Shih Zanafilla 43:3–5, 11–14.)
- Duke dërguar Beniaminin në Egjipt me vëllezërit e tij, Jakobi ndiente se do të humbiste një tjetër bir (Zanafilla 42:36). Në ç'mënyrë Zoti e ktheu këtë ngjarje që perceptohej si sprovë, në një bekim për Jakobin?
- Kur Jozefi qe i ri, pa një ëndërr që parashikonte se vëllezërit e tij së fundi do t'i përkuleshin atij (Zanafilla 37:5–11). Si u përmbush kjo ëndërr? (Shih Zanafilla 42:6; 43:26–28.) Në ç'mënyrë kjo përmbushje, që vëllezërit e tij kishin menduar se do të ishte një sprovë e madhe për ta, doli të ishte një bekim?
- Më shumë se 20 vite pasi e shitën Jozefin në skllavëri, vëllezërit e tij ende ndiheshin fajtorë për veprimin e tyre (Zanafilla 42:21). Në ç'mënyrë faji mund të jetë një forcë pozitive në jetën tonë? Si mund të jetë një forcë negative? Në ç'mënyrë ndikon te ndjenjat e fajit pendimi i plotë? (Shih Enosi 1:4–6.)

- Në ç'mënyrë vëllai i Jozefit, Juda, tregoi se ishte bërë njeri më i mirë që nga hera e fundit që kishte parë Jozefin? (Shih Zanafilla 44:18, 30–34. Kujtojin anëtarët e klasës se kishte qenë ideja e Judës që ta shisnin Jozefin si skllav.)
- Si mendoni ju, përse vëllezërit e Jozefit qenë të shqetësuar kur Jozefi u tregoi atyre identitetin e tij? (Shih Zanafilla 45:1–3.) Si e tregoi Jozefi se ai i kishte falur vëllezërit e tij? (Shih Zanafilla 45:4–11, 14–15.) Si mendoni ju, si ndihmoi falja e Jozefit që të ngriheshin shpirtërisht vëllezërit e tij?
- Çfarë na thotë bota të bëjmë kur dikush është sjellë keq me ne, ashtu si vëllezërit e Jozefit bënë me të? Çfarë na thotë Zoti që të bëjmë? (Shih DeB 64:8–11.) Si jeni bekuar kur jeni sjellë mirë me të tjerë që ju kanë trajtuar keq? Si mund të bëhemi më shpirtbutë?
- Në ç'mënyrë burgimi i Jozefit në Egjipt, që ishte një provë për të, u bë një bekim për të, familjen e tij dhe të gjithë Egjiptin? (Shih Zanafilla 45:4–8.) Si mund të ndjekim shembullin e Jozefit kur përballemi me sfidat dhe sprovat tona?
- Në Dhiatën e Re, Apostulli Pal u tha romakëve se “të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë” (Romakëve 8:28). Në ç'mënyrë ka qenë kjo e vërtetë në jetën tuaj? Ftojini anëtarët e klasës të ndajnë përvoja vetjake në të cilat një ngjarje që së pari dukej negative, më vonë u bë një bekim.

## Përfundim

Kujtoni anëtarët e klasës se përmes sprovave të shumta të tij, Jozefi mbeti besnik. Ai madje, i fali vëllezërit e tij që e shitën në skllavëri. Për shkak të drejtësisë së tij, Jozefi u bekuar shumë. Dëshmoni që, nëse jemi besnikë, Perëndia do të na bekojë duke bërë që të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për të mirën tonë.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Jozefi i madh i ditëve të mëvonshme

Përkthimi prej Jozef Smithit i Zanafillës 50:24–38 përmban profeci që bëri Jozefi për një prej pasardhësve të tij që do të bëhej një “shikues i zgjedhur”. Profeti Lehi i Librit të Mormonit i rishpalli këto profeci te 2 Nefi 3:5–15. Pasardhësi të cilit i referohet në këto profeci, është Profeti Jozef Smith.

Diskutoni për mënyrën se si profecitë vijuese të bëra nga Jozefi i Egjiptit u përmbushën në jetën e Jozef Smithit:

- Një nga pasardhësit e Jozefit do të ishte një “shikues i zgjedhur” (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:26; 2 Nefi 3:6).
- Ky shikues do të respektohej shumë nga pasardhësit e tjerë të Jozefit (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:27; 2 Nefi 3:7).
- Ai do t'u mësonte atyre për besëlidhjet që Perëndia kishte bërë me paraardhësit e tyre (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:28; 2 Nefi 3:7).
- Ai do të ishte i bindur ndaj Perëndisë (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:28; 2 Nefi 3:8).
- Ai do të ishte një profet i madh, ashtu si Moisiu (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:29; 2 Nefi 3:9).
- Ai do të ishte mjeti për të sjellë shkrimin e ri të shenjtë (Librin e Mormonit) që do të mbështeste dhe do të funksiononte me shkrimin e shenjtë ekzistues (Biblën) (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:30–31; 2 Nefi 3:11–12).



- e. Edhe pse ai do të ishte i dobët, Zoti do ta bënte atë të fortë (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:32; 2 Nefi 3:13).
- ë. Edhe ai edhe babai i tij do të quheshin Jozef (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 50:33; 2 Nefi 3:15).

## 2. Përgatitja për zinë e bukës

- Jozefi e këshilloi Faraonin t'i përdorte shtatë vitet e bollëkut për ta përgatitur Egjiptin për shtatë vitet e zisë së bukës që do të vijonin (Zanafilla 41:29–30, 34–36). Çfarë këshille na japin udhëheqësit e Kishës mbi përgatitjen për kohë zie buke ose vështirësi të tjera?

Plaku L. Tom Peri dha mësim:

“Po aq e rëndësishme sa është që të përgatitemi shpirtërisht, ne duhet të përgatitemi për nevojat tona materiale. . . . Prej vitesh kemi marrë udhëzimin që të ndjekim të paktën katër kërkesa në përgatitjen për atë që do të vijë.

Së pari, merrni një arsimim të përshtatshëm. Mësoni një zeje ose një profesion që t'ju mundësojë të zini një punësim të qëndrueshëm që do të sigurojë të ardhura të mjaftueshme sa të kujdeseni për veten dhe familjen tuaj. . . .

Së dyti, mos shpenzoni kurrë më shumë sesa fitoni dhe kurseni diçka për ditët e vështira. Ndiqni në jetën tuaj një plan strikt mbi mënyrën se si të përdorni ato me të cilat ju ka bekuar Zoti. Po aq rregullisht sa paguani të dhjetën, lini mënjane një shumë të nevojshme për kërkesat e familjes në të ardhmen. . . .

Së treti, shmangni borxhin e tepërt. Borxhi i nevojshëm duhet marrë vetëm pas lutjes së kujdesshme e të matur dhe pasi të merrni këshillën më të mirë të mundshme. Ne kemi nevojë për të mbetur plotësisht brenda aftësisë sonë për të paguar. . . .

Së katërti, siguroni dhe ruani një rezervë ushqimesh e pajisjesh që do të mbështesin jetën [nëse ligjet lokale e lejojnë një ruajtje të tillë]. Siguroni veshje dhe krijoni një llogari kursimesh mbi një bazë të ndjeshme e të mirëplanifikuar që mund të shërbejë mirë në kohë urgjence. Për aq kohë sa mund të kujtoj, na është dhënë mësim që të përgatitemi për të ardhmen dhe për të siguruar një furnizim për një vit me gjëra të nevojshme. Do të hamendësoja se vitet e bollëkut na kanë bërë thuajse përgjithësisht që ta lëmë mënjane këtë këshillë. Besoj se koha që ta shpërfillim këtë këshillë ka marrë fund. Me ngjarjet që po ndodhin sot në botë, ajo duhet marrë parasysh me shumë seriozitet” (në Conference Report, tetor 1995, f. 46–47; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 36).

- Gjatë zisë së bukës, “njerëzit e të gjitha vendeve vinin në Egjipt te Jozefi” për të blerë ushqim sepse Egjipti ishte vendi i vetëm që ishte përgatitur për zinë e bukës (Zanafilla 41:54–57). Në ç' mënyrë të qenit i përgatitur na jep mundësi për t'iu shërbyer të tjerëve?

## 3. Bijtë e Jozefit

- Pasi Faraoni e bëri sundimtar mbi Egjiptin, Jozefi u martua me një grua që quhej Asenath dhe ata patën dy bij (Zanafilla 41:45, 50). Si i quajtën bijtë e tyre Jozefi dhe Asenathi? (Shih Zanafilla 41:51–52.) Përse këta qenë emra me vend për bijtë e Jozefit? (Ju mund të keni nevojë t'u tregoni pjesëtarëve të klasës se *Manas* do të thotë “të harrosh” dhe *Efraim* do të thotë “frytdhënës”. Shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, faqet 110 dhe 38.)

**Qëllimi**

Të nxisë anëtarët e klasës që 1) t'i mirëbesojnë Zotit se do t'i përmbushë premtimet e Tij, 2) të rrisin vlerësimin e tyre për sakrificën shlyese të Shpëtimtarit dhe 3) ta bëjnë sakramentin më domethënës në jetën e tyre.

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:

- a. Eksodi 1–3. Bijtë e Izraelit bëhen skllavër nga egjiptianët (1:1–14). Faraoni urdhëron që të vriten të gjithë bijtë që u lindin izraelitëve (1:15–22). Lind Moisiu dhe rritet nga e bija e Faraonit (2:1–10). Moisiu vret një egjiptas dhe arratiset për në Midian, ku martohet me Seforën (2:11–22). Zoti i shfaqet Moisiut te ferrishtja që digjej dhe e thërret për ta çliruar Izraelin nga skllavëria (3:1–22; vini re se në Përkthimin prej Jozef Smithit të Biblës, fjala “engjell” tek Eksodi 3:2 është ndërruar me “prania”).
- b. Eksodi 5–6. Moisiu dhe Aaroni i kërkojnë Faraonit që të çlirojë Izraelin, por Faraoni nuk pranon dhe vendos barrë më të rëndë mbi njerëzit (5:1–23). Zoti premton që ta përmbushë besëlidhjen që bëri me Abrahamin (6:1–8). (Vini re: Kapitujt 7–10 tregojnë se Moisiu shkoi te Faraoni edhe shumë herë të tjera duke i kërkuar që ta çlironte Izraelin. Pavarësisht shumë shenjave, mrekullive dhe plagëve, Faraoni kundërshton. Te Përkthimi prej Jozef Smithit i këtyre kapitujve, fraza “[Zoti] e ngurtës[oi] zemrën e [Faraonit]” është ndërruar me “Faraoni [e] ngurtës[oi] zemrën e tij”.)
- c. Eksodi 11–13. Zoti premton të dërgojë edhe një plagë tjetër në Egjipt, në të cilën do të vdesin të parëlindurit në çdo shtëpi (11:1–10). Zoti e udhëzon Moisiun në përgatitjen e Pashkës, që do ta mbrojë Izraelin nga plaga (12:1–20). Të parëlindurit e Egjiptit vriten (12:29–30). Faraoni i thotë Moisiut ta largojë popullin e tij nga Egjipti dhe izraelitët largohen (12:31–42). Moisiu u thotë bijve të Izraelit që ta mbajnë Festën e Bukës së Ndorme në të ardhmen si kujtim të çlirimit të tyre (13:1–16). Zoti shkon përpara kampit të Izraelit ditën në një re dhe natën në një kolonë zjarri (13:17–22). (Vini re se titujt “Festa e Pashkës” dhe “Festa e Bukës së Ndorme” shpesh përdoren si sinonime; Pashka është dita e parë e Festës së Bukës së Ndorme.)
- ç. Eksodi 14. Faraoni dhe ushtria e tij ndjekin bijtë e Izraelit (14:1–9). Njerëzit kanë frikë dhe Moisiu i bën thirrje Zotit për ndihmë (14:10–18). Bijtë e Izraelit çlirohen nga ushtria dhe kapërcejnë Detin e Kuq nëpër tokë të thatë; njerëzit e Faraonit i ndjekin ata dhe mbyten (14:19–31).

2. Lexim shtesë: Eksodi 4; 7–10; 15.

3. Kërkojini një anëtar të klasës që të përgatitet për të paraqitur një përmbledhje të shkurtër të Eksodit 1 dhe Eksodit 2.

4. Përgatisni shirita me fjalët *Pashka* dhe *Sakramenti*.

5. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi të përdorni disa prej tyre si pjesë të mësimi:

- a. "Sakrifica e Kafshëve dhe Shlyerja", një fragment nëntëminutësh nga *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224).
- b. Figurat Jezusi Krishti (62572; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 240); Moisiu në Xunkthe (62063; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 106); Moisiu dhe Ferrishtja që Flakëron (62239; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 107); dhe Kapërcimi i Detit të Kuq (62100).

### Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

### Aktivitet Vëmendjeje

Pyetini anëtarët e klasës nëse ata kanë shpëtuar ndonjëherë prej një situatë të rrezikshme. Ftoni një apo dy prej tyre që të tregojnë shkurtimisht përvojën e tyre, ose tregoni një tuajën. Pyetini anëtarët e klasës se si u ndien kundrejt atyre që i shpëtuan ata.

Shpjegoni se ky mësim flet për një prej shpëttimeve më mbresëlënëse që kanë ndodhur ndonjëherë – çlirimi i bijve të Izraelit nga plaga e vdekjes dhe nga skllavëria egjiptiane. Shpjegoni gjithashtu se në shumë mënyra, ky shpëtim simbolizon një shpëtim edhe më të madh – çlirimin tonë nga mëkati dhe vdekja përmes sakrificës shlyese të Shpëtimtarit.

### Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Pasi Jakobi dhe familja e tij u shpërngulën për në Egjipt, izraelitët jetuan atje për 430 vite. Gjatë asaj kohe, u ngrit një Faraon që i skllavëroi ata dhe vendosi barrë të rënda mbi ta. Ashtu si kishte profetizuar Jozefi, Zoti ngriti Moisiun për të çliruar bijtë e Izraelit (2 Nefi 3:10).

#### 1. Zoti thërret Moisiun për të çliruar Izraelin nga skllavëria.

Vëreni anëtarin e caktuar të klasës që të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të Eksodit 1 dhe 2; pastaj jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 3.

- Si e thirri Zoti Moisiun për të çliruar Izraelin nga skllavëria? (Shih Eksodi 3:1–4.) Çfarë i tha Zoti Moisiut ndërsa po e thërriste? (Shih Eksodi 3:5–10.) Çfarë mund të mësojmë për Zotin nga thirrja e Moisiut prej Tij? (Përgjigjet mund të përfshijnë se Zoti i njeh njerëzit e Tij, është i mëshirshëm ndaj tyre, dëshiron t'i bekojë ata dhe i mban premtimet e Tij ndaj tyre.)
- Ftojini anëtarët e klasës që të përfytyrojnë sikur janë bijtë e Izraelit që jetojnë në Egjipt. Për breza me radhë atyre u ishte dhënë mësim se ishin populli i besëlidhur i Perëndisë dhe se Ai do t'i përmbushte premtimet që i kishte bërë Abrahamit. Përsëri, tani ata ishin skllavër, që jetonin në shtypje dhe skllavëri. Çfarë mund të mësojmë nga kjo rrethanë që mund të na ndihmojë kur përjetojmë vështirësi? (Perëndia nuk na harron në vështirësitë tona, siç tregoi duke thirrur Moisiun dhe duke e çliruar së fundi Izraelin. Por zakonisht, Ai nuk na

çliron menjëherë nga sprovat. Pavarësisht se sa e gjatë të jetë sprovat, ne duhet të vazhdojmë t'i lutemi Atij, duke mirëbesuar se Ai na do dhe se do të bëjë që të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për të mirën tonë nëse i bindemi Atij. Shih DeB 90:24; 98:3; Mosia 24:14–15.) Në ç'mënyrë keni marrë ju ngushëllim e ndihmë nga Zoti në kohë vështirësish?

- Çfarë tha Moisiu kur Zoti e thirri atë për të çliruar Izraelin? (Shih Eksodi 3:11; 4:1, 10.) Në çfarë mënyrash Moisiu ndihej i papërshtatshëm? Çfarë sigurie i dha Zoti atij? (Shih Eksodi 3:12; 4:11–12.) Si ndiheni kur merrni një thirrje nga Zoti? Përse disa ndjenja papërshtatshmërie mund të jenë të mira? Si ju ka ndihmuar Zoti në thirrje për të cilat u ndiet i papërshtatshëm?
- Çfarë sakrifikoi Moisiu duke pranuar thirrjen për të udhëhequr popullin e tij? (Shih Hebrenjve 11:24–26.) Çfarë sakrifikojmë ne duke pranuar thirrje për t'i shërbyer Zotit? Përse është e rëndësishme që ne të jemi të gatshëm të sakrifikojmë për Zotin?

## 2. Përse Zoti dërgoi plagët mbi Egjipt?

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 5–6. Ju mund të dëshironi gjithashtu të jepni një përmbledhje të shkurtër të Eksodit 7–10, duke shpjeguar se Moisiu shkoi shumë herë tek Faraoni dhe i kërkoi ta çlironte Izraelin. Me gjithë shenjat, mrekullitë dhe plagët, Faraoni kundërshtoi. Ju ndoshta nuk duhet të shpenzoni nga koha e mësimin për të rishikuar shenjat, mrekullitë dhe plagët e veçanta.

- Si u përgjigj Faraoni herën e parë që Moisiu dhe Aaroni i kërkuan atij t'i linte të shkonin bijtë e Izraelit? (Shih Eksodi 5:1–9.) Si reagues bijtë e Izraelit ndaj kësaj sprove? (Shih Eksodi 5:15–21.) Si reagoi Moisiu ndaj saj? (Shih Eksodi 5:22–23.) Çfarë mund të mësojmë nga ky tregim? (Një gjë që mund të mësojmë është nevoja për durim në vështirësi. Zoti do t'i përmbushë premtimet e Tij, ndonëse mund të mos ta bëjë këtë në kohën ose mënyrën se si presim ne.)
- Pasi Faraoni e shtoi barrën e Izraelit, Zoti ia përsëriti premtimet e Tij Moisiut. Cilat ishin këto premtime? (Shih Eksodi 6:4–8.) Si u përgjigjën bijtë e Izraelit kur Moisiu ua kujtoi këto premtime? (Shih Eksodi 6:9.) Përse disa nga ne pushojnë së dëgjuari profetët dhe së besuari në premtimet e Perëndisë gjatë kohës së sprovave? Si mund ta ruajmë besimin te Perëndia gjatë vështirësive?
- Si u përgjigj Moisiu kur Zoti i kërkoi të shkonte përpara Faraonit për herë të dytë për të kërkuar lirinë e Izraelit? (Shih Eksodi 6:10–12.) Vini në dukje se dhe ne nganjëherë mund të jemi gjithashtu ngurrues për të bërë atë që kërkon Zoti për shkak të frikës ose për shkak se nuk mendojmë se është e mundur. Si ju ka ndihmuar Zoti kur keni ndier dyshim ose frikë?

## 3. Zoti e udhëzon Moisiun për përgatitjen e Pashkës.

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 11–13.

- Cili ishte qëllimi i Pashkës së parë? (Shih Eksodi 12:12–13, 22–23.) Përse Zoti dëshironte që Izraeli të vazhdonte ta mbante Festën e Pashkës në vitet e ardhshme? (Shih Eksodi 12:24–27, 42; 13:1–10.)
- Shpjegoni se përveç që ta kujtonte Izraelin se Perëndia i kishte mbrojtur ata nga plaga e vdekjes dhe i kishte çliruar nga egjiptianët, Pashka simbolizonte gjithashtu një ngjarje të ardhshme të rëndësishme. Cila ishte kjo ngjarje? (Sakrifika

shlyese e Jezu Krishtit, Qengjit të Perëndisë, që na çliron nga mëkati dhe vdekja. Shih 1 Korintasve 5:7.) Në ç'mënyrë Pashka simbolizonte Shlyerjen?

Ju mund të dëshironi të tregoni ngjashmëritë vijuese midis Pashkës dhe sakrificës shlyese të Jezu Krishtit:

- a. Bijtë e Izraelit duhej të përdornin një qengj mashkull të parëlindur e pa të meta në Pashkë (Eksodi 12:5). Shpëtimtari është Biri i Parëlindur i Perëndisë, Qengji i Perëndisë i panjollë dhe i patëmetë (1 Pjetrit 1:19).
  - b. Bijtë e Izraelit duhej të spërkatnin dyert e tyre me gjakun e qengjit për të shpëtuar nga vdekja të parëlindurit e tyre (Eksodi 12:7, 22–23). Gjaku i Shpëtimtarit, që Ai e derdhi në Gjetseman dhe në kryq, pastron besnikët dhe i shpëton ata nga vdekja shpirtërore (Mosia 4:2).
  - c. Bijtë e Izraelit duhej të hanin bukë të ndorme (Eksodi 12:8, 15–20). “Majaja, ose tharmi, shihej në kohët e lashta si një simbol i korrupsionit sepse prishet dhe myket kaq lehtë. . . . Për izraelitët, ngrënia e bukës së ndorme simbolizonte se ata po merrnin nga buka që nuk kishte korrupsion ose papastërti, domethënë, Buka e Jetës, që është Jezu Krishti (shih Gjoni 6:35)” (*Old Testament Student Manual: Zanafilla–2 Samuel* [1981], f. 119). Heqja e majasë sugjeronte gjithashtu pendim, apo heqjen e mëkatit nga jeta e një njeriu.
  - ç. Bijtë e Izraelit duhej ta hanin Pashkën me nxitim (Eksodi 12:11). Ashtu si izraelitët, ne duhet t'i përgjigjemi me padurim dhe menjëherë çlirimit që Shpëtimtari na ofron.
- Në Darkën e Fundit, Shpëtimtari krijoi sakramentin në vend të Pashkës (Mateu 26:19, 26–28). Paraqisni figurën e Shpëtimtarit, duke vendosur shiritin me fjalën *Pashka* në anën e majtë dhe shiritin me fjalën *Sakramenti* në të djathtën. Çfarë ngjashmëri ka midis Pashkës dhe sakramentit? (Shih Eksodi 12:14; 13:9–10; DeB 20:75–79.)

Plaku Hauard W. Hanter dha mësim se në vaktin e Pashkës që tani njihet si Darka e Fundit, “buka dhe vera në vend të kafshëve e të barishteve, [u bënë] emblemat e trupit dhe gjakut të Qengjit të mrekullueshëm, emblema që duhen ngrënë e pirë me nderim dhe në kujtim të tij përgjithmonë.

Në këtë mënyrë të thjeshtë por mbresëlënëse, Shpëtimtari krijoi ordinancën që njihet tani si sakramenti i Darkës së Zotit. Me vuajtjen në Gjetseman, sakrificën në Kalvar dhe ringjalljen nga një varr në kopsht, Jezusi përmbushi ligjin e lashtë dhe shpalli një periudhë të re ungjillore bazuar në një kuptueshmëri më të lartë e më të shenjtë të ligjit të sakrificës. Njerëzve nuk do t'u kërkohej më të ofronin qengjin e parëlindur nga tufa e tyre, sepse i Parëlinduri i Perëndisë kishte ardhur për t'u ofruar si një ‘flijim i pafundëm dhe i përjetshëm’ ” (në Conference Report, prill 1985, f. 22; ose *Ensign*, maj 1985, f. 19).

- Plaku Hauard W. Hanter tha se tamam ashtu si Pashka ishte një besëlidhje mbrojtjeje për Izraelin e lashtë, sakramenti është një “besëlidhje e re sigurie” për ne (në Conference Report, prill 1974, f. 24; ose *Ensign*, maj 1974, f. 18). Në ç'mënyrë sakramenti është një besëlidhje sigurie për ne? (Sakramenti na kujton për sakrificën shlyese të Shpëtimtarit, që sjell siguri të përjetshme duke na liruar nga lidhjet e mëkatit e të vdekjes. Besëlidhjet që përtërijmë kur marrim sakramentin, na ndihmojnë gjithashtu të marrim siguri të përjetshme.)

Plaku Xhefri R. Holland pyeti:

“A e shohim [sakramentin] si pashkën *tonë*, kujtimin e sigurisë dhe çlirimit, dhe shëlbimit *tonë*?”

Me kaq shumë në rrezik, kjo ordinancë që përkujton shpëtimin tonë nga engjëlli i errësirës, duhet të merret më seriozisht nga sa merret ndonjëherë. Ajo duhet të jetë një çast i fuqishëm, nderues, mendimi të thellë. Ajo duhet të nxisë ndjenja dhe mbresa shpirtërore” (në Conference Report, tetor 1995, f. 89; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 68).

- Në udhëzimet e Tij për Pashkën, Zoti theksoi nevojën që prindërit t’u mësojnë fëmijëve të tyre kuptimin e saj (Eksodi 12:26–27; 13:8, 14). Përse ishte e rëndësishme që prindërit izraelitë ta bënë këtë? Si mund të zbatohet kjo në kohën tonë? (Ashtu si Izraeli i lashtë, ne duhet t’u mësojmë fëmijëve tanë kuptimin e sakramentit dhe të ordinancave të tjera që na kujtojnë për dorën e Zotit në çlirimin tonë nga mëkati dhe vdekja.)

#### 4. Bijtë e Izraelit kapërcejnë Detin e Kuq.

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 14.

- Pasi Faraoni i lejoi bijtë e Izraelit që të largoheshin nga Egjipti, ai u kthye kundër tyre dhe dërgoi ushtrinë e tij pas tyre (Eksodi 14:5–9). Çfarë bënë bijtë e Izraelit kur panë ushtrinë që po afrohej? (Shih Eksodi 14:10–12.) Çfarë u tha Moisiu bijve të Izraelit kur besimi i tyre u lëkund? (Shih Eksodi 14:13–14.) Si mund të zhvillojmë besim mjaft të fortë sa të na mbështesë kur jemi të mbushur me frikë?
- Si i shpëtoi Zoti bijtë e Izraelit nga ushtria egjiptiane që po afrohej? (Shih Eksodi 14:21–31.) Si mund të na ndihmojë kjo histori në kohë sprove?

Përfundim

Dëshmoni se po ashtu si Zoti e përmbushi premtimin e Tij për të çliruar izraelitët nga skllavëria, Ai do të përmbushë premtimet e Tij ndaj nesh. Nxitini anëtarët e klasës që ta rrisin vlerësimin e tyre për sakrificën shlyese të Shpëtimtarit dhe ta marrin sakramentin denjësisht e mendueshëm, duke mbajtur besëlidhjen që “gjithmonë ta kujtojnë atë” (DeB 20:77).

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

#### 1. Satani falsifikon fuqinë e Perëndisë

- Çfarë bëri Faraoni kur Moisiu dhe Aaroni po i tregonin shenja të fuqisë së Perëndisë? (Shih Eksodi 7:8–12, 17–22.) Çfarë mund të mësojmë për Satanin nga këto vargje?
- Cilat janë disa mënyra se si Satani falsifikon sot fuqinë dhe bekimet e Perëndisë? Çfarë dhuntish na ka dhënë Zoti për të na ndihmuar që të dallojmë midis së mirës e së ligës? Si mund ta rrisim aftësinë tonë për të dalluar midis së mirës dhe së ligës?



## 2. Plagët

- Përse Zoti dërgoi plagët mbi Egjipt? (Shih Eksodi 7:5, 17; 8:10; 9:14, 29; 10:2; 14:4.) Cili ishte reagimi i Faraonit ndaj plagëve? (Shih, për shembull, Eksodi 8:8, 15, 25, 28, 32.) Përse plagët nuk dëmtuan bijtë e Izraelit? (Shih Eksodi 9:4–6, 23–26; 10:22–23; 11:4–7.)

## 3. Pashka

Ndërsa jepni mësim se si Pashka është simbol i Shlyerjes së Jezu Krishtit, ju mund të dëshironi të merrni artikujt vijues për të ilustruar simbolet e Pashkës:

- a. Figura të një qengji dhe një dere.
- b. Tortila, biskota të thata, ose mecu (për të përfaqësuar bukën e sheshtë, pa maja).
- c. Rrepë ose marule (për barishte të hidhura).
- ç. Një palë këpucë ose sandale (izraelitët e hëngrën vaktin ushqimor me këpucë të veshura, duke simbolizuar nxitimin me të cilin lanë Egjiptin).

## 4. “Të gjithë u pagëzuan . . . në re dhe në det” (1 Korintasve 10:2)

Ju mund të dëshironi të lexoni 1 Korintasve 10:1–4, ku Pali jep mësim se bijtë e Izraelit u pagëzuan në re dhe në det. Duke shpjeguar domethënien e kësaj, Plaku Brus R. Mek-Konki tha: “[Pali] po thotë se tamam si Izraeli, kur ata kaluan nëpër Detin e Kuq, u arratisën nga natyra materialiste e Egjiptit, po ashtu pasardhësit e tyre të krishterë, nëpërmjet pagëzimit, duhet të braktisin epshet e mishit dhe të jetojnë jetë të perëndishme” (*Doctrinal New Testament Commentary*, 3 vëll. [1966–1973], 2:355).

## Qëllimi

Të nxisë anëtarët e klasës që të marrin nga uji dhe buka shpirtërore e Zotit, të mbështesin udhëheqësit e Tij të zgjedhur e t’u binden urdhërimeve të Tij, që Ai të mund t’i bëjë ata një “komb [të] shenjtë” (Eksodi 19:6).

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Eksodi 15:22–27; 16:1–31; 17:1–7. Bijtë e Izraelit mërmërisin sepse janë të etur e të uritur dhe Zoti siguron ujë, manë dhe shkurta.
  - b. Eksodi 17:8–13; 18:13–26. Amaleku vjen për të luftuar me Izraelin. Izraeli fiton kur Moisiu i mban lart duart e tij, por Amaleku fiton kur Moisiu lodhet dhe i ul duart. Aaroni dhe Huri i mbajnë lart duart e Moisiut dhe Izraeli e fiton betejën (17:8–13). Moisiu ndjek këshillën e Jethros për të caktuar gjykatës dhe për t’u deleguar autoritet atyre (18:13–26).
  - c. Eksodi 19–20. Zoti takon Moisiun në malin Sinai dhe i jep Izraelit Dhjetë Urdhërimet.
  - ç. Eksodi 32–34. Moisiu merr pllakat prej guri që përmbajnë udhëzimet nga Zoti, por i thyen pllakat kur kthehet nga Sinai dhe i sheh njerëzit që adhurjnë një viç të artë (31:18; 32:1–24). Zoti i merr ordinancat e Priftërisë Melkizedeke nga Izraeli dhe jep një ligj më të ulët, ligjin e Moisiut (Përkthimi prej Jozef Smithit, Eksodi 34:1–2). Moisiu pret pllaka të reja prej guri për të zëvendësuar ato që kishte thyer, por pllakat e reja nuk përfshijnë “fjalë[t e] besëlidhjes së përjetshme të priftërisë së shenjtë” (Eksodi 34:1–5; Përkthimi prej Jozef Smithit, Ligji i Përtërirë 10:2). Populli besëlidh që t’i bindet ligjit të Moisiut (34:10–35).
2. Lexim shtesë: Psalmeve 78; 1 Korintasve 10:1–11; Doktrina e Besëlidhje 84:19–27.
3. Sillni në klasë disa libra ose objekte të tjera të rënda nëse do të përdorni mësimin me objekt në faqet 64–65.
4. Nëse është e disponueshme *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224), ju mund të dëshironi të shfaqni “Modern Idolatry” [“Idhujtaria Moderne”], një fragment shtatëminutësh, si pjesë të mësimin.

## Sugjerime për

### Zhvillimin e Mësimin

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

### Aktivitet Vëmendjeje

- Përfytyroni sikur duhet të bëni një udhëtim në një vend të shkretë ku nuk keni qenë kurrë dhe për të cilin nuk ka hartë. Si do të përgatiteshit për këtë udhëtim? (Përgjigjet mund të ndryshojnë, por një përgatitje e dobishme do të ishte të gjenit një udhërrëfyes.)
- Çfarë kualifikimi do të dëshironit te një udhërrëfyes që po ju udhëheq nëpër një vend të shkretë? (Përgjigjet mund të ndryshojnë, por udhërrëfyesi duhet ta njohë zonën dhe të jetë i besuar.)

- Cili ishte udhërrëfytyesi për Moisiun dhe bijtë e Izraelit pasi u arratisën nga Egjipti dhe hynë në vendin e shkretë? (Zoti.)

Vini në dukje se përvojat e izraelitëve ndërsa po udhëtonin nëpër vendin e shkretë mund të na japin mësim të rëndësishme ndërsa udhëtojmë nëpër vdekshmëri. Një mësim i rëndësishëm është se mund të kemi mirëbesim te Perëndia që të na udhëheqë e të kujdeset për ne siç bëri për izraelitët.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë. Meqë do të jetë e vështirë të bëni çdo pyetje ose të trajtoni çdo pikë në mësim, përzgjidhni me lutje ato që do të plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës.

### 1. Zoti siguron ujë, manë dhe shkurta për bijtë e Izraelit.

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 15:22–27; 16:1–31; dhe 17:1–7.

Pasi izraelitët kishin kaluar nëpër Detin e Kuq, Zoti e udhëzoi Moisiun që t'i udhëhiqte ata për në tokën e premtuar. Por së pari, Zoti testoi besimin e izraelitëve në vendin e shkretë. Shumë prej njerëzve iu mungoi besimi, duke u ankuar për Zotin në vend që të ktheheshin tek Ai. Megjithatë, Zoti siguroi ujë për etjen e tyre dhe mana e shkurta për urinë e tyre.

- Me çfarë problemi u përballën izraelitët tek Eksodi 15:22–24 dhe 17:1–3? Si u përgjigj Moisiu kur njerëzit murmuritën kundër tij? (Shih Eksodi 15:25; 17:4. Ai iu drejtua Zotit për ndihmë.) Çfarë mund të mësojmë nga përgjigjja e Moisiut? Si iu përgjigj Zoti lutjeve të Moisiut për ndihmë? (Shih Eksodi 15:25–26; 17:5–7.)
- Zoti siguroi ujë fizik dhe shpirtëror për bijtë e Izraelit. Uji fizik doli nga shkëmbi që goditi Moisiu; “pjj[a] frymërore” erdhi nga “shkëmbi frymëror”, që është Krishti (1 Korintasve 10:4). Çfarë është uji shpirtëror që rrjedh nga Krishti? (Shih 1 Nefi 11:25.) Si mund ta pijmë atë ujë? Çfarë u premtohet atyre që e pijnë atë ujë? (Shih Gjoni 4:14; DeB 63:23.)
- Me çfarë problemi u përballën izraelitët tek Eksodi 16:2–3? Si u përgjigj Zoti? (Shih Eksodi 16:4, 11–15.) Përveç që të shuante urinë e njerëzve, cilat qenë disa qëllime të tjera të dërgimit të manës?
  - a. Do t'i tregonte Zotit nëse njerëzit e Tij do t'i bindeshin Atij (Eksodi 16:4, 16–31).
  - b. Do t'u jepte njerëzve kujtues të përditshëm të fuqisë dhe të dashurisë së Zotit (Eksodi 16:12).
  - c. Do t'u mësonte njerëzve se ata nuk rrojnë “vetëm me bukë, por . . . me çdo fjalë që del nga goja e Zotit” (Ligji i Përtërirë 8:3).
  - ç. Do t'i përulte njerëzit dhe do t'i ndihmonte të merrnin shpëtim (Ligji i Përtërirë 8:16).
- Si mendoni në ju, në ç'mënyrë dërgimi i manës ndihmoi për të përmbushur secilin prej këtyre qëllimeve? Në ç'mënyrë e përmbush Zoti secilin prej këtyre qëllimeve në jetën tonë?
- Në ç'mënyrë mana është një përfaqësuese për Krishtin? (Shih Gjoni 6:35.) Në ç'mënyrë buka e gjallë e Krishtit ndryshon nga mana? (Shih Gjoni 6:48–51.) Në ç'mënyrë mund të hamë përditë nga buka e gjallë e Krishtit?

- Izraelitëve u duhej të mblidhnin mana çdo ditë për të mbajtur forcën e tyre fizike. Në ç'mënyrë mund të krahasohet kjo me atë që duhet të bëjmë për të ruajtur forcën shpirtërore? (Pikërisht ashtu siç na duhet ushqim i përditshëm për të ruajtur forcën fizike, na duhet edhe ushqim i përditshëm për të ruajtur forcën shpirtërore. Nuk mund të presim të ushqehemi shpirtërisht nëse studiojmë shkrimet e shenjta dhe lutemi vetëm nganjëherë.)
- Çfarë ndodhte zakonisht kur izraelitët e mbanin manën gjatë natës? (Shih Eksodi 16:19–20.) Çfarë ndodhi kur ata e mbajtën manën gjatë natës në përgatitje për Shabatin? (Shih Eksodi 16:22–25.) Si mund ta zbatojmë këtë parim për përgatitjen tonë javore për Shabatin?
- Çfarë do t'u kishte ndodhur izraelitëve nëse do të ishin përpjekur të udhëtonin nëpër vendin e shkretë pa ndihmën e Zotit? Çfarë do të na ndodhë neve nëse përpiqemi të udhëtojmë nëpër vdekshmëri pa ndihmën e Zotit?

## 2. Aaroni dhe Huri i mbajnë lart duart e Moisiut dhe Izraeli fiton në betejën kundër Amalekut. Moisiu ndjek këshillën e Jethros për të caktuar gjykatës dhe për t'u deleguar autoritet atyre.

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 17:8–13 dhe 18:13–26. Vini në dukje se të dy këto rrëfime na mësojnë rëndësinë e mbështetjes dhe përkrahjes së udhëheqësve të Kishës.

- Amalekitët luftuan me fëmijët e Izraelit për shumë vite, duke filluar që nga koha e Moisiut. Në ç'mënyrë izraelitët qenë në gjendje të mundnin popullin e Amalekut në betejën e përshkruar tek Eksodi 17:8–13? (Kur Aaroni dhe Huri e mbështetën Moisiun duke i mbajtur lart krahët e tij, Izraeli fitoi në betejë.) Çfarë lloj betejash shpirtërore zhvillojmë ne sot? Në ç'mënyrë mbështetja e profetit na ndihmon të fitojmë në këto beteja?

Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Më kujtohet se si Moisiu lart në kodër ngriti krahët për fitoren e ushtrive të Izraelit. Për aq kohë sa krahët e tij ishin të ngritur, Izraeli fitoi, por kur ato uleshin poshtë nga lodhja, atëherë armiku fitonte. Dhe kështu Aaroni dhe Huri 'ia mbanin duart, njëri nga një krah, tjetri nga krahu tjetër' dhe Izraeli qe fitimtar (Eksodi 17:12). Po kështu do të jemi ne fitimtarë kur mbajmë lart krahët e shërbëtorëve të vajosur të Zotit” (në Conference Report, prill 1986, f. 98; ose *Ensign*, maj 1986, f. 77).

- Çfarë e shqetësoi Jethron kur pa njerëzit që vinin te Moisiu nga mëngjesi deri në mbrëmje? (Shih Eksodi 18:13–18.) Çfarë këshilloi Jethro që të bënte Moisiu? (Shih Eksodi 18:19–23.)
- Çfarë përgjegjësish të një profeti përmenden tek Eksodi 18:16–20?

Ju mund të dëshironi t'i vini anëtarët e klasës që të kërkojnë përgjegjësitë në këto vargje, pastaj rendisni përgjigjet në dërrasë. Ju mund të dëshironi gjithashtu të përdorni mësimin vijues me objekt: Ftoni një anëtar të klasës që të mbajë lart duart e tij apo të saj. Ndërsa dallohet përgjegjësia e parë, vendosni një libër ose ndonjë objekt tjetër të rëndë në duart e anëtarit të klasës. Shtoni një libër tjetër ose objekt të rëndë ndërsa dallohet secila përgjegjësi tjetër.

- a. Të qenit gjykatës për njerëzit (Eksodi 18:16).
- b. Përfaqëson njerëzit përpara Perëndisë (Eksodi 18:19).
- c. “[U mëson] atyre statutet dhe ligjet” (Eksodi 18:20).
- ç. “[U tregon] rrugën nëpër të cilën duhet të ecin” (Eksodi 18:20).
- d. “[U tregon] . . . atë që duhet të bëjnë” (Eksodi 18:20).

- Si mundemi ne që t'u mbajmë lart duart dhe t'u lehtësojmë barrët profetit dhe apostujve tanë sot? (Shih DeB 21:4–5; 107:22. Ndërsa anëtarët e klasës japin sugjerime, hiqni disa nga librat ose objektet e tjera nga krahët e anëtarit të klasës që po i mban ato.)
- Si mundemi ne që t'i mbështesim dhe përkrahim udhëheqësit tanë vendorë të Kishës? (Përgjigjet mund të përfshijnë që të flasim mirë për ta, të shërbejmë me zell në thirrjet tona në Kishë dhe të jemi mësues shtëpie dhe mësuese vizitore të mira.)
- Si jeni bekuar ndërsa keni mbështetur udhëheqësit e Kishës? (Ju mund të dëshironi të përdorni DeB 21:6 në këtë diskutim.)

### 3. Zoti takon Moisiun në malin Sinai dhe i jep Izraelit Dhjetë Urdhërimet.

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 19–20.

Brenda tre muajve nga hyrja e Izraelit në shkretëtirë, Zoti dëshironte të vendoste besëlidhjen e Tij me ta (Eksodi 19:5–6). Si pjesë e kësaj besëlidhjeje Ai i zbuloi Moisiut Dhjetë Urdhërimet.

- Ndërsa fëmijët e Izraelit ngritën kampin tek mali Sinai, çfarë u premtoi Zoti nëse do të ishin të bindur? (Shih Eksodi 19:3–6. Ai do t'i bënte ata “thesar[ të] veçantë . . . një mbretëri priftërinjsh dhe një komb [të] shenjtë”.) Çfarë duan të thonë këto premtime? Si zbatohen sot për ne këto premtime?

Këto premtime duan të thonë se Izraeli do të bëhej populli i besëlidhjes së Zotit, i favorizuar mbi gjithë të tjerët dhe i zgjedhur për t'u dhënë priftërinë dhe ungjillin të gjithë njerëzve (shih edhe Ligji i Përtërirë 7:6; 14:1–2; 1 Pjetrit 2:9).

- Çfarë përvoja dëshironte Zoti që të kishte populli i Tij tek mali Sinai? (Shih Eksodi 19:9, 11, 16–17; DeB 84:23.) Çfarë i kërkoi Zoti popullit të Tij që të bënte përpara se njerëzit të mund të takoheshin me Të? (Shih Eksodi 19:10, 14.)
- Mali Sinai ishte një vend i shenjtë ku Zoti dëshironte të fliste me popullin e Tij dhe t'i shfaqej atij. Çfarë vendesh të shenjta ka siguruar Ai ku ne mund të marrim po ato bekime? (Tempujt; shih DeB 97:15–16; 109:12–13.) Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë se si tempulli i ka ndihmuar ata të dëgjojnë zërin e Zotit dhe të ndiejnë praninë e Tij.
- Katër urdhërimet e para tek Eksodi 20, japin mësim marrëdhënien e duhur midis nesh dhe Perëndisë (Eksodi 20:3–11). Në ç'mënyrë urdhërimi për të adhuruar Zotin dhe për të mos pasur perëndi të tjera përpara Tij është i përshtatshëm sot? Çfarë perëndish të rreme adhurojnë njerëzit sot? (Shih 1 Samuelit 15:23; Efesianëve 5:5; DeB 1:15–16.)

Presidenti Spenser W. Kimball tha:

“Idhujtaria është mes mëkateve më serioze. . . . Idhuj modernë ose perëndi të rreme mund të marrin forma të tilla si veshje, shtëpi, biznese, makineri, automobila, barka për qejf dhe zotërime të tjera të shumta materiale që na mbajnë larg shtegut drejt perëndishmërisë. . . .

Gjëra jo të prekshme mund të bëhen po aq lehtë perëndi të rreme. Grada shkencore dhe çmime arritjeje, dhe tituj postesh mund të bëhen idhuj. . . .

Shumë njerëz ndërtojnë e mobilojnë një shtëpi dhe blejnë një automobil së pari – dhe pastaj ‘nuk kanë para mjaftueshëm’ sa të paguajnë të dhjetën. Cilin adhurojnë ata? Sigurisht jo Zotin e qiellit dhe të tokës. . . .

Shumë adhurojnë gjuetinë, udhëtimin për peshkim, pushimet, piknikët e shëtitjet për fundjavë. Të tjerë kanë si idhuj të tyre lojërat sportive, bejzbollin, futbollin, ndeshjet me dema, ose golfin. . . .

Përsëri një tjetër imazh që njerëzit adhurojnë, është ai i pushtetit dhe i prestigjit. Këto perëndi të pushtetit, pasurisë dhe ndikimit marrin shumë nga koha jonë dhe janë po aq të vërtetë sa viçat e artë të fëmijëve të Izraelit në shkretëtirë” (*The Miracle of Forgiveness* [1969], f. 40–42).

- Cilat janë disa mënyra se si njerëzit e përdorin më kot emrin e Perëndisë? Përse është e rëndësishme që ne të mos e përdorim kot emrin e Tij?
- Përse është e rëndësishme për ne që ta mbajmë të shenjtë ditën e Shabatit? (Shih Eksodi 20:8; 31:16–17; Isaia 58:13–14; DeB 59:9–10.) Si duhet të vendosim se cilat aktivitete janë të përshtatshme për Shabatit? Si jeni bekuar ndërsa e keni mbajtur të shenjtë këtë ditë?
- Rishikoni gjashtë urdhërimet që lidhen me marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë (Eksodi 20:12–17). Në ç’mënyrë bindja ndaj këtyre urdhërimeve përmirëson marrëdhëniet tona me të tjerët? (Ju mund të dëshironi të përqendrohni tek urdhërimet e veçanta, duke shpjeguar se çfarë duan të thonë dhe duke i diskutuar si të jetë e përshtatshme.)

#### 4. Zoti paraqet ligjin e Moisiut.

Jepni mësim dhe diskutoni për Eksodin 32–34.

Kur Zoti foli me Moisiun në malin Sinai, Ai zbuloi një ligj që përfshinte ordnancat e Priftërisë Melkizedeke (DeB 84:19–23). Megjithatë, sjellja idhujtare e izraelitëve tregoi se ata nuk ishin gati që të jetonin plotësinë e ungjillit (Eksodi 32:1–9; DeB 84:24). Meqenëse ata e harruan kaq shpejt Zotin, Ai e hoqi prej tyre Priftërinë Melkizedeke dhe zbuloi një ligj më të ulët – ligjin e Moisiut (Përkthimi prej Jozef Smithit, Eksodi 34:1–2; DeB 84:25–27).

Ligji i Moisiut nuk zëvendësoi urdhërimet, besëlidhjet, ose parimet e ungjillit. Përkundrazi, ai siguroi “një ligj kryerjesh dhe ordinancash, një ligj që ata duhej ta respektonin rreptësisht nga dita në ditë, për t’i bërë ata të kujtonin Perëndinë dhe detyrën e tyre kundrejt tij” (Mosia 13:30). Ligji i Moisiut u mësoi njerëzve t’i rrëfenin mëkatet e tyre dhe të kompensonin për to, të ndiqnin rregulla strikte në ofrimin e sakrifikimit të kafshëve, t’i mbanin të shëndetshëm trupat e tyre, të jepnin për të mbështetur punën e Zotit, t’i jepnin falënderime dhe të ishin në pajtim me Perëndinë.

- Përse Zoti u dha ligjin e Moisiut fëmijëve të Izraelit? (Shih Galatasve 3:23–24; Mosia 13:29; Alma 25:15–16; DeB 84:19–27.) Në ç’mënyrë ky ligj do të ndihmonte për ta bërë të shenjtë Izraelin dhe për ta sjellë atë te Krishti? (Shih Mosia 13:30, Alma 34:14–15.)
- Kur u përmbush ligji i Moisiut? (Shih 3 Nefi 15:4–10.) Tani që Zoti nuk kërkon më sakrifikime të kafshëve, që ishin një pjesë e rëndësishme e ligjit të Moisiut, çfarë sakrifice na kërkon Ai që të bëjmë ne? (Shih 3 Nefi 9:19–22.) Çfarë do të thotë të ofrosh një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar?

Plaku M. Rasëll Ballard dha mësim:

“Edhe pse ligji i Moisiut u përmbush, parimet e ligjit të sakrificës vazhdojnë të jenë një pjesë e doktrinës së Kishës.



Ndërkohë që qëllimi fillestar i ligjit të sakrificës vazhdoi të jetë ai i vënies në provë dhe i ndihmës për ne që të vijmë te Krishti, dy rregullime u bënë pas sakrificës përfundimtare të Krishtit. Së pari, ordianca e sakramentit zëvendësoi ordinancën e sakrifikimit [të kafshëve]; dhe e dyta, ky ndryshim e zhvendosi përqendrimin e sakrificës nga kafsha e një njeriu te vetë njeriu. Në një kuptim, sakrifica ndryshoi nga oferta tek ofruesi. . . .

. . . Pas shërbesës së Tij në vdekshmëri, Krishti e ngriti ligjin e sakrificës në një nivel të ri. . . . Në vend që Zoti të kërkojë kafshën ose grurin e një personi, tani Zoti dëshiron që ne të heqim dorë prej gjithçkaje që është e paperëndishme. Kjo është një praktikë më e lartë e ligjit të sakrificës; ajo arrin në shpirtin e brendshëm të një njeriu” (*The Law of Sacrifice* [fjalim i dhënë në Church Educational System Symposium, 13 gusht 1996], f. 5).

## Përfundim

Dëshmojuni anëtarëve të klasës që, nëse ata do të marrin nga uji dhe buka shpirtërore e Zotit, do të mbështesin udhëheqësit e Tij të zgjedhur e do t’u binden urdhërimeve të Tij, Ai do t’i ftojë ata te mali i Tij i shenjtë – tempulli. Atje ata mund të takohen me Të, të marrin ligjet e Tij, të shohin lavdinë e Tij dhe të ecin përpara të frymëzuar që të jenë më shumë si Ai.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

### 1. Dhjetë Urdhërimet

Vëreni se të Dhjetë Urdhërimet përsëriten te Ligji i Përtërirë 5:5–21, Mosia 12:33–36 e Mosia 13:12–24 dhe DeB 42:18–27 e DeB 59:5–16. Rishikojini këto fragmente për ide të mëtejshme mbi Dhjetë Urdhërimet.

### 2. Viçi i artë

Ju mund të dëshironi të diskutoni për historinë e ndërtimit e të adhurimit të viçit të artë siç është shënuar tek Eksodi 32. Parime të shumta mund të nxirren nga kjo histori, përfshirë dy të mëposhtmet:

- a. Zakonet dhe modelet e vjetra të besimit ose të sjelljes hiqen me vështirësi. Edhe pse izraelitët e kishin lënë Egjiptin fizikisht, ata ende nuk ishin të lirë shpirtërisht nga ndikimet e tij. Pasi izraelitët e kishin dëgjuar zërin e Perëndisë të shpallte Dhjetë Urdhërimet nga Sinai, ata shpejt i shkelën dy të parët.
- b. Është e rëndësishme t’i rezistojmë shtytjes negative të shokëve. Aaroni iu dha dëshirave të padrejta të izraelitëve. Nganjëherë, udhëheqësit dhe prindërit duhet të thonë “jo”, edhe nëse ka rrezik të fyhen ose largohen ata për të cilët ata janë përgjegjës.

## Qëllimi

Të nxisë anëtarët e klasës që të kapërcejnë dëshirat e frikën tokësore dhe të shikojnë te Shpëtimtari e profetët e Tij për udhëheqje.

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:

- a. Numrat 11. Izraelitët ankohen për manën dhe dëshirojnë të hanë mish (11:1–9). Moisiu i kërkon Zotit udhëheqje dhe ndihmë për të duruar barrët e tij (11:10–15). Siç udhëzohet nga Zoti, Moisiu mbledh 70 pleq që ta ndihmojnë atë (11:16–17, 24–30). Zoti i përgjigjet dëshirës së izraelitëve për mish duke u dërguar shkurta me sipërbollëk dhe duke i goditur me një plagë për shkak të lakmisë dhe abuzimit të tyre (11:18–23, 31–35).
- b. Numrat 12. Miriami dhe Aaroni iu kundërvunë Moisiut me fjalë, duke u ankuar për martesën e tij me një grua etiopase dhe duke e sfiduar atë si autoritetin e tyre kryesues (12:1–3). Zoti i qorton dhe i dënon Miriamin dhe Aaronin për murmuritjen e tyre (12:4–16).
- c. Numrat 13–14. Moisiu udhëzon 12 burra që të vëzhgojnë vendin e Kanaanit (13:1–20; vini re se “Jozueu” në vargun 16 është një formë e emrit Jozue). Ata kthehen me raporte të mbara për burimet e vendit, por të gjithë përveç Jozueut dhe Kalebit, kanë frikë nga vendasit dhe dëshirojnë të kthehen në Egjipt (13:21–14:10). Zoti i thotë Moisiut se izraelitët mosbesues dhe ankues do të endeshin në shkretëtirë për 40 vite, derisa të vdisnin të gjithë të rriturit përveç Jozueut dhe Kalebit (14:11–39).
- ç. Numrat 21:1–9. Izraelitët i shkatërrojnë kanaanitët që vijnë kundër tyre (21:1–3). Zoti dërgon gjarpërinj flakërues si ndëshkim për ankimin e pareshtur të izraelitëve (21:4–6). Moisiu bën një gjarpër prej bronzi, e vendos mbi një shtizë dhe u thotë njerëzve që, nëse do të shihnin tek ai, ata do të jetonin (21:7–9).

2. Lexim shtesë: Gjoni 3:14–16; 1 Nefi 17:41; Alma 33:18–22; 37:46–47; Helamani 8:13–15.

3. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, bëni një afishe me fjalët *Toka e Premtuar*.

4. Nëse është e disponueshme figura Moisiu dhe Gjarpri prej Bronzi, ju mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë mësimin (62202).

## Sugjerime për

### Zhvillimin e Mësimin

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

### Aktivitet Vëmendjeje

Shkruani në dërrasë fjalën *Egjipt*. Vendosni një afishe me fjalët *Toka e Premtuar* në anën tjetër të dhomës. Sfidoni një anëtar të klasës që të shkojë nga dërrasa deri tek afishja ndërsa sheh mbi supin e tij ose të saj fjalën *Egjipt*.

Nëse anëtari i klasës ka vështirësi për të arritur tek afishja, bëjini pyetjen vijuese:

- Përse është e vështirë të ecësh drejt përpara ndërsa sheh pas?

Nëse anëtari i klasës e arrin lehtë afishen, bëjini pyetjen vijuese:

- Sa larg mendon se mund të shkosh pa u larguar nga vija e drejtë? Përse është e vështirë të ecësh drejt përpara ndërsa sheh pas?

Shpjegoni se kjo paraqitje mund të krahasohet me udhëtimin e izraelitëve nga Egjipti. Me gjithë bekimet që izraelitët morën nga Zoti, frika dhe mungesa e besimit prej tyre, shpesh i bënë që të uronin që të mos e kishin lënë Egjiptin. Malli i tyre për Egjiptin e vonoi dhe e ngatërroi udhëtimin e tyre për në tokën e premtuar.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë. Meqë do të jetë e vështirë të bëni çdo pyetje ose të trajtoni çdo pikë në mësim, përzgjidhni me lutje ato që do të plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës. Juve mund t'ju nevojitet t'i përshtasni disa pyetje që t'u shkojnë për shtat rrethanave të pjesëtarëve të klasës.

### 1. Zoti i përgjigjet dëshirës së izraelitëve për mish duke u dërguar shkurta dhe duke i goditur me një plagë.

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 11.

- Edhe pse mana që një bekim i madh nga Zoti, izraelitët filluan të ankohen për të (Numrat 11:6). Çfarë e nxiti ankimin e tyre? (Shih Numrat 11:4–5; ata filluan të mendonin e të dëshironin mishin dhe ushqime të tjera që kishin ngrënë në Egjipt.) Cilat janë rreziqet e të dëshiruara më shumë nga sa kemi tashmë?
- Izraelitët filluan ta dëshirojnë kaq shumë mishin saqë e humbën përqendrimin e tyre te toka e premtuar dhe filluan të dëshironin që të mos e kishin lënë Egjiptin (Numrat 11:4–6). Cilët janë disa shembuj nga ditët tona të njerëzve që heqin dorë nga bekime të mëdha me qëllim që të kënaqin dëshira të menjëherëshme? Përse e bëjnë njerëzit këtë? Si mund t'i kapërcejmë tundime të tilla?
- Si iu përgjigj Zoti dëshirës së izraelitëve për mish? (Shih Numrat 11:18–20, 31–33.)
- Moisiu u rëndua kaq shumë nga mëkatet e izraelitëve saqë i kërkoi Zotit që t'i merrte jetën (Numrat 11:14–15). Si e lehtësoi atë Zoti? (Shih Numrat 11:16–17. Shtatëdhjetë burra u thirrën për të ndihmuar Moisiun.) Çfarë bekimesh të mëdha morën këta burra? (Shih Numrat 11:24–29.)

### 2. Zoti qorton Miriamin dhe Aaronin ngaqë folën kundër Moisiut.

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 12.

- Miriami dhe Aaroni folën kundër Moisiut si autoriteti kryesues i tyre, duke vënë në dukje se edhe ata kishin marrë zbuluesë (Numrat 12:2). Cila ishte përgjigja e Zotit ndaj ankimit të tyre? (Shih Numrat 12:5–9.) Cilat janë kufizimet ndaj të drejtës sonë për të marrë zbuluesë?

Plaku Xhejms E. Faust tha: “Profetët, shikuesit dhe zbuluesit e kanë pasur dhe ende e kanë përgjegjësinë dhe privilegjin që të marrin e të shpallin fjalën e Perëndisë për botën. Anëtarët e veçantë, prindërit dhe udhëheqësit kanë të drejtën që të marrin zbuluesë për çfarë kanë në përgjegjësinë e tyre, por nuk e kanë as detyrë dhe as të drejtë që të shpallin fjalën e Perëndisë përtej kufijve të përgjegjësisë së tyre” (në Conference Report, tetor 1989, f. 9; ose *Ensign*, nëntor 1989, f. 8).

- Zoti i qortoi dhe i dënoi Miriamin dhe Aaronin sepse u ankuan për martesën e Moisiut me një grua etiopase (Numrat 12:1, 9–10). Si ndikohemi ne kur kritikojmë udhëheqësit e Kishës? Si mund të ndikojë kritika jonë për udhëheqësit e Kishës te familja dhe miqtë tanë?

- Te Numrat 12:3 thuhet se “Moisiu ishte një njeri shumë zemërbutë”. Çfarë do të thotë të jesh zemërbutë?

Presidenti Gordon B. Hinkli tha: “Zemërbutësia përfshin një shpirt mirënjohjeje, në kundërshtim me një qëndrim pavarësie, pranimin e një fuqie më të madhe përtej vetes, një njohje të Perëndisë dhe një pranim të urdhërimeve të Tij” (“With All Thy Getting Get Understanding”, *Ensign*, gusht 1988, f. 3–4).

- Si e tregoi Moisiu zemërbutësinë e tij kur Miriami u dënua për kundërshtimin ndaj tij? (Shih Numrat 12:13–15. Në vend që të kënaqej me autoritetin e tij për të kryesuar mbi motrën e vet, ai iu përgjërua Zotit që ta shëronte atë. Ai dhe njerëzit e tij e shtynë udhëtimin e tyre derisa ajo u shërua.) Si mund të jemi zemërbutë, edhe kur njerëzit na kritikojnë ose kthehen kundër nesh? Si na ndihmon përgjigjja ndaj kritikës me zemërbutësi?

### 3. Moisiu udhëzoi 12 burra që të vëzhgojnë tokën e Kanaanit.

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 13–14.

- Kur izraelitët arritën kufirin e tokës së Kanaanit, Moisiu dërgoi 12 burra që të vëzhgonin tokën, burimet e saj dhe popullin e saj (Numrat 13:17–20). Çfarë raporti sollën ata për burimet e vendit? (Shih Numrat 13:23–27.) Çfarë raportuan 10 burrat, përveç Kalebit dhe Jozueut, për popullin që jetonte në Kanaan? (Shih Numrat 13:28–33.) Në ç’mënyrë disa prej nesh bëjnë të njëjtin gabim si këta 10 burra?

Presidenti Gordon B. Hinkli tha:

“Dhjetë nga spiunët qenë viktimat e vetë dyshimeve dhe frikës së tyre. Ata dhanë një raport negativ mbi numrin dhe shtatlartësinë e kanaanitëve. . . . Ata e krahasuan veten me karkaleca kundrejt gjigantëve që kishin parë në atë vend. . . .

Ne shohim disa njerëz rreth nesh që janë mospërfillës në lidhje me të ardhmen e kësaj vepre, që janë të plogësht, që flasin për kufizime, që shprehin frikë, që e kalojnë kohën duke kërkuar e duke shkruar rreth atyre që ata i konsiderojnë si dobësi, të cilat vërtet nuk kanë rëndësi. Me dyshime në lidhje me të shkuarën e saj, ata nuk kanë largpamësi në lidhje me të ardhmen e saj” (në Conference Report, tetor 1995, f. 93–94; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 71).

- Në ç’mënyrë ndryshonte raporti i Kalebit dhe Jozueut nga raporti i 10 burrave të tjerë? (Shih Numrat 13:30; 14:6–9.) Përse Kalebi dhe Jozueu nuk kishin frikë nga banorët e Kanaanit? (Shih Numrat 14:9.) Cilat janë disa mënyra se si mund të ndjekim shembullin e Kalebit dhe të Jozueut kur përballemi me situata të vështira?

Presidenti Gordon B. Hinkli tha:

“Nuk ka vend në këtë vepër për ata që besojnë vetëm në ungjillin e mungesës së lumturisë e të shpresës. Ungjilli është lajm i mirë. Ai është një mesazh triumfi. Është një çështje që duhet të përqafohet me entuziazëm.

Zoti nuk tha asnjëherë se nuk do të kishte telashe. Njerëzit tanë kanë njohur shqetësime të çdo lloji kur ata që e kanë kundërshtuar këtë vepër, u janë turrur atyre. Por besimi i tyre është shfaqur dukshëm me gjithë hidhërimet e tyre. Kjo vepër ka ecur vazhdimisht përpara dhe kurrë nuk ka bërë ndonjë hap pas që nga zanafilla e saj. . . .

Kjo është një epokë pesimizmi. I yni është një mision besimi. Vëllezërve e motrave të mia kudo, unë ju bëj thirrje që të ripohoni besimin tuaj, për ta çuar përpara këtë vepër nëpër botë. Ju mund ta forconi atë me anë të mënyrës se si jetoni” (në Conference Report, tetor 1995, f. 94–95; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 71–72).

- Si reagoi asambleja ndaj fjalëve të Kalebit dhe të Jozueut? (Shih Numrat 14:10.) Si i dënoi Zoti izraelitët për murmuritjen e tyre të vazhdueshme dhe dëshirën e tyre për t’u kthyer në Egjipt? (Shih Numrat 14:22–23, 26–35.) Si i dënoi Ai 10 burrat që kishin dhënë raport negativ për Kanaanin? (Shih Numrat 14:36–37.) Si i bekoi Ai Kalebin dhe Jozueun për besnikërinë e tyre? (Numrat 14:24, 38.)

#### 4. Moisiu bën një gjarpër prej bronzi dhe u thotë njerëzve që, nëse do të shihnin tek ai, ata do të shëroheshin.

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 21:1–9.

- Edhe pse Zoti i ndihmoi izraelitët që të mposhtnin kanaanitët që po i sulmonin, izraelitët vazhduan të murmuritnin. Si i ndëshkoi Zoti ata? (Shih Numrat 21:6.) Si iu përgjigjën izraelitët këtij ndëshkimi? (Shih Numrat 21:7.)
- Çfarë i tha Zoti të bënte Moisiut kur Moisiu i kërkoi të largonte gjarpërinjtë flakërues? (Shih Numrat 21:8–9.) Çfarë duhet të bënte çdo njeri që të shpëtohej nga kafshimet e gjarpërinjve flakërues?
- Nefi dhe Alma, dy profetë nga Libri i Mormonit, dhanë mësim se shumë izraelitë vdiqën ngaqë nuk shikuan te gjarpri prej bronzi. Përse nuk panë ata? (Shih 1 Nefi 17:41; Alma 33:18–20.)
- Kë simbolizonte gjarpri prej bronzi? (Shih Gjoni 3:14–16; Helamani 8:13–14.)
- Ashtu si fëmijët e Izraelit duhet të shihnin te gjarpri prej bronzi që të jetonin, ne duhet të shohim te Jezu Krishti për të marrë jetë të përjetshme (Alma 37:46–47; Helamani 8:15). Çfarë do të thotë të shohësh te Krishti? Në ç’mënyrë njerëzit sot bëjnë të njëjtin gabim si izraelitët të cilët nuk do të shihnin te gjarpri prej bronzi? (Shih Alma 33:20. Ata nuk shohin te Jezu Krishti sepse nuk e besojnë që, bërja e kësaj, mund t’i shpëtojë ata.)

Plaku Karlos E. Esei tha: “Ne, ashtu si Izraeli i lashtë, duhet t’i ngulim sytë dhe mendjen te . . . Krishti, nëse shpresojmë të fitojmë jetën e përjetshme. . . . Vështrimet tona nuk duhet të lejohen të enden matanë udhës ose të nguliten mbi gjërat e prishshme të botës. Syri . . . duhet të stërvitet që të shohë lart. Ne duhet të shikojmë te Perëndia dhe të jetojmë!” (në Conference Report, tetor 1978, f. 81; ose *Ensign*, nëntor 1978, f. 54).

- Alma dha mësim se, ashtu si rruga për t’u shëruar nga gjarpërinjtë flakërues që e lehtë, rruga drejt jetës së përjetshme është e lehtë (Alma 37:46). Në çfarë kuptimi rruga drejt jetës së përjetshme është e lehtë? Në ç’mënyrë disa njerëz përpiqen ta ngatërrojnë rrugën drejt jetës së përjetshme? (Shih Jakobi [LiM] 4:14. Ata shohin përtej parimeve të thjeshta e shpëtuese të besimit në Jezu

Krisht, pendimit dhe bindjes.) Në ç'mënyrë mund ta mbajmë ne përqendrimin tonë tek besimi te Krishti?

Përfundim

Nxitini anëtarët e klasës që të shohin përtej gjërave të botës dhe të mos kenë frikë nga "gjigantët" të cilët na tërheqin vëmendjen nga gjërat që janë më të rëndësishme. Dëshmoni që, nëse do të "shikoj[m]ë në Birin e Perëndisë me besim" (Helamani 8:15) dhe do të ndjekim profetët e Tij, ne do të bekohemi në këtë jetë dhe në jetën që do të vijë.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

### 1. "Të kthehemi në Egjipt" (Numrat 14:4)

- Cila ishte përgjigja e izraelitëve kur:
  - a. Qenë të bllokuar mes egjiptianëve dhe Detit të Kuq? (Shih Eksodi 14:10–12.)
  - b. Nuk iu dha asgjë tjetër për të ngrënë veç manës? (Shih Numrat 11:4–6, 18–20.)
  - c. U sfiduan me detyrën për të pushtuar tokën e Kanaanit? (Shih Numrat 14:1–4.)
  - ç. U shkurajuan nga udhëtimi i vështirë në shkretëtirë? (Shih Numrat 21:4–5.)
- Si mendoni ju, përse qe kaq e vështirë për izraelitët që ta braktisnin Egjiptin? Cilat janë disa gjëra që ne e kemi të vështirë t'i braktisim sot? Si mund ta forcojmë njëri-tjetrin ndërsa përpiqemi që t'u largohemi zakoneve të vjetra ose qëndrimeve sipas botës?

### 2. Ku të shohim për udhëheqje

Libri i Numrave na mëson se ku duhet të shohim për udhëheqje. Ju mund të dëshironi të theksoni këto mësim duke shkruar në dërrasë parimet në vijim ndërsa jepni mësim rrëfimet nga shkrimi i shenjtë:

- a. Shihni te profeti (Numrat 12).
- b. Shihni te toka e premtuar – për ne, mbretëria çelestiale (Numrat 13–14).
- c. Shihni te Shpëtimtari (Numrat 21:4–9).



# “Nuk Mund të Shkel Urdhrin e Zotit”

Mësimi

# 16

Numrat 22–24; 31:1–16

**Qëllimi**

Të nxisë anëtarët e klasës që t’i nënshtrohen vullnetit të Perëndisë pa mëdyshje.

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:

- a. Numrat 22:1–21. Balaku, mbreti i Moabit, tmerrohet nga afrimi i izraelitëve. Ai i ofron shpërblime Balaamit nëse ai do të vijë në Moab që të mallkojë izraelitët. Perëndia e urdhëron Balaamin që të mos pranojë dhe Balaami i bindet (22:1–14). Balaku i ofron Balaamit më shumë nderime e pasuri nëse ai do të vijë në Moab dhe do të mallkojë Izraelin. Perëndia i thotë Balaamit se ai mund të shkojë nëse dëshiron, por që duhet të thotë vetëm fjalët që i jep Perëndia (22:15–21). Balaami vendos të shkojë. (Vini re se Përkthimi prej Jozef Smithit i Numrave 22:20 thotë se Balaami mund të shkojë me burrat nëse dëshiron.)
- b. Numrat 22:22–35. Perëndia inatoset me Balaamin ngaqë po shkon në Moab, sepse e di që ai shpreson për ndonjë shpërblim nga Balaku. Ndërsa po shkon në udhën e tij, Balaami mëson rreziqet [që vijnë] nëse fyen Perëndinë kur gomarica e tij dhe një engjëll i flasin atij.
- c. Numrat 22:36–24:25. Balaami takohet me Balakun (22:36–23:2). Tri herë Balaku i kërkon atij që të mallkojë Izraelin, por Balaami i bindet Perëndisë dhe e bekon Izraelin çdo herë (23:3–24:9). Ai pastaj mallkon Moabin dhe profetizon për Jezu Krishtin (24:10–25).
- ç. Numrat 31:1–16. Izraelitët shkatërrojnë midianitët dhe vrasin Balaamin. Moisiu shpjegon se Balaami i kishte këshilluar midianitët që t’i joshnin izraelitët në mëkat. (Pasojat e këshillës së Balaamit përshkruhen tek Numrat 25:1–3. Edhe pse Balaami nuk do ta mallkonte drejtpërsëdrejti Izraelin, duket se ai dëshironte aq shumë një shpërblim nga Balaku saqë sugjeroi që ta tundonin Izraelin që të mëkatonte, duke bërë që të humbte mbrojtjen e Perëndisë.)

2. Lexim shtesë: 2 Pjetrit 2:15–16; Judës 1:11; Zbulesa 2:14.

**Sugjerime për**

**Zhvillimin e Mësimi**

**Aktivitet Vëmendjeje**

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

Kërkojuni anëtarëve të klasës që të dëgjojnë me vëmendje thëniet vijuese dhe të mendojnë mbi llojin e njeriut që do t’i bënte ato:

“Edhe sikur [mbreti] të më jepte shtëpinë e tij të mbushur me argjend dhe me ar, nuk mund të shkel urdhrin e Zotit, Perëndisë tim” (Numrat 22:18).

“Unë do të bëj tërë ato që do të tho[të] Zoti” (Numrat 23:26).

“Nuk mund të shkel urdhrat e Zotit për të bërë të mirë ose të keq me nismën time, por duhet të them atë që Zoti do të thotë” (Numrat 24:13).

- Cilat janë disa nga cilësitë e një njeriu që do t’i thoshte këto gjëra? (Thënie të tilla sugjerojnë se një njeri është i bindur, besnik dhe i përlulur.)

Shpjegoni se këto deklaramë u bënë nga një njeri që quhej Balaam, që shpallte bindje të prerë, por që në zemrën e tij dëshironte shpërblime e nderime tokësore.

Ky mësim tregon pasojat e këmbënguljes me kokëfortësi në vullnetin tonë për të përmbushur dëshira të tilla.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### **1. Balaami refuzon ofertën e Balakut për shpërblime në shkëmbim me mallkimin e Izraelit.**

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 22:1–21.

- I tmerruar nga afrimi i izraelitëve, Balaku, mbret i Moabit, dërgon lajmëtarë që t'i ofrojnë shpërblime Balaamit nëse ai do të vinte në Moab dhe do ta mallkonte Izraelin (Numrat 22:5–7). Si iu përgjigj Balaami kësaj oferte? (Shih Numrat 22:8–14.) Çfarë të ashtuquajturash shpërblime na ofrohen nganjëherë në shkëmbim të mosbindjes ndaj Perëndisë?
- Pasi Balaami nuk pranoi të vinte në Moab, Balaku dërgoi një grup të dytë burrash, më mbresëlënës se i pari, që të përpiqeshin t'ia mbushnin mendjen atij. Çfarë i ofroi Balaku Balaamit? (Shih Numrat 22:15–17.) Si u përgjigj Balaami? (Shih Numrat 22:18–19.) Si mendoni ju, përse ai dëshironte ta pyeste sërish Zotin? (Balaami mund të ketë shpresuar që Zoti do ta ndryshonte mendjen dhe do ta lejonte të merrte shpërblimet e ofruara nga Balaku.) Cilat janë rreziqet e kërimit të shfajësimeve për të bërë diçka në kundërshtim me urdhërimet dhe këshillën e Perëndisë?
- Zoti i dha leje Balaamit që të shkante me lajmëtarët e Balakut nëse dëshironte. Por pastaj Zoti u inatos me Balaamin që shkoi (Numrat 22:20–22). Çfarë tregon inati i Zotit për atë që ishte në zemrën e Balaamit? (Shih 2 Pjetrit 2:15; Isaia 29:13.)

### **2. Zoti tregon rrezikun prej këmbënguljes kokëfortë të Balaamit në vullnetin e tij.**

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 22:22–35.

- Në udhën e tij për në Moab, Balaami u përpoq tri herë që ta detyronte të ecte përpara gomaricën e tij (Numrat 22:22–30). Në çfarë mënyre ngjasonte kjo me marrëdhënien e Balaamit me Zotin? (Balaami dëshironte t'i detyronte gomaricën dhe Zotin që të bënin atë që ai donte. Ju mund të dëshironi të vini në dukje gjithashtu se gomarica e pa engjëllin, kurse Balaami jo. Në mënyrë të ngjashme, Zoti pa shumë gjëra që Balaami nuk i pa.)
- Cilët janë disa shembuj të ngjashëm të kohëve të sotme me individë ose grupe që përpiqen me kokëfortësi të bëjnë atë që duan në vend që t'i nënshtrohen vullnetit të Perëndisë ose këshillës së drejtë të prindërve apo udhëheqësve?

Ju mund të dëshironi të diskutoni disa nga shembujt vijues:

- a. Një fëmijë, i pakënaqur nga përgjigjja e njërit prind, shkon te prindi tjetër, duke shpresuar për një përgjigje të ndryshme.
- b. Një anëtar i Kishës, i pakënaqur nga këshilla e një udhëheqësi të priftërisë, shkon te një tjetër udhëheqës priftërie.
- c. Një anëtar i Kishës jep arsye se përse një urdhërim nuk zbatohet për atë ashtu si zbatohet për anëtarët e tjerë.

- Zoti e ndëshkoi Balaamin nëpërmjet engjëllit dhe gomaricës. Si iu përgjigj Balaami fjalëve ndëshkuese të engjëllit? (Shih Numrat 22:31–35.) Përse Perëndia i qorton fëmijët e Tij? (Shih DeB 95:1.) Në ç'mënyrë qortimi i Perëndisë mund të jetë një bekim për ne?

### 3. Balaami refuzon të mallkojë Izraelin.

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 22:36–24:25.

- Pasi Balaami arriti në Moab, Balaku i kërkoi tri herë që ta mallkonte Izraelin. Çdo herë Zoti i tha Balaamit që ta bekonte Izraelin dhe Balaami iu bind. Çfarë pikash të forta paraqiti Balaami në këtë rrëfim? (Shih Numrat 22:38; 23:8, 19–20; 24:1, 12–13.) Çfarë pikash të dobëta ishin ende të dukshme tek Balaami? (Shih Numrat 22:41; 23:1–3, 13–15, 27–30. Edhe pse Balaami i refuzoi kërkesat e Balakut për ta mallkuar Izraelin, ai që i gatshëm ta ndiqte Balakun nga njëri vend te tjetri dhe të dëgjonte kërkesat e tij edhe pse e dinte se ato ishin të gabuara.) Cilat janë rreziqet e dëgjimit të sugjerimeve të padrejta (nga miqtë apo media, për shembull) kur e dimë se janë të gabuara?

### 4. Izraelitët shkatërrojnë midianitët dhe vrasin Balaamin.

Jepni mësim dhe diskutoni për Numrat 31:1–16.

- Përse izraelitët shkuan në luftë kundër midianitëve? (Shih Numrat 31:1–3; Zoti që i zemëruar me midianitët sepse i joshën izraelitët në mëkat, siç shënohet tek Numrat 25:1–3.) Cili i këshilloi midianitët që të tundonin fëmijët e Izraelit për të marrë pjesë në adhurim idhujsh dhe imoralitet? (Shih Numrat 31:16.) Përse e dha Balaami këtë këshillë? (Edhe pse Balaami iu bind urdhrave të Zotit për të bekuar në vend që ta mallkonte Izraelin, në zemrën e tij ai dëshironte nderime e shpërblime tokësore. Për të marrë këto shpërblime, ai sugjeroi ta tundonin Izraelin që të mëkatonte, duke i shkaktuar që të humbiste mbrojtjen e Perëndisë.) Çfarë i ndodhi Balaamit gjatë betejës së izraelitëve me midianitët? (Shih Numrat 31:8.)
- Tre shkrimtarë në Dhiatën e Re iu referuan Balaamit (2 Pjetrit 2:15–16; Juda 1:11; Zbulesa 2:14). Cilat janë përshtypjet e tyre për të?
- Çfarë mësimesh mund të nxjerrim nga ky tregim? (Anëtarët e Kishës që kërkojnë shpërblime e nderime tokësore, që kërkojnë justifikime për këshillën dhe urdhërimet e Perëndisë, ose që përpiqen të fusin ide, praktika ose standarde të botës në Kishë, po ndjekin shembullin e padrejtë të Balaamit. Ky quhet “mësimi [i] Balaamit” te Zbulesa 2:14.)

Plaku Brus R. Mek-Konki tha:

“Çfarë historie është kjo! Këtu është një profet i Perëndisë që u zotua vendosmërisht që të shpallte vetëm atë që tregon Zoti i qiellit. Duket sikur nuk ka as dyshimin më të vogël në mendjen e tij mbi drejtimin që duhej të ndiqte. Ai përfaqëson Zotin dhe as një shtëpi plot me ar e argjend, as nderimet e larta të ofruara nga mbreti, nuk mund ta lëkundin nga drejtimi i vendosur i tij. . . .

Por lakmia për pasuri dhe etja për nderim e tundojnë atë. Sa e mrekullueshme do të ishte [për atë] që të ishte i pasur e i fuqishëm. . . . Ndoshta Zoti do ta lejonte t'i ulte standardet dhe të kishte njëfarë mirëqenieje dhe fuqie tokësore. . . . Vras mendjen se sa shpesh disa prej nesh e marrin drejtimin nga Kisha dhe pastaj, ashtu si Balaami, kërkojnë disa shpërblime tokësore. . . .

Balaami, . . . i frymëzuar dhe i fuqishëm siç qe dikur, e humbi në fund shpirtin e tij, sepse e vendosi zemrën te gjërat e kësaj bote në vend që ta vinte te pasuritë e përjetësisë” (“The Story of a Prophet’s Madness”, *New Era*, prill 1972, f. 7).

- Referojuni sërish thënieve në aktivitetin e vëmendjes. Vini në dukje se edhe pse Balaami dukej se qe prerazi i bindur, dëshirat e zemrës së tij ishin që të merrte shpërblime dhe nderime tokësore. Çfarë na mëson kjo histori mbi rëndësinë e mbajtjes së dëshirave të zemrës sonë të kulluara? Si mund t’i mbajmë dëshirat e zemrës sonë të kulluara?

## Përfundim

Dëshmoni që nëse Balaami do t’i qe nënshtuar përulësisht vullnetit të Perëndisë, do të ishin shmangur shumë mëkate e vuajtje për të dhe për Izraelin. Nxitini anëtarët e klasës që të jenë të palëkundur në vend që të jenë kokëfortë – të kërkojnë e të ndjekin vullnetin e Zotit pa u përpjekur që t’i shmangen apo ta ndryshojnë atë.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Bindja ndaj Zotit

Ne mund ta mësojmë nga Balaami rëndësinë e bindjes ndaj Zotit. Ne mund ta mësojmë këtë gjithashtu nga shembujt e mirë të shumë burrave e grave të tjera në shkrimet e shenjta. Ju mund të dëshironi t’iu referoheni shembujve vijues:

- a. Shpëtimtari, i vetëdijshëm për agoninë që e priste në Gjetseman dhe në kryq, “ra në gjunj dhe lutej, duke thënë: ‘O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti’” (Lluka 22:41–42).
- b. Kur Abrahami u urdhërua të sakrifikonte birin e tij, Isakun, ai “u ngrit herët në mëngjes” për të filluar udhëtimin drejt malit Moriah (Zanafilla 22:3).
- c. Kur Maries iu tha se ajo do të ishte nëna e Birit të Perëndisë, ajo u përgjigj: “Ja shërbëtorja e Zotit; le të më ndodhë sipas fjalës sate” (Lluka 1:38).
- ç. Kur Nefi u udhëzua të kthehej në Jerusalem që të merrte fletët prej tunxhi nga Labani, ai menjëherë u përgjigj: “Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar” (1 Nefi 3:7).
- d. Bijtë e Helamanit patën sukses në betejë sepse “ata u bindën dhe u përpoqën të zbatonin çdo fjalë të urdhërit me përpikmëri” (Alma 57:21).

### 2. “Zoti nuk ka lejuar t’i marrësh [nderimet]” (Numrat 24:11)

- Kur Balaami nuk pranoi të mallkonte Izraelin dhe të merrte shpërblimet e nderimin e Balakut, Balaku i tha: “Zoti nuk ka lejuar t’i marrësh” (Numrat 24:11). Në ç’mënyrë ndjekja e Zotit nganjëherë nuk na lejon të marrim shpërblime e nderime të botës? Çfarë premtion Zoti në vend të shpërblimeve tokësore? (Shih DeB 81:6.)


Ligji i Përtërirë 6; 8; 11; 32

---

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që 1) të kujtojnë Zotin e besëlidhjet që ata kanë bërë me Të dhe 2) të krijojnë një mjedis që do t'i ndihmojë ata ta bëjnë këtë.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:<ol style="list-style-type: none"><li>a. Ligji i Përtërirë 6:1–9; 11:18–21. Moisiu u jep udhëzime izraelitëve që t'i ndihmojë ata të kujtojnë besëlidhjet e tyre. Ai i udhëzon prindërit që t'iu mësojnë fëmijëve të tyre fjalët e tij.</li><li>b. Ligji i Përtërirë 6:10–12; 8:1–20. Moisiu i kujton izraelitët për bekimet e Perëndisë ndaj tyre. Ai i paralajmëron ata se do të mbarojnë nëse nuk u binden urdhërimeve të Perëndisë dhe nuk e kujtojnë Atë.</li><li>c. Ligji i Përtërirë 32:1–4, 15–18, 30–40, 45–47. Moisiu i këshillon izraelitët që të kujtohen për Shkëmbin e shpëtimit të tyre (Jezu Krishtin).</li></ol></li><li>2. Lexim shtesë: Ligji i Përtërirë 4; 7:1–4; 13:1–8; 34.</li><li>3. Nëse do të përdorni aktivitetin e parë të vëmendjes, sillni objekte nga shtëpia juaj siç përshkruhet tek “Aktivitet Vëmendje”.</li></ol>

---

<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Paraqisni objekte nga shtëpia juaj që ju kujtojnë për Zotin dhe besëlidhjet që ju keni bërë me Të. (Objekte të tilla mund të përfshijnë shkrime të shenjta, figura, libra dhe regjistrime muzikore.) Tregojuni anëtarëve të klasës se përse këto objekte janë të rëndësishme për ju. Shpjegoni se një pjesë e këtij mësimi u kushtohet objekteve fizike që përdorën izraelitët e lashtë që të kujtoheshin për Zotin dhe besëlidhjet e tyre me Të. Vini në dukje se objektet fizike mund të jenë kujtues të fuqishëm edhe për ne gjithashtu.</li><li>2. Shkruani fjalët vijuese në dërrasë: <i>Mashtron, gënjen, kurth, gëlltis, nxit, tundojë, paqësojë, inat, verbon, zhdukesh</i><ul style="list-style-type: none"><li>• Çfarë kanë të përbashkët këto fjalë? (Një karakteristikë e përbashkët është se të gjitha ato përshkruajnë taktikat e Satanit në përpjekjet e tij për të na larguar nga Zoti.)</li><li>• Vini një anëtar të klasës që të lexojë DeB 76:28–29. Shpjegoni se këto vargje janë nga një vegim i dhënë Jozef Smithit dhe Sidni Rigdonit. Çfarë mund të bëjmë që të mbrohemi nga ndikimi i Satanit? (Ju mund të dëshironi të përdorni diagramin vijues për të ilustruar disa nga gjërat që mund të bëjmë për të mbrojtur veten nga tundimet e Satanit.)</li></ul></li></ol>
---	---



Shpjegoni se në librin e Ligjit të Përtërirë, Moisiu i mësoi izraelitët se si të krijonin një mjedis që do t'i ndihmonte t'u rezistonin tundimeve të Satanit. Ky mësim shqyrton këshillën e Moisiut dhe diskuton për mënyrën se si mund ta zbatojmë atë sot.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Pasi i vuri në provë, i ndëshkoi dhe u dha mësim izraelitëve në shkretëtirë për 40 vite, Zoti tha se ata ishin gati për të hyrë në tokën e premtuar. Por fillimisht, Ai kishte disa udhëzime të rëndësishme për ata. Moisiu i dha këto udhëzime në tre predikime që janë regjistruar te Ligji i Përtërirë.

Në këto predikime Moisiu shqyrtoi udhëtimin 40-vjeçar të Izraelit në shkretëtirë, duke njohur dorën e Perëndisë në çlirimin e tyre. Moisiu diskutoi gjithashtu përgjegjësitë e Izraelit si populli i zgjedhur i Perëndisë. Ai theksoi sa ata duhet t'u bindeshin urdhërimeve të Perëndisë, veçanërisht urdhrave për ta kujtuar Atë dhe për t'u përmbajtur nga adhurimi i idhujve. Moisiu paralajmëroi se edhe pse fëmijët e Izraelit qenë gati për të hyrë në tokën e premtuar, nëse ata do të ktheheshin tek ligësia, ata do ta humbisnin trashëgiminë e tyre dhe do të shpërndaheshin.

### 1. Moisiu u jep udhëzime izraelitëve që t'i ndihmojë ata të kujtojnë besëlidhjet e tyre.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ligjin e Përtërirë 6:1–9 dhe 11:18–21.

- Ligji i Përtërirë përmban fjalët e fundit të Moisiut drejtuar izraelitëve. Nëse ju do t'u jepnit një mesazh të fundit familjes dhe miqve tuaj, cili do të ishte ai?
- Çfarë i urdhëroi Zoti të bënin izraelitët te Ligji i Përtërirë 6:5–7? Si mund t'i fusim në zemrat tona fjalët e shkrimeve të shenjta? Në ç'mënyrë prindërit mund t'u japin mësim ungjillin me efektshmëri fëmijëve të tyre dhe t'i ndihmojnë ata që të mësojnë t'i duan shkrimet e shenjta?
- Çfarë i këshilloi Moisiu që të bënin izraelitët te Ligji i Përtërirë 6:8–9 dhe Ligji i Përtërirë 11:18–20? (Vini re se balloret [filateritë] ishin "rripa pergamene në të cilat shkruheshin katër fragmente shkrimi të shenjtë . . . të cilat mbështilleshin dhe ngjiteshin në shirita lëkure që viheshin . . . në ballë ose rreth krahut" [Bible Dictionary, "Frontlets", f. 676]).



- Si mendoni ju, përse Moisiu u tha njerëzve që t'i vendosnin fragmentet e shkrimit të shenjtë midis syve, në duar, në shtalkat e shtëpive dhe mbi porta? Në ç'mënyrë ndikon një kujtues i tillë te veprimet tona? Çfarë mund të bëjmë në shtëpitë tona që të na kujtojnë për Zotin, fjalët e Tij dhe besëlidhjet tona me Të? Pikturat në muret tona, librat që lexojmë dhe filmat e shfaqjet televizive që shohim, a na kujtojnë për Zotin, apo tregojnë një mall për botën?

Presidenti Ezra Taft Benson tha se njerëzit që “udhëhiqen nga Krishti do të përvetësohen nga Krishti. . . . Hyni në shtëpitë e tyre dhe pikturat në mure, librat në raftet e tyre, muzika në mjedis, fjalët dhe veprimet e tyre tregojnë se ata janë të krishterë” (në Conference Report, tetor 1985, f. 6; ose *Ensign*, nëntor 1985, f. 6–7).

## 2. Moisiu i këshillon izraelitët që t'u binden urdhërimeve të Perëndisë dhe që ta kujtojnë Atë.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ligjin e Përtërirë 6:10–12 dhe 8:1–20.

- Cilat janë mesazhet kryesore të Moisiut te Ligji i Përtërirë 6:10–12 dhe 8:1–20? Çfarë do të thotë të harrosh Zotin? (Shih Ligji i Përtërirë 8:11.) Cilat janë pasojat e harrimit të Tij? (Shih Ligji i Përtërirë 8:19.) Si mund të sigurohemi se nuk e harrojmë Perëndinë?
- Çfarë kushtesh apo sfidash përmendi Moisiu që mund t'i bëjnë njerëzit që ta harrojnë Perëndinë? (Shih Ligji i Përtërirë 6:10–12; 8:10–20.) Përse disa njerëz e harrojnë Zotin pasi Ai i bekon ata bollshëm? (Shih Ligji i Përtërirë 8:17.)

Presidenti Brigam Jang tha: “Frika më e madhe që kam për [anëtarët e kësaj Kisha] është se ata do të pasurohen në këtë vend, do ta harrojnë Perëndinë e popullin e Tij, do të shëndoshen e do të largohen nga Kisha dhe do të shkojnë në ferr. Këta njerëz do t'i durojnë sulmet e turmave, plaçkitjet, varfërinë dhe të gjitha llojet e përndjekjeve e do të mbeten të vërtetë. Por frika ime më e madhe për ta është se ata nuk do ta durojnë dot pasurinë; por ende ata duhet të provohen me pasuri, pasi ata do të bëhen populli më i pasur në këtë tokë” (në Preston Nibley, *Brigham Young: The Man and His Work* [1936], f. 128).

- Cili është burimi i çfarëdo pasurie që mund të kemi? (Shih Ligji i Përtërirë 8:18.) Si mund ta përdorim mirëqenien tonë për ta çuar më tej punën e Zotit? (Shih Ligji i Përtërirë 8:18; Jakobi [LiM] 2:18–19.)

## 3. Moisiu i këshillon izraelitët që të kujtohen për Shkëmbin e shpëtimit të tyre (Jezu Krishtin).

Jepni mësim dhe diskutoni për Ligjin e Përtërirë 32:1–4, 15–18, 30–40, 45–47.

- Cili është Shkëmbi për të cilin flitet te Ligji i Përtërirë 32:3–4? (Jezu Krishti; shih edhe vargjet 15, 18 dhe 30–31.) Si mendoni ju, përse Jezu Krishti nganjëherë quhet Shkëmbi? (Shih Helamani 5:12.)
- Moisiu shpalli se “shkëmbi i tyre” (perënditë e rreme të të ligjve) “nuk është si Shkëmbi ynë” (Ligji i Përtërirë 32:31). Në ç'mënyrë “shkëmbi i tyre” është i ndryshëm nga “Shkëmbi ynë”? (Shih Ligji i Përtërirë 32:37–40.)
- Çfarë do të thotë të ndërtosh mbi Shkëmb? (Shih Ligji i Përtërirë 32:46–47; Mateu 7:24–27; DeB 50:44.) Si mund ta bëjmë këtë? (Shih Ligjin e Përtërirë

18:18–19, ku, në profetizimin për ardhjen e Krishtit, tregohet nevoja për t’ua vënë veshin fjalëve të Tij.)

## Përfundim

Jepni dëshminë tuaj për Shpëtimtarin dhe shprehni mirënjohjen tuaj për besëlidhjet që keni bërë me Të. Theksoni rëndësinë e të kujtuarit të Perëndisë dhe të mbajtjes së besëlidhjeve që bëjmë me Të. Dëshmoni se gjërat që mbajmë rreth vetes – të tilla si piktura, libra dhe muzika – mund të jenë kujtues të fuqishëm të Zotit dhe të besëlidhjeve që kemi bërë me Të. Vini në dukje se qëllimi ynë në mbajtjen rreth vetes të këtyre gjërave është i njëjtë me qëllimin e izraelitëve të lashtë që mbanin ballore: të na ndihmojnë të ndërtojmë mbi Shkëmbin – të na ndihmojnë të kujtojmë e të ndjekim Zotin.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

### 1. “Dhe do t’i shkruash mbi pllakat e shtëpisë sate” (Ligji i Përtërirë 6:9)

Ftojini anëtarët e klasës që të rendisin pikturat, afishet, regjistrimet muzikore dhe objekte të tjera në shtëpitë e tyre. Bëjini ata ta etiketojnë secilin artikull ose me një “+” (duke treguar se objekti ka gjasa t’i udhëheqë drejt të kujtuarit të Zotit) ose me një “-” (duke treguar se ka më shumë gjasa t’i udhëheqë zemrat e tyre larg nga Zoti). Ju mund të dëshironi të sugjeroni që anëtarët e klasës ta bëjnë këtë me familjet e tyre gjatë një mbrëmjeje familjare.

### 2. “Ai nuk të ka braktisur” (Ligji i Përtëritë 4:31)

- Pasi profetizon se izraelitët do t’i kthehen adhurimit të perëndive të tjera dhe do të shkatërrohen (Ligji i Përtërirë 4:25–28), Moisiu ofron fjalë shprese. Çfarë u premtoi ai atyre që e kërkojnë Zotin me gjithë zemrën e tyre? (Shih Ligji i Përtërirë 4:29–31; Isaia 49:14–16.) Si është përmbushur ky premtim në jetën tuaj? Çfarë duhet të bëjmë që ta kërkojmë Zotin me gjithë zemrën dhe shpirtin tonë?

### 3. Përballimi i ndikimeve negative të të tjerëve

- Për çfarë rreziku paralajmëron Moisiu te Ligji i Përtërirë 13:6–8? Si mund ta dallojmë kur dikush përpiket të na tërheqë larg Zotit? Si duhet t’i përgjigjemi një njeriu të tillë?

### 4. “Asnjëri prej tyre nuk do të paraqitet para Zotit duarbosh” (Ligji i Përtërirë 16:16)

- Vendi i përmendur te Ligji i Përtërirë 16:2, 11, 16 është tabernakulli, që ishte një tempull i mbartshëm për izraelitët. Në përgatitje për një festë te tabernakulli, Moisiu i udhëzoi njerëzit që të mos “paraqite[shin] para Zotit duarbosh” (Ligji i Përtërirë 16:16). Si mund të zbatohet kjo për pjesëmarrjen tonë në tempull? Si mund të përgatitemi për pjesëmarrje në tempull që të mos shkojmë “duarbosh” në tempull? Në ç’mënyrë na ndihmon kjo përgatitje të “gëzo[hemi] përpara Zotit” në tempull? (Ligji i Përtërirë 16:11).
- Presidenti Huard W. Hanter këshilloi: “Le të jemi një popull që frekuentojmë tempullin. Frekuentojeni tempullin aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat personale. Mbani një fotografi të një tempulli në shtëpinë tuaj, që fëmijët tuaj të mund

ta shohin atë” (në Conference Report, tetor 1994, f. 8; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 8). Përse është e rëndësishme për ne që të shkojmë në tempull sa më shpesh që të jetë e mundur? Përse është e rëndësishme të mbajmë një fotografi të një tempulli në shtëpinë tonë?

#### 5. “Askush nuk e ka mësuar deri më sot vendin e varrit të tij” (Ligji i Përtërirë 34:6)

Shkruesi që mbaroi librin e Ligjit të Përtërirë dinte vetëm se Moisiu ishte zhdukur dhe kështu mori me mend se ai kishte vdekur, se Zoti e kishte varrosur atë dhe se askush nuk e dinte se ku ishte varri i tij. Megjithatë, ne e dimë se Moisiu u mor në qiell. (Për një shpjegim të gjendjes së qenieve të transformuara, shih 3 Nefi 28:7–9, 37–40.) Fjalori Biblik jep shpjegimin vijues për transformimin e Moisiut:

“Ashtu siç ishte rasti me shumë prej profetëve të lashtë, shërbesa e Moisiut u shtri përtej kufijve të kohëzgjatjes së jetës së tij të vdekshme. Në shoqërinë e Eliasit, ai erdhi në malin e Shpërfytyrimit dhe u dha çelësat e priftërisë Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit (Mateu 17:3–4; Marku 9:4–9; Lluka 9:30; DeB 63:21; *History of the Church*, 3:387). Nga kjo ngjarje, që ndodhi përpara ringjalljes së Jezusit, ne kuptojmë se Moisiu qe një qenie e transformuar dhe nuk kishte vdekur siç raportohet te Ligji i Përtërirë 34 (Alma 45:19). Ishte e nevojshme që ai të transformohej, me qëllim që të kishte një trup prej mishi dhe kockash në kohën e shpërfytyrimit, meqë ringjallja nuk kishte ndodhur ende. Po të kishte qenë vetëm një shpirt, ai nuk do të mund të kishte kryer në mal punën e dhënies së çelësave, Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit të vdekshëm (krahaso me DeB 129)” (Bible Dictionary, “Moses”, f. 735).

**Qëllimi** Të nxisë çdo anëtar të klasës që të jetë i fortë e trim në të jetuarit e ungjillit të Jezu Krishtit.

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Jozueut 1. Zoti thërret Jozueun që të pasojë Moisiun dhe e urdhëron atë të jetë i fuqishëm, të ketë kurajë, të studiojë shkrimet e shenjta dhe të mbajë urdhërimet. Jozueu i përgatit izraelitët që të zotërojnë tokën që Zoti u kishte premtuar atyre.
  - b. Jozueut 3–4; 6. Izraelitët kapërcejnë lumin Jordan në vend të thatë dhe vendosin 12 gurë si përmendore të kalimit të tyre. Nëpërmjet besimit të izraelitëve, Jeriko shkatërrohet.
  - c. Jozueut 23; 24:14–31. Jozueu dhe populli i tij besëlidhin që t’i shërbejnë Zotit.
2. Lexim shtesë: Jozueut 7; 14.
3. Kërkojini një anëtar të klasës që të përgatitet të tregojë rrëfimin e betejës së Jerikos sikur ai apo ajo të ishte dëshmitar okular (Jozueut 6). Kërkojini një ose dy anëtarëve të tjerë të klasës që të përgatiten të ndajnë një përvojë që i kujton ata për fuqinë dhe dashurinë e Perëndisë.
4. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, siguroni një copë letër, një shirit ngjitës ose një rrip llastiku dhe një libër. Nëse përdorni pyetjet mbi kurthet e grackat, mund të dëshironi të sillni një kurth të vogël, si për shembull një kurth minjsh, për të ilustruar diskutimin.

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje** Shpjegoni se ky mësim i kushtohet Jozueut, profetit që udhëhoqi fëmijët e Izraelit në zaptimin prej tyre të tokës së premtuar. Kur e thirri Jozueun që të ishte profet, Zoti e këshilloi atë që të ishte “i fortë dhe trim” (Jozueut 1:6). Shkruajeni këtë frazë në dërrasë. Paraqisni një copë letër dhe një libër. Kërkojini një anëtar të klasës që ta vendosë letrën që të qëndrojë në këmbë dhe të përpiqet të vendosë një libër në baraspeshë mbi të.

Pasi anëtar i klasës ta ketë provuar këtë, shpjegoni se ka një mënyrë për ta bërë letrën mjaftueshëm të fortë sa ta mbajë librin. Mbështilleni letrën si tub dhe sigurojeni me një rrip llastiku ose shirit ngjitës. Vendoseni tubin me bazë mbi një sipërfaqe të sheshtë. Vendosjani me kujdes librin sipër. (Mund të dëshironi ta praktikoni këtë para mësimin.)

Shpjegoni se Jozueu u bë i fortë kur e lejoi Perëndinë t’i formonte karakterin. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa e lejojme Perëndinë që të formojë karakterin tonë, ne mund të bëhemi të fortë dhe të kryejmë gjërat që Zoti dëshiron që t’i bëjmë.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Gjatë udhëtimit 40-vjeçar të izraelitëve në shkretëtirë, Moisiu u kishte dhënë atyre ligjin e Perëndisë, kishte vepruar si zëdhënës i Perëndisë dhe kishte shërbyer si udhërrëfyesi i tyre. Ai ishte udhëheqësi i vetëm që kishte njohur një brez i tërë izraelitësh. Por Zoti e mori atë në fund të udhëtimit të tyre – pikërisht kur ata u përballën me një provë të madhe. Duke kujtuar premtimet e Tij ndaj Izraelit, Zoti ngriti një udhëheqës të ri, Jozueun, që drejtoi me aftësi zaptimin dhe kolonizimin e tokës së premtuar.

### 1. Zoti thërret Jozueun.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jozueun 1.

- Si mendoni ju, me çfarë sfidash u përball Jozueu kur Zoti e thirri atë që të pasonte Moisiun në udhëheqje të izraelitëve? (Ai duhej të udhëhiqte Izraelin në zaptimin dhe kolonizimin e Kanaanit, që ishte një ndërmarrje e fuqishme. Gjithashtu, ai po zëvendësonte një udhëheqës të shkëlqyer.) Çfarë sigurimi i dha Zoti Jozueut kur Jozueu u përgatit që të hynte në tokën e premtuar? (Shih Jozueu 1:5.) Si mund të na ndihmojë ne ky sigurim në thirrjet ose sfidat e reja? Si ju ka ndihmuar Zoti në rrethana të tilla?
- Çfarë urdhri përsëriti Zoti tri herë tek Jozueut 1:6–9? Çfarë duhej të bënte Jozueu për të cilat Zoti tha se i duhej guxim e forcë? (Shih Jozueut 1:7. Vini në dukje se edhe pse Jozueut do t'i duhej kurajë për të luftuar në shumë beteja ushtarake, atij do t'i duhej gjithashtu kurajë morale – kuraja për të bërë atë që është e drejtë.) Me çfarë sfidash përballemi sot që kërkojnë forcë dhe kurajë morale? Çfarë shembujsh të kurajës morale keni vërejtur ju?
- Çfarë i tha Zoti të bënte Jozueut që të “[kishte] sukses”? (Shih Jozueut 1:8. Shpjegoni se libri i ligjit janë shkrimet e shenjta.) Si mendoni ju, përse studimi i shkrimit të shenjtë do të ishte i rëndësishëm që Jozueu të kishte sukses në thirrjen e tij? Si na ndihmon ne studimi i rregullt i shkrimit të shenjtë?

### 2. Izraelitët e kapërcejnë lumin Jordan në vend të thatë; nëpërmjet besimit të tyre, Jeriko shkatërrohet.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jozueun 3–4 dhe 6.

- Kur izraelitëve u duhej të kapërcenin lumin Jordan, brigjet e tij ishin mbushur plot. Në ç'mënyrë Zoti u tregoi fëmijëve të Izraelit se ai qe me Jozueun, pikërisht siç kishte qenë me Moisiun? (Shih Jozueut 3:7–8, 14–17; 4:14. Nëse është e nevojshme, shpjegoni se arka e besëlidhjes ishte një altar i mbartshëm që përmbante shkrime të shenjta, përfshirë shkrimet e Moisiut dhe pllakat që përmbanin Dhjetë Urdhërimet.) Në ç'mënyrë Zoti na tregon se Ai e drejton dhe e frymëzon profetin e gjallë ashtu si bëri me profetët e shkuar?
- Çfarë duhet të bënin priftërinjtë që mbartnin arkën, përpara se të ndalonin ujërat e lumit Jordan? (Shih Jozueut 3:13–17. Ata duhej të hynin në lumin e tejmbushur ndërsa mbartnin arkën.) Në ç'mënyrë Zoti nganjëherë na kërkon neve gjëra të ngjashme?

Plaku Bojd K. Paker ka thënë:

“Pak pasi u thirra si Autoritet i Përgjithshëm, shkova te Plaku Harold B. Li për këshillë. Ai e dëgjoji me shumë kujdes problemin tim dhe sugjeroi që të takohesha me Presidentin Dejvid O. Mek-Kei. Presidenti Mek-Kei më këshilloi në lidhje me drejtimin nga duhej të shkoja. Unë isha shumë i gatshëm që të isha i bindur, por nuk shihja mënyrë të mundshme që të bëja ashtu si më këshilloi ai të bëja.

U ktheva tek Plaku Li dhe i thashë se nuk shihja asnjë mënyrë se si të shkoja në drejtimin që më këshilloi të shkoja. Ai tha: ‘Problemi yt është se ti dëshiron të shohësh fundin që në fillim’. Iu përgjigja se dëshiroja të shihja të paktën një ose dy hapa më tej. Atëherë erdhi një nga mësimet më të rëndësishme të jetës sime: ‘Ti duhet të mësosh të ecësh në skaj të dritës dhe pastaj për pak hapa në errësirë; atëherë drita do të shfaqet dhe do të të tregojë udhën përpara teje’” (“The Edge of the Light”, *BYU Today*, mars 1991, f. 22–23).

- Përse Izraeli ngriti një përmendore me 12 gurë pasi kapërceu lumin Jordan? (Shih Jozueut 4:1–9. Ajo duhej të ishte një dëshmi e fuqisë së Zotit për brezat e ardhshëm, që t’u kujtonte atyre se Zoti do t’i bekonte ata pikërisht si i kishte bekuar etërit e tyre.) Çfarë përmendoresh vetjake ju kujtojnë ju për fuqinë e Perëndisë në jetën tuaj? (Përgjigjet mund të përfshijnë sakramentin; figura të Krishtit, tempujt dhe profetët; shkrimet e shenjta; dhe përvojat shpirtërore të shënuara në ditare.) Në ç’ mënyrë këto përmendore bekojnë jetën e të tjerëve? (Shih Jozueut 4:21–24.)

Dëshmoni se Zoti do t’u përgjigjet lutjeve, do të japë bekime, do të japë zbulësë dhe do të kryejë vepra të mrekullueshme për çdo brez të ri. Kërkojini anëtarit të caktuar që më parë të klasës që të ndajë përvoja që u kujtojnë atyre fuqinë dhe dashurinë e Perëndisë.

- Kërkojini anëtarit të klasës të caktuar që më parë, që të përshkruajë rënien e Jerikos sikur ai ose ajo të ishte dëshmitar okular (Jozueut 6). Çfarë bëri që të binin muret e Jerikos? (Shih Hebrenjve 11:30.) Përse sjellja e izraelitëve ishte një veprim besimi?
- Cilët qenë të vetmit banorë të Jerikos që u shpëtuan? (Shih Jozueut 6:17, 22–25; shih edhe Jozueut 2:1–15.) Çfarë mund të mësojmë nga shpëtimi i Rahabit dhe familjes së saj?

### 3. Jozueu dhe populli i tij besëlidhin që t’i shërbejnë Zotit.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jozueun 23 dhe 24:14–31.

- Nga fundi i jetës së tij, Jozueu i kujtoi izraelitët se çfarë kishte bërë Perëndia për ta. Jozueu i këshilloi ata gjithashtu që të shmangnin kurthet e grackat. Nëse keni sjellë një kurth të vogël, tregoni se si funksionon ai. Nëse nuk keni sjellë një kurth, përshkruani se si funksionon. Cilat janë disa gjëra që duhet të bëjmë që të shmangim zënien në kurth? (Duhet së pari ta dallojmë se është një kurth dhe pastaj t’i qëndrojmë larg atij.)
- Në këshillën e tij të fundit, Jozueu e paralajmëroi Izraelin që të “lidhe[shin] ngushtë me Zotin” në vend që të “bashkohe[shin] me mbeturinat e . . . kombeve [kanaanite]” (Jozueut 23:8, 12. Si mundemi ne të “lidhe[m]i ngushtë me Zotin” në vend që të lidhemi ngushtë me botën? Në ç’ mënyrë lidhja ngushtë



me kombet kanaanite do të ishte një kurth e një grackë për izraelitët? Cilat janë disa nga kurthet e grackat e botës me të cilat ne përballemi sot?

- Çfarë këshille të rëndësishme dha Jozueu në fund të jetës së tij? (Shih Jozueut 24:14–15.) Cilit besëlidhën që t'i shërbenin Jozueu dhe Izraeli? (Shih Jozueut 24:15–18, 21–25, 31.) Përse njeriu nuk mund t'i shërbejë Perëndisë së vërtetë dhe perëndive të botës në të njëjtën kohë?
- Përse është e rëndësishme të zgjedhim *sot* që t'i shërbejmë Zotit? Si mund ta tregojmë se kemi zgjedhur t'i shërbejmë Atij?

Plaku Marvin J. Ashton tha: “Jozueu na kujton për rëndësinë e marrjes së vendimeve sakaq: ‘Zgjidhni sot kujt doni t'i shërbeni, . . . sa për mua dhe për shtëpinë time do t'i shërbejmë Zotit’ (Jozueut 24:15). Jo nesër, jo kur të bëhemi gati, as kur është e volitshme – por ‘sot’, menjëherë, zgjidhni se kujt do t'i shërbeni. Ai që na fton që ta ndjekim, do të jetë gjithmonë përpara nesh me Shpirtin dhe ndikimin e Tij duke na prirë gjatë rrugës. Ai e ka hartuar e shenjuar shtegun, i ka hapur portat dhe e ka treguar udhën. Ai na ka ftuar që të shkojmë tek Ai dhe koha më e mirë për të shijuar shoqërimin e Tij është menjëherë. Mënyra më e mirë se si ne mund të hyjmë në shteg dhe të qëndrojmë në shteg është duke vepruar ashtu si Jezusi – duke u zotuar plotësisht që të bëjmë vullnetin e Atit të Tij” (në Conference Report, prill 1983, f. 41; ose *Ensign*, maj 1983, f. 30–31).

## Përfundim

Këshilla e fundit e Jozueut për izraelitët përfshiu të njëjtën përgjegjësi që kishte dhënë Zoti kur e thirri të ishte profet – të ishin të fortë dhe trima (Jozueut 23:1–6). Ajo përgjegjësi gjen zbatim sot, po aq shumë sa atëherë sepse të gjithë ne jemi të përfshirë në betejën e rëndësishme shpirtërore mes së mirës e të ligës.

Plaku Ezra Taft Benson tha se dy parime janë thelbësore për siguri dhe paqe: “Së pari, mirëbesimi te Perëndia; dhe së dyti, një vendosmëri për të mbajtur urdhërimet, për t'i shërbyer Zotit, për të bërë atë që është e drejtë. . . . Zoti e ka bërë shumë të qartë në zbulesa që edhe pse kohët bëhen të rrezikshme, edhe pse ne rrethohemi nga tundimi e mëkati, edhe pse ka një ndjenjë pasigurie, edhe pse njerëzit mund t'i lëshojë zemra dhe ankthi të mbushë shpirtin e tyre, nëse ne vetëm i mirëbesojmë Perëndisë dhe mbajmë urdhërimet e Tij, nuk kemi pse të frikësohemi” (në Conference Report, tetor 1950, f. 146).

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Zënia e vendit të një udhëheqësi të suksesshëm

- Shumë njerëz, të tillë si Jozueu dhe Brigam Jangu, u thirrën të zinin vendin e udhëheqësve të shkëlqyer. Cilat mund të kenë qenë disa prej sfidave të tyre? Si mendoni ju, çfarë i ndihmoi ata të ishin të suksesshëm? Çfarë mund të bëjmë për të na ndihmuar që të kemi sukses kur zëmë vendin e dikujt që ka shkëlqyer, qoftë në punë, në kishë, në shkollë apo shtëpi?

### 2. Pasoja e mëkateve të një njeriu te njerëzit e tjerë

- Jepni mësim tregimin e Akanit te Jozueut 7. Për shkak të mosbindjes së Akanit, izraelitët u mundën nga njerëzit e Ait (Jozueut 7:1–5). Çfarë kishte bërë Akani që e shkaktoi këtë? (Shih Jozueut 7:20–21. Ai kishte sjellë mosmiratimin e Zotit mbi Izraelin duke mos iu bindur Atij kur mori plaçka dhe para nga Jeriko.)

- Çfarë sugjerojnë pasojat e mëkatit të Akanit mbi mënyrën se si mëkatet tona vetjake mund të ndikojnë te njerëzit e tjerë? Çfarë ka të gabuar në mendimin se ajo që bëjmë na përket vetëm neve dhe nuk do të lëndojë askënd tjetër? (Ju mund të dëshironi të përdorni shembuj se si veprimet e një personi mund të ndikojnë te të tjerët: Një aksident i shkaktuar nga një shofer i dehur, mund të ndikojë jetën e njerëzve të pafajshëm që dëmtohen. Një njeri që prish mësimin në Shkollën e së Dielës, e bën të vështirë që të tjerët të përqendrohen e të ndiejnë Shpirtin. Një njeri që kryen mëkat seksual ose nuk jeton Fjalën e Urtësisë, u sjell të tjerëve dhembje e vuajtje. Një bashkëshort/e që nuk është besnik/e mund të prishë një familje dhe t’u shkaktojë dhembje të madhe anëtarëve të pafajshëm të familjes. Anëtarë të veçantë të Kishës që nuk ndjekin Zotin, mund të pengojnë të gjithë Kishën që të marrë bekimet e Zotit.)

Plaku Xhejms E. Faust tha: “Zgjedhjet vetjake nuk janë vetjake; ato kanë të gjitha pasoja të përgjithshme. . . . Shoqëria jonë është totali i shumës së asaj që bëjnë miliona individë në jetën e tyre private. Ai total i shumës së sjelljes private ka pasoja publike mbarëbotërore me rëndësi të pamasë. Nuk ka zgjedhje plotësisht vetjake” (në Conference Report, prill 1987, f. 101; ose *Ensign*, maj 1987, f. 80).

### 3. Kalebi merr tokën e Hebronit

- Jozueut 14 tregon se si Kalebi mori tokën e Hebronit nga Jozueu. Përse Kalebi mori tokën e Hebronit? (Shih Jozueut 14:6–14. Vini re se fraza “ka ndjekur plotësisht Zotin” përsëritet në vargjet 8, 9 dhe 14.)

Presidenti Spenser W. Kimball tregoi admirimin e tij për Kalebin dhe sugjeroi disa mësimet që mund t’i marrim prej tij:

“Nga shembulli i Kalebit ne marrim mësimet shumë të rëndësishme. Pikërisht siç iu desh Kalebit të luftonte e të mbetej i vërtetë e besnik që të merrte trashëgiminë e tij, po ashtu ne duhet të kujtojmë se, ndërkohë që Zoti na ka premtuar një vend në mbretërinë e Tij, ne duhet të përpiqemi vazhdimisht e besnikërisht që të jemi të denjë për ta marrë shpërblimin.

Kalebi e mbylli deklarin e tij prekës me një kërkesë e një sfidë me të cilat unë jam plotësisht dakord. Anakimët, gjigantët, ende po banonin në tokën e premtuar dhe ata duheshin mposhtur. Kalebi, tashmë 85-vjeçar, tha: ‘Ma jep këtë mal’ (Jozueut 14:12).

Kjo është ndjenja ime për punën në këtë çast. Ka sfida të mëdha para nesh, mundësi gjigante që duhen përdorur. E mirëpres atë këndvështrim emocional dhe e ndiej që t’i them Zotit, përulësisht: ‘Ma jep këtë mal’, m’i jep këto sfida” (në Conference Report, tetor 1979, f. 115; ose *Ensign*, nëntor 1979, f. 79).

### 4. “Zgjidhni Sot Kujt Doni t’i Shërbeni”


Nëse është e disponueshme *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224), ju mund të dëshironi të shfaqni “Choose You This Day Whom Ye Will Serve” [“Zgjidhni Sot Kujt Doni t’i Shërbeni”], një fragment gjashtëminutësh mbi vënien në provë të bindjes së një hamshori arab në një kohë urie dhe etjeje.

Gjyqtarët 2; 4; 6–7; 13–16

---

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të kërkojnë ndikime të cilat do t'i forcojnë ata në të jetuarit e ungjillit në një botë sfiduese.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:<ol style="list-style-type: none"><li>a. Gjyqtarët 2:6–23. Cikli i braktisjes fillon kur një brez i ri i fëmijëve të Izraelit braktis Zotin për t'u shërbyer perëndive të popujve rreth tij.</li><li>b. Gjyqtarët 4:1–16. Baraku urdhërohet të çlirojë Izraelin nga Jabini, mbreti i Kanaanit (4:1–7). Ai pranon të shkojë nëse Debora do të shkojë me të (4:8–9). Debora dhe Baraku e çlirojnë Izraelin nga kanaanitët (4:10–16).</li><li>c. Gjyqtarët 6–7. Gedeoni urdhërohet që të çlirojë Izraelin nga midianitët (6:1–24). Ai dhe 10 burra të tjerë shkatërrojnë natën altarin e Baalit (6:25–35). Zoti e siguron Gedeonin për ndihmën duke i dhënë dy shenja (6:36–40). Gedeoni dhe 300 burra të tjerë e çlirojnë Izraelin nga midianitët (7:1–25).</li><li>ç. Gjyqtarët 13–16. Një engjell udhëzon prindërit e Sansonit që ta rrisin atë si nazireo (13:1–25). Sansoni kryen akte të mëdha force por shkel shumë nga betimet e tij si nazire (14–15). Sansoni i jepet joshjes së Delilahs; atij i presin flokët dhe bëhet i dobët, kapet nga filistejtë dhe vdes duke shkatërruar tempullin e tyre (16:1–31).</li></ol></li><li>2. Lexim shtesë: “Gjyqtarë(ve), Libri i, Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, faqe 61.</li><li>3. Ju mund të dëshironi t'u kërkonin anëtarëve të klasës që të përgatiten për të përmbledhur një ose më shumë prej rrëfimeve nga shkrimet e shenjta në këtë mësim.</li></ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Presidenti Gordon B. Hinkli tregoi për një rast kur mbolli një pemë të re në kopsht, por nuk mori parasysh që të përdorte kunj mbështetës për ta ndihmuar që të rritej drejt. Me kohë, era bëri që pema të prirej shumë nga njëra anë. Presidenti Hinkli e kuptoi që, po ta kishte lidhur pemën me kunj, do të kishte pasur mbështetje derisa të ishte mjaft e fortë sa t'i bënte vetë ballë erës. (Në Conference Report, tetor 1993, f. 77–78; ose <i>Ensign</i>, nëntor 1993, f. 59.)</p> <p>Shpjegoni se nganjëherë ne mund të jemi si ajo pemë e re, të paaftë që t'i bëjmë ballë vetë erës (tundimeve të Satanit). Tek libri i Gjyqtarëve, ne mësojmë për disa nga “kunjat” që mund të na mbështesin. Vizatoni në dërrasë një pemë të re të lidhur te katër kunj mbështetës. Ndërsa kaloni nëpër katër rrëfimet nga shkrimet e shenjta në mësim, etiketojeni çdo kunj si vijon:</p>

---



## Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.


Të udhëhequr nga Jozueu, izraelitët pushtuan shumë prej tokës së premtuar. Pasi vdiq Jozueu, Izraeli nuk u bashkua nën një udhëheqës të vetëm deri në kohën e profetit Samuel dhe të mbretit Saul. Gjatë kësaj periudhe, 12 gjyqtarë shërbyen si sundimtarët dhe udhëheqësit ushtarakë të Izraelit. Shumica e mbretërimit të tyre qe tragjike, ndërsa Izraeli kaloi shumë herë nëpër një cikël braktisjeje, robërie, pendimi dhe çlirimi.

Si kompensim për pjesët tragjike të kësaj historie, janë ndodhi të njerëzve që mbetën të drejtë, duke dhënë shembuj të fuqishëm të mënyrës si të ushtrohet besim e kurajë në një botë braktisëse. Debora dhe Gedeoni qenë që të dy gjyqtarë të drejtë të cilët Zoti i ngriti për të çliruar Izraelin. Besimi i Deboras dhe kontribut të madh për çlirimin e Izraelit nga ushtria kanaanite. Mbështetja e Gedeonit tek Zoti e lejoi ushtrinë e tij prej 300 burrash që të mposhte mrekullisht midianitët.

### 1. Forca e prindërve të drejtë dhe pasojat e braktisjes së rrugës së tyre

Jepni mësim dhe diskutoni për Gjyqtarët 2:6–23.

- Tek libri i Gjyqtarëve, fëmijët e Izraelit përjetuan disa cikle drejtësie dhe braktisjeje (shih diagramin “Cikli i Braktisjes tek Gjyqtarët” në faqe 89). Si e nisi ciklin e braktisjes brezi i ri i Izraelitëve? (Shih veçanërisht Gjyqtarët 2:10, 12, 17, 20 dhe 22. Sugjeroni që anëtarët e klasës të shenjojnë fjalë kyç në këto vargje. Vini në dukje se fëmijët e Izraelit e braktisën Perëndinë dhe i braktisën rrugën e besëlidhjet e prindërve të tyre.)



- Përse fëmijët nganjëherë i braktisin mësimet dhe rrugët e drejta të prindërve të tyre? Si mund t'i ndihmojnë prindërit fëmijët e tyre që të jenë besnikë? Në ç'mënyrë ju kanë forcuar ju prindërit ose anëtarë të tjerë të familjes në të jetuarit e drejtë?
- Si mund t'i dallojmë shenjat e hershme të braktisjes? Në ç'mënyrë një individ mund të ndërpresë ciklin e braktisjes? Si mund ta ndihmojmë siç duhet një anëtar të familjes ose mik që duket se është larguar nga e vërteta?

## 2. Debora – forca e një mikeje të drejtë

Shihni shkurtimisht historinë e Deboras dhe Barakut nga Gjyqtarët 4:1–16, ose vini një anëtar të caktuar të klasës që ta bëjë atë.

- Çfarë e urdhëroi Zoti që të bënte Barakun? (Shih Gjyqtarët 4:6–7.) Si u ndie Baraku për këtë detyrë? Me çfarë kushti Baraku që i gatshëm që të shkonte në betejë kundër Siseras dhe 900 qerreve të tij të hekurta? (Shih Gjyqtarët 4:8.) Si mendoni ju, përse Baraku që i gatshëm të përballlej me Siseran nëse Debora do të shkonte me të?
- Çfarë ju lë mbresë për Deboran? Çfarë cilësish kishte ajo që Baraku mund të mos i ketë pasur? (Shih Gjyqtarët 4:4–9, 14.)
- Çfarë mund të mësojmë rreth Deboras mbi të qenit një mike e vërtetë? (Një gjë që mund të mësojmë është se miqtë e vërtetë na frymëzojnë t'i bindemi Zotit dhe na japin forcë që të bëjmë atë që është e drejtë.) Në ç'mënyrë ju kanë ndihmuar miqtë tuaj të përballeni me sfida të vështira ose t'u bindeni urdhërimeve të Zotit? Në ç'mënyrë mund të jemi miq më të mirë për të tjerët?

Sugjeroni që anëtarët e klasës të shkruajnë emrat e miqve të tyre dhe të pyesin veten 1) nëse ata janë si Debora për këta miq dhe 2) nëse këta miq janë si Debora.

## 3. Gedeoni – forca e besimit të Perëndia

Shihni shkurtimisht historinë e Gedeonit nga Gjyqtarët 6–7, ose vini një anëtar të caktuar të klasës që ta bëjë atë.

- Çfarë e urdhëroi Zoti që të bënte Gedeonin? (Shih Gjyqtarët 6:14.) Cila ishte përgjigjja e parë e Gedeonit? (Shih Gjyqtarët 6:15.)
- Në ç'mënyrë Zoti e siguroi Gedeonin se Ai e kishte urdhëruar atë të çlironte Izraelin dhe Ai do të ishte me të e do ta ndihmonte? (Shih Gjyqtarët 6:16–23, 36–40; 7:9–15.)

- Kur Gedeoni besoi se Zoti e kishte urdhëruar vërtet atë që të çlironte Izraelin, ai shkoi përpara me besim. Përse Zoti dëshironte që ushtria e Gedeonit prej 32.000 burrash të zvogëlohej në 300 për të luftuar midianitët? (Shih Gjyqtarët 7:2. Zoti dëshironte që izraelitët t'i mirëbesonin Atij e ta njihnin fuqinë e Tij, jo fuqinë e tyre.) Në ç'mënyrë Zoti na mëson sot t'i mirëbesojmë Atij dhe të njohim fuqinë e Tij?
- Çfarë ndodhi kur Gedeoni dhe 300 burrat e tij u përballën me midianitët? (Shih Gjyqtarët 7:16–23.) Si mendoni ju, përse Gedeoni dhe burrat e tij bërtitën: “Shpata e Zotit dhe e Gedeonit”? (Shih Gjyqtarët 7:20. Gedeoni e dinte – dhe dëshironte që burrat e tij ta dinin – se Zoti qe me ta.)
- Çfarë mund të mësojmë ne nga Gedeoni? Në ç'mënyrë ju ka ndihmuar Zoti të bëni diçka që ju kërkoi dhe që ishte e vështirë? (Ndërsa anëtarët e klasës ndajnë përvoja, dëshmoni se kur Zoti na urdhëron të bëjmë diçka, Ai do të na ndihmojë ta përmbushim atë.)

#### 4. Sansoni – forca e besëlidhjeve dhe pasojat e shkeljes së tyre

Shihni shkurtimisht historinë e Sansonit nga Gjyqtarët 13–16, ose vini një anëtar të caktuar të klasës që ta bëjë atë.

- Në ç'mënyrë e mësoi nëna e Sansonit, që ishte shterpë, se do të kishte një bir? (Shih Gjyqtarët 13:2–3.) Çfarë i tha engjëlli nënës së Sansonit për birin që do të kishte? (Shih Gjyqtarët 13:4–5. Shpjegoni se nazireasit bënë besëlidhje me Zotin që të ndaheshin nga gjërat e botës dhe të shenjtëroheshin tek Ai. Betimi i nazireatit paraqitet te Numrat 6:2–6, 8.)
- Çfarë bekimesh i dha Zoti Sansonit për ta ndihmuar që të përmbushte misionin e tij për të çliruar Izraelin nga filistejtë? (Shih Gjyqtarët 13:24–25; 14:5–6, 19; 15:14–15. Zoti i dha atij forcë shpirtërore dhe fizike.)
- Si nazire dhe anëtar i shtëpisë së Izraelit, Sansoni bëri besëlidhje me Zotin. Megjithatë, ai shpejt e shkeli betimin e tij nazireas dhe besëlidhjet e tij si anëtar i shtëpisë së Izraelit. Çfarë betimesh e besëlidhjesh shkeli ai? (Disa nga besëlidhjet që shkeli Sansoni renditen më poshtë.)
  - a. Ai u martua jashtë besëlidhjes së shtëpisë së Izraelit (Gjyqtarët 14:1–3).
  - b. Ai kreu shkelje morale me një prostitutë (Gjyqtarët 16:1).
  - c. Atij i prenë flokët (Gjyqtarët 16:4–20).
- Cilat qenë pasojat e shkeljes prej Sansonit të besëlidhjeve të tij? (Shih Gjyqtarët 16:17–21. Ai humbi forcën e tij shpirtërore e fizike dhe filistejtë e verbuan dhe e lidhën. Nëse është e nevojshme, shpjegoni se flokët e Sansonit nuk ishin burimi i forcës së tij fizike. Përkundrazi, flokët e tij ishin një shenjë e besëlidhjes së tij me Zotin dhe, kur iu prenë flokët, Zoti ia hoqi forcën e tij fizike sepse besëlidhja u shkel.) Çfarë ndodh kur ne shkelim besëlidhjet tona? Çfarë shenjash kemi ne të besëlidhjeve tona me Zotin?
- Besëlidhjet që bëjmë me Zotin, duhet të jenë një burim force, udhëheqjeje dhe zotimi. Çfarë besëlidhjesh bëjmë ne me Zotin? Në ç'mënyrë këto besëlidhje ju kanë forcuar ju? (Një mënyrë se si besëlidhjet na forcojnë është duke na ndihmuar t'u bëjmë ballë përpyekjeve të Satanit për të na verbuar ose lidhur.)
- Sansoni kishte mundësi të mëdha. Engjëlli që shpalli lindjen e tij, tha se ai do të fillonte të çlironte Izraelin nga filistejtë. Zoti e bekoi atë me shumë dhurata,



përfshirë forcë të madhe fizike. Çfarë dobësish të brendshme shkaktuan rrënimin e tij? (Shih Gjyqtarët 15:7; 16:1; DeB 3:4. Përgjigjet mund të përfshijnë vetëkënaqjen, imoralitetin, kërkimin e hakmarrjes dhe shkeljen e besëlidhjeve.) Si mund t'i kapërcejmë dobësitë që mund të na pengojnë të përmbushim mundësitë tona?

## Përfundim

Shpjegoni se te libri i Jozueut, izraelitët luftuan dhe fituan shumë beteja fizike kundër kanaanitëve. Megjithatë, në librin e Gjyqtarëve, izraelitët filluan të humbasin betejat shpirtërore, duke u lejuar të ndikoheshin nga praktika si të botës dhe perënditë e rreme të kanaanitëve. Ne përballemi me beteja të ngjashme shpirtërore. Dëshmoni se ne mund të kemi sukses në këto beteja kur 1) ndjekim rrugën e prindërve dhe paraardhësve të drejtë, 2) zëmë miq të mirë, 3) rrisim besimin tonë te Zoti dhe 4) mbajmë besëlidhjet tona.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

### 1. Kontributi i prindërve për dhënien pas dëshirave si të botës të fëmijëve të tyre (Gjyqtarët 1:28)

- Dështimi i brezit të ri të izraelitëve që të mbeteshin besnikë nuk qe i gjithi për faj të tyre. Sipas Gjyqtarëve 1:21, 27–33 dhe Gjyqtarëve 2:1–4, si u hodh themeli për dështimin e fëmijëve? (U hodh nga dështimi i prindërve që t'i dëbonin krejt kanaanitët. Edhe pse prindërit qenë mjaft të fortë sa t'u bënin ballë ndikimeve të botës rreth tyre, fëmijët e tyre nuk ishin aq të fortë.)
- Në ç'mënyrë disa prindër sot i ekspozojnë fëmijët e tyre ndaj ndikimeve të botës, duke bërë të njëjtin gabim si prindërit e "brezit të ri" të izraelitëve? (Nxisni përgjigje të veçanta.)

### 2. Mrekullitë në kohën tonë

- Përse disa njerëz, ashtu si Gedeoni, ndiejnë se Zoti bëri më shumë mrekulli në brezat e mëparshëm sesa bën në të tyrin? (Shih Gjyqtarët 6:13.) Cili është roli ynë në kryerjen e mrekullive? (Shih Moroni 7:35–38.) Si e dini se Perëndia vazhdon të bëjë mrekulli sot? Në ç'mënyrë mund t'i dallojmë mrekullitë e thjeshta në jetën tonë?

### 3. "Izraeli do të mund të mburrej para meje" (Gjyqtarët 7:2)

- Përse Zoti e urdhëroi Gedeonin që t'i kthente në shtëpi shumicën e trupave të tij përpara se të përballej me midianitët? (Shih Gjyqtarët 7:2.) Në ç'mënyrë "mburre[n]" disa prej nesh sot? (Në vend që ta dallojnë se bekimet dhe forca jonë vijnë nga Zoti, disa prej nesh pretendojnë se e kanë fituar gjithçka kanë nëpërmjet vetë përpjekjeve të tyre.) Si mund ta kapërcejmë këtë problem?

### 4. Qëndresa ndaj tundimit

- Pasi Sansoni e dinte se Delilah ishte përpjekur tri herë që ta tradhëtonte atë, përse ia tregoi asaj sekretin e forcës së tij? (Shih Gjyqtarët 16:15–17.) Krahasoni përgjigjet e Sansonit ndaj Delilahs me përgjigjet e Jozefit ndaj gruas së Potifarit (Zanafilla 39:7–12). Si mund t'u bëjmë ballë ose t'i kapërcejmë tundimet ngulmuese?

# “Gjithë . . . Qyteti . . . e Di . . . që Ti Je një Grua e Virtytshme”

Ruthi; 1 Samuelit 1

Qëllimi	Të nxisë anëtarët e klasës që të kenë si shembull cilësitë e drejta të Ruthit, Naomit dhe Anës.
Përgatitja	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ruthi 1–2. Pasi i vdes bashkëshorti, Ruthi lë shtëpinë e saj për të shkuar në Bethlehem me vjehrrën e saj, Naomin. Në Bethlehem, Ruthi punon në fushat e Boazit, i cili e trajton me mirësi.</li> <li>Ruthi 3–4. Ruthi shtrihet tek këmbët e Boazit dhe ai i premton të martohet me të. Ata martohen dhe bëhen me një fëmijë. Pasardhësit e tyre përfshijnë mbretin David dhe Jezu Krishtin.</li> <li>1 Samuelit 1; 2:1–2, 20–21. Ana bekohet me një bir, të cilin ajo ia dorëzon Zotit, siç kishte premtuar. Më vonë ajo bekohet me fëmijë të tjerë.</li> </ol> <p>2. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni një copë letër dhe një stilolaps ose laps për secilin anëtar të klasës.</p> <p>3. Nëse është e disponueshme <i>Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]</i> (53224), ju mund të dëshironi të shfaqni “Hannah’s Faith” [“Besimi Anës”], një fragment treminutësh, si pjesë të mësimin.</p>
Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	<p>Jepini secilit anëtar të klasës një copë letër dhe një stilolaps ose laps.</p> <p>Shpjegoni që edhe pse Libri i Ruthit është i shkurtër, ai tregon qartë se Ruthi ishte një grua e drejtë. Pastaj bëni pyetjet vijuese dhe vëreni çdo anëtar të klasës që të shkruajë përgjigjet e tij në copën e tij ose të saj të letrës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nëse karakteri juaj duhet të përshkruhet me vetëm pak fjalë, cilat do të dëshironit që të ishin këto fjalë? Çfarë është një gjë që mund ta bëni këtë javë që t’i afroheni përputhjes me atë përshkrim të dëshiruar?</li> </ul> <p>Shpjegoni se ky mësim do të diskutojë cilësitë e drejta të Ruthit dhe të dy grave të tjera, të Naomit dhe të Anës.</p>
Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Ruthi lë shtëpinë e saj për të shkuar në Bethlehem me Naomin.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për Ruthin 1–2.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përse Naomi dhe familja e saj shkuan të jetonin në Moab? (Shih Ruthi 1:1–2.) Përse Naomi u kthye në Bethlehem pas vdekjes së bashkëshortit dhe bijve të saj? (Shih Ruthi 1:6. Bethleheми që shtëpia e saj dhe zia e bukës atje kishte mbaruar.)</li> </ul>

- Ndërsa jetonin në Moab, bijtë e Naomit u martuan me Orpahun dhe Ruthin, që ishin gra moabite (Ruthi 1:4). Si e tregoi Naomi dashurinë dhe interesimin e saj për nuset kur ato u ofruan të ktheheshin në Bethlehem me të? (Shih Ruthi 1:7–13.) Çfarë mund të mësojmë nga interesimi i Naomit për nuset e saj që mund të na ndihmojë në marrëdhëniet tona familjare?
- Një nga nuset e Naomit, Orpahu, u kthye te familja e saj, por tjetra, Ruthi, këmbënguli që të shkonte në Bethlehem me Naomin. Çfarë mund të mësojmë për Ruthin nga premtimi i saj ndaj Naomit tek Ruthi 1:16–17? (Ajo ishte e dashur, besnike dhe e gatshme të sakrifikoje.) Si mund të tregojmë besnikëri më të madhe në familjet tona? Si mund të tregojmë vetëmohim më të madh, ashtu si Ruthi?
- Nga çfarë hoqi dorë Ruthi duke shkuar në Bethlehem me Naomin? (Përgjigjet mund të përfshijnë atdheun, familjen, miqtë dhe fenë e saj.) Çfarë fitoi Ruthi duke shkuar me Naomin? (Ungjillin e Jezu Krishtit; shih idenë e parë shtesë për mësimdhënie.) Çfarë mund të mësojmë nga Ruthi mbi bërjen e sakrificave për ungjillin?
- Pasi shkoi në Bethlehem, çfarë bëri Ruthi që të siguronte ushqim për vete dhe për Naomin? (Shih Ruthi 2:2. Ju mund të doni të shpjegoni se mbledhësi i kallinjve ishte një njeri që lejohej të mblidhte e të mbante grurin që mbetej në fusha pas korrjes.) Në fushat e kujt mblodhi kallinj Ruthi? (Shih Ruthi 2:1, 3.) Përse Boazit i la mbresë Ruthi? (Shih Ruthi 2:5–7, 11. Boazi e pa se Ruthi ishte shumë punëtoare. Ai gjithashtu dinte gjithçka kishte bërë Ruthi për Naomin.) Në ç'mënyrë e tregoi Boazi shpirtmirësinë e tij ndaj Ruthit? (Shih Ruthi 2:8–9, 14–16.)
- Në ç'mënyrë e tregoi Ruthi vetëmohimin e saj kur u kthye nga mbledhja e kallinjve? (Shih Ruthi 2:14, 17–18. Ruthi ia solli Naomit në shtëpi grurin që kishte mbledhur dhe gjithashtu ajo i solli Naomit ushqim që e kishte kursyer nga vakti i saj i drekës.) Si jeni bekuar nga veprimet vetëmohuese të njerëzve të tjerë?

## 2. Ruthi dhe Boazi martohen dhe bëhen me një fëmijë.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ruthin 3–4.

- Naomi e këshilloi Ruthin të kryente një ritual që ajo shpresonte se do të sillte martesën e Ruthit dhe Boazit (Ruthi 3:1–5). Duke u shtrirë tek këmbët e Boazit, në fakt, Ruthi po i propozonte martesë atij. Çfarë na zbulon bindja e Ruthit ndaj këshillës së Naomit për ndjenjat e saj kundrejt Naomit?
- Si u përgjigj Boazi kur u zgjua dhe gjeti Ruthin shtrirë tek këmbët e tij? (Shih Ruthi 3:8–15. Vini re se kur Ruthi tha: “Shtrije . . . manteli[n] tënd mbi shërbëtoreshen tënde”, ajo donte të thoshte “më ruaj, më mbro, kujdesu për mua”.) Me çfarë kushti Boazi ra dakord që të martohej me Ruthin? (Shih Ruthi 3:11–13. Shpjegoni se kur bashkëshorti i Ruthit vdiq, kushëriri i tij më i afërt maskull supozohej të martohej me Ruthin. Boazi nuk ishte kushëriri maskull më i afërt, por ai ra dakord të martohej me Ruthin nëse kushëriri maskull më i afërt nuk dëshironte ta bënte këtë.)
- Cili ishte nami i Ruthit mes njerëzve të Bethlehemit? (Shih Ruthi 3:11.) Në ç'mënyrë ky nam i solli dobi asaj në marrëdhënien e saj me Boazin? Përse është e rëndësishme që anëtarët e familjes, miqtë e fqinjët tanë ta dinë se çfarë besojmë ne dhe çfarë vlerash mundohemi të përkrahim?

- Çfarë bëri Boazi pasi premtoi të martohej me Ruthin? (Shih Ruthi 3:15; 4:1–8.) Në ç'mënyrë Boazi tregoi se ishte burrë me integritet moral? (Shih Ruthi 4:9–10, 13. Ai e mbajti premtimin e tij ndaj Ruthit dhe nderoi detyrimin e tij shoqëror ndaj bashkëshortit të saj të ndjerë.)
- Cili mbret i famshëm i Izraelit qe pasardhës i Ruthit dhe Boazit? (Mbreti David qe një nga stërnipërit e tyre; shih Ruthi 4:17, 21–22.) Kush tjetër qe pasardhës i Ruthit dhe Boazit? (Jezu Krishti; shih Mateu 1:5–16; Gjoni 7:42.)
- Plaku Tomas S. Monson e quajti Ruthin një heroinë (në Conference Report, tetor 1974, f. 156; ose *Ensign*, nëntor 1974, f. 108). Si mendoni ju, në çfarë mënyrë Ruthi ishte një heroinë? (Plaku Monson tha se Ruthi ishte një shembull besnikërie. Anëtarët e klasës mund të sugjerojnë mënyra të tjera se si Ruthi ishte një heroinë.)

### 3. Ana bekohet me një bir, të cilin ajo ia dorëzon Zotit, siç kishte premtuar.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 1.

- Ana, bashkëshortja e Elkanahut, nuk kishte fëmijë. Çdo vit në tempull ajo qau dhe u lut për një bir (1 Samuelit 1:1–7). Çfarë premtimi i bëri Ana Zotit te 1 Samuelit 1:11? Çfarë mund të mësojmë për Anën nga ky premtim? (Ajo qe grua me besim të madh; anëtarët e klasës mund të sugjerojnë përgjigje të tjera.)
- Cili qe dëshmitar i Anës që lutej në tempull? (Shih 1 Samuelit 1:9–12.) Çfarë i tha Eli Anës për premtimin e saj ndaj Zotit? (Shih 1 Samuelit 1:17.) Si u ndie Ana pasi dëgjoi fjalët e Elit? (Shih 1 Samuelit 1:18.) Si mund të na ndihmojnë udhëheqësit e Kishës kur jemi të shqetësuar?
- Ana i tha Elit se ajo kishte qenë “duke hapur zemrën [e saj] para Zotit” (1 Samuelit 1:15). Si mund t’i bëjmë lutjet tona personale më të sinqerta e kuptimplote?
- Çfarë ndodhi në përgjigje të premtimit të Anës ndaj Zotit? (Shih 1 Samuelit 1:9–20.) Si e mbajti Ana premtimin e saj pas lindjes së Samuelit? (Shih 1 Samuelit 1:21–28.) Çfarë premtimesh i bëjmë ne Zotit? (Përgjigjet mund të përfshijnë besëlidhjet që bëjmë me Të në pagëzim dhe në tempull.) Çfarë mund të mësojmë nga Ana për të na ndihmuar që të jemi të zellshëm në mbajtjen e këtyre premtimeve?
- Si mendoni ju, si u ndie Ana për dhënien e Samuelit në shërbim të Zotit? Çfarë na kërkon Zoti që t’i japim Atij? Si duhet të jetë qëndrimi ynë kur i japim diçka Atij? (Ne duhet të japim me gatishmëri, duke kujtuar se gjithçka që kemi vjen nga Zoti.)
- Kur Ana e solli Samuelin në tempull, ajo bëri oferta dhe i thuri lavde Zotit (1 Samuelit 1:24–25, 28; 2:1–2). Përse është e rëndësishme që të kujtohemi ta falënderojmë Zotin për bekimet që Ai na jep?
- Ana priti shumë vite përpara se të bekohej me fëmijë (1 Samuelit 1:2; 2:21). Cilët personazhe të tjerë biblikë u bekuan sepse patën besim të madh te Zoti? Çfarë thotë bota në lidhje me kohën kur duhet të marrim gjërat që duam? Çfarë thotë Zoti? Si mund të mësojmë që t’i presim me durim bekimet që do të vijnë sipas kohës së Zotit?

## Përfundim

- Çfarë cilësish të drejta janë dhënë si shembull nga Ruthi, Naomi dhe Ana? (Renditini këto cilësi në dërrasë.)

Nxitini anëtarët e klasës që të kenë si shembull cilësitë e drejta të shfaqura nga Ruthi, Naomi dhe Ana. Dëshmoni se zhvillimi i këtyre cilësive do të na sjellë më pranë Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

**1. Pranimi i johebrenjve të kthyer në besëlidhjen e Abrahamit**

Shpjegoni se Ruthi nuk ishte izraelite nga lindja. Kur u largua nga Moabi që të shkonte në Bethlehem me Naomin, ajo la gjithashtu fenë e saj dhe ndoqi Perëndinë e Izraelit, duke i thënë Naomit: “Perëndia yt do të jetë edhe Perëndia im” (Ruthi 1:16). Duke u martuar me Boazin, Ruthi u bë pjesë e prejardhjes mbretërore të Izraelit, një paraardhëse e mbretit David dhe Jezu Krishtit.

- Në ç’mënyrë kthimi në besim i Ruthit dhe pranimi në shtëpinë e Izraelit pasqyrojnë qëndrimin e Krishtit kundrejt atyre që dëshirojnë të bashkohen me Kishën e Tij? (Shih 2 Nefi 26:33; Alma 19:36; 3 Nefi 21:6.) Në ç’mënyrë mund t’i ndihmojmë ne të sapokthyerit në besim që të ndihen të mirëpritur në Kishë?

**2. Gjykimi siç duhet**

- Kur prifti Eli pa Anën duke u lutur në tempull, ai e keqgjykoi atë duke menduar se ajo “ishte e dehur” (1 Samuelit 1:13). Cilat janë rreziqet e gjykimit të njerëzve duke u nisur vetëm nga pamja e jashtme? Si mund ta shmangim këtë lloj gjykimi?
- Presidenti Hug B. Braun tha: “Nëse bëj gabime [në të gjykuarin e njerëzve,] dëshiroj që ato të jenë nga ana e mëshirës” (në Eugene E. Campbell dhe Richard D. Poll, *Hugh B. Brown: His Life and Thought* [1975], f. 225). Si mund ta zbatojmë këtë parim?

**3. Zgjidhja e shqetësimeve dhe telasheve duke shkuar në tempull**

- Ku ia bëri Ana premtimin e saj Zotit? (Shih 1 Samuelit 1:9–11.) Në ç’mënyrë vajtja në tempull na ndihmon për shqetësimet dhe telashtet tona?


Plaku Xhon A. Uitso tha: “Unë besoj se personi i zënë me punë . . . që ka shqetësime e telashe, mund t’i zgjidhë problemet e tij më mirë dhe më shpejt në shtëpinë e Zotit se kudo tjetër. Nëse do të [bëjë] punë në tempull për vete dhe për të vdekurit e tij, ai do të japë një bekim të fuqishëm mbi ata që kanë shkuar më parë dhe . . . një bekim do t’i vijë atij, sepse në çastet më të papritura, brenda ose jashtë tempullit do t’i vijë atij, si zbulesë, zgjidhja për problemet që e shqetësojnë. Kjo është dhurata që u vjen atyre që hyjnë në tempull denjësisht” (cituar nga David B. Haight, në Conference Report, tetor 1990, f. 76; ose *Ensign*, nëntor 1990, f. 61).

# Perëndia do të Nderojë Ata që e Nderojnë Atë

1 Samuelit 2–3; 8

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë bekimet [që vijnë] nga nderimi dhe kënaqja e Zotit përmbi veten, të tjerët ose botën.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. 1 Samuelit 2:12–17, 22–25. Bijtë e Elit kryejnë shkelje dhe këshillohen nga ati i tyre.</li> <li>b. 1 Samuelit 2:27–36; 3:12–14. Një njeri i Perëndisë paralajmëron Elin për pasojat e ligësisë në familjen e tij.</li> <li>c. 1 Samuelit 3. Zoti thërret Samuelin dhe ai përgjigjet.</li> <li>ç. 1 Samuelit 8. Izraelitët dëshirojnë një mbret që të mund të jetë “siç ndodh në të gjitha kombet”. Samueli i paralajmëron për rreziqet e një zgjedhjeje të tillë.</li> </ol> </li> <li>2. Ju mund të dëshironi t’i kërkonti një anëtar të klasës që të përgatitet për të përmbledhur rrëfimin e thirrjes së Samuelit (1 Samuelit 3) dhe një tjetër anëtar të klasës që të përgatitet për të përmbledhur rrëfimin e Izraelit që dëshiron një mbret (1 Samuelit 8).</li> <li>3. Nëse vendosni të diskutoni broshurën <i>Për Forcën e Rinisë</i> (34285) në këtë mësim, sillni një kopje të saj në klasë.</li> <li>4. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni një pikturë të Shpëtimtarit (62572; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 240). Nëse nuk parapëlqeni t’i skiconi vizatimet në dërrasë, sillni një pasqyrë, një objekt për të përfaqësuar njerëzit e tjerë, si dhe një hartë, glob ose objekt tjetër për të përfaqësuar botën.</li> <li>5. Nëse është e disponueshme figura I Riu Samuel i Thirrur nga Zoti, ju mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë mësimin (62498; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 111).</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	<p>Përpara mësimin, paraqisni dhe mbulonit një figurë të Shpëtimtarit. Skicojini në dërrasë tri figurat e faqes 97 dhe mbulojini ato (ose paraqisni dhe mbulonit tre objektet e renditur tek “Përgatitja”). Shpjegoni se çdo send i fshehur lidhet disi me atë që nderojmë dhe që përpiqemi ta kënaqim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipas 1 Samuelit 2:30, cilin do të nderojë Zoti?</li> </ul> <p>Thuajuni anëtarëve të klasës se ky mësim do të diskutojë për bekimet që vijnë nga nderimi i Zotit. Shpjegoni se ju do të zbuloni artikujt e fshehur në çastet e përshtatshme gjatë mësimin.</p>





Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Bijtë e Elit nderojnë veten më tepër se Zotin.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet 1 Samuelit 2:12–17, 22–25.

Hofni dhe Finehasi qenë bijtë e Elit, priftit të lartë, dhe qenë priftërinj edhe vetë. Megjithatë, ata ishin të ligj. Kur izraelitët vinin për të ofruar sakrifica në tabernakull, Hofni dhe Finehasi merrnin me forcë mish nga kafshët e flijimit përpara se pjesët e dhjavit të ishin djegur në altar. Ata gjithashtu merrnin nga mishi që ofruesi ziente për vaktin e flijimit (1 Samuelit 2:12–17). Këto qenë shkelje të rënda të ligjeve të Perëndisë, të barasvlerëshme me vjedhjen ndaj Perëndisë. Bijtë e Elit gjithashtu kryen mëkatin jashtëzakonisht të rëndë të rënies në shtrat me gratë që mblidheshin te porta e tabernakullit (1 Samuelit 2:22).

- Çfarë ndikimi patën veprimet e bijve të Elit mbi njerëzit e tjerë në Izrael? (Shih 1 Samuelit 2:17, 24.)
- Çfarë sugjerojnë veprimet e bijve të Elit mbi atë që ata zgjedhën të nderonin? (Zbuloni skicën e parë ose një pasqyrë të vërtetë.) Në çfarë fushash të jetës sonë nganjëherë ne nderojmë e kënaqim veten në vend që të kënaqim Zotin? Anëtarët e klasës mund të sugjerojnë fusha të tilla si vijon:
  - a. Zbavitja
  - b. Respektimi i Shabatit
  - c. Takimet për njohje dhe parimet morale
  - ç. Agjërimi
  - d. Thirrjet në Kishë
- Si mendoni ju, përse ne nganjëherë zgjedhim të nderojmë veten në vend të Perëndisë? Cilat janë pasojat e nderimit të vetes më tepër se të Perëndisë?

### 2. Eli nderon bijtë e tij më tepër se Zotin.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 2:27–36; 3:12–14.

- Çfarë përgjegjësie kishte Eli kur mësoi për ligësinë e bijve të tij? Çfarë bëri ai? (Shih 1 Samuelit 2:22–25.) Cila ishte përgjigja e tyre? (Shih 1 Samuelit 2:25.)

- Pasi i qortoi bijtë e tij, Eli nuk bëri gjë tjetër për të korrigjuar mëkatet e tmerrshme në familjen e tij dhe në tabernakull. Si rezultat, një njeri i Perëndisë erdhi dhe e qortoi, duke i thënë se ai kishte nderuar bijtë e tij më shumë se Perëndinë (1 Samuelit 2:27–29). Në çfarë mënyre Eli i kishte nderuar bijtë e tij më shumë se Perëndinë? Çfarë tha njeriu i Perëndisë se do t’i ndodhte shtëpisë së Elit? (Shih 1 Samuelit 2:30–35.)
- Në çfarë mënyrash ne nganjëherë nderojmë njerëzit e tjerë më shumë se Perëndinë? (Zbuloni skicën e dytë ose objektin që përfaqëson njerëzit e tjerë.) Anëtarët e klasës mund të sugjerojnë mënyra të tilla si vijon:
  - a. Ne e lejojmë shoqërinë tonë që të na mbushë mendjen për të bërë diçka që e dimë se është e gabuar.
  - b. Ne veprojmë me pandershmëri sepse kemi frikë nga ajo që njerëzit e tjerë mund të mendojnë për ne.
  - c. Ne nuk ia dalim t’i korrigojmë anëtarët e familjes ose miqtë për keqbërjet e tyre sepse duam të mbajmë marrëdhënie të mira me ta.

Presidenti Jozef F. Smith dha mësim: “Nuk duhet të ketë asnjë prej nesh kaq papërgjegjshëm tolerues, kaq të shkuajdesur e kaq të cekët në dashurinë për fëmijët tanë sa që të mos guxojmë t’i ndalojmë ata në një udhë mosbindjeje, për keqbërje dhe në dashurinë e tyre të pamend për gjërat e botës më shumë sesa për gjërat e drejtësisë, nga frika se mos i fyejmë ata” (*Gospel Doctrine*, bot. 5-të [1939], f. 286).

- Në ç’mënyrë prindërit mund të përmbushin përgjegjësinë e tyre ndaj fëmijëve të pabindur me një shpirt dashurie? Cila është përgjegjësia e fëmijëve kur prindërit e tyre përpiqen fort t’i udhëheqin ata në drejtësi?

### 3. Samueli nderon Zotin.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 3. Ju mund të dëshironi që një anëtar i caktuar i klasës ta përmbledhë shkurt këtë kapitull. Kujtojeni anëtarët e klasës që djaloshi Samuel po shërbente në tempull pasi nëna e tij, Ana, e kishte dhënë atë në shërbim të Zotit, ashtu siç kishte premtuar (1 Samuelit 1).

- Kush i foli natën Samuelit? (Shih 1 Samuelit 3:4.) Për cilin mendoi Samueli në fillim se po e thërriste atë? (Shih 1 Samuelit 3:5–6, 8.) Si e mësoi Samueli se ishte Zoti që po e thërriste? (Shih 1 Samuelit 3:8–9.)
- Si komunikoi Zoti me ne? (Ai komunikoi më shpesh nëpërmjet pëshpëritjeve të Frymës së Shenjtë. Anëtarët e klasës mund të sugjerojnë mënyra të tjera se si Ai komunikoi me ne.) Si mund të përgatitemi që t’i marrim dhe t’i kuptojmë komunikimet nga Zoti?
- Në çfarë mënyrash Samueli e nderoi Zotin? (Zbuloni figurën e Zotit.) Ju mund të dëshironi të merrni parasysh fragmentet vijuese në diskutimin tuaj:

“Unë do të zgjedh për vete një prift besnik, që ka për të vepruar simbas asaj që ndjej në zemrën dhe në shpirtin tim” (1 Samuelit 2:35).

“Zoti thirri Samuelin që u përgjegj: ‘Ja ku jam!’” (1 Samuelit 3:4).

“Samueli u përgjegj: ‘Folë, sepse shërbëtori yt të dëgjon’” (1 Samuelit 3:10).

- Zoti premtoi të nderonte ata që e nderonin Atë (1 Samuelit 2:30). Në ç'mënyrë e nderoi Zoti Samuelin? (Shih 1 Samuelit 3:19.) Si mendoni ju se do të na nderojë Zoti nëse ne e nderojmë ashtu si bëri Samueli?

#### 4. Izraelitët nderojnë botën.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelin 8. Ju mund të dëshironi që një anëtar i caktuar i klasës ta përmbledhë shkurt këtë kapitull.

- Çfarë lloj qeverisjeje kishte Izraeli gjatë shërbesës së Samuelit? (Shih 1 Samuelit 8:1. Izraelitët qeveriseshin nga gjyqtarët.) Cilin supozohej ta konsideronte Izraeli si mbretin e tij? (Shih 1 Samuelit 12:12.)
- Përse fëmijët e Izraelit dëshironin një mbret? (Shih 1 Samuelit 8:5, 20.) Duke kërkuar një mbret "ashtu siç ndodh në të gjitha kombet", cilin nuk kishte pranuar Izraeli? (Shih 1 Samuelit 8:7.) Çfarë e udhëzoi Zoti që të thoshte Samuelin lidhur me problemet e pasjes së një mbreti? (Shih 1 Samuelit 8:9–18.) Cila ishte përgjigjja e izraelitëve ndaj paralajmërimeve të Samuelit? (Shih 1 Samuelit 8:19–22.)
- Duke kërkuar një mbret, cilin nderuan izraelitët? (Zbuloni skicën e tretë ose një objekt që përfaqëson botën.)
- Në çfarë mënyrash ne nganjëherë dëshirojmë të jemi "ashtu siç ndodh në të gjitha kombet"? (Shih 1 Samuelit 8:5.)

Ju mund të dëshironi të përdorni broshurën *Për Forcën e Rinisë* (34285) për të diskutuar standardet që ka vendosur Zoti për ne, kështu që ne të mos marrim pjesë në mënyrat e liga të botës. Shpjegoni se këto standarde zbatohen si për të rriturit ashtu edhe për rininë.

- Zoti Jezus Krisht është mbreti ynë i vërtetë, ashtu siç qe mbreti i vërtetë i izraelitëve (Psalmeve 47:7; 89:18; 149:2). Në ç'mënyrë kjo njohuri duhet të ndikojë të qëndrimet tona kundrejt mënyrave të botës? Në ç'mënyrë ne nganjëherë nuk e pranojmë Zotin si mbretin tonë?

#### Përfundim

Tërhiqeni vëmendjen te katër sendet që janë paraqitur gjatë orës mësimore. Shpjegoni se të gjithë ne duhet të zgjedhim çdo ditë se kë do të nderojmë. Jepni dëshmi për bekimet dhe gëzimin që keni marrë kur keni nderuar Zotin. Ftoni anëtarët e klasës që të ndajnë përvojat ose dëshmitë e tyre.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

##### 1. Vlera e gjërave që zgjedhim

- Nganjëherë ne shkëmbejmë gjëra me vlerë të madhe me gjëra me vlerë më të vogël. Nga çfarë hoqën dorë Eli dhe bijtë e tij për shkak të zgjedhjeve të tyre? Nga çfarë gjërash u tha Samueli izraelitëve se do të hiqnin dorë nëse dëshironin një mbret? (Shih 1 Samuelit 8:11–17.) Nga çfarë gjërash me vlerë të madhe heqim dorë ne nganjëherë për gjëra me vlerë më të vogël?

## 2. “Atë që Zoti e thërret, atë Zoti e kualifikon”

Presidenti Tomas S. Monson bëri deklarinimin e mëposhtëm për të treguar se si Zoti i nderon ata që e nderojnë Atë:

“Disa nga ju mund të jenë të druajtur nga natyra ose ta konsiderojnë veten të papërshtatshëm për t’iu përgjigjur pozitivisht një thirrjeje. Mbani mend që kjo vepër nuk është vetëm e juaja dhe e imja. Ajo është vepra e Zotit dhe, kur jemi në punën e Zotit, na është dhënë e drejta të kemi ndihmën e Zotit. Kujtoni se atë që Zoti e thërret, atë Zoti e kualifikon” (në Conference Report, prill 1996, f. 62; ose *Ensign*, maj 1996, f. 44).

Pastaj, Presidenti Monson tregoi ndodhinë e mëposhtme:

“Nëse ndiejmë se një detyrë është tepër e lodhshme ose ha tepër kohë, më lejoni të ndaj me ju përvojën e një mësuesi shtëpie besnik dhe të shokut të tij në atë që atëherë qe Gjermania Lindore.

Vëllai Johan Dendorfer ishte kthyer në besim në Kishë në Gjermani dhe, pas Luftës II Botërore, e gjeti veten praktikisht të burgosur në vetë tokën e tij – toka e Hungarisë në qytetin Debrecën. Sa shumë dëshironte të vizitonte tempullin! Sa shumë dëshironte t’i merrte bekimet e tij shpirtërore! Kërkesa pas kërkesash për të shkuar në tempull në Zvicër i ishin mohuar dhe ai gati e humbi shpresën. Pastaj e vizitoi mësuesi i tij i shtëpisë. Vëllai Valter Krauze bëri gjithë rrugën nga pjesa verilindore e Gjermanisë për në Hungari. Ai i kishte thënë shokut të tij në vizitat e shtëpisë: ‘A do të dëshiroje të vije për mësimin e shtëpisë me mua këtë javë?’

Shoku i tij pyeti: ‘Kur do të nisemi?’

‘Nesër’, iu përgjigj Vëllai Krauze.

‘Kur do të kthehem?’ pyeti shoku.

‘Oh, për rreth një javë – nëse mund të kthehem në atë kohë!’

Dhe ata u nisën për të vizituar Vëllanë Dendorfer. Ai nuk kishte pasur mësues shtëpie që përpara luftës. Tani, kur pa shërbëtorët e Zotit, ai u trondit. Ai nuk u toku duart atyre; përkundrazi, shkoi në dhomën e tij të gjumit dhe nxori nga një vend i fshehtë të dhjetën e tij që e kishte kursyer që nga koha kur ishte bërë anëtar i Kishës dhe ishte kthyer në Hungari. Ai ua dha të dhjetën mësuesve të tij të shtëpisë dhe tha: ‘Tani jam në rregull me Zotin. Tani ndihem i denjë për të tokur duart me shërbëtorët e Zotit!’

Vëllai Krauze e pyeti për dëshirën e tij për të shkuar në tempull në Zvicër. Vëllai Dendorfer tha: ‘S’ka shpresë. Unë jam përpjekur e jam përpjekur. Qeveria madje më ka konfiskuar librat e mi të Kishës, thesarin tim më të madh.’

Vëllai Krauze, një patriark, i dha Vëllait Dendorfer një bekim patriarkal. Në përfundim të bekimit, ai i tha Vëllait Dendorfer: ‘Bëji kërkesë sërish qeverisë për të shkuar në Zvicër’. Dhe Vëllai Dendorfer ua paraqiti edhe një herë kërkesën autoriteteve. Këtë herë miratimi erdhi dhe, me gëzim, Vëllai Dendorfer shkoi në Tempullin e Zvicrës dhe qëndroi një muaj. Ai mori indaumentin e tij, bashkëshortja e tij e vdekur u vulos me të dhe ai qe në gjendje të kryente punën për qindra prej paraardhësve të tij. Ai u kthye në shtëpi i përtëritur në trup e në shpirt” (në Conference Report, prill 1996, f. 64–65; ose *Ensign*, maj 1996, f. 45–46).

1 Samuelit 9–11; 13; 15–17

---

**Qëllimi**

Të nxisë anëtarët e klasës që t’i besojnë Zotit në vend të gjykimit të tyre.

---

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. 1 Samuelit 9–11. Sauli kërkon udhëheqje nga profeti Samuel (9:1–14, 18–24). Zoti i zbulon Samuelit se Sauli duhet të bëhet mbret (9:15–17). Samueli e këshillon Saulin dhe e vajos atë si mbretin e parë të Izraelit (1 Samuelit 9:25–27; 10:1–8). Sauli rilindet shpirtërisht dhe profetizon (10:9–13). Samueli ua paraqit njerëzve Saulin (10:17–27). Sauli e udhëheq Izraelin në fitore në një betejë me amonitët (11:1–11). Ai nuk pranon të dënojë njerëzit që kishin dyshuar në aftësinë e tij për të udhëhequr popullin (11:12–15).
  - b. 1 Samuelit 13:1–14. Sauli ofron një flijim me djegie pa autoritetin e përshtatshëm.
  - c. 1 Samuelit 15. Sauli urdhërohet të shkatërrojë amalekitët dhe të gjitha pasuritë e tyre, por ai ruan disa nga kafshët e tyre për një flijim (15:1–9). Zoti nuk e pranon Saulin si mbret dhe Samueli i thotë Saulit se bindja është më e mirë se flijimi (15:10–35).
  - ç. 1 Samuelit 16. Zoti zgjedh Davidin, një djalosh të ri bari, që të pasojë Saulin si mbret (16:1–13). Shpirti i Shenjtë largohet nga Sauli dhe një shpirt i lig e zotëron atë (16:14–16; vini re se Përkthimi prej Jozef Smithit i korrigjon këto vargje që të tregojnë se shpirti i lig *nuk* ishte nga Perëndia). Sauli zgjedh Davidin që t’i bjerë harpës për të dhe që të jetë shqytar i tij (16:17–23).
  - d. 1 Samuelit 17. Davidi vret Goliathin me forcën e Zotit.
2. Lexim shtesë: 1 Samuelit 12; 14.
3. Ju mund të dëshironi t’i kërkonti një anëtar të klasës që të përgatitet për të përmbledhur rrëfimin e zgjedhjes së Davidit si mbret nga Zoti (1 Samuelit 16:1–13) dhe një tjetër anëtar të klasës që të përgatitet për të përmbledhur rrëfimin e Davidit që vret Goliathin (1 Samuelit 17:1–54).
4. Nëse përdorni cilindo prej aktiviteteve të vëmendjes, shkruani shkrimin e shenjtë vijues në dërrasë ose në një afishe: “Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në gjykimin tënd; pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua” ( Fjalët e Urta 3:5–6). Nëse përdorni aktivitetin e parë të vëmendjes, përzgjidhni një fjalë nga Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe që mund të jetë jo e njohur për anëtarët e klasës, e tillë si *abak*, *halmucë*, ose *lagjin*. Shkruajeni këtë fjalë në dërrasë ose në një afishe.
5. Nëse materialet e mëposhtme audiovizive janë të disponueshme, ju mund të dëshironi t’i përdorni ato si pjesë të mësimi:
  - a. “The Lord . . . Will Deliver Me” [“Zoti . . . Do të më Çlirojë”], një fragment katër minutësh mbi Davidin nga *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224).
  - b. Figurën Davidi Mund Goliathin (62073; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 112).

**Sugjerime për  
Zhvillimin e Mësimit**  
Aktivitet Vëmendjeje

Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.

1. Drejtojini anëtarët e klasës tek fjala jo e njohur që keni shkruar në dërrasë ose në një afishe (shih "Përgatitja" më sipër). Kërkojuni anëtarëve të klasës që të hamendësojnë përkufizimin e fjalës. Pas disa hamendësimeve, vëri anëtarët e klasës që të kërkojnë përkufizimin e saktë tek Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe.

Shpjegoni se hamendësimi i përkufizimit të një fjale jo të njohur është si marrja e vendimeve bazuar vetëm mbi kuptueshmërinë tonë. Paraqisni tekstin e Fjalëve të Urta 3:5–6. Theksoni se pikërisht ashtu si iu drejtua një burimi të besuar për të mësuar përkufizimin e saktë të fjalës, ne duhet t'i mirëbesojmë Zotit dhe të kërkojmë vullnetin e Tij për të marrë vendimet e sakta në jetën tonë. Ky mësim ballafaqon përvojat e dy burrave, Saulit dhe Davidit, për të dhënë mësim rëndësinë e mirëbesimit tek Zoti the të kërkimit të udhëheqjes së Tij kur marrim vendime.

2. Kërkojuni anëtarëve të klasës që të tregojnë për disa vendime të rëndësishme që kanë marrë kohët e fundit. I pyesni se çfarë i ndihmoi për të marrë ato vendime.

Paraqisni tekstin e Fjalëve të Urta 3:5–6 (ju mund të dëshironi t'i vini anëtarët e klasës që ta mësojnë përmendësh këtë shkrim të shenjtë). Shpjegoni se ky mësim ballafaqon përvojat e dy burrave, Saulit dhe Davidit, për të dhënë mësim rëndësinë e mirëbesimit tek Zoti the të kërkimit të udhëheqjes së Tij kur marrim vendime.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë. Meqë do të jetë e vështirë të bëni çdo pyetje ose të trajtoni çdo pikë në mësim, përzgjidhni me lutje ato që do të plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës. Nëse dëshironi të përqendrohëni tek Davidi dhe Goliathi, për shembull, mund të shpenzoni më pak kohë duke diskutuar për jetën e Saulit.

**1. Sauli kërkon udhërrëfim nga Samueli dhe vajoset për të qenë mbret.**

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 9–11.

- Izraelitët dëshironin një mbret ashtu si ata të kombeve rreth tyre. Duke i hapur udhë kërkesës së izraelitëve, Zoti i tha Samuelit që të vajoste Saulin si mbretin e parë të Izraelit. Sauli ishte "i ri dhe i bukur, ndër bijtë e Izraelit nuk kishte asnjë më të bukur se ai" (1 Samuelit 9:2). Çfarë bëri Sauli përpara se të vajosej mbret dhe pak pas kësaj që tregonte cilësitë e tij të mira?
  - a. Ai qe i zellshëm në kërkimin e tij për gomaret e të atit (1 Samuelit 9:3–4).
  - b. Ai qe i gatshëm që të dëgjonte dhe të ndiqte këshillën e urtë të shërbëtorit të të atit (1 Samuelit 9:5–10).
  - c. Ai i mirëbesoi profetit Samuel dhe foli me të (1 Samuelit 9:18–25).
  - ç. Ai qe i përlurur (1 Samuelit 9:20–21).
  - d. Ai rilindi shpirtërisht dhe profetizoi (1 Samuelit 10:6–10).
  - dh. Ai i fali kritikuesit e tij (1 Samuelit 11:11–13).
  - e. Ai e njohu ndihmën e Zotit në fitoren e Izraelit mbi amonitët (1 Samuelit 11:13).



## 2. Sauli ofron flijim me djegie pa autoritetin e duhur.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 13:1–14.

- Dy vjet pasi Sauli u vajos mbret, filistejtë mblodhën një ushtri të fuqishme për të luftuar kundër Izraelit. Njerëzit e Saulit qenë kaq të frikësuar sa shumë prej tyre u fshehën dhe u shpërndanë. Përse Sauli dëshironte që profeti Samuel të vinte tek ai këtë herë? (Shih 1 Samuelit 13:7–8. Sauli dëshironte që Samueli t'i ofronte flijime Zotit në emër të njerëzve.) Çfarë bëri Sauli kur Samueli nuk erdhi në kohën e caktuar? (Shih 1 Samuelit 13:9. Sauli i ofroi vetë flijimet edhe pse ai nuk e kishte autoritetin e priftërisë për ta bërë këtë.)

Plaku Xhejms E. Talmixh shkroi: “Sauli e përgatiti vetë ofertën me djegie, duke harruar që edhe pse ai zinte fronin, vinte kurorën dhe mbante skeptrin, [ai] nuk kishte të drejtë të kryente shërbesë . . . në Priftërinë e Perëndisë; dhe për këtë rast dhe raste të tjera të mendjemadhësisë së tij të padrejtë, ai nuk u pranua nga Perëndia dhe një tjetër u bë mbret në vendin e tij” (*The Articles of Faith*, bot. 12-të [1924], f. 185).

- Cila ishte përgjigja e Samuelit ndaj ofrimit të një flijimi të paautorizuar nga Sauli? (Shih 1 Samuelit 13:10–14.)
- Çfarë zbulon për të ofrimi prej Saulit i një flijimi të paautorizuar? (Ai nuk qe më “një njeri simbas zemrës së [Zotit]” [1 Samuelit 13:14]. Ai ishte bërë i paduruar, nuk ia doli të mirëbesonte tek Zoti dhe nuk u bind. Përveç kësaj, marrja përsipër e autoritetit për të ofruar flijime, sugjeron se ai kishte një mendim të tepruar për fuqinë dhe rëndësinë e vet.) Në çfarë mënyrash ne nganjëherë jemi të paduruar me Zotin ose shërbëtorët e Tij? Cilat mund të jenë pasojat e një padurimi të tillë? Si mund të arrijmë t'i mirëbesojmë plotësisht Zotit?

## 3. Sauli nuk i bindet Zotit në betejën me amalekitët dhe nuk pranohet si mbret.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 15.

- Çfarë e urdhëroi Zoti Saulin që t'u bënte amalekitëve? (Shih 1 Samuelit 15:1–3.) Çfarë bëri Sauli në vend të kësaj? (Shih 1 Samuelit 15:4–9.) Çfarë zbulojnë veprimet e Saulit për të? (Shih 1 Samuelit 15:11. Ai ndoqi gjykimin e vet në vend që të bënte vullnetin e Zotit.)
- Si u përpoq ta justifikonte Sauli mosbindjen e tij duke ruajtur kafshët më të mira të amalekitëve? (Shih 1 Samuelit 15:13–15, 20–21, 24. Ai ua vuri fajin njerëzve të tij që dëshironin të ruanin kafshët.) Sipas Saulit, përse njerëzit e tij dëshironin të ruanin kafshët më të mira të amalekitëve? (Shih 1 Samuelit 15:15, 21.) Në çfarë mënyrash ne nganjëherë përpiqemi të justifikojmë mosbindjen ndaj Zotit? (Ne mund t'i themi vetes: “Është vetëm një mëkat i vogël”, “Unë po i bindem frymës së ligjit dhe jo shkronjës së ligjit”, “Kjo nuk do të lëndojë njeri”, “Do ta provoj vetëm një herë”, “Edhe njerëz të tjerë e bëjnë këtë” ose “Ai urdhërim nuk zbatohet për mua”.) Si mund ta kapërcejmë atë prirje për ta shfajësuar ose justifikuar mëkatin?
- Si iu përgjigj Samueli shpjegimit të Saulit për ruajtjen e kafshëve të amalekitëve? (Shih 1 Samuelit 15:22.) Si mund të zbatohen për ne fjalët e Samuelit?
- Kur e qortoi Saulin sepse qe kryeneç dhe nuk pranoi fjalën e Zotit, Samueli i tha atij: “Kryeneçësia është si kulti i idhujve” (1 Samuelit 15:23). Në ç'mënyrë kryeneçësia është si idhujtaria? Çfarë solli si rezultat bërja e Saulit kryeneç

dhe rebel? (Shih 1 Samuelit 15:23, 26, 28.) Në ç'mënyrë ne nganjëherë jemi kryeneçë dhe rebelë? Çfarë sjell si rezultat të qenit kryeneçë dhe rebelë? Si mund t'i dallojmë dhe t'i kapërcejmë këto qëndrime?

#### 4. Zoti zgjedh Davidin si mbret.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 16. Ju mund të dëshironi që një anëtar i caktuar i klasës ta përmbledhë shkurt këtë rrëfim. Shpjegoni se edhe pse Samueli e vajosi Davidin që të bëhej mbret, Davidi nuk u bë mbret derisa Sauli vdiq shumë vite më vonë.

- Çfarë mësoi Samueli kur po përpiquej të përcaktonte se cili nga bijtë e Isait duhet të ishte mbreti i ardhshëm? (Shih 1 Samuelit 16:6–7.) Në ç'mënyrë mënyra e Zotit për të zgjedhur Davidin krahasohet me mënyrën se si Ai zgjedh udhëheqësit sot? Çfarë na mëson vargu 1 Samuelit 16:7 mbi atë se si na vlerëson Zoti? Çfarë kërkon Zoti në zemrat tona?

Plaku Marvin J. Ashton tha:

“Ne . . . priremi t'i vlerësojmë të tjerët në bazë të pamjes së jashtme, fizike: 'pamja e tyre e mirë', gjendja e tyre shoqërore, prejardhja e tyre familjare, arsimimi i tyre, ose gjendja e tyre ekonomike.

Zoti megjithatë, ka një standard tjetër sipas të cilit e mat një njeri. . . . Ai nuk vendos një metër shirit rreth kokës së njeriut për të përcaktuar aftësinë e tij mendore, as rreth kraharorit për të përcaktuar burrërinë e tij, por Ai mat zemrën si një tregues i aftësisë dhe potencialit të njeriut për të bekuar të tjerët” (në Conference Report, tetor 1988, f. 17; ose *Ensign*, nëntor 1988, f. 15).

- Përse është e rëndësishme që, në marrëdhëniet tona me të tjerët, të shohim përtej pamjes së jashtme dhe të vështrojmë zemrën? Si mund ta përmirësojmë aftësinë dhe zotimin tonë për ta bërë këtë?
- Meqë Sauli kishte qenë i pabindur, Shpirti i Zotit u largua nga ai (1 Samuelit 16:14). Si kërkoi qetësim Sauli nga shpirti i lig që erdhi tek ai? (Shih 1 Samuelit 16:15–23.) Cilave burime të jashtme iu drejtohen njerëzit nganjëherë kur përpiquejnë të gjejnë lehtësim nga mëkatet e tyre? Cila është mënyra e Zotit për ne që të gjejmë lehtësim nga mëkatet tona? (Shih Mateu 11:28–30; DeB 58:42.)
- Çfarë karakteristikash kishte Davidi që e kualifikonin atë për të qenë udhëheqës? (Shih 1 Samuelit 16:18.)

#### 5. Davidi vret Goliathin me forcën e Zotit.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 17. Ju mund të dëshironi që një anëtar i caktuar i klasës ta përmbledhë shkurt këtë rrëfim.

- Çfarë mund të fitonin ose humbisnin izraelitët në betejë me Goliathin? (Shih 1 Samuelit 17:8–9.) Përse Sauli dhe ushtria e tij kishin frikë të luftonin me Goliathin? (Shih 1 Samuelit 17:4–11. Ata nuk mendonin se mund ta mundnin Goliathin për shkak të përmasave, forcës, parzmores dhe armëve të tij.)
- Si mori kurajë Davidi që të luftonte kundër Goliathit? (Shih 1 Samuelit 17:32–37, 45–47. Davidi e dalloj se Zoti e kishte çliruar atë nga një luan e një ari ndërsa kujdesej për dhentë e të atit dhe ai i mirëbesonte Zotit për ta ndihmuar që të luftonte Goliathin.)

- Çfarë tha Goliathi kur pa Davidin që erdhi të luftonte me të? (Shih 1 Samuelit 17:42–44.) Çfarë tha Davidi si përgjigje? (Shih 1 Samuelit 17:45–47.) Si mund të na ndihmojë mbajtja mend e përgjigjes së Davidit kur njerëzit na tallin ose na kërcënojnë?
- Kur qe i ri, fitoret e Davidit mbi një luan e një ari e ndihmuan atë të përballte sfidën më të madhe të Goliathit. Me çfarë sfidash mund të përballemi tani që na përgatisin për sfida më të mëdha? Në ç'mënyrë përgjigjet tona ndaj këtyre sfidave ndikojnë në aftësinë tonë për të luftuar Goliathët që mund të vijnë më vonë? Dëshmoni që, kur mundim luanët e arinjët në jetën tonë, ne do të zhvillojmë besimin tek vetja, karakterin dhe besimin për të mundur Goliathët tanë.
- Çfarë Goliathësh hasim sot? Çfarë mund të mësojmë nga Davidi mbi mënyrën si t'i mposhtim ata? (Shih 1 Samuelit 17:45; Efesianëve 6:11–18.) Në ç'mënyrë Zoti ju ka ndihmuar të kapërceni Goliathët që keni hasur?

Presidenti Gordon B. Hinkli tha:

“Ka Goliathë gjithandej rreth jush, gjigantë kaba me qëllimin e ligë që t’ju shkatërrojnë. Këta nuk janë burra 2,7 metra të lartë, por janë njerëz e institucione që kontrollojnë gjëra tërheqëse po të liga, që mund t’ju sfidojnë dhe dobësojnë, dhe shkatërrojnë ju. Përfshirë në këto janë birra dhe pijet alkoolike e duhani. Ata që i tregtojnë këto mallra, do të dëshironin t’ju skllavëronin ju në përdorimin e tyre. Ka droga të llojeve të ndryshme të cilat, më kanë thënë, sigurohen relativisht lehtë në shumë shkolla të mesme. Për ata që i shesin ato, kjo është një industri miliona dollarëshe, një grackë gjigante e së ligës. Është pornografia, joshëse dhe interesante, dhe tërheqëse. Ajo është bërë një industri gjigante, që prodhon revista, filma dhe materiale të tjera të projektuara për t’ju marrë paratë dhe për t’ju çuar drejt aktiviteteve që do t’ju shkatërrojnë.

Gjigantët që qëndrojnë pas këtyre përpjekjeve, janë të frikshëm e të aftë. Ata kanë fituar përvojë të gjerë në luftën që po kryejnë. Ata do të dëshironin t’ju zinin në grackë.

Është gati e pamundur që ta shmangim plotësisht ekspozimin ndaj prodhimeve të tyre. Ju i shihni këto materiale në të gjitha anët. Por nuk keni pse të frikësoheni nëse keni hobën e së vërtetës në duart tuaja. Juve ju kanë këshilluar dhe mësuar, dhe informuar. Ju keni gurët e virtytit dhe nderit, dhe integritetit moral për t’i përdorur kundër këtyre armiqve që do të dëshironin t’ju pushtonin ju. Për aq sa ju përket juve, ju mund t’i habisni ose t’u lini shumë mbresë atyre. Ju mund të triumfoni mbi ta duke e disiplinuar veten që t’i shmangni ata. Ju mund t’u thoni të gjithëve atyre, ashtu si Davidi i tha Goliathit: “Ti po më vjen me shpatë, me shtizë dhe me ushtë; kurse unë po të dal në emër të Zotit të ushtrive, Perëndisë të ushtrisë së Izraelit që ti ke fyer’.

Fitorja do të jetë e juaja. . . . Ju keni fuqinë e Tij me ju që t’ju mbështesë. Ju keni të drejtën për engjëj shërbetarë mbi ju që t’ju mbrojnë. Mos e lejoni Goliathin që t’ju frikësojë. Mbroni besimet tuaja dhe qëndroni në pozitën tuaja, dhe ju do të jeni triumfues” (në Conference Report, prill 1983, f. 66; ose *Ensign*, maj 1983, f. 46, 51).

## Përfundim

Nxitini anëtarët e klasës që t’i mirëbesojnë e t’i binden Zotit. Premtoni se, duke vepëruar kështu, ata do të bëhen më të fortë dhe do të kenë sigurimin e Zotit se Ai do t’i ndihmojë të triumfojnë mbi Goliathët vetjakë. Kujtojinë anëtarët e klasës se Zoti shikon zemrat, jo pasurinë, ose pozitën, ose përshtatjen me standardet e përhapura.

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Arsyetimi mbi mëkatit

Citati vijues nga Plaku Spenser W. Kimball mund të jetë i dobishëm kur të diskutoni mosbindjen e Saulit në lidhje me amalekitët:

“Sauli arsyetoi. Ishte e lehtë për të të bindej për sa i përket heqjes qafe të mbretërve, sepse për çfarë vlenin mbretërit e mundur? Por përse të mos mbante delet e gjedhët e majme? A nuk ishte gjykimi i tij mbretëror më i lartë se ai i Samuelit modest? . . .

Sa shumë ngjajnë me Saulin shumë njerëz në Izrael sot. Dikush do t'i zbatojë disa nga zbulesat e Zotit për shëndetin, përveç që duhet të ketë herë pas here filxhanin e tij të kafesë; ajo nuk do të përdorë duhan ose pije alkoolike, për të cilat sidoqoftë nuk ka dëshirë, por duhet ta ketë filxhanin ngushëllues të çajit.

Ai do të shërbejë në një detyrë në Kishë, sepse këtu ka aktivitet që atij i pëlqen dhe nderim që e dëshiron fort, . . . por arsyetimi është i lehtë përse i përket pagimit të së dhjetës, që është kaq i vështirë për të. Ai nuk mund ta përballojë që ta paguajë atë. . . . Ai nuk është i sigurt nëse shpërndahet gjithmonë ashtu si do ta bënte ai dhe, sidoqoftë, kush e di se ai nuk e bëri?

Një tjetër do të marrë pjesë në disa mbledhje, por do të arsyetojë si Sauli për pjesën tjetër të ditës. Përse nuk duhet të shohë ai një lojë me top, një shfaqje, të bëjë punën e nevojshme në kopsht, ose të vazhdojë biznesin si zakonisht?

Një tjetër do të kryejë si besimtar detyrat e tij të jashtme të Kishës, por do t'i rezistojë çfarëdo sugjerimi përse i përket problemeve familjare në shtëpinë e tij ose lutjeve familjare kur familja është kaq e vështirë të mblidhet.

Sauli qe kështu. Ai mund të bënte gjërat që i leverdisnin, por do të gjente alibira për gjërat që binin ndesh me dëshirat e veta” (në Conference Report, tetor 1954, f. 51).

### 2. Mundja e Goliathëve tanë

Prisni një copë spango 3 metra të gjatë, afërsisht sa lartësia e Goliathit. Çoni në klasë spangon, pak shirit ngjitës, disa copa letre dhe një shënues. Fiksojeni spangon vertikalisht në mur me një copë shiriti ngjitës në majë dhe një në fund (nëse muri nuk është mjaft i lartë, vendoseni pjesën e fundit të spangos në dysheme). Thuajuni anëtarëve të klasës se spangoja përfaqëson Goliathin. Kërkojuni anëtarëve të klasës që të përmendin gjëra që mund të jenë të rrezikshme për ta (përgjigjet mund të përfshijnë krenarinë, pornografinë, xhelozinë dhe drogat). Shkruajeni secilin rrezik në një copë letër dhe ngjiteni me shirit secilën letër në mur dhe në spango, duke e mbuluar spangon nga maja deri në fund.

Shpjegoni se neve na duhen armë për të mundur Goliathin. Kërkojuni anëtarëve që të përmendin armë që mund të mundin Goliathin (përgjigjet mund të përfshijnë mirëbesimin te Zoti, lutjen, studimin e shkrimeve të shenjta, mësimin e së vërtetës, të qenit moralisht të pastër dhe zgjedhjen e miqve të mirë). Ndërsa anëtarët e klasës përmendin çdo armë, hiqni një letër. Filloni tek maja e spangos, duke hequr letrën dhe shiritin që e mban spangon në mur. Lëreni spangon të bjerë tek letra tjetër. Pasi të hiqen të gjitha letrat dhe shiriti ngjitës, spangoja do të bjerë në dysheme dhe Goliathi do të jetë mundur.

# “Zoti Qoftë Dëshmitar Midis Teje dhe Meje për Gjithnjë”

Mësimi

# 23

1 Samuelit 18–20; 23–24

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të jenë të vërtetë ndaj miqve të tyre, siç ishin Jonathani dhe Davidi, dhe të shmangin mposhtjen nga xhelozia e urrejtja, siç u mposht Sauli.
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1 Samuelit 18:1–16. Jonathani dhe Davidi bëjnë një besëlidhje miqësie (18:1–4). Davidi nderohet nga izraelitët për suksesin e tij në betejë (1 Samuelit 18:5–7). Sauli bëhet xheloz për Davidin dhe përpiqet ta vrasë atë me një shtizë (18:8–16; vini re se Përkthimi prej Jozef Smithit i 1 Samuelit 18:10 tregon se shpirti i lig që erdhi mbi Saulin, <i>nuk</i> ishte nga Perëndia).</li><li>1 Samuelit 18:17–30; 19:1–18. Davidi lufton me filistejtë në këmbim të së drejtës për t’u martuar me bijën e Saulit, pa e ditur se Sauli po shpresonte që Davidi të vdiste në fushë beteje (18:17–25). Davidi triumfon mbi filistejtë dhe martohet me të bijën e Saulit, Mikalin (18:26–28). Jonathani i thotë Davidit të fshihet dhe përpiqet t’ia mbushë mendjen Saulit që të mos ta vrasë (19:1–7). Sauli dështon në një tjetër përpjekje për ta vrarë Davidin me një shtizë (19:9–10). Mikali e shpëton Davidin nga një tjetër përpjekje e Saulit për t’i marrë jetën (19:11–18).</li><li>1 Samuelit 20. Jonathani dhe Davidi e përtërijnë besëlidhjen e tyre të miqësisë e të paqes (vini re se kjo besëlidhje nuk qe vetëm mes Jonathanit dhe Davidit, por gjithashtu mes shtëpive të tyre). Kur Sauli përpiqet sërish ta vrasë Davidin, Jonathani e paralajmëron Davidin që të ikë.</li><li>1 Samuelit 23–24. Davidi vazhdon të luftojë filistejtë dhe të ikë nga Sauli. Davidi e gjen Saulin dhe ia kursen jetën.</li></ol> <p>2. Lexim shtesë: 1 Samuelit 14:1–16; 2 Samuelit 1.</p>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>U bëni anëtarëve të klasës pyetjen vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>Cilat janë disa cilësi që kërkonit te një mik? (Ju mund të dëshironi t’i shkruani përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë. Përgjigjet mund të përfshijnë besnikërinë, integritetin moral, vetëmohimin, dashamirësinë dhe dashurinë hyjnore.)</li></ul> <p>Shpjegoni se një pjesë e këtij mësimi flet për rëndësinë e të qenit mik i vërtetë.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Jonathani dhe Davidi bëjnë një besëlidhje miqësie. Sauli bëhet xheloz për Davidin dhe përpiqet ta vrasë atë.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 18:1–16.</p>



Davidi u bë shpejt hero pasi vrau Goliathin. Mbreti Saul dhe e gjithë mbretëria e nderuan atë. Megjithatë, askush nuk qe i vërtetë ndaj Davidit siç qe Jonathani, biri i Saulit.

- Çfarë ndien Jonathani dhe Davidi për njëri-tjetrin? (1 Samuelit 18:1, 3.) Përse do të kishte qenë e lehtë për Jonathanin që të ndihej xheloz për Davidin?
  - a. Si i biri i Saulit, Jonathani vinte pas tij në radhë për t'u bërë mbret. Megjithatë, profeti Samuel kishte vajosur Davidin që të bëhej mbreti i ardhshëm (1 Samuelit 16:6–13).
  - b. Ndërkohë që Davidi u nderua shumë nga njerëzit për suksesin e tij në betejë, Jonathanit iu kushtua pak vëmendje për suksesin e vet në fushën e betejës (1 Samuelit 14:1–16).
- Si mendoni ju, përse Jonathani nuk ishte xheloz për Davidin apo i kërcënuar prej tij? (1 Samuelit 18:1, 3.) Si e tregoi Jonathani mbështetjen e tij për Davidin? (Shih 1 Samuelit 18:4. Ai i dha Davidit veshjen mbretërore dhe armët e tij.)
- Si u ndie mbreti Saul për Davidin pas vrasjes së Goliathit? (Shih 1 Samuelit 18:2, 5. Sauli e mori Davidin në shtëpinë e tij dhe e vuri në krye të ushtrive të tij.) Si e tregoi Davidi besnikërinë e tij ndaj mbretit Saul? (Shih 1 Samuelit 18:5.) Çfarë e nxiti Saulin që të kthehej kundër Davidit? (Shih 1 Samuelit 18:6–9.) Përse nganjëherë është e vështirë të jemi të lumtur për suksesin e të tjerëve? Në ç'mënyrë e ndikojnë mirëqenien tonë shpirtërore xhelozia dhe krenaria?

Presidenti Ezra Taft Benson tha:

“Sauli u bë armik i Davidit nëpërmjet krenarisë. Ai u bë xheloz sepse turmat e grave izraelite po këndonin se ‘Sauli vrau mijëshen e tij dhe Davidi dhjetëmijëshen e tij’ (1 Samuelit 18:7; shih edhe 1 Samuelit 18:6, 8).

Krenari ka më shumë frikë gjykimin e njerëzve sesa gjykimin e Perëndisë. . . . ‘Çfarë do të mendojnë njerëzit për mua?’ ka më shumë rëndësi sesa ‘Çfarë do të mendojë Perëndia për mua?’ . . .

Frika nga gjykimi i njerëzve shfaqet në konkurrimin për miratimin e njerëzve. Krenari e do ‘lavdinë e njerëzve më tepër se lavdinë e Perëndisë’ (Gjoni 12:42–43). Shkaqet për gjërat që bëjmë janë vendi ku tregojmë mëkatin e krenarisë. Jezusi tha se Ai bëri ‘vazhdimisht gjërat’ që i pëlqenin Perëndisë (Gjoni 8:29). A nuk do të ishte mirë për ne nëse shkakun ynë do të ishte të kënaqim Perëndinë në vend që të përpiqemi ta ngremë veten mbi vëllanë tonë dhe t’ia kalojmë një tjetri?

Disa njerëz krenarë nuk janë aq të shqetësuar për faktin nëse pagat e tyre u mbulojnë nevojat sesa për faktin që pagat e tyre të jenë më të larta se të dikujt tjetër. Shpërblimi i tyre është të jenë pak më mirë se të tjerët. . . .

Kur krenaria na rrëmben zemrat, ne e humbasim pavarësinë nga bota dhe ia dorëzojmë lirinë tonë robërisë së gjykimin të njerëzve. Bota bërtet më fort sesa pëshpëritjet e Frymës së Shenjtë. Arsyetimi i njerëzve bëhet më i rëndësishëm se zbulosat e Perëndisë dhe krenaria e lëshon shufrën prej hekuri” (në Conference Report, prill 1989, f. 4–5; ose *Ensign*, maj 1989, f. 5).

- Si veproi Davidi pasi Zoti e bekoji atë me sukses në fushën e betejës? (Shih 1 Samuelit 18:5, 14–16.) Çfarë mund të mësojmë nga shembulli i tij? Si mendoni ju, çfarë do të thotë të “sillemi me mençuri” kur kemi sukses?



## 2. Sauli dështon në tri përpjekje të tjera për t'i marrë jetën Davidit.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 18:17–30; 19:1–18.

- Sauli ofroi ta linte Davidin të martohej me një nga bijat e tij nëse Davidi do të luftonte me filistejtë. Cili ishte shkaku i vërtetë i Saulit pse po e bënte këtë? (Shih 1 Samuelit 18:20–25. Ai shpresonte që Davidi do të vritej nga filistejtë.)
- Si qe një mik i vërtetë Jonathani kur Sauli u përpoq ta vriste Davidin? (Shih 1 Samuelit 19:1–7.) Çfarë do të thotë të jesh një mik i vërtetë? Në çfarë mënyrash miqtë tuaj janë të vërtetë ndaj jush? Si jeni ju të vërtetë ndaj miqve tuaj?
- Megjithë përpjekjet e Jonathanit për të ndryshuar ndjenjat e Saulit kundrejt Davidit, Sauli vazhdoi të kërkonte jetën e Davidit (1 Samuelit 19:9–10). Si e tregoi Mikali, bashkëshortja e Davidit, se ajo qe e vërtetë ndaj bashkëshortit të saj? (Shih 1 Samuelit 19:11–18.)

## 3. Davidi dhe Jonathani përtërijnë besëlidhjen e tyre të miqësisë dhe Jonathani i shpëton jetën Davidit.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 20.

- Cili qe reagimi i Davidit ndaj urrejtjes së Saulit dhe përpjekjeve për ta vrarë atë? (Shih 1 Samuelit 20:1.) Si vazhdoi Jonathani ta tregonte miqësinë e tij ndërsa Sauli kërkoi jetën e Davidit? (Shih 1 Samuelit 20:2–4, 13–17, 23; shih edhe 1 Samuelit 20:24–42, që diskutohet më poshtë.)
- Si ndikoi besimi tek Perëndia në miqësinë e Jonathanit dhe Davidit? (Shih 1 Samuelit 20:23.) Si ndikon dashuria jonë për Perëndinë në dashurinë për të tjerët?
- Nëse vendosim besnikërinë ndaj Perëndisë të parën në jetën tonë, çfarë do të bëjmë nëse miqtë tanë bëjnë gjëra të gabuara? (Ne do të përpiqemi me dashuri që t'i ndihmojmë miqtë tanë që të ndryshojnë.) Çfarë do të bëjmë nëse miqtë tanë na kërkojnë të bëjmë gjëra që janë të gabuara? (Ne nuk do të bëjmë gjëra të padrejta që miqtë tanë na kërkojnë të bëjmë, pavarësisht nga pasojat shoqërore, dhe do të përpiqemi të ndikojmë te miqtë tanë që të bëjnë zgjedhje të drejta.)
- Si do ta njoftonte Jonathani Davidin nëse do të ishte e parrezikshme po të kthehej në oborrin e Saulit? (Shih 1 Samuelit 20:5–7, 18–22.) Si iu përgjigj mbreti Saul mungesës së Davidit dhe mbrojtjes prej Jonathanit të mikut të tij? (Shih 1 Samuelit 20:24–33.) Si e paralajmëroi Jonathani Davidin që të ikte nga Sauli? (Shih 1 Samuelit 20:35–42.)

## 4. Sauli mposhtet nga urrejtja për Davidin. Davidi ia kursen jetën Saulit.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Samuelit 23–24.

- Davidi u bekua me sukses të vazhdueshëm në betejë (1 Samuelit 23:1–5). Përse Davidit iu desh të linte qytetin e Kejlahut pasi i kishte shpëtuar njerëzit e tij nga filistejtë? (Shih 1 Samuelit 23:7–13.)
- Kur Sauli mësoi se Davidi qe në Kejlah, ai përgatiti ushtritë e tij për ta shkatërruar të gjithë qytetin (1 Samuelit 23:10). Çfarë e shndërroi Saulin nga një mbret të drejtë në dikë që ishte i gatshëm të shkatërronte një qytet të tërë me qëllim që të vriste një njeri? Përse xhelozia dhe urrejtja janë kaq shkatërruese? Si mund t'i largojmë nga vetja xhelozinë ose urrejtjen?

- Kur Davidi po fshihej nga Sauli, Jonathani e takoi Davidin dhe “e ndihmoi të gjejë forcë te Perëndia” (1 Samuelit 23:16). Si mendoni, çfarë do të thotë kjo? Si mund t’i forcojmë miqtë tanë te Perëndia?
- Gjatë një përpjekjeje tjetër për të gjetur dhe vrarë Davidin, Sauli ndaloi për të pushuar në një shpellë (1 Samuelit 24:1–3). Çfarë thanë njerëzit e Davidit kur e gjetën Saulin? (Shih 1 Samuelit 24:4.) Çfarë bëri Davidi? (Shih 1 Samuelit 24:4–5. Një poshtëshënim për vargun 4, shpjegon se Davidi preu një cep të mantelit të Saulit – pjesën e mantelit që simbolizon autoritet.)
- Përse Davidi nuk pranoi t’i bënte keq Saulit? (Shih 1 Samuelit 24:6–12.) Çfarë na mëson shembulli i Davidit mbi hakmarrjen dhe mbi përgjigjen ndaj atyre që na bëjnë të liga? (Shih 1 Samuelit 24:12–15; shih edhe Mormoni 8:20.) Çfarë tha Sauli kur Davidi ia kurseu jetën? (Shih 1 Samuelit 24:16–19.)

#### Përfundim

Vini në dukje se historia e Jonathanit dhe Davidit na kujton se miqësia e dashuria e vërtetë na afrojnë me miqtë tanë dhe me Perëndinë. Historia e Saulit na kujton se xhelozia dhe urrejtja mund të na mposhtin dhe të na largojnë nga miqtë tanë dhe nga Perëndia. Nxitini anëtarët e klasës që të jenë të vërtetë ndaj miqve të tyre, kështu që ata të mund t’u thonë atyre: “Zoti qoftë dëshmitar midis teje dhe meje për gjithnjë” (1 Samuelit 20:23).

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

#### Vetëvlerësim i miqësisë

Përdorni aktivitetin vijues nëse dëshironi të theksoni rëndësinë e të qenit një mik i vërtetë.

Jepini secilit anëtar të klasës një copë letër dhe një stilolaps ose laps. Shpjegoni se ju do t’u bëni disa pyetje për t’i ndihmuar të përcaktojnë nëse janë miq të vërtetë. Bëjini anëtarët e klasës që t’i shkruajnë përgjigjet e tyre, duke i siguruar se atyre nuk do t’u duhet t’i tregojnë përgjigjet e tyre. Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:

1. Cila qe gjëja e fundit e mirë që bëtë për dikë?
2. Çfarë bëni kur dëgjoni dikë të thotë gjëra jo dashamirëse për një njeri tjetër?
3. Çfarë keni bërë për t’i ndihmuar miqtë tuaj që të jenë njerëz më të mirë?

2 Samuelit 11–12; Psalmeve 51

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të jenë të dëlirë në mendim e në veprim dhe të pendohen për mëkatet e tyre.
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <p>a. 2 Samuelit 11. Davidi kryen shkelje kurore me Bath-Sheban, bashkëshorten e Uriahut (11:1–5). Davidi dështon në përpjekjen për të fshehur mëkatën e tij (2 Samuelit 11:6–13). Ai organizon që Uriahu të vritet në betejë (11:14–17). Davidi martohet me Bath-Sheban dhe atyre u lind një bir (11:26–27).</p> <p>b. 2 Samuelit 12:1–23. Profeti Nathani i jep mësim Davidit se sa i rëndë ishte mëkati i tij duke i treguar një shëmbëlltyrë (12:1–6). Davidit i thuhet se ai do të dënohet për shkak të mëkateve të tij (12:7–14; vini re se në Përkthimin prej Jozef Smithit të vargut 13, Nathani deklaron: “Zoti gjithashtu <i>nuk</i> e ka hequr mëkatën tënd, që ti të mos vdesësh”). Biri i parë i Davidit dhe Bath-Shebas vdes që foshnjë (12:15–23).</p> <p>c. Psalmeve 51. Një David i penduar kërkon falje.</p> <p>2. Lexim shtesë: 2 Samuelit 2–10.</p> <p>3. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni një gjep fijeje dhe një palë gërshërë.</p>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Vëreni një vullnetar që të qëndrojë përpara klasës me duart e shtrira përpara. Lidhni lirshëm një fije peri rreth të dy kyçeve të anëtarit të klasës. Shpjegoni se kjo fije e vetme përfaqëson një mendim të papastër. Pastaj bëjeni anëtarin e klasës që ta këpusë fijen duke i hapur duart me forcë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë duhet të bëjmë kur një mendim i papastër na vjen në mendje? (Ne duhet ta largojmë atë menjëherë.)</li> </ul> <p>Kërkojini anëtarit të klasës t’i mbajë duart të zgjatura përpara sërish. Mbështillini kyçet e anëtarit të klasës me disa fije peri – mjaftueshëm sa të bëhet më e vështirë për t’i këputur ato. Pastaj kërkojini anëtarit të klasës që të përpiqet t’i këpusë fijet e perit. Përsëriteni këtë proces duke përdorur mjaftueshëm fije peri sa të bëhet e pamundur që të çlirohet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë ndodh kur ne i lejojmë mendimet e papastra që të qëndrojnë në mendjen tonë?</li> </ul> <p>Çlirojini duart e anëtarit të klasës duke i prerë fijet me gërshërë. Shpjegoni se një pjesë e këtij mësimi trajton pasojat e mbajtjes së mendimeve të papastra në mendje. Mësimi diskuton gjithashtu mënyra se si të çlirohemi nga mendimet e papastra.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë. Meqë do të jetë e vështirë të

bëni çdo pyetje ose të trajtoni çdo pikë në mësim, me lutje përzgjidhni ato që do t'i plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës. Juve mund t'ju nevojitet t'i përshitasni disa pyetje që t'u shkojnë për shtat rrethanave të pjesëtarëve të klasës.

Kapitujt 1 Samuelit 25 deri tek 2 Samuelit 10 japin informacion të rëndësishëm mbi mjedisin historik për këtë mësim. Meqë këta kapituj nuk trajtohen në këtë manual, ju mund të dëshironi t'i përmbledhni ata si vijon:

Pak kohë pasi Davidi i kurseu jetën Saulit, Sauli kërkoi t'ia merrte jetën Davidit edhe një herë. Sërish, Davidi pati mundësinë ta vriste mbretin, por nuk pranoi ta bënte këtë. Betejat vijuan mes njerëzve të Judës dhe kombeve përreth dhe Sauli e Jonathani u vranë në një prej këtyre betejave. Davidi pasoi Saulin si mbret dhe u bë një nga mbretërit më të mëdhenj në historinë e Izraelit. Ai i bashkoi fiset në një komb, siguroi zotërimin e tokës që i ishte premtuar popullit të tij dhe krijoi një qeveri bazuar në ligjin e Perëndisë. Megjithatë, 20 vitet e fundit të jetës së tij u dëmtuan nga vendimet plot mëkat që diskutohen në këtë mësim.

### 1. Davidi kryen shkelje kurore me Bath-Sheban dhe organizon vdekjen e Uriahut, bashkëshortit të Bath-Shebas.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Samuelit 11.

- Davidi po ecte në tarracën e tij kur pa Bath-Sheban dhe u tundua të kryente shkelje kurore me të (2 Samuelit 11:2). Çfarë duhet të kishte bërë Davidi kur pa Bath-Sheban? Çfarë bëri Davidi që e çoi atë të bënte mëkat me të? (Shih 2 Samuelit 11:2–4.) Çfarë mund t'i çojë njerëzit që të tundohen për të kryer mëkate seksuale? Çfarë mund të bëjmë që të shmangim tundimin për të kryer mëkate seksuale?

Ju mund të dëshironi t'i rendisni përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë duke përdorur një tabelë si ajo që vijon. Përgjigjet mund të përfshijnë sa vijon:

Gjëra për t'u shmangur	Si t'i shmangim
Mendime të papastra ose imorale	Mbusheni mendjen me mendime lartësuese.
Shfaqje televizive, filma, revista, libra dhe muzikë që janë pornografike ose sugjerojnë diçka imorale në çfarëdolloj mënyre	Zgjidhni mjete komunikimi që do t'ju frymëzojnë të veproni mirë.
Aktivitete të dëmshme takimesh	Ndiqni standardet për takime që jepen mësim nga profetët e ditëve të mëvonshme dhe skicohen te broshura <i>Për Forcën e Rinisë</i> .
Flirtimi pas martesë	Duajeni bashkëshortin/en tuaj me gjithë zemër. Vazhdoni t'i "vini rrotull" (ta zhvilloni marrëdhënien) me bashkëshortin/en tuaj.
Vende ose aktivitete që nuk do t'ju mundësojnë të keni shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë.	Sigurohuni që vendet ku shkoni dhe aktivitetet ku merrni pjesë, do t'ju mundësojnë të keni shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë.

Ju mund të dëshironi të përdorni idenë e parë shtesë të mësimdhënies për të diskutuar mënyra se si të largoni mendimet e papastra.

- Çfarë u përpoq të bënte Davidi kur mësoi se Bath-Sheba priste fëmijë? (Shih 2 Samuelit 11:6–13. Ai u përpoq ta çonte Uriahun, bashkëshortin e Bath-Shebas, që të kthehej në shtëpi tek ajo. Atëherë do të dukej sikur fëmija i palindur ishte i Uriahut.) Përse dështoi plani i Davidit? (Shih 2 Samuelit 11:11. Uriahu

nuk do të kthehej në shtëpi në atë kohë sepse ishte besnik ndaj shokëve të tij të betejës dhe e ndiente se duhej të qëndronte me ta.)

- Çfarë mëkati më të rëndë kreu Davidi në një përpjekje për të fshehur imoralitetin e tij? (Shih 2 Samuelit 11:14–17.) Si mendoni ju, nga kush mendoi Davidi se mund ta fshihte mëkatin e tij? Në ç'mënyrë njerëzit mundohen t'i mbulojnë mëkatet sot? Çfarë ndodh kur ne përpiqemi t'i mbulojmë mëkatet tona?

Plaku Riçard G. Skot tha:

“Mos u ngushëlloni me faktin se shkeljet tuaja nuk njihen nga të tjerët. Kjo ngjan me një struc me kokën të fshehur në rërë. Ai sheh vetëm errësirë dhe ndihet i fshehur mirë. Në të vërtetë, ai është i dukshëm në mënyrë qesharake. Po ashtu, çdo veprim i yni shihet nga Ati ynë në Qiell dhe Biri i Tij i Dashur. Ata dinë gjithçka për ne. . . .

Nëse keni bërë shkelje serioze, nuk do të gjeni ndonjë kënaqësi ose rehati të vazhdueshme në atë që keni bërë. Shfajësimi i shkeljes duke e fshehur atë mund të duket sikur e zgjidh problemin, por nuk e bën. Tunduesi ka qëllim që t'i bëjë të njohura veprimet tuaja më sikletosëse në kohën më të dëmshme. Gënjeshtarit thurin një pëlhurë që është gjithmonë e më kufizuese dhe bëhet një grackë që Satani do ta shkrehë në dëmin tuaj” (në Conference Report, prill 1995, f. 103; ose *Ensign*, maj 1995, f. 77).

Ju mund të dëshironi të përdorni idenë e dytë shtesë të mësimdhënies për të ilustruar rrezikun e përpjekjes për të mbuluar mëkatet tona.

## 2. Davidit i thuhet se do të dënohet për shkak të mëkateve të tij.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Samuelit 12:1–23.

- Çfarë shëmbëlltyre tregoi profeti Nathani për të sqaruar se sa i pakënaqur qe Zoti me Davidin? (Shih 2 Samuelit 12:1–4.) Çfarë mendoi Davidi për veprimet e njeriut të pasur kundër njeriut të varfër në shëmbëlltyrë? (Shih 2 Samuelit 12:5–6.) Në ç'mënyrë veprimet e Davidit kishin qenë si ato të njeriut të pasur? (Shih 2 Samuelit 12:7–9.) Si reagoi Davidi ndaj qortimit të Zotit? (Shih 2 Samuelit 12:13.)
- Si mendoni ju, përse Davidi nuk ia doli të kuptonte se ai përfaqësohej nga njeriu i pasur në shëmbëlltyrë? Përse ne nganjëherë nuk jemi të aftë të kuptojmë vetë mëkatet tona?
- Cilat qenë pasojat e mëkateve të Davidit? (Shih 2 Samuelit 12:10–14. Përmbushja e këtyre profecive mund të gjendet te 2 Samuelit 12:15–23 dhe kapitujt pasues të 2 Samuelit dhe 1 Mbretërve; shih edhe DeB 132:39. Vini re se shkelja e kurorës është një mëkat i rëndë, por Davidi e humbi ekzaltimin e tij sepse Zoti e mbajti përgjegjës për vrasjen e Uriahut.)

Presidenti Marion G. Romni tha: “Davidi, . . . edhe pse shumë i favorizuar nga Zoti (atë e quanin, në fakt, një burrë sipas vetë zemrës së Perëndisë), iu nënshtrua tundimit. Mungesa e dëlirësisë së tij çoi në vrasje dhe, si pasojë, ai humbi familjet e tij dhe ekzaltimin e tij” (në Conference Report, prill 1979, f. 60; ose *Ensign*, maj 1979, f. 42).

- Cilat janë disa nga pasojat e menjëhershme të imoralitetit sot? Cilat janë disa pasoja afatgjata për të papënduarin?

### 3. Një David i penduar kërkon falje.

Jepni mësim dhe diskutoni për Psalmeve 51.

Në psalmin drejtuar Zotit, Davidi shprehu një dëshirë për t'i ndihmuar të tjerët që të pendohen duke thënë: "Do t'u mësoj rrugët e tua shkelësve dhe mëkatarët do të kthehen drejt teje" (Psalmeve 51:13). Edhe pse Davidi e humbi ekzaltimin e tij sepse organizoi vdekjen e Uriahut, mund të mësojmë nga qëndrimi i tij i penduar kur kërkoi falje për mëkatin e shkeljes së kurorës. Fjalët e tij te Psalmeve 51 japin mësim mbi shumë aspekte të pendimit të vërtetë. Ndërsa studioni psalmin me anëtarët e klasës, diskutoni se si mund ta zbatojmë shembullin e pendimit të Davidit në jetën tonë.

- Te Psalmeve 51, Davidi së pari iu drejtua Perëndisë dhe mëshirës së Tij (Psalmeve 51:1). Davidi pranoi gjithashtu gjendjen e vet mëkatore (Psalmeve 51:1–3). Përse është e rëndësishme të njohim madhësitinë e Perëndisë dhe gjendjen tonë mëkatore kur pendohemi për mëkatet tona?
- Çfarë duhet të sakrifikojmë me qëllim që të marrim falje për mëkatet tona? (Shih Psalmeve 51:16–17.) Si mendoni ju, çfarë do të thotë të kesh "zemrën e thyer dhe të penduar"?
- Në ç'mënyrë mëkatet tona "[na] rri[në] gjithnjë përpara" përpara se të marrim falje? (Psalmeve 51:3). Si ndryshon kjo pasi të kemi marrë falje? (Shih Psalmeve 51:10; Alma 36:17–19.) Si i sheh Perëndia mëkatet tona të kaluara pasi të na ketë falur? (Shih Psalmeve 51:9; Isaia 43:25; DeB 58:42.)
- Davidi e përshkroi faljen si pastrim (Psalmeve 51:1–2, 7, 9–10), rivendosje (Psalmeve 51:12) dhe çlirim (Psalmeve 51:14). Përse këto janë përshkrime të përshtatshme për bekimin e faljes prej Perëndisë?

#### Përfundim

Shpjegoni se pavarësisht se sa të suksesshëm ose të fuqishëm mund të jemi, ne ende mund të tundohemi. Nxitini anëtarët e klasës që të bëjnë çfarëdo ndryshimi të nevojshëm në jetën e tyre që do t'i ndihmojë të jenë të dëlirë në mendim e në veprim. Shprehni dashurinë tuaj për Jezu Krishtin dhe mirënjohjen tuaj për Shlyerjen e Tij. Dëshmoni që për shkak të Shlyerjes, neve mund të na falen mëkatet tona.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

#### 1. Largimi i mendimeve të papastra nga mendjet tona

Me vetë fjalët tuaja, tregoni paraqitjen vijuese nga Plaku Bojd K. Paker mbi mënyrën se si t'i largojmë mendimet e papastra që kanë hyrë pa i ftuar në mendjen tonë:

"Mendja është si një skenë. Përveç se kur jemi duke fjetur, perdja është gjithmonë e ngritur. Gjithmonë ka ndonjë akt që po shfaqet në atë skenë. Mund të jetë një komedi, një tragjedi, interesant ose i mërziqshëm, i mirë ose i keq; por ka gjithmonë ndonjë akt që po luhet në skenën e mendjes.

A e keni vënë re se pa ndonjë qëllim të vërtetë nga ana juaj, në mes të pothuajse çfarëdo shfaqjeje, një mendim i vogël dyshues mund të hyjë shkarazi që nga prapaskena dhe t'ju tërheqë vëmendjen? Këto mendime të këqija do të përpiqen të tërheqin gjithë vëmendjen tuaj. Nëse do t'i lejoni të vazhdojnë, të gjitha



mendimet e çfarëdolloj virtyti do ta lënë skenën. Ju do të ngeleni, sepse e lejuat, nën ndikimin e mendimeve të padrejta.

Nëse do t'u nënshtroheni atyre, ato do të luajnë për ju në skenën e mendjes tuaj gjithçka deri në kufijtë e durimit tuaj. Ato mund të vënë në skenë një motiv hidhërimi, xhelozie ose urrejtjeje. Mund të jetë vulgar, imoral, madje i degjeneruar. Kur ato të kenë skenën, nëse i lejoni, ato do të sajajnë bindjen më mjeshtërore që të mbajnë vëmendjen tuaj. Ato sigurisht që mund ta bëjnë interesante, madje dhe t'ju bindin se është e pafajshme – sepse ato janë thjesht mendime.

Çfarë bëni në një kohë si kjo, kur skena e mendjes tuaj është nën komandën e djallushëve të mendimeve të papastra, qofshin ato me nuancat gri që duken thuajse të pastra, ose ato të ndyrat që nuk lënë vend për dyshim? Nëse mund t'i kontrolloni mendimet tuaja, ju mund t'i mposhtni zakonet, madje dhe zakonet personale shkatërruese. Nëse mund të mësoni t'i zotëroni ato, ju do të keni një jetë të lumtur.

Kjo është ajo çfarë do t'ju mësoja. Zgjidhni nga muzika e shenjtë e Kishës një himn të parapëlqyer, një me tekst që është lartësues dhe muzikë që është ndërruese, një himn që ju bën të ndieni diçka të ngjashme me frymëzimin. Rishikojeni në mendjen tuaj me kujdes. Mësojeni përmendësh. Edhe pse [mund] të mos keni pasur përgatitje muzikore, ju mund të mendoni nëpërmjet një himni.



Tani, përdoreni këtë himn si vendin ku duhet të shkojnë mendimet tuaja. Bëjeni atë kanal tuaj të urgjencës. Kurdoherë që të shihni se këta aktorë të këqij kanë hyrë shkarazi nga vijat anësore të mendimit tuaj për në skenën e mendjes suaj, luajeni këtë muzikë në mendje si të ishte një regjistrim. Kur muzika të fillojë dhe fjalët të formohen në mendimet tuaja, ata të padenjët do të largohen shkarazi e me turp. Ajo do ta ndryshojë tërësisht humorin në skenën e mendjes suaj. Për shkak se ajo është lartësuese dhe e pastër, mendimet e ulëta do të zhduken. Sepse, ndërsa virtyti zgjedh të mos shoqërohet me fëlliqësinë, e liga nuk mund ta durojë praninë e dritës.

Në kohën e duhur ju do ta gjeni veten, me raste, duke kënduar nën zë muzikën së brendshmi. Kur t'i ripërshkoni mendimet tuaja, ju do të zbuloni se ndonjë ndikim mbi ju nga bota nxiti një mendim të padenjët që të hynte në skenën e mendjes suaj dhe muzika filloi thuajse automatikisht.

Pasi të keni mësuar ta pastroni skenën e mendjes suaj nga mendimet e padenja, mbajeni të zënë me mësimin e gjërave që ia vlejné. Ndryshojeni mjedisin tuaj që të mund të keni gjëra rreth jush që do të frymëzojnë mendime të mira dhe lartësuese. Qëndroni të zënë me gjëra që janë të drejta" (në Conference Report, tetor 1976, f. 99–100).

## 2. Rreziku i përpjekjes për t'i fshehur mëkatet tona

Në përpjekje për të fshehur mëkatet e tij të shkeljes së kurorës, Davidi kreu një mëkat edhe më të madh. Për të diskutuar mbi rrezikun e përpjekjes për të fshehur mëkatet tona, krahasojeni mëkatet me një piriq balte. Sqarojeni këtë koncept në dërrasë siç tregohet në vizatimin e parë në faqe 116.



- Çfarë do të ndodhë nëse përpiqemi të mbulojmë një pirg të vogël balte? (Pirgu do të bëhet më i madh dhe më i dukshëm. Sqaroheni këtë koncept siç tregohet në vizatimin e dytë më sipër.)
- Në ç'mënyrë mbulimi i mëkateve tona ngjan me mbulimin e një pirgu balte? (Gjendja jonë në mëkat bëhet më e madhe dhe më e rëndë kur përpiqemi t'i mbulojmë mëkatet tona.)
- Nëse nuk dëshirojmë që njerëzit të shohin një pirg balte, çfarë duhet të bëjmë? (Ne duhet ta heqim pirgun në vend që ta mbulojmë atë.) Si mund t'i heqim mëkatet nga jeta jonë?

### 3. "Amnoni filloi ta urrejë me një urrejtje shumë të madhe" (2 Samuelit 13:15)

2 Samuelit 13 përmban historinë e birit të Davidit, Amnonit, dhe të bijës së Davidit, Tamarës. Amnoni e donte Tamarën dhe e detyroi atë të kryente kurvëri me të.

- 2 Samuelit 13:1 thotë se Amnoni e dashuronte Tamarën. Si ndryshuan ndjenjat e Amnonit ndaj Tamarës pasi ai kishte kryer mëkat kundrejt asaj? (Shih 2 Samuelit 13:15.) Përse urrejtja, në vend të dashurisë, vjen shpesh si rezultat mes njerëzve që shkelin parimet e moralit?

Presidenti Gordon B. Hinkli tha: "Kam dëgjuar Plakun Xhon A. Widso . . . të thoshte: 'Ajo çfarë unë kam vrotuar është se një i ri dhe një e re që shkelin parimet e moralit, shpejt përfundojnë duke e urryer njëri-tjetrin'. Unë kam vrotuar të njëjtën gjë. Mund të ketë fjalë dashurie si fillim, por do të ketë fjalë zemërimi dhe hidhërimi më vonë" ("True to the Faith", *Ensign*, qershor 1996, f. 5).

### 4. Shpresë për të pënduarin

Nëse theksoni se nuk është kurrë tepër vonë për t'u pënduar, ju mund të dëshironi të thoni deklarin e mëposhtëm nga Plaku Bojd K. Parker:

"Ideja shkurajuese se një gabim (ose madje një seri syresh) e bën atë përjetësisht tepër të vonë [pendimin dhe faljen], nuk vjen nga Zoti. Ai ka thënë që, *nëse* ne do të pendohemi, jo vetëm që Ai do t'i falë shkeljet tona, por Ai do t'i harrojë dhe nuk do t'i kujtojë më mëkatet tona. . . . Pendimi është si sapuni; ai mund ta lajë mëkatin. Për pislleqet e futura thellë mund të duhet pastruesi i fuqishëm i disiplinës që t'i heqë njollat, por ato do të hiqen" (në Conference Report, prill 1989, f. 72; ose *Ensign*, maj 1989, f. 59).

# “Çdo Gjë që Merr Frymë le të Lëvdojë Zotin”

Mësimi  
25

*Psalmeve*

---

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të shfaqin mirënjohjen e tyre për Shpëtimtarin dhe për bekimet e shumta që na kanë dhënë neve Ai dhe Ati ynë Qiellor.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta që diskutohen në mësim dhe sa më shumë që të mundeni nga libri i Psalmeve.</li><li>2. Studiojeni mësimin dhe përzgjidhni me lutje shkrimet e shenjta, temat dhe pyetjet që i plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës. Ky mësim nuk e trajton të gjithë librin e Psalmeve. Në vend të kësaj, ai trajton disa nga motivet e rëndësishme që shprehen gjatë të gjithë librit.</li><li>3. Nëse përdorni aktivitetin e parë të vëmendjes, sillni një figurë të Shpëtimtarit dhe katër ose pesë sende që përfaqësojnë gjëra për të cilat ju jeni mirënjohës, të tilla si shkrimet e shenjta, fotografinë e një njeriu të dashur, një send që përfaqëson një prej talenteve tuaja, ose një send ushqimor. Nëse përdorni aktivitetin e dytë të vëmendjes, kërkoni një ose dy prej anëtarëve të klasës që të përgatiten për të treguar një psalm të parapëlqyer dhe që të thonë se përse është i rëndësishëm për ta.</li><li>4. Sillni një ose më shumë figura tempujsh.</li></ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b> Aktivitet Vëmendjeje	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) kur të fillojë mësimi. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Paraqisni një figurë të Shpëtimtarit dhe shprehni mirënjohjen tuaj për jetën dhe misionin e Tij. Paraqisni sendet që përfaqësojnë gjërat e tjera për të cilat jeni mirënjohës. Shprehni mirënjohjen tuaj për secilën prej tyre. Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:<ul style="list-style-type: none"><li>• Për cilat dhurata dhe mundësi nga Zoti jeni veçanërisht mirënjohës? Si do të ndryshonte jeta juaj pa këto bekime?</li></ul>Shpjegoni se shumë prej psalmeve shprehin mirënjohje për bekimet që na ka dhënë Zoti. Një pjesë e këtij mësimi përqendrohet tek ato bekime dhe tek ajo që mund të bëjmë ne për të treguar mirënjohjen tonë për to.</li><li>2. Kërkoni një anëtar të klasës që të lexojë me zë të lartë Psalmeve 23. Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:<ul style="list-style-type: none"><li>• Çfarë ndjenjash shprehen në këtë psalm? Cilat janë ndjenjat tuaja kur e lexoni ose e dëgjoni këtë psalm?</li></ul>Kërkoni një ose dy anëtarëve të caktuar të klasës që të tregojnë një psalm të parapëlqyer dhe të thonë se përse është i rëndësishëm për ta.</li></ol>

---

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Shpjegoni se libri i Psalmeve është një përmbledhje vjershash që fillimisht këndoheshin si lëvdata ose kërkesa të zjarrta ndaj Perëndisë. Shumë janë shkruar nga Davidi. Ky libër është si një libër himnesh fetare nga Izraeli i lashtë. Vargjet e tij përbëjnë pjesë nga letërsia frymëzuese botërore më e mirë, duke shprehur besim të Zoti dhe një dëshirë të zjarrtë për të jetuar me drejtësi.

### 1. Profecitë për jetën dhe misionin e Jezu Krishtit

Shumë psalme profetizojnë për misionin e Krishtit si Mesia. Shpëtimtari i ringjallur shpalli: “Duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në ligjin e Moisiut, në profetët dhe në psalmet” (Lluka 24:44). Diskutoni mbi përmbushjen e disa prej profecive të mëposhtme për Krishtin që janë shkruar në librin e Psalmeve:

Profecia	Përmbushja
Psalmeve 107:23–30	Mateu 8:23–27. Jezusi qetësoi erërat dhe valët.
Psalmeve 69:8.	Gjoni 1:11; 7:5. Jezusi nuk u pranua nga vetë njerëzit e vet.
Psalmeve 41:9; 55:12–14	Gjoni 13:18, 21. Jezusi u tradhëtua nga një mik.
Psalmeve 69:20	Marku 14:32–41. Jezusi vuajti i vetëm në Gjetseman.
Psalmeve 22:7–8	Mateu 27:39–43. Jezusin e tallën.
Psalmeve 22:16	Marku 15:25. Jezusin e kryqëzuan.
Psalmeve 22:18	Mateu 27:35. Ushtarët hodhën short për rrobat e Krishtit.
Psalmeve 22:1	Mateu 27:46. Jezusi e pyeti Atin se përse e kishte braktisur.
Psalmeve 69:21	Gjoni 19:28–30. Jezusit i dhanë uthull për të shuar etjen.
Psalmeve 34:20	Gjoni 19:33–36. Asnjë nga kockat e Jezusit nuk u thye.
Psalmeve 31:5	Lluka 23:46. Jezusi ia dorëzoi shpirtin e Tij Atit dhe vdiq.
Psalmeve 16:10	Veprat e Apostujve 2:31–32; 13:34–35. Mishi i Shpëtimtarit nuk njohu korruptim, duke u ngritur në Ringjallje.

- Jezu Krishti është i vetmi njeri lindja, jeta, vdekja dhe ringjallja e të cilit u profetizuan përpara lindjes së Tij. Si mendoni ju, përse u dhanë profeci kaq të hollësishtme për jetën e Shpëtimtarit? (Këto profeci e bënë të qartë se Jezusi ishte Mesia i premtuar, Shpëtimtari i botës.) Në ç'mënyrë këto profeci qenë një bekim për ata që i morën ato? (Këto profeci i ndihmuan njerëzit që të mësonin për Shpëtimtarin dhe të merrnin dëshmi për Të madje përpara se Ai të lindte [shih Mosia 3:13]. Profecitë gjithashtu, i ndihmuan disa njerëz që ta njihnin Atë kur Ai erdhi.)

### 2. “Zoti të mbushi me të mira” (Psalmeve 116:7).

Përveç që profetizojnë për jetën dhe misionin e Shpëtimtarit, shumë psalme shprehin mirënjohje për bekime të tilla si krijimi i qiellit dhe i tokës; mëshira, falja dhe dashuria e Shpëtimtarit; shkrimet e shenjtja dhe tempulli.

*Krijimi i Qiellit dhe i Tokës*

Diskutoni për psalmet vijuese që shprehin mirënjohje ndaj Zotit për krijimin e qiellit dhe të tokës:

Psalmeve 19:1

Psalmeve 104:5–7, 14, 24

Psalmeve 136:3–9

- Në ç' mënyrë krijimi i qiellit dhe i tokës dëshmon për fuqinë dhe dashurinë e Perëndisë? (Shih Alma 30:44; Moisiu 6:63.) Si mund të tregojmë ne mirënjohje për dhuratën e Krijimit?

*Mëshira, Falja dhe Dashuria e Shpëtimtarit*

Diskutoni për disa nga psalmet vijuese që shprehin mirënjohje ndaj Shpëtimtarit për mëshirën, faljen dhe dashurinë e Tij:

Psalmeve 23 (ju mund të mos keni nevojë të diskutoni për këtë psalm nëse e përdorët atë në aktivitetin e vëmendjes)

Psalmeve 51 (ju mund të mos keni nevojë të diskutoni për këtë psalm nëse e diskutuat në mësimin 24)

Psalmeve 59:16

Psalmeve 78:38

Psalmeve 86:5, 13

Psalmeve 100:4–5

Psalmeve 103:2–4, 8–11, 17–18

- Çfarë mund të mësojmë mbi Zotin nga këto psalme? Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë se si kanë arritur të marrin njohuri për mëshirën, faljen dhe dashurinë e Zotit.
- Çfarë ju lë mbresë nga përgjërimi i Davidit për falje te Psalmeve 51? Çfarë na mëson ky psalm mbi pendimin dhe faljen? (Vini re fjalët e para në vargjet 2, 7 dhe 12. Këto fjalë përshkruajnë aspekte të rëndësishme të pendimit. Vini re gjithashtu vargun 17, që përshkruan gjendjen e zemrës që duhet të kemi, që të pendohemi vërtet.)

*Shkrimet e Shenjta*

Diskutoni për psalmet vijuese që shprehin mirënjohje ndaj Zotit për shkrimet e shenjta:

Psalmeve 19:7–11

Psalmeve 119

- Çfarë fjalësh përdori Davidi te Psalmeve 19:7–10 për të përshkruar shkrimet e shenjta? (Sinonime për shkrimet e shenjta përfshijnë *ligji, dëshmia, porositë, urdhërimet* dhe *grykimet*. Mbiemra që përshkruajnë shkrimet e shenjta përfshijnë *i përsosur, e vërtetë, të pastra* dhe *të drejta*. Shkrimet e shenjta përshkruhen gjithashtu si më të dëshirueshme se ari dhe më të ëmbla se mjalti.)
- Çfarë bekimesh mund të sjellin shkrimet e shenjta në jetën tonë, siç shënohet te Psalmeve 19:7–11? Ju mund të dëshironi t'i rendisni këto bekime në tabelë:
  - a. Ato na përtërijnë shpirtin (vargu 7).
  - b. Ato e bëjnë të ditur njeriun e thjeshtë (vargu 7).
  - c. Ato na gëzojnë zemrën (vargu 8).

ç. Ato na ndriçojnë sytë (vargu 8).

d. Ato na mësojnë (vargu 11).

- Si e kanë bekuar jetën tuaj shkrimet e shenjta në këto mënyra ose në të tjera?
- Psalmisti i thirri Zotit: “Oh, sa shumë e dua ligjin tënd! Ai është përsiatja ime gjithë ditën” (Psalmeve 119:97; shih edhe vargjet 15–16, 33–35, 40, 47–50, 72, 92, 104, 174). Si mund të zhvillojmë një dashuri të tillë për shkrimet e shenjta?
- Në ç’mënyrë shkrimet e shenjta janë si “një llambë në këmbë[t tona] dhe një dritë në shtegun [tonë]”? (Psalmeve 119:105).

### *Tempulli*

Diskutoni për disa nga psalmet vijuese mbi tempullin. Ju mund të dëshironi të paraqisni një ose më shumë fotografi tempujsh ndërsa anëtarët e klasës lexojnë këto psalme:

Psalmeve 5:7

Psalmeve 15:1–3

Psalmeve 24

Psalmeve 27:4

Psalmeve 65:4

Psalmeve 84:1–2, 4, 10–12

Psalmeve 122

Psalmeve 134

- Çfarë mund të mësojmë mbi tempullin nga këto psalme? Çfarë mund të mësojmë mbi përgatitjen tonë për të shkuar në tempull?

Ju mund të dëshironi të ftoni disa nga fëmijët e Fillores që të vijnë në klasë dhe të këndojnë “Unë Tempullin e Dua” (*Children’s Songbook*, f. 95).

### **3. “Ç’do t’i jap Zotit në këmbim të të gjitha të mirave që më ka bërë?” (Psalmeve 116:12)**

- Te Psalmeve 116:12, Davidi pyeti: “Ç’do t’i jap Zotit në këmbim të të gjitha të mirave që më ka bërë?” Si iu përgjigj Davidi kësaj pyetjeje? Ju mund të dëshironi të rendisni secilin prej pohimeve të Davidit siç tregohet më poshtë:
  - a. “Unë do të ngre kupën e shpëtimit” (116:13).
  - b. “Unë . . . do të thërres emrin e Zotit” (116:13).
  - c. “Unë jam me të vërtetë shërbëtori yt, o Zot” (116:16).
  - ç. “Unë do të të ofroj një flijim falenderimi” (116:17).
  - d. “Do t’i plotësoj zotimet e mia Zotit në prani të të gjithë popullit të tij, në oborret e shtëpisë së Zotit” (116:18–19).
- Si mund t’i zbatojmë përgjigjet e Davidit në paraqitjen e mirënjohjes ndaj Zotit?

### **4. “Kini besim te Zoti” (Psalmeve 4:5)**

- “Kini besim te Zoti” është një prej paralajmërimeve më të zakonshme në librin e Psalmeve (Psalmeve 4:5; 5:11; 9:10; 18:2; 56:11; 62:8; 118:8–9). Si e vendosim mirëbesimin tonë te Zoti? Si jeni bekuar ju kur i keni mirëbesuar Atij?

### **Përfundim**

Psalmet japin dëshmi të fuqishme për misionin hyjnor të Jezu Krishtit. Ato na kujtojnë gjithashtu për bekimet e shkëlqyera që na kanë dhënë Ai dhe Ati ynë Qiellor. Dhe ato sugjerojnë mënyra se si ne mund të shprehim mirënjohje për ato bekime.



Ju mund të dëshironi t'i ftoni anëtarët e klasës që të lexojnë Psalmin e fundit (Psalmeve 150) për të përmbledhur mesazhin e librit të Psalmeve. Shtoni dëshminë tuaj të lavdërimit dhe falënderimit.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

### 1. Himnet e ditëve të mëvonshme të frymëzuara nga psalmet e Dhiatës së Vjetër

Shpjegoni se libri i himneve mund të konsiderohet si i barasvlerëshmi ynë i ditëve të mëvonshme për psalmet. Ju mund të dëshironi që t'i vini anëtarët e klasës të këndojnë një himn të ditëve të mëvonshme që ishte frymëzuar nga një psalm i Dhiatës së Vjetër. Një prej këtyre himneve është "Sa i Madh Je Ti" (*Hymns*, nr. 86; Psalmeve 8:3–9; 9:1–2).

### 2. Bekimet nga të kënduarit e himneve

- Cilat janë disa nga temat kryesore të himneve tona të ditëve të mëvonshme? (Përgjigjet mund të përfshijnë Shpëtimtari, detyrat tona si anëtarë të Kishës, durimi deri në fund, besimi, shtëpia e familja, dashuria, puna misionare, lutja, priftëria, profetët, rivendosja e ungjillit, sakramenti, shërbimi, durimi i sprovave dhe Sioni.) Si na bekon këndimi i himneve? (Shih DeB 25:12.)

Diskutoni për disa nga mënyrat e mëposhtme se si këndimi i himneve mund të na bekojë:

- Himnet lartësojnë shpirtin tonë.
- Himnet na frymëzojnë të jetojmë më drejtësisht.
- Himnet na kujtojnë për bekimet tona.
- Himnet na japin një mundësi për t'i kënduar lavdërime Zotit.
- Himnet na japin një mënyrë për të dhënë dëshmi.
- Himnet na ndihmojnë t'i rizotohemi Zotit.
- Himnet na ndihmojnë të ndiejmë Shpirtin.
- Himnet na ndihmojnë të jemi më në harmoni me Atin tonë Qiellor.
- Himnet na ndihmojnë të mësojmë e të japim mësim ungjillin.

Presidenca e Parë ka thënë:

"Muzika frymëzuese është pjesë thelbësore e mbledhjeve tona të kishës. Himnet ftojnë Shpirtin e Zotit, krijojnë një ndjenjë nderimi, na bashkojnë ne si anëtarë dhe na sigurojnë një mënyrë për t'i ofruar lavde Zotit.

Disa prej predikimeve më të mëdha janë dhënë duke kënduar himne. Himnet na çojnë në pendim dhe vepra të mira, forcojnë dëshminë dhe besimin, ngushëllojnë zemërlëshuarit, qetësojnë ata që vajtojnë dhe na frymëzojnë të durojmë deri në fund" (*Hymns*, f. ix).

- Disa psalme shprehen për të kënduarit si "britma gëzimi Zotit" (Psalmeve 98:4; 100:1; shih edhe 66:1; 95:1–2). Si mund ta përdorim më mirë këndimin e himneve në mbledhjet në Kishë dhe shtëpitë tona, duke siguruar që të jetë i gëzueshëm dhe kuptimplotë?
- Në Darkën e Fundit, Jezusi dhe Apostujt e Tij kënduan një himn (Mateu 26:30). Si mendoni ju, në ç'mënyrë këndimi i një himni i ndihmoi Jezusin dhe Apostujt e Tij që të përgatiteshin për të përmbushur punën që qëndronte para tyre?

- Fare pak përpara se Profeti Jozef Smith të martirizohej në burgun e Kartheixhit, ai i kërkoi Xhon Tejlorit që të këndonte “A Poor Wayfaring Man of Grief” (*Hymns*, nr. 29). Si mendoni ju, në ç’mënyrë e ndihmoi Profetin këndimi i këtij himni?

### 3. Paralelizma poetike te psalmet

Studimi juaj i psalmeve mund të pasurohet nga një kuptueshmëri e teknikave poetike që përdorën Davidi dhe poetë të tjerë hebrej. Një prej këtyre teknikave është paralelizmi. Një karakteristikë e zakonshme e paralelizmit është përsëritja e një mendimi me fjalë të ndryshme. Një përsëritje e tillë e zgjeron ose e përforcon kuptimin e një ideje. Një shembull i këtij lloji paralelizmi është Psalmeve 102:1–2, në të cilin i njëjti mendim është shprehur me fjalë të ndryshme pesë herë (“dëgjo lutjen time”, “britma ime arriftë tek ty”, “mos ma fshih fytyrën tënde”, “zgjate ndaj meje veshin tënd” dhe “kur unë të kërkoj, nxito të më përgjigjesh”). Vini në dukje se si përsëritja e përforcon mesazhin.

# Mbreti Salomon: Burrë Mençurie, Burrë Marrëzie

Mësimi  
**26**

1 Mbretërve 3; 5–11

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që t'i përdorin me mençuri bekimet e tyre dhe që të hyjnë denjësisht në tempull.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:<ol style="list-style-type: none"><li>a. 1 Mbretërve 3:5–28. Salomoni pason si mbret atin e tij, Davidin, dhe ndjek Zotin. Zoti i shfaqet Salomonit, që kërkon të bekohet me një zemër të zgjuar (3:5–9). Zoti e bekon Salomonin me mençuri, pasuri dhe nderim (3:10–15). Dy gra çojnë një fëmijë te Salomoni, i cili me mençuri përcakton se cila grua është nëna e fëmijës (3:16–28).</li><li>b. 1 Mbretërve 5–6; 7:1–12. Mbreti Salomon drejton ndërtimin e një tempulli të shkëlqyer (5–6). Ai bën që t'i ndërtohet një pallat për vete (1 Mbretërve 7:1–12).</li><li>c. 1 Mbretërve 8:22–66; 9:1–9. Salomoni përkushton tempullin dhe i kërkon Zotit që t'i bekojë izraelitët me mirëqenie shpirtërore dhe materiale (8:22–53). Populli adhuron për 14 ditë (8:54–66). Zoti i shfaqet sërish Salomonit, duke premtuar që t'i bekojë izraelitët nëse i shërbejnë Atij, por që t'i mallkojë ata nëse u drejtohen perëndive të tjera (9:1–9).</li><li>ç. 1 Mbretërve 10–11. Fama e Salomonit rritet për shkak të pasurisë dhe mençurisë së tij (10:1–13, 24–25). Ai bëhet jashtëzakonisht i pasur (10:14–23, 26). Ai martohet me shumë gra joizraelite që ia mbushin mendjen që të adhurojë perëndi të rreme (11:1–10). Zoti ngre armiq kundër Salomonit (11:11–25). Një profet parashikon se mbretëria e Izraelit do të ndahet për shkak të ligësisë së Salomonit (11:26–40).</li></ol></li><li>2. Lexim shtesë: 1 Mbretërve 2:1–12; 4:29–34; 7:13–51; 1 Kronikave 29; Doktrina e Besëlidhje 46.</li><li>3. Nëse është e disponueshme figura Tempulli i Përdorur në Lashtësi, ju mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë mësimin (62300; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 118).</li></ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Lexoni ose bëni një anëtar të klasës që të lexojë thënien e mëposhtme nga Plaku Dallin H. Ouks:</p> <p>“Ne në përgjithësi mendojmë se Satani na sulmon në pikën tonë më të dobët. . . . Por dobësia nuk është vendi ynë i vetëm ku lëndohemi. Satani mund të na sulmojë gjithashtu aty ku mendojmë se jemi të fortë – në vetë fushat ku jemi krenarë për forcën tonë. Ai do të na qaset nëpërmjet talenteve dhe dhuratave shpirtërore më të mëdha që zotërojmë. Nëse nuk jemi syçelë, Satani mund të shkaktojë rënien tonë shpirtërore duke na korruptuar nëpërmjet anëve tona të forta po ashtu si duke shfrytëzuar dobësitë tona” (“Our Strengths Can Become Our Downfall”, <i>Ensign</i>, tetor 1994, f. 12).</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Cilat janë disa anë të forta që mund të bëhen rënia jonë?</li></ul>

Shpjegoni se ky mësim i kushtohet mbretit Salomon, një burrë që mori dhurata të mëdha nga Perëndia, por që përfundimisht, i përdori këto dhurata mëkatësisht. Sugjeroni që anëtarët e klasës të kërkojnë ngjarje që tregojnë rënien graduale të Salomonit. Theksoni se ne duhet të kërkojmë të metat e tij jo që ta gjykojmë atë, por që të mësojmë nga gabimet e tij.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Pak përpara se Davidi të vdiste, prifti Tsadok dhe profeti Nathan e vajosën Salomonin si mbretin e ri. Salomoni, që ishte bir i Davidit dhe i Bath-Shebës, mori këshillën që vijon nga ati i tij: “Tregohu i fortë dhe sillu si burrë! Respekto urdhrat e Zotit, Perëndisë tënd, duke ecur në rrugët e tij, duke zbatuar në praktikë statutet e tij, urdhërimet e tij, dekretet e tij dhe porositë e tij, . . . me qëllim që ti t’ia dalësh mbanë në të gjitha gjërat që do të bësh” (1 Mbretërve 2:2–3).

### 1. Zoti e bekon Salomonin me mençuri, pasuri dhe nderim.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 3:5–28.

- Pak pasi Salomoni u bë mbret, Zoti iu shfaq atij në ëndërr dhe i tha: “Kërko ç’ të duash dhe unë do ta jap” (1 Mbretërve 3:5). Çfarë kërkoi Salomoni? (Shih 1 Mbretërve 3:9.) Çfarë do të thotë të kesh një “zemër të zgjuar”? (Shih 1 Mbretërve 3:28; 4:29.) Përse Salomoni ndiente një nevojë të veçantë për atë bekim? (Shih 1 Mbretërve 3:7–8.) Në ç’ mënyrë të pasurit të “dituri[së së] Perëndisë” na ndihmon për përgjegjësitë tona në shtëpi, në punë, në shkollë, në Kishë? Si mund ta marrim këtë mençuri?
- Përse Zoti që i kënaqur nga kërkesa e Salomonit për një zemër të zgjuar? (Shih 1 Mbretërve 3:11–12. Salomoni kërkoi një dhuratë që do ta ndihmonte atë t’u shërbente të tjerëve në vend të një dhurate për qëllime egoiste.) Cilat janë disa dhurata shpirtërore që mund të kërkojmë? (Shih DeB 46:13–26.) Me çfarë kushtesh i jep Zoti dhuratat e Shpirtit? (Shih 1 Mbretërve 3:14; DeB 46:8–12.) Si mund t’i përdorim këto dhurata për t’u shërbyer të tjerëve?
- Çfarë bekimesh të tjera i fali Zoti Salomonit? (Shih 1 Mbretërve 3:13–14.) Si mund të përdoren këto bekime për t’u shërbyer të tjerëve?
- Cila ishte situata e parë që kërkonte gjykimin e mbretit Salomon? (Shih 1 Mbretërve 3:16–22.) Si e zgjidhi problemin Salomoni? (Shih 1 Mbretërve 3:23–28.) Në ç’ mënyrë zgjidhja e Salomonit tregoi se Zoti e kishte bekuar atë me mençuri?

### 2. Mbreti Salomon drejton ndërtimin e një tempulli të shkëlqyer dhe bën që t’i ndërtohet një pallat për vete.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 5–6; 7:1–12.

- Siç u urdhërua nga Zoti, Salomoni drejtoi që të ndërtohej një tempull. (Ju mund të dëshironi që të rishikoni shkurt 1 Mbretërve 5:1–6, 17–18; 6:15–36 për të theksuar llojin e përpunuar të tempullit.) Si mendoni ju, përse Salomoni përdori material kaq të shkëlqyer për të ndërtuar tempullin?
- Në ç’ mënyrë ndërtuesit treguan nderim për tempullin gjatë ndërtimit të tij? (Shih 1 Mbretërve 6:7.)

- Në ç'mënyrë Salomoni përdori mençurinë, pasuritë dhe nderimin e tij për të siguruar ndërtimin siç duhet të tempullit? (Shih 1 Mbretërve 5:1–12. Për shkak të këtyre bekimeve ai qe në gjendje të siguronte materiale ndërtimi dhe të merrte në shërbim punëtorë të zotë për ndërtimin e tempullit.)
- Çfarë premtimi i dha Zoti Salomonit në lidhje me tempullin? (Shih 1 Mbretërve 6:11–13.) Çfarë premtimi të ngjashëm na ka dhënë Zoti neve sot? (Shih DeB 97:15–17.)
- Salomoni bëri gjithashtu që t'i ndërtohej një shtëpi për atë vetë. Si ishin përmasat e shtëpisë së tij në krahasim me përmasat e shtëpisë së Zotit? (Shih 1 Mbretërve 6:2–3; 7:2, 6–7.) Në ç'mënyrë ky përdorim i pasurive tregon rënien graduale të Salomonit?

### 3. Salomoni përkushton tempullin.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 8:22–66; 9:1–9.

- Pas shtatë vitesh ndërtimi, tempulli u përkushtua. Cilat janë disa nga gjërat për të cilat Salomoni u lut në lutjen përkushtuese? (Shih 1 Mbretërve 8:22–53.)

Ju mund të dëshironi t'i shkruani përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë. Përgjigjet mund të përfshijnë sa vijon:

- Përgjigje ndaj lutjeve (1 Mbretërve 8:28–30, 49–52)
  - Falje (1 Mbretërve 8:33–39)
  - Shi (1 Mbretërve 8:35–36)
  - Ndihmë gjatë zisë së bukës dhe sëmundjeve (1 Mbretërve 8:37)
  - Ndihmë në betejë (1 Mbretërve 8:44–45)
- Në lutjen e tij përkushtuese, Salomoni iu lut Zotit që ta ndihmonte popullin e tij për shumë probleme të vështira. Në ç'mënyrë pjesëmarrja në tempull na ndihmon kur jemi të rënduar nga problemet?

Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Në paqen e këtyre tempujve të dashur, nganjëherë ne gjejmë zgjidhje për problemet e rënda të jetës. Nën ndikimin e Shpirtit, nganjëherë dituria e kulluar rrjedh drejt nesh atje. Tempujt janë vende për zbulesë personale. Kur kam qenë i rënduar nga një problem ose vështirësi, unë kam shkruar te Shtëpia e Zotit me një lutje në zemrën time për përgjigje. Këto përgjigje kanë ardhur në mënyra të qarta dhe të padyshimta” (“What I Hope You Will Teach Your Children about the Temple”, *Ensign*, gusht 1985, f. 8).

- Salomoni u lut që tempulli të ndihmonte për të drejtuar jobesimtarët te Zoti (1 Mbretërve 8:41–43). Në ç'mënyrë mund ta bënte tempulli këtë? (Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë shembuj për mënyrat se si ata ose të tjerë janë interesuar për Kishën për shkak të interesimit të tyre për tempujt.)
- Pasi Salomoni bëri lutjen përkushtuese, ai e këshilloi popullin e tij: “Le të jetë, pra, zemra juaj e dhënë plotësisht Zotit, Perëndisë tonë” (1 Mbretërve 8:61). Si mendoni ju, çfarë do të thotë të kesh një zemër që i është “dhënë plotësisht Zotit”? Në ç'mënyrë pjesëmarrja në tempull mund të na ndihmojë t'ia japim plotësisht [Zotit] zemrat tona?
- Çfarë mund të bëjmë që ta mbajmë të fortë ndikimin e tempullit në jetën tonë? (Përgjigjet mund të përfshijnë: Të shkojmë shpesh aty ku është e mundur, të mbajmë një rekomandim aktual dhe të ekspozojmë figura tempujsh në shtëpitë tona.)

- Çfarë bëri populli pasi u përkushtua tempulli? (Shih 1 Mbretërve 8:62–66.) Cili ishte qëndrimi i njerëzve kur u kthyen në shtëpitë e tyre pas përkushtimit të tempullit dhe 14 ditëve të adhurimit? (Shih 1 Mbretërve 8:66.) Si ndiheni ju kur ktheheni në shtëpi nga tempulli?
- Cili ishte mesazhi i Zotit kur e vizitoi Salomonin pas përkushtimit të tempullit? (Shih 1 Mbretërve 9:3–9. Shih edhe 1 Mbretërve 6:11–13. Vini re se Zoti bëri një deklaram të ngjashëm gjatë ndërtimit të tempullit.) Si mendoni ju, përse Salomoni kishte nevojë që ta kujtonin për besëlidhjet e tij? Në ç'mënyrë Zoti na kujton për besëlidhjet tona?

#### 4. Salomoni bëhet jashtëzakonisht i pasur dhe martohet me shumë gra joizraelite që ia mbushin mendjen të adhurojë idhuj.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 10–11.

- Si u shtuan pasuritë dhe nderimi i Salomonit pasi u ndërtua tempulli? (Shih 1 Mbretërve 10:1–15, 24–25.) Në ç'mënyrë i keqpërdori Salomoni këto bekime? (Shih 1 Mbretërve 10:16–23, 26–29. Vini në dukje se ai i përdori ato për të ndërtuar mbretërinë e tij në vend të mbretërisë së Perëndisë.) Si duhet të përdoren mençuria, pasuritë dhe nderimi? (Shih Jakobi [LiM] 2:18–19.)
- Në ç'mënyrë zgjedhja e grave prej Salomonit tregoi se ai ishte larguar nga Perëndia? (Shih 1 Mbretërve 11:1–2. Ai u martua jashtë besëlidhjes.) Si ndikuan gratë e tij joizraelite tek ajo që bëri Salomoni? (Shih 1 Mbretërve 11:3–8. Vini re se në Përkthimin prej Jozef Smithit, vargu 4 thotë se zemra e Salomonit “u bë si zemra e Davidit, atit të tij” dhe vargu 6 thotë se “Salomoni bëri të keqen në sytë e Zotit, ashtu si Davidi, ati i tij”.)
- Çfarë bëri Zoti kur Salomoni shkeli besëlidhjet e tij dhe u largua? (Shih 1 Mbretërve 11:9–14, 23–25, 33–36.)
- Si mendoni ju, në ç'mënyrë bekimet e mençurisë, pasurive dhe nderimit kontribuan në rënien e Salomonit? Si i keni parë këto anë të forta që të kontribuojnë në rënien e njerëzve sot? Si mund të sigurohemi që anët tona të forta të mos bëhen një rënie për ne? (Shih 1 Mbretërve 8:61; DeB 88:67.)

Plaku Dallin H. Ouks tha:

“Si . . . i parandalojmë anët tona të forta që të bëhen rënia jonë? Cilësia që duhet të forcojmë është përlësia. Përlësia është mbrojtësja e madhe. Përlësia është kundërhelmi ndaj krenarisë. Përlësia është katalizatori për të gjithë të mësuarin, veçanërisht për gjëra shpirtërore. Nëpërmjet profetit Moroni, Zoti na dha këtë sqarim të shkëlqyer për rolin e përlësisë: ‘Unë u jap njerëzve dobësi, që ata të jenë të përlulur dhe hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përlulen para meje; pasi në qoftë se ata përlulen para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta’ (Ethëri 12:27).

Ne gjithashtu mund të themi që, nëse burrat e gratë përlulen përpara Perëndisë, Ai do t'i ndihmojë ata që të parandalojnë që anët e tyre të bëhen dobësi që kundërshtari mund t'i shfrytëzojë për t'i shkatërruar ata. . . .

. . . Nëse jemi të përlulur dhe të mësueshëm, duke ua vënë veshin urdhërimeve të Perëndisë, këshillës së udhëheqësve të Tij dhe nxitjeve të Shpirtit, ne mund të marrim udhëheqje për mënyrën se si t'i përdorim dhuratat tona shpirtërore,



arritjet tona dhe të gjitha anët tona të tjera të forta për drejtësi. Dhe ne mund të marrim udhëheqje për mënyrën se si t'i shmangim përpjekjet e Satanit për të përdorur anët tona të forta që të shkaktojë rënien tonë.

Në të gjithë këtë, ne duhet të kujtojmë e të mbështetemi në drejtimin dhe premtimin e Zotit: 'Ji i përulur; dhe Zoti, Perëndia yt, do të të udhëheqë përdore dhe do t'u japë përgjigje lutjeve të tua' (DeB 112:10)" ("Our Strengths Can Become Our Downfall", *Ensign*, tetor 1994, f. 19).

## Përfundim

Shprehni mirënjohjen tuaj për bekimet shpirtërore dhe materiale që ju ka dhënë Zoti dhe për tempullin. Nxitini anëtarët e klasës që të përulen përpara Zotit që të mund t'i përdorin bekimet e tyre me mençuri dhe që të hyjnë denjësisht në tempull.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimit. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimit.

### 1. "Me qëllim që zemra e tij të mos ngrihet mbi vëllezërit e tij" (Ligji i Përtërirë 17:20)

- Bëni një anëtar të klasës që të lexojë me zë të lartë vargjet nga Ligji i Përtërirë 17:14–20. Si do ta kishte ndryshuar zbatimi i këtij shkrimi të shenjtë jetën e Salomonit dhe të njerëzve në mbretërinë e tij?

### 2. Lutje përkushtuese për tempujt

Nëse anëtarët e klasës kanë marrë pjesë në një përkushtim tempulli, kërkojini njërit apo dy prej tyre të tregojnë mbi përvojën e tyre. Ju mund të dëshironi t'i kërkonin një anëtar të klasës që të përgatitet për të treguar dy ose tre mendime nga lutja përkushtuese e një tempulli të ditëve të mëvonshme. (Doktrina e Besëlidhje 109 përmban lutjen e dhënë në përkushtimin e Tempullit të Kirtlandit.)

- Si duhet të ndikojnë lutjet përkushtuese në jetën tonë personale?

Presidenti Jozef Filding Smith tha: "Kur i përkushtojmë një shtëpi Zotit, ajo çfarë bëjmë në të vërtetë është që ia përkushtojmë veten shërbimit për Zotin, me një besëlidhje se do ta përdorim shtëpinë në mënyrën si Ai ka për qëllim që ajo të përdoret" (*Church News*, 22 janar 1972, f. 3).

# Ndikimi i Udhëheqësve të Ligj dhe i Atyre të Drejtë

1 Mbretërve 12–14; 2 Kronikave 17; 20

**Qëllimi** Të nxisë anëtarët e klasës që të zhvillojnë cilësi të mira udhëheqësi që të mund të ndikojnë të tjerët për të jetuar me drejtësi.

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:

- a. 1 Mbretërve 12:1–20. Roboami pason atin e tij, Salomonin, si mbret mbi dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Ai nuk e pranon këshillën e pleqve për t'i shërbyer popullit të tij, duke kërkuar përkundrazi të vendoste barra më të mëdha mbi ta (12:1–15). Mbretëria ndahet kur dhjetë fise rebelohen (12:16–19; dhjetë fiset mbajnë titullin e mbretërisë së Izraelit, ndërsa fiset e Judës dhe të Beniaminit mbeten nën sundimin e Roboamit dhe quhen mbretëria e Judës). Mbretëria e Izraelit përzgjedh si mbret Jeroboamin, një ish-administrator në mbretërinë e Salomonit (12:20).
- b. 1 Mbretërve 12:25–33; 13:33–34; 14:14–16, 21–24. Jeroboami e udhëheq popullin e tij në idhujtari dhe i zëvendëson priftërinjtë me burra që nuk ishin levitë (12:25–33; 13:33–34; për një shpjegim të asherimëve dhe vendeve të larta, shih idenë e dytë shtesë të mësimdhënies). Një profet parashikon shkatërrimin e familjes së Jeroboamit dhe shpërndarjen e Izraelit (14:14–16). Roboami e udhëheq mbretërinë e Judës në idhujtari (14:21–24).
- c. 2 Kronikave 17:1–10; 20:1–30. Jozafati, stërnip i Roboamit, mbretëron me drejtësi në mbretërinë e Judës, duke shkatërruar asherimët e vendet e larta dhe duke dërguar levitët nëpër Jude për të dhënë mësim nga libri i ligjit të Zotit (17:1–10). Ndërkohë që armiqtë e Judës vijnë kundër tyre, Jozafati dhe populli i tij agjërojnë dhe luten. Zoti u thotë atyre se beteja nuk është e tyre, por e Atij. Sulmuesit e tyre luftojnë midis tyre dhe shkatërrojnë njëri-tjetrin (20:1–30).

2. Lexim shtesë: 1 Mbretërve 11:26–40; 2 Mbretërve 17:20–23.

3. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, siguroni një cohë pëlhere të vjetër që mund të ndahet në copa, ose një copë të madhe letre që është prerë në formën e një cohe pëlhere.

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin**

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje**

Merrni një cohë të vjetër pëlhere ose një copë letre që është prerë në formën e një cohe pëlhere dhe grisni në 12 pjesë. Shpjegoni se nga fundi i jetës së Salomonit, profeti Ahijah profetizoi se Jeroboami, një nga 12 mbikëqyrësit e Salomonit për taksat dhe fuqinë punëtore, do të merrte shumicën e kombit izraelit. Për ta sqaruar këtë, Ahijahu mori mantelin nga shpina e Jeroboamit, e grisni në 12 pjesë dhe ia dha Jeroboamit 10 prej pjesëve (1 Mbretërve 11:29–32; një poshtëshënim në Biblën SHDM anglisht për vargun 32 vë në dukje që, sipas Septuagintës, përkthimit në greqisht të Dhiatës së Vjetër, dy fise dhe jo një, do të liheshin në mbretërinë e sunduar nga pasardhësit e Davidit).

Shpëtimtari dha mësim se “çdo mbretëri, që përçahet në vetvete, shkon drejt shkatërrimit” (Mateu 12:25). Shpjegoni se kjo është çfarë i ndodhi mbretërisë së Izraelit pas vdekjes së Salomonit. Ky mësim i kushtohet ndikimit të udhëheqësve të ligj dhe të atyre të drejtë në mbretërinë e ndarë të Izraelit.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Mbretëria e Izraelit ndahet, kryesisht për shkak të udhëheqjes së ashpër të Roboamit.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 12:1–20.

Ju mund të dëshironi të shkruani paraqitjen e mëposhtme në dërrasë:

*Një udhëheqës i mirë:*

#### 1. Jep shërbim.

- Pasi vdiq Salomoni, biri i tij, Roboami, u bë mbret i Izraelit. Çfarë ndryshimesh donin izraelitët që të bënte Roboami nga mënyra se si sundoi i ati? (Shih 1 Mbretërve 12:3–4.) Çfarë këshille i dhanë pleqtë Roboamit mbi sundimin me sukses? (Shih 1 Mbretërve 12:6–7; 2 Kronikave 10:7.) Përse ka më shumë gjasa që të ndikohemi pozitivisht nga një udhëheqës që është i sjellshëm dhe që na shërben? Si mund ta zbatojmë këtë këshillë në shtëpi, në kishë, në shkollë, në punë? (Shih DeB 121:41–46.) Cilët janë disa shembuj që keni parë ju të prindërve ose udhëheqësve të tjerë, që e zbatojnë këtë këshillë me sukses?
- Pasi nuk e pranoi këshillën e pleqve, Roboami iu drejtua të rinjve që kishte njohur që në rininë e tij. Cila ishte këshilla e tyre? (Shih 1 Mbretërve 12:8–11.) Cilat qenë pasojat e vendimit të Roboamit për të ndjekur këshillën e tyre? (Shih 1 Mbretërve 12:12–17. Shpjegoni se fraza “Izraeli u tërhoq në çadrat e tij” iu referohet dhjetë fiseve që u ndanë nga mbretëria e Roboamit.) Si mund të kishin qenë ndryshe këto rezultate nëse Roboami do të kishte ndjekur këshillën e pleqve? (Shih 1 Mbretërve 12:7.)
- Jeroboami kishte qenë një prej 12 mbikëqyrësve të Salomonit për taksat dhe fuqinë punëtore. Nga fundi i mbretërimit të Salomonit, profeti Ahijah kishte profetizuar se Jeroboami do të bëhej mbret mbi shumicën e fiseve të Izraelit (1 Mbretërve 11:29–31; shih aktivitetin e vëmendjes). Si u përmbush kjo profeci? (Shih 1 Mbretërve 12:20, një poshtëshënim në Biblën SHDM anglisht thotë se Septuaginta, përkthimi greqisht i Dhiatës së Vjetër, përfshin Beniaminin ashtu si dhe Judën në fund të atij vargu. Fiset e Judës dhe të Beniaminit qëndrojnë me Roboamin në Mbretërinë Jugore, ose mbretërinë e Judës. Dhjetë fiset e tjera ndoqën Jeroboamin në Mbretërinë Veriore, ose mbretërinë e Izraelit.)

### 2. Jeroboami dhe Roboami i çojnë në idhujtari mbretëritë e tyre.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 12:25–33; 13:33–34; 14:14–16, 21–24.

Ju mund të dëshironi të shtoni te paraqitja që keni shkruar në dërrasë:

*Një udhëheqës i mirë:*

#### 1. Jep shërbim.

#### 2. I mirëbeson dhe i bindet Zotit.

- Njëpërmjet profetit Ahijah, Zoti i premtoi Jeroboamit se atij do t'i jepej një "shtëpi [e] qëndrueshme" (një mbretëri e sigurt) nëse ai do të ecte në rrugët e Zotit (1 Mbretërve 11:38). Në ç'mënyrë Jeroboami i humbi bekimet e atij premtimi? (Shih 1 Mbretërve 12:25–33.) Përse Jeroboami ndërtoi viçat e artë e vendet e larta dhe shuguroi priftërinj të rremë? (Shih 1 Mbretërve 12:26–33; 13:33–34.)

Shpjegoni se Jeroboami kishte frikë që, nëse populli i tij do të shkonte në Jerusaleem për të adhuruar, ai mund të kthehej te Roboami. Në një përpjekje për ta kontrolluar popullin dhe për të mbajtur besnikërinë e tij, ai bëri viçat e artë në Bethel e në Dan, dy qytete në Mbretërinë Veriore, dhe e ftoi popullin e tij që të adhuronte në ato qytete. Duke e bërë këtë, ai lejoi që frika e tij nga disfata ta kapërcente mirëbesimin e tij në premtimet e Zotit. Vini në dukje se një udhëheqës i mençur i mirëbeson Zotit dhe nuk i bazon vendimet mbi frikën ose gjykimin personal.

- Kur i biri i tij u sëmur, Jeroboami kërkoi ndihmën e profetit Ahijah. Çfarë profetizoi Ahijahu në lidhje me shtëpinë (familjen) dhe mbretërinë e Jeroboamit? (Shih 1 Mbretërve 14:14–16. Përmbushja e kësaj profecie gjendet te 2 Mbretërve 17:20–23.)
- Ashtu si Jeroboami, Roboami gjithashtu nuk iu bind Perëndisë duke e çuar popullin në idhujtari (1 Mbretërve 14:21–24). Udhëheqjet e liga të këtyre dy mbretërve patën rezultate afatgjata. Të dy mbretëritë u shpërndanë ose u shpërngulën si robër shumë vite më vonë (Izraeli nga asirët dhe Juda nga babilonasit) sepse vazhduan në traditat e tyre të liga. Në ç'mënyrë një udhëheqës i lig mund të ketë një ndikim kaq të thellë mbi kaq shumë njerëz?

Ju mund të dëshironi që të vini në dukje se ne nuk duhet të ndjekim veprimet e udhëheqësve të ligj siç bënë njerëzit e Izraelit dhe të Judës. Perëndia na ka dhënë lirinë e zgjedhjes dhe ne mund ta përdorim atë fuqi për të zgjedhur të mirën edhe nëse udhëheqësit zgjedhin të ligën (Helamani 14:30–31).

### 3. Jozafati e udhëheq mbretërinë e Judës që të ndjekë Zotin dhe profetët e Tij.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Kronikave 17:1–10; 20:1–30.

Ju mund të dëshironi të shtoni sërish te lista në dërrasë:

*Një udhëheqës i mirë:*

1. Jep shërbim.
2. I mirëbeson dhe i bindet Zotit.
3. Ka besim te Perëndia.
4. Jep mësim nga shkrimet e shenjta.
5. Ndjek profetët.

- Tre breza pas Roboamit, stërnipi i tij Jozafati sundoi mbi mbretërinë e Judës. Në ç'mënyrë e tregoi Jozafati drejtësinë e tij personale? (Shih 2 Kronikave 17:3–4, 6.) Në ç'mënyrë ndikon devocioni ynë vetjak tek aftësia jonë për të udhëhequr të tjerët?
- Jozafati "hoqi . . . vendet e larta dhe Asherimët nga Juda" (2 Kronikave 17:6). Si mendoni ju, çfarë mësuan njerëzit nga kjo? (Shih 2 Kronikave 20:12–13, duke vënë re se "tërë burrat e Judës, me fëmijët, bashkëshortet dhe bijtë e tyre, rrinin

më këmbë përpara Zotit".) Çfarë mund të heqim nga shtëpitë tona dhe jeta jonë personale që të mund ta adhurojmë Perëndinë me devocion më të madh?

- Jozafati i dërgoi levitët nëpër mbarë mbretërinë për t'u dhënë mësim njerëzve nga "libri[i] ligjit të Zotit" (2 Kronikave 17:9). Si mendoni ju, në ç'mënyrë ndikoi te njerëzit e Judës mësimdhënia nga shkrimet e shenjta? Në ç'mënyrë ju ka ndihmuar juve studimi personal dhe familjar i shkrimit të shenjtë? Në ç'mënyrë ndikon studimi i shkrimit të shenjtë në shtëpi te familjet tona dhe te Kisha si e tërë?

Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim: "Shpesh ne shpenzojmë orvatje të mëdha duke u përpjekur të rrisim nivelet e aktivitetit në kunjët tona. Ne punojmë me zell për të ngritur përqindjet e atyre që marrin pjesë në mbledhjet e sakramentit. Ne punojmë që të marrim një përqindje më të lartë të të rinjve tanë në misionet. Ne përpiqemi fort që të përmirësojmë shifrat e atyre që martohen në tempull. Të gjitha këto janë përpjekje të lavdërueshme dhe të rëndësishme për rritjen e mbretërisë. Por kur familjet dhe anëtarët individualisht zhyten në shkrimet e shenjta rregullisht dhe qëndrueshëm, këto fusha të tjera të aktivitetit do të vijnë automatikisht. Dëshmitë do të rriten. Zotimi do të forcohet. Familjet do të fuqizohen. Zbulesa personale do të rrjedhë" (*The Teachings of Ezra Taft Benson* [1988], f. 44).

- 2 Kronikave 20 tregon për një periudhë shqetësimi të tmerrshëm për popullin e Judës, ndërsa tre kombe i kishin shpallur luftë atij. Rezultati dukej i vlerësuar për mbretin Jozafat dhe popullin e tij, që ishte shumë më i vogël në numër. Çfarë bëri Jozafati që të merrte ndihmë? (Shih 2 Kronikave 20:3–13.) Cila ishte përgjigjja e Zotit ndaj këtij përgjërimit? (Shih 2 Kronikave 20:14–17.) Vini re se kjo përgjigje erdhi përmes profetit Jahaziel.) Çfarë këshille i dha Jozafati popullit të tij? (Shih 2 Kronikave 20:20.) Si shenjtorë të ditëve të mëvonshme, në ç'mënyrë jemi ne më të paktë në numër siç qe populli i Judës në lashtësi? Në ç'mënyrë zbatohet për ne këshilla e Jozafatit?
- Duke kujtuar sigurimin e profetit Jahaziel se beteja që e Perëndisë, Jozafati caktoi këngëtarë që të lëvdonin Zotin në vend që të luftonin. Kur ata filluan të këndonin, Zoti i mbrojti ata duke bërë që sulmuesit të luftonin midis tyre dhe të shkatërronin njëri-tjetrin (2 Kronikave 20:21–24). Në ç'mënyrë jemi të mbrojtur kur kujtojmë dhe u bindemi fjalëve të profetit të gjallë?
- Në ndryshim nga Jeroboami dhe Roboami, që e udhëhoqën popullin e tyre në idhujtari, Jozafati ndikoi te populli i Judës që të përulej përpara Zotit (2 Kronikave 20:3–4). Çfarë shembujsh keni parë të ndikimit të udhëheqësve të drejtë? Çfarë mund të bëjmë që t'i ndihmojmë ata të cilëve u shërbejmë, që të jetojnë drejtësisht?

#### Përfundim

Dëshmoni për fuqinë që kanë udhëheqësit që ta udhëheqin popullin e tyre në ligësi ose drejtësi. Kujtojin anëtarët e klasës për përgjegjësinë tonë që të udhëheqim në thirrjet tona në Kishë, në komunitetet tona, në punë dhe në shtëpi. Nxitini anëtarët e klasës që të jenë udhëheqës të mirë duke dhënë shërbim, duke i mirëbesuar e duke iu bindur Zotit, duke pasur besim tek Ai, duke dhënë mësim nga shkrimet e shenjta dhe duke ndjekur profetët.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

## 1. Kapërcimi i shtytjes negative nga shokët

- Mbretëria e Izraelit u nda kryesisht sepse Roboami zgjodhi të ndiqte këshillën e pamatur të shokëve të tij (1 Mbretërve 12:9–16). Në ç'mënyrë mund t'i rezistojmë tundimit për të ndjekur këshillën e pamatur të miqve tanë?

Plaku Malkolm S. Jepsen tha:

“Shumëve prej jush . . . në ndonjë kohë ose një tjetër, do t'ju qaset një ose më shumë nga 'miqtë' tuaj, që do t'ju joshë të bëni diçka që ju e dini se nuk duhet ta bëni. . . .

'Askush nuk do ta dijë ndonjëherë', do t'ju thonë të ashtuquajturit miq. 'Përveç kësaj, çfarë ndryshimi ka?'

. . . Juve nuk do t'ju duhet të mos i pranoni miqtë që janë në shtegun e gabuar; juve madje nuk do t'ju duhet të hiqni dorë prej tyre medoemos. Ju mund të jeni miku i tyre që kujdeset, gati t'i ndihmojë ata kur ata të jenë gati për të marrë ndihmë. Ju mund t'u flisni atyre, t'i lartësoni moralisht dhe t'ju jepni dëshmi atyre. Udhëhiqini ata me anë të shembullit.

Por kurrë mos u udhëhiqni në moskënaqjen e Atit tuaj në Qiell nga miqtë tuaj, që mund ta kërkojnë atë si kusht për të qenë miku juaj, ju duhet të zgjidhni midis udhës së tyre dhe udhës së Zotit.

Nëse ndodh kjo, zgjidhni udhën e Zotit dhe kërkon miq të rinj” (në Conference Report, prill 1990, f. 59; ose *Ensign*, maj 1990, f. 45).

## 2. Kuptimi i vendeve të larta dhe asherimëve

Përkufizimet në vijim do t'ju ndihmojnë të shpjegoni adhurimin e rremë të nxitur nga Jeroboami dhe Roboami.

Vende të larta (1 Mbretërve 12:31): altarë që ishin ndërtuar në majë të kodrave. Kur njerëzit ranë në idhujtari, ata i përdhosën këta altarë dhe i përdorën për adhurim të idhujve.

Asherimë [korije] (1 Mbretërve 14:15): vende të adhurimit pagan ku njerëzit nga-njëherë përfshiheshin në sjellje imorale.

## 3. “Dhe . . . do t'u shërbeni perëndive . . . , të bëra nga dora e njeriut” (Ligji i Përtërirë 4:28)

- Kur Jeroboami krijoi viçat e artë dhe njerëzit adhuruan në vendet e larta dhe në asherimët, ai dhe populli i tij po shpërfillnin paralajmërimet e Moisiut dhënë 500 vite më parë (Ligji i Përtërirë 4:25–28). Çfarë katastrofe po i përgatisnin ata vetes? Çfarë ishte premtuar nëse do t'i drejtoheshin Zotit në vend të idhujve të rremë? (Shih Ligji i Përtërirë 4:29–31.)

## 4. Mësim me objekt për udhëheqjen

Sillni në klasë dy komplete identike blloqesh (ose objektesh të tjera). Ftoni dy anëtarë të klasës që të marrin pjesë në paraqitjen vijuese. Jepini secilit pjesëmarrës një komplet blloqesh. Caktoni njërin anëtar të klasës që të jetë udhëheqësi dhe tjetrin të jetë ndjekësi. Bëni që dy anëtarët e klasës t'i kthejnë shpinën njëri-tjetrit që të mos mund t'i shohin blloqet e njëri-tjetrit. Bëni që udhëheqësi të ndërtojë shpejt diçka me blloqet dhe t'i japë udhëzime ndjekësit se si të ndërtojë një strukturë identike. Ndjekësi nuk duhet të bëjë pyetje ndërkohë që ai ose ajo



ndjek udhëzimet. Asnjë nga pjesëmarrësit nuk duhet t'i shohë bllloqet e tjetrit derisa të përfundojë projektin.

Kur ndjekësi të mbarojë me ndërtimin, diskutoni se sa e rëndësishme është që udhëheqësit të japin udhëzime të qarta dhe që ndjekësit të dëgjojnë me kujdes. Nëse ndjekësi ka ndërtuar një strukturë identike me të udhëheqësit, lavdërojini të dy pjesëmarrësit dhe kërkoni anëtarëve të tjerë të klasës që të komentojnë mbi arsyen pse ata qenë të suksesshëm. Nëse paraqitja ka përfunduar me strukturë të ndryshme, bëni pyetjet vijuese:

- A mund t'i kishte dhënë udhëheqësi udhëzimet më qartë? A mund të kishte dëgjuar ndjekësi më me kujdes? Si do të kishte ndihmuar lejimi i ndjekësit që të shihte ndërsa udhëheqësi ndërtonte strukturën?
- Si mund të zbatojmë atë që kemi mësuar nga kjo paraqitje në thirrjet tona në Kishë dhe në shtëpitë tona?

# “Mbas Zjarrit . . . një Zë, si një Shushuritje e Ëmbël”

1 Mbretërve 17–19

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që ta vendosin Perëndinë të parin në jetën e tyre dhe që të gjejnë udhëheqje dhe ngushëllim në fjalët e profetit të gjallë dhe pëshpëritjet e Frymës së Shenjtë.
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. 1 Mbretërve 17. Elija vulos qiejt kundër shiut, ikën nga Ashabi e Jezebela dhe ushqehet mrekullisht në shkretëtirë (17:1–6). Zoti e dërgon Elijan tek një e ve që i jep atij ushqim dhe ujë (17:7–16). Elija ngre nga vdekja të birin e së vesë (17:17–24).</li> <li>b. 1 Mbretërve 18. Pas më shumë se dy viteve me zi buke, Elija takon Ashabin dhe sfidon priftërinjtë e Baalit që të zbresin zjarr nga qielli për të konsumuar sakrificën e tyre (18:1–2, 17–24). Priftërinjtë e Baalit dështojnë në përpjekjet e tyre, por Elija lutet dhe Zoti zbret zjarr për të konsumuar sakrificën që ai kishte përgatitur (18:25–40). Elija lutet që të marrë fund zia e bukës dhe Zoti dërgon shi (18:41–46).</li> <li>c. 1 Mbretërve 19. Jezebela përpiqet ta vrasë Elijan (19:1–2). Elija ikën në shkretëtirë dhe ushqehet nga një engjëll (19:3–8). Elija shkon në Horeb, ku ngushëllohet nga Fryma e Shenjtë dhe udhëzohet që të vazhdojë në punën e Perëndisë (19:9–19).</li> </ul> <p>2. Kërkojini një anëtari të klasës që të përgatitet për të dhënë një raport të shkurtër mbi ballafaqimin e Elijas me priftërinjtë e Baalit (1 Mbretërve 18:17–40).</p>

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje** Tregoni ndodhinë e mëposhtme nga Plaku Tomas S. Monson:

“I lindur në varfëri por i ushqyer në besim, [Hozé Garsía] u përgatit për një thirrje misioni. Unë isha i pranishëm në ditën kur u mor rekomandimi i tij. Atje paraqitej deklarimi: ‘Vëllai Garsía do të shërbejë në saje të sakrificës së madhe të familjes së tij, sepse ai luan një rol të madh në mbështetjen e familjes. Ai ka vetëm një zotërim – një koleksion të çmuar pullash – të cilin është i gatshëm ta shesë, po të jetë e nevojshme, për të ndihmuar në financimin për misionin e tij.’

Presidenti [Spenser W.] Kimball dëgjoi me vëmendje kur ky deklarim iu lexua atij dhe pastaj u përgjigj: ‘Bëjeni atë që ta shesë koleksionin e tij të pullave. Një sakrificë e tillë do të jetë një bekim për të.’”

Ftojini anëtarët e klasës që të mendojnë se si do të reagonin nëse do t’u kërkohej që të hiqnin dorë nga të gjitha zotërimet e tyre për t’i shërbyer Zotit. Pastaj vazhdoni me ndodhinë:

“Pastaj, me një vezullim në sy dhe një buzëqeshje në fytyrë, ai profet i dashur tha: ‘Çdo muaj në selinë e Kishës ne marrim mijëra letra nga të gjitha anët e botës. Kujdesuni që t’i ruajmë ato pulla dhe t’ia japim Hozesë në përfundim të misionit të tij. Ai do të ketë, pa shpenzim, koleksionin më të shkëlqyer të pullave

nga cilido i ri në Meksikë'' (në Conference Report, tetor 1978, f. 83; ose *Ensign*, nëntor 1978, f. 56).

Shpjegoni se kur i vendosim gjërat e Perëndisë të parat në jetën tonë, shpërblimet që marrim janë shumë më të mëdha se çfarëdo gjëje që mund të na duhet ta sakrifikojmë përgjatë udhës. Ky mësim tregon për dy njerëz – Elijan dhe të venë në Sarepta – që morën bekime të mëdha sepse qenë të gatshëm të ndiqnin Perëndinë edhe kur ishte e vështirë që ta bënë këtë.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Pasi Jeroboami e udhëhoqi mbretërinë e Izraelit në idhujtari, ai dhe pasardhësit e tij u shkatërruan. Ata u pasuan nga një varg tjetër mbretërisht idhujtarë. Nga këta sundimtarë, Ashabi që mbreti që "provokoi zemërimin e Zotit, Perëndisë të Izraelit, më tepër se gjithë etërit e Izraelit që e kishin paraprirë" (1 Mbretërve 16:33). Ai u martua me Jezebelën, përvetësoi praktikën e saj të adhurimit të Baalit dhe e nxiti popullin e tij që të bashkohej me të në adhurimin e kësaj perëndie të rreme. Profeti Elija i dërgoi fjalë paralajmërimi Ashabit dhe mbretërisë së tij.

### 1. Elija vulos qiejt, ushqehet mrekullisht dhe ngre nga vdekja të birin e një të veje.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 17.

- Për shkak të ligësisë së Ashabit dhe popullit të tij, Elija shpalli: "Nuk do të ketë as vesë as shi gjatë këtyre viteve, *veçse me fjalën time*" (1 Mbretërve 17:1; kursivi i shtuar). Përse Elija që në gjendje të bënte një deklaram të tillë? (Ju mund të dëshironi të krahasoni Elijan me Nefin, birin e Helamanit, të cilit iu dha një fuqi e ngjashme. Arsyet e Zotit pse lejoi që të bëheshin të gjitha këto gjëra sipas fjalëve të Nefit gjenden te Helamani 10:4–5.)
- Pasi Elija deklaroi se nuk do të binte shi në mbretëri, Zoti e urdhëroi atë të largohej. Si iu përgjigj Elija urdhrit të Zotit? (Shih 1 Mbretërve 17:2–5.) Çfarë mund të mësojmë nga përgjigjja e Elijas?

Plaku Gordon B. Hinkli tha:

"Unë marr forcë nga një deklaram i thjeshtë i bërë në lidhje me Profetin Elija, që paralajmëroi mbretin Ashab për thatësinë dhe zinë e bukës që do të vinin mbi tokë. Por Ashabi u tall. Por Zoti i tha Elijas të shkonte e të fshihej pranë përroit Kerith, se atje ai duhej të pinte nga përroi dhe do të ushqehet nga korbat. Dhe shkrimi i shenjtë regjistron një deklaram të thjeshtë e të mrekullueshëm: 'Kështu ai u nis dhe veproi sipas fjalës të Zotit'. (1 Mbretërve 17:5.)

Nuk pati debatim. Nuk pati shfaqësime. Nuk pati gënjeshtër. Elija thjesht 'u nis dhe veproi sipas fjalës të Zotit'. Dhe u shpëtua nga katastrofat e tmerrshme që u ndodhën atyre që u tallën, debatuan dhe vunë në dyshim" (në Conference Report, tetor 1971, f. 159; ose *Ensign*, dhjetor 1971, f. 123–124).

- Si mbijetoi Elija në shkretëtirë pasi filloi thatësira? (Shih 1 Mbretërve 17:4, 6.) Çfarë përvojash keni pasur ju kur Zoti ju ka mbështetur fizikisht ose shpirtërisht?
- Cilën kishte përgatitur Zoti që ta ndihmonte Elijan pasi u tha përroi në shkretëtirë? (Shih 1 Mbretërve 17:7–13.) Çfarë mund të na mësojë kjo mbi mënyrën se si i ndihmon Zoti njerëzit në nevojë? (Shpjegoni se Zoti shpesh i ndihmon

njerëzit në nevojë nëpërmjet shërbimit të njerëzve të tjerë.) Si e keni parë Zotin t'i ndihmojë njerëzit në nevojë nëpërmjet shërbimit të njerëzve të tjerë? Çfarë mund të bëjmë që të ndihmojmë të tjerët që janë në nevojë?

Plaku Xhefri R. Holland tha: "Unë e di se secili prej nesh mund të bëjë diçka, pavarësisht se sa i vogël mund të duket të jetë ai veprim. Ne mund të paguajmë një të dhjetë të ndershme dhe të japim ofertat tona të agjërimit e vullnetare. . . . Dhe mund të vëzhgojmë për mënyra të tjera për të ndihmuar. Kauzave të denja dhe njerëzve në nevojë ne mund t'u japim kohë nëse nuk kemi para dhe mund të japim dashuri kur nuk kemi më kohë për të dhënë. Mund të ndajmë ushqimin që kemi dhe të mirëbesojmë te Perëndia se qypi i vajit nuk do të pakësohet" (në Conference Report, prill 1996, f. 41; ose *Ensign*, maj 1996, f. 31).

- Si iu përgjigj e veja kërkesës së Elijas për pak ujë për të pirë? (Shih 1 Mbretërve 17:10–11. Ajo shkoi pa ngurrim.) Çfarë tha e veja kur Elija i kërkoi asaj ushqim? (Shih 1 Mbretërve 17:11–12.) Çfarë i premtoi asaj Elija? (Shih 1 Mbretërve 17:13–14.) Çfarë bëri atëherë e veja? (Shih 1 Mbretërve 17:15.) Çfarë mund të mësojmë nga përgjigja e së vesë?

Plaku Holland tha se përgjigja e së vesë kur Elija i kërkoi ushqim asaj, ishte një "shprehje besimi – aq e madhe, në ato rrethana, sa cilado që unë di në shkrimet e shenjta. . . . Ndoshta e pasigurt se cila do të ishte kostoja e besimit të saj . . . , ajo së pari ia çoi kulaçin e vogël Elijas, duke mirëbesuar me sa duket që, nëse nuk do të mbetej bukë mjaftueshëm, të paktën ajo dhe biri i saj do të kishin vdekur në një veprim dashurie të pastër hyjnore" (në Conference Report, prill 1996, f. 39; ose *Ensign*, maj 1996, f. 29).

- Si mendoni ju, përse Perëndia e urdhëroi të venë që ta ushqente Elijan kur ajo kishte kaq pak? Çfarë bekimi mori e veja për bindjen e saj? (Shih 1 Mbretërve 17:16.) Cilat janë disa gjëra që Perëndia i kërkon prej nesh, të cilat mund të jenë të vështira? Në çfarë mënyrash bekohemi kur e vendosim Perëndinë të parin, duke bërë atë që Ai kërkon edhe kur është e vështirë?

Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim:

"Kur ne e vendosim Perëndinë të parin, gjithë gjërat e tjera shkojnë në vendin e duhur ose largohen nga jeta jonë. Dashuria jonë për Zotin do të qeverisë atë çfarë na pëlqen ose e duam, atë kujt ia kushtojmë kohën tonë, gjërat që zgjedhim të bëjmë dhe rendin e përparësive tona. . . .

Perëndia na bekoftë që ta vendosim [Atë] të parin dhe, si rezultat, të korrim paqe në këtë jetë dhe jetë të përjetshme me një plotësi të gëzimit në jetën që do të vijë" (në Conference Report, prill 1988, f. 3, 6; ose *Ensign*, maj 1988, f. 4, 6).

- Çfarë bëri Elija kur i biri i së vesë u sëmur dhe vdiq? (Shih 1 Mbretërve 17:17–22.) Me cilën fuqi Elija që në gjendje që ta sillte sërish në jetë të birin e së vesë? Si është bekuar jeta juaj nëpërmjet fuqisë së priftërisë?

## 2. Elija sfidon priftërinjtë e Baalit dhe i hap qiejt për shi.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 18.

- Në vitin e tretë të zisë së bukës, Zoti e urdhëroi Elijan: "Shko dhe paraqitu te Ashabi dhe unë do të dërgoj shiun mbi vendin" (1 Mbretërve 18:1). Si reagoi Ashabi kur pa Elijan? (Shih 1 Mbretërve 18:17. Vini në dukje se Ashabi ia vuri fajin Elijas për zinë e bukës.) Cili ishte shkaku i vërtetë i zisë së bukës? (Shih 1 Mbretërve 18:18.)

- Ashtu si kërkoi Elija, Ashabi mblodhi gjithë Izraelin dhe 850 priftërinj të rremë në malin Karmel (1 Mbretërve 18:19–20). Kur njerëzit u mblodhën që ta dëgjonin Elijan të fliste, ai i pyeti: “Deri kur do të lëkundeni midis dy mendimeve?” (1 Mbretërve 18:21). Si mendoni ju, çfarë do të thotë të lëkundeni midis dy mendimeve? Në ç’mënyrë ne nganjëherë lëkundemi midis dy mendimeve? (Shih Mateu 6:24. Vini në dukje se fjala *mamonit* i referohet tipareve si të botës.)

Plaku Nil A. Maksuell tha: “Fjalët energjike të profetëve të ndryshëm . . . na nxisin të zgjedhim, të vendosim e të mos lëkundemi. . . . Mesazhi i Elijas ka shumë kuptim për ne sot, sepse të gjithë së fundi duhet të zgjedhim midis perëndive të kësaj bote dhe Perëndisë së përjetësisë” (*That My Family Should Partake* [1974], f. 22).

Vëreni anëtarin e caktuar të klasës që të japë një raport të shkurtër mbi ballafaqimin e Elijas me priftërinjtë e Baalit (1 Mbretërve 18:17–40).

- Cili ishte qëllimi i Elijas kur i sfidoi priftërinjtë e Baalit? (Shih 1 Mbretërve 18:36–37.) Si reagues ndaj paraqitjes së fuqisë prej Zotit? (Shih 1 Mbretërve 18:38–39.) Si u bekuan ata sepse e njohën Zotin dhe fuqinë e Tij? (Shih 1 Mbretërve 18:45.) Si mund ta njohim më plotësisht Zotin dhe fuqinë e Tij? (Shih 1 Thesalonikasve 5:16–18; Alma 34:38; Moroni 7:33–39.)

### 3. Elija ngushëllohet nga Fryma e Shenjtë dhe udhëzohet që të vazhdojë në punën e Perëndisë.

Jepni mësim dhe diskutoni për 1 Mbretërve 19.

E inatosur nga fitorja e Elijas mbi priftërinjtë e Baalit, Jezebela u përpoq ta vriste atë. Elija iku në shkretëtirë dhe i thirri Zotit duke thënë: “Tani mjaft, o Zot! Merr jetën time” (1 Mbretërve 19:4). Zoti e bekoji Elijan duke dërguar një engjell me ushqim dhe ujë. Ju mund të dëshironi të vini në dukje se edhe profetët mund të përjetojnë dëshpërim dhe nevojë për ngushëllim e udhëheqje, që vetëm Perëndia mund ta sigurojë.

- Përse Elija qe i shkurajuar? (Shih 1 Mbretërve 19:10, 14. Megjithë reagimin e njerëzve ndaj paraqitjes mbresëlënëse të fuqisë prej Perëndisë, Elija ndiente se ai ishte i vetmi izraelit që kishte mbetur, i cili adhuronte Perëndinë e vërtetë.) Çfarë bëri ai që të fitonte paqe? (Shih 1 Mbretërve 19:4, 8. Ai u lut dhe agjëroi.) Çfarë mund të mësojmë nga përvoja e Elijas që të na ndihmojë nëse ndihemi të shkurajuar, të brengosur ose të dëshpëruar?
- Si e ngushëlloi Perëndia Elijan në malin Horeb? (Shih 1 Mbretërve 19:9–13.) Çfarë mund të mësojmë nga kjo mbi mënyrën se si Perëndia komunikon me ne? Si mendoni ju, përse Perëndia komunikon më shpesh nëpërmjet “zërit si një shushuritje e ëmbël” të Frymës së Shenjtë sesa nëpërmjet paraqitjeve mbresëlënëse dhe të zhurmshme të fuqisë? Si mund t’i dallojmë pëshpëritjet e Frymës së Shenjtë?

Kur një korrespondent lajmesh e pyeti Presidentin Hinkli se si komunikonte ai me Perëndinë, profeti iu përgjigj: “Mendoj se mënyra më e mirë se si mund ta përshkruaj procesin është ta krahasoj atë me përvojën e Elijas siç përshkruhet te libri i Parë i Mbretërve. Elija i foli Zotit dhe pati një erë, një erë të furishme, dhe Zoti nuk qe në erë. Dhe pati një tërmet, dhe Zoti nuk qe në tërmet. Dhe pati një zjarr, dhe Zoti nuk qe në zjarr. Dhe pas zjarrit, një zë si një shushuritje e ëmbël, që unë e përshkruaj si pëshpëritjet e Shpirtit” (në Conference Report, tetor 1996, f. 71; ose *Ensign*, nëntor 1996, f. 51).

Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim: “A kaloni kohë duke dëgjuar nxitjet e Shpirtit? Përgjigjet ndaj lutjes më shpesh vijnë me anë të një zëri të qetë dhe dallohen nga *ndjenjat* tona më të thella e më intime. Unë ju them se ju mund ta dini vullnetin e Perëndisë në lidhje me juve vetë nëse do të shpenzoni kohë për t’u lutur e për të dëgjuar” (në Conference Report, tetor 1977, f. 46; ose *Ensign*, nëntor 1977, f. 32).

- Përveç të qenit Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë është gjithashtu një mësues (Gjoni 14:26; 2 Nefi 32:5). Çfarë e udhëzoi Zoti që të bënte Elijan – nëpërmjet Frymës së Shenjtë? (Shih 1 Mbretërve 19:15–16.) Në ç’mënyrë shërbimi ndaj Zotit na ndihmon kur jemi të shkurajuar?
- Një mënyrë se si Zoti e ngushëlloi Elijan që duke i thënë atij se kishte ende shumë izraelitë që nuk kishin përvetësuar adhurimin e Baalit (1 Mbretërve 19:18). Në ç’mënyrë na ngushëllon shoqëria me shenjtorë të tjerë besnikë të ditëve të mëvonshme? Çfarë ndikimesh keni përreth që ju ndihmojnë të dini se ju nuk jeni vetëm? Çfarë mund të bëni për t’i ndihmuar të tjerët kur ata ndihen vetëm?

Përfundim

Dëshmoni se ne do të ngushëllohemi e do të udhëzohemi kur e vendosim Perëndinë të parin dhe ua vëmë veshin pëshpëritjeve të Frymës së Shenjtë.

**Ide Mësimdhënieje Shtesë**

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi ta përdorni atë si pjesë të mësimin.

### Shpirti i Elijas

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme flasin shpesh për Shpirtin e Elijas. Kjo frazë i referohet punës që bëjmë “për t’i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit” (DeB 110:15). Kjo punë përfshin kërkimin për historinë familjare dhe punën në tempull për të gjallët dhe për të vdekurit. Ne e quajmë atë Shpirtin e Elijas sepse Elija ia rivendosi Jozef Smithit çelësat e fuqisë vulosëse të priftërisë (DeB 110:13–16). Nëpërmjet kësaj fuqie, ordinancat vulosëse mund të kryhen dhe të bashkojnë familjet për përjetësinë.

Jozef Smithi tha:

“Shpirti, fuqia dhe thirrja e Elijas është që ju keni fuqi të mbani çelësin e zbulësive, ordinancave, orakujve, fuqive dhe indaumenteve të plotësisë së Priftërisë Melkizedeke dhe të mbretërisë së Perëndisë në tokë; dhe për të marrë, siguruar dhe kryer të gjitha ordinancat që i përkasin mbretërisë së Perëndisë, madje në kthimin e zemrave të etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit, madje atyre që janë në qiell. . . .

Dëshiroj që ju ta kuptoni këtë çështje, sepse është e rëndësishme; dhe nëse ju do ta merrni atë, ky është shpirti i Elijas, që ne shëlbejmë të vdekurit tanë, dhe lidhemi me etërit tanë që janë në qiell, dhe vulosim të vdekurit tanë që të vijnë në ringjalljen e parë; dhe këtu ne na duhet fuqia e Elijas për të vulosur ata që banojnë në tokë me ata që banojnë në qiell. Kjo është fuqia e Elijas dhe çelësat e mbretërisë së Jehovahit” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith, [2009], f. 331–332*).



2 Mbretërve 2; 5–6

<p><b>Qëllimi</b></p>	<p>Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë se si autoriteti (manteli) kalon nga një profet te tjetri, t’i nxisë ata t’u binden fjalëve të profetëve dhe t’i sigurojë ata se fuqia e Perëndisë është më e madhe se çfarëdolloj fuqie tjetër.</p>
<p><b>Përgatitja</b></p>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. 2 Mbretërve 2:1–18. Elija e përgatit Eliseun që të bëhet profeti i ri (2:1–10). Elija merret në qiell. Eliseu merr mantelin e Elijas dhe bëhet profet (2:11–15). Pesëdhjetë burra e kërkojnë Elijan për tre ditë me gjithë këshillën e Eliseut se nuk duhet ta bënë këtë (2:16–18).</li> <li>b. 2 Mbretërve 5. Eliseu shëron Naamanin nga lebra (5:1–14). Naamani lavdëron Perëndinë dhe i ofron një shpërblim Eliseut, të cilin Eliseu nuk e pranon (5:15–19).</li> <li>c. 2 Mbretërve 6:8–18. Eliseu e udhëzon mbretin e Izraelit në luftën me Sirinë (6:8–10). Mbreti i Sirisë i urdhëron njerëzit e tij që të kapin Eliseun dhe ushtria rrethon qytetin e Dothanit (6:11–14). I patrembur, Eliseu lutet dhe Zoti zbulon një mal plot me kuaj dhe me qerre të zjarra, pastaj godet ushtrinë siriane me verbëri (6:15–18).</li> </ul> <p>2. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni një copë pëlhere që ta përdorni si mantel.</p>
<p><b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b></p> <p>Aktivitet Vëmendjeje</p>	<p>Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.</p> <p>Hidhni një copë pëlhere rreth supeve tuaja (ose rreth supeve të një anëtari të klasës). Shpjegoni se profeti Elija mbante një mantel. Ne nuk e dimë saktësisht pamjen e mantelit, por duket se ishte një pelerinë e bërë me pëlhurë. Kalimi i mantelit nga Elija tek Eliseu simbolizoi kalimin e autoritetit profetik tek Eliseu.</p> <p>Në kohët moderne, ne nganjëherë flasim për “mantelin” e autoritetit që merr profeti kur ai shugurohet dhe veçohet. Edhe pse profeti sot nuk mban një pelerinë ose një copë pëlhere, Perëndia i jep atij çelësat e priftërisë. Këta çelësa i japin atij fuqinë që të veprojnë në emrin e Perëndisë si udhëheqësi i Kishës në tokë. Kur një profet vdes, ky mantel i autoritetit i jepet profetit të ri.</p>
<p><b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b></p>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p>
	<p><b>1. Eliseu pason Elijan si profet.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Mbretërve 2:1–18.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë marrëdhënieje ekzistonte mes Elijas dhe Eliseut? (Shih 2 Mbretërve 2:2–10.) Si mendoni ju, përse Eliseu qe kaq i vendosur që të qëndronte me Elijan? Çfarë bëri Eliseu pasi Elija u mor në qiell? (Shih 2 Mbretërve 2:11–13. Nëse</li> </ul>

nuk e përdorët aktivitetin e vëmendjes, referojuni atij për të shpjeguar se çfarë ishte manteli i Elijas dhe çfarë përfaqësonte ai.)

- Cili e ka mantelin e profetit sot? (Presidenti i tanishëm i Kishës.) Si transferohet ky mantel kur profeti vdes?

Presidenti Jozef Filding Smith shpjegoi:

“Nuk ka mister mbi zgjedhjen e pasuesit të Presidentit të Kishës. Zoti e vendosi këtë shumë kohë më parë dhe *apostulli më i vjetër bëhet automatikisht udhëheqësi kryesues i Kishës*, dhe ai mbështetet kështu nga Këshilli i Të Dymbëdhjetëve që bëhet organi kryesues i Kishës kur nuk ka Presidencë të Parë. Presidenti *nuk zgjidhet*, por ai duhet të mbështetet si nga vëllezërit e tij të Këshillit ashtu edhe nga anëtarët e Kishës” (*Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. [1954–1956], 3:156).

Presidenti Gordon B. Hinkli shpjegoi se si u ndoq kjo procedurë kur ai u shugurua dhe u veçua si profeti dhe Presidenti i Kishës pas vdekjes së Presidentit Hauard W. Hanter:

“Pasi ndërroi jetë Presidenti Hanter, Presidenca e Parë u shpërnda. Vëllai Monson dhe unë, që kishim shërbyer si këshilltarët e tij, zumë vendet tona në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, që u bë autoriteti kryesues i Kishës.

[Disa ditë më vonë] të gjithë Apostujt e shuguruar e të gjallë u mblodhën në një shpirt agjërimit e lutjeje në dhomën e sipërme të tempullit. Atje ne kënduam një himn të shenjtë dhe u lutëm së bashku. Ne morëm sakramentin e darkës së Zotit, duke përtërirë në atë testament të shenjtë e simbolik, besëlidhjet tona dhe marrëdhënien tonë me Atë që është Shëlbuesi ynë hyjnor. Presidenca pastaj u riorganizua, duke ndjekur një model të krijuar mirë nëpër brezat e së shkuarës [ky model shpjegohet në deklarinimin paraprirës nga Presidenti Jozef Filding Smith]. Nuk pati fushatë, diskutim, ambicje për detyrën. Ishte e qetë, me paqe, e thjeshtë dhe e shenjtë. U krye sipas modelit që Vetë Zoti e kishte vendosur” (në Conference Report, prill 1995, f. 92; ose *Ensign*, maj 1995, f. 69).

Ju mund të dëshironi të vini në dukje se ashtu si bëri në lashtësi, Shpëtimtari i ka dhënë çelësat e priftërisë secilit prej Apostujve të ditëve të mëvonshme. Megjithatë, vetëm Presidenti i Kishës, që është Apostulli më i vjetër i gjallë, mund t’i përdorë këta çelësa (ose të autorizojë të tjerë që t’i përdorin ata) në emër të të gjithë Kishës (shih DeB 132:7).

- Si reagues njerëzit kur e panë Eliseun të përsëriste mrekullinë që bëri Elija duke ndarë ujërat e Jordanit? (Shih 2 Mbretërve 2:14–15.) Përse është e rëndësishme që ne menjëherë ta pranojmë e ta mbështesim Presidentin e saposhuguruar të Kishës? (Shih DeB 43:2–3, 7.)
- Menjëherë pasi Elija ishte marrë në qiell, njerëzit donin të dërgonin 50 burra të fuqishëm që ta kërkonin atë. Çfarë u tha Eliseu njerëzve? (Shih 2 Mbretërve 2:16.) Si reagues njerëzit ndaj përgjigjes së Eliseut? (Shih 2 Mbretërve 2:17. Ata iu lutën fort Eliseut derisa ai lejoi që burrat të shkonin.)
- Çfarë u tha Eliseu njerëzve kur 50 burrat u kthyen pa e gjetur Elijan? (Shih 2 Mbretërve 2:18.) Çfarë mund të mësojmë ne nga përvoja e 50 burrave? (Ne duhet ta ndjekim këshillën e profetit që herën e parë që e dëgjojmë atë.) Përse ne nganjëherë presim që profetët ta përsërisin këshillën përpara se ta ndjekim atë? Çfarë këshille na kanë dhënë udhëheqësit e Kishës në vitet e fundit? Si jeni bekuar ju kur e keni ndjekur këtë këshillë?

## 2. Eliseu shëron Naamanin nga lebra.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Mbretërve 5.

- Cili ishte Naamani dhe cila ishte vuajtja e tij? (Shih 2 Mbretërve 5:1.) Përse shkoi ai tek Eliseu? (Shih 2 Mbretërve 5:2–9.) Çfarë i tha lajmëtari i Eliseut Naamanit që të bënte për t’u shëruar? (Shih 2 Mbretërve 5:10.) Përse në fillim Naamani refuzoi t’i ndiqte udhëzimet e Eliseut? (Shih 2 Mbretërve 5:11–12.)
- Në ç’mënyrë e bindën Naamanin shërbëtorët e tij që të bënte atë që Eliseu i kishte thënë atij që të bënte? (Shih 2 Mbretërve 5:13.) Çfarë ndodhi pasi Naamani u zhyt shtatë herë në lumin Jordan? (Shih 2 Mbretërve 5:14.)
- Çfarë mund të na mësojë historia e Naamanit mbi ndjekjen e këshillës së profetit – edhe kur ne mund të mos ta pëlqejmë ose ta kuptojmë atë, ose kur mund të jetë për çështje të vogla e të thjeshta? Cilat janë disa gjëra të vogla e të thjeshta që na është kërkuar t’i bëjmë nga profeti ose udhëheqës të tjerë të Kishës? Përse këto gjëra nganjëherë është e vështirë që të bëhen? Si mund ta rrisim gatishmërinë tonë që të ndjekim këshillën e udhëheqësve të Kishës?

Plaku Reks D. Pajnëgar pyeti: “A nuk jemi ne nganjëherë si Naamani, duke kërkuar për të bërë gjëra të mëdha ose të rëndësishme dhe duke anashkuar gjëra të thjeshta që do të mund të na ndryshonin jetën ose të na shëronin nga vuajtjet tona?” (në Conference Report, tetor 1994, f. 106; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 80).

Pasi rrefeu historinë e Naamanit, Plaku Gordon B. Hinkli tha: “Udha e ungjillit është një udhë e thjeshtë. Disa nga kërkesat mund t’ju duken kaq elementare dhe të panevojshme. Mos i refuzoni ato. Përluni dhe ecni në bindje. Unë premtoj se rezultatet që do të vijojnë, do të jenë të mrekullueshme për t’u parë dhe të kënaqshme për t’i provuar” (në Conference Report, tetor 1976, f. 143; ose *Ensign*, nëntor 1976, f. 96).

- Çfarë mësoi Naamani nga shërimi i tij? (Shih 2 Mbretërve 5:15.) Në ç’mënyrë bindja në gjëra të vogla e ka forcuar dëshminë tuaj?
- Çfarë u përpoq t’i jepte Naamani Eliseut pasi u shërua? (Shih 2 Mbretërve 5:15.) Si mendoni ju, përse Eliseu e refuzoi ofertën e Naamanit? Përse është e rëndësishme që të shërbejmë pa interesim për shpërblime tokësore?

## 3. Eliseu udhëzon Izraelin në luftë me Sirinë.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Mbretërve 6:8–18.

- Në ç’mënyrë Eliseu e ndihmoi mbretin e Izraelit në luftë kundër Sirisë? (Shih 2 Mbretërve 6:8–10.) Çfarë bëri mbreti i Sirisë kur mësoi atë që po bënte Eliseu? (Shih 2 Mbretërve 6:11–14.)
- Si u përgjigj shërbëtori i Eliseut kur pa kuajt dhe qerret e sirianëve që po rrethonin qytetin? (Shih 2 Mbretërve 6:15.) Si u përgjigj Eliseu? (Shih 2 Mbretërve 6:16.) Çfarë kishte parasysh Eliseu kur i tha shërbëtorit të tij: “Ata që janë me ne, janë më të shumtë se ata që janë me ta”? (2 Mbretërve 6:16). Si e keni parë se deklarimi i Eliseut është ende i vërtetë sot?
- Çfarë rrethanash të kohëve moderne mund t’i çojnë disa nga ne të besojnë se jemi të pafuqishëm kundrejt të ligave të botës? Në ç’mënyrë mirëbesimi që “ata që janë me ne, janë më të shumtë se ata që janë me ta” mund të na ndihmojë ndërsa luftojmë kundër këtyre të ligave?

Plaku Dallin H. Ouks tha: “Kur e lexoja këtë histori të mrekullueshme si djalosh, gjithmonë e identifikoja veten me shërbëtorin e ri të Eliseut. Mendoja: ‘Nëse do të jem ndonjëherë i rrethuar nga forcat e së ligës ndërsa jam në shërbim të Zotit, shpresoj që Zoti do të m’i hapë sytë e do të më japë besim të kuptoj se, kur jemi në punën e Zotit, ata që janë me ne janë gjithmonë më të fuqishëm se ata që na kundërshtojnë’” (në Conference Report, tetor 1992, f. 54; ose *Ensign*, nëntor 1992, f. 39).

- Në ç’mënyrë mirëbesimi se “ata që janë me ne, janë më të shumtë se ata që janë me ta” mund të na ndihmojë që t’ua çojmë ungjillin të gjithë njerëzve? (Shih DeB 84:87–88.)

Presidenti Gordon B. Hinkli tha: “Ne ende nuk ia kemi çuar ungjillin çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli. Por kemi bërë hapa të mëdhenj. Ne kemi shkuar kudo që na lejohet të shkojmë. Perëndia është në timon dhe dyert do të hapen me anë të fuqisë së Tij në përputhje me vullnetin e Tij hyjnor. Për këtë unë kam besim. Për këtë unë jam i sigurt” (në Conference Report, tetor 1995, f. 93; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 70–71).

- Cila ishte lutja e Eliseut në emër të shërbëtorit të tij? (Shih 2 Mbretërve 6:17.) Përse fillimisht shërbëtori nuk e pa malin plot me kuaj dhe qerre të zjarrta që kishte dërguar Perëndia? Çfarë mund të bëjmë që t’i hapim sytë më plotësisht ndaj fuqisë së Perëndisë në vetë jetën tonë dhe në botë?

## Përfundim

Dëshmoni se Presidenti i Kishës është një profet i Perëndisë. Nxitini anëtarët e klasës që t’i mbështesin udhëheqësit e rinj të Kishës dhe që të ndjekin këshillën e profetëve. Dëshmoni se fuqia e Perëndisë është më e madhe se çfarëdolloj fuqie tjetër.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Mrekullitë e Eliseut

Eliseu kreu shumë mrekulli të mëdha, duke treguar dhembshuri për njerëzit dhe duke dhënë prova të mëtejshme se ai qe pasuesi i autorizuar i Elijas. Ai i ndau ujërat e Jordanit, i bëri të mbara ujërat e Jerikos, shumoi vajin e një të veje, ngriti një djalë nga vdekja, shëroi njerëzit që ishin helmuar, ushqeui të uriturit, shëroi lebrën e Naamanit, bëri të pluskojë një sëpatë dhe udhëzoi mbretërit në luftë. Ju mund të dëshironi t’i këqyrni disa prej këtyre mrekullive nga 2 Mbretërve 2–6.

- A mendoni se mrekullitë ndodhin në kohën tonë në të njëjtën shtrirje siç ndodhën në kohën e Eliseut? Cilat janë rreziqet e kërkimit vetëm të mrekullive mbresëlënëse? Çfarë mrekullish, të vogla në dukje, ndodhin në jetën tonë?

### 2. Një vajzë e vogël izraelite i tregon Naamanit për Eliseun

- Si mësoi Naamani për Eliseun dhe fuqitë e tij shëruese? (Shih 2 Mbretërve 5:2–4. Një vajzë e vogël izraelite, të cilën sirianët e kishin kapur robinjë, i tregoi bashkëshortes së Naamanit se kishte një profet në Izrael që mund ta shëronte Naamanin.) Në ç’mënyrë kjo vajzë e vogël izraelite është një shembull për ne? (Pavarësisht nga mosha, rrethanat, ose thirrja jonë në Kishë, ne mund të bëjmë shumë të mira duke i drejtuar njerëzit te profetët – dhe te Zoti.)

2 Kronikave 29–30; 32; 34

---

**Qëllimi** Të frymëzojë çdo anëtar të klasës që të marrë bekimet e premtuara që vijnë nga puna në tempull dhe studimi i shkrimit të shenjtë.

---

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. 2 Kronikave 29–30. Ezekia, mbreti i Judës, hap dyert e tempullit dhe udhëzon priftërinjtë e levitët që ta pastrojnë e ta shenjtërojnë atë për adhurim (29:1–19). Kur tempulli pastrohet, Ezekia dhe populli i tij adhurojnë e lavdërojnë Zotin (29:20–36). Ezekia e fton të gjithë Izraelin që të vijë te shtëpia e Zotit në Jerusalem (30:1–9). Disa qeshën e u tallën me ftesën, por besnikët e Izraelit e adhuruan Zotin në Jerusalem (30:10–27).
  - b. 2 Kronikave 32:1–23. Senasheribi, mbreti i Asirisë, hyn në Judë dhe flet me fyerje kundër Zotit (32:1–19). Isaia dhe Ezekia luten për ndihmë dhe një engjëll i Zotit shkatërron shumicën e ushtrisë asirase (32:20–23).
  - c. 2 Kronikave 34. Pasi biri dhe nipi i Ezekias sundojnë në ligësi, stërnipi i Ezekias, Josia, bëhet mbret i Judës. Josia shkatërron idhujt në mbretëri dhe riparoi tempullin (34:1–13). Libri i ligjit gjendet në tempull dhe i lexohet Josias, i cili qan kur mëson sa shumë ishte larguar populli nga ligji (34:14–21). Profeteshë Huldah tregon për shkretimin e ardhshëm të Judës, por profetizon se Josias nuk do t’i duhet ta dëshmojë atë (34:22–28). Josia dhe populli i tij besëlidhin që t’i shërbejnë Zotit (34:29–33).
2. Lexim shtesë: 2 Kronikave 31; 33; 2 Mbretërve 18–19; 22–23; Isaia 37:10–20, 33–38.
3. Nëse figurat vijuese janë të disponueshme, ju mund të dëshironi t’i përdorni ato gjatë mësimi: Tempull i Përdorur në Lashtësi (62300) dhe një figurë e një tempulli të ditëve të mëvonshme.

---

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje** Shpjegoni se për të ndihmuar që të mbrohej Jerusalemi nga sulmet e asirëve, mbreti Ezekia devijoi ujin e burimit të Gihonit për te pellgu i Siloamit, brenda mureve të qytetit (2 Kronikave 32:2–4, 30). Kjo u bë duke gërmuar një kanal (tunel) për ujin përmes rreth 540 metrave në shkëmb gëlqeror. Ezekia pastaj urdhëroi që të mbuloheshin burimet jashtë qytetit që asirasit të mos gjenin ujë lehtësisht. Pa këtë ujë brenda mureve të qytetit, populli i Jerusalemit nuk do t’i kishte mbijetuar rrethimit të asirasve.

Vini në dukje që ashtu si uji nga burimi i Gihonit ishte jetik për mbijetesën fizike të popullit të Ezekias gjatë betejave të tyre me asirët, uji i gjallë është thelbësor për mbijetesën tonë shpirtërore gjatë betejave tona me Satanin.

- Çfarë është uji i gjallë? (Shih Gjoni 4:10–14.)

Plaku Brus R. Mek-Konki shpjegoi se uji i gjallë është “fjalët e jetës së përjetshme, mesazhi i shpëtimit, të vërtetat mbi Perëndinë dhe mbretërinë e Tij; është doktrinat e ungjillit” (*Doctrinal New Testament Commentary*, 3 vëll. [1966–1973], 1:151).

- Si mund të hapim një kanal ndaj Zotit që uji i gjallë të mund të rrjedhë në jetën tonë?

Shpjegoni se një mënyrë se si të marrim ujë të gjallë është që të shkojmë te tempulli, shtëpia e Zotit, ku mund të na jepet fuqi dhe kuptueshmëri, të udhëzohemi nga Zoti dhe të ndiejmë paqe e gëzim.

Vini në dukje se adhurimi në tempull ishte një mbrojtje e rëndësishme për izraelitët në kohën e Ezekias dhe ai mund të jetë gjithashtu një mbrojtje e rëndësishme për ne sot.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Ezekia urdhëron që shtëpia e Zotit të pastrohet.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Kronikave 29–30.

- Babai i Ezekias, Ashazi, qe një mbret i lig, që e kishte çshenjtëruar tempullin e Zotit dhe kishte “mbyll[ur] portat e [tij]” (2 Kronikave 28:24). Kur Ezekia u bë mbret i Judës (Mbretëria Jugore) në vitin 715 PR. K., një nga gjërat e para që bëri ai, ishte të hapte dyert e tempullit dhe të urdhëronte priftërinjtë e levitët që ta pastrojnë e ta shenjtëronin atë (2 Kronikave 29:3–5). Përse, sipas Ezekias, tempulli kishte nevojë të shenjtërohej? (Shih 2 Kronikave 29:6–7.) Në çfarë mënyrash mund të jemi edhe ne fajtorë për “heq[jen e] fytyra[ve tona] nga banesa e Zotit”? Çfarë u ndodhi njerëzve të Judës për shkak të shpërfilljes së tyre ndaj tempullit? (Shih 2 Kronikave 29:8–9.)
- Çfarë shpresonte të arrinte Ezekia duke e pastruar tempullin dhe duke e përgatitur atë përsëri për adhurim? (Shih 2 Kronikave 29:10.) Përse është e rëndësishme që t’i mbajmë gjërat e papastra jashtë tempullit? (Shih DeB 97:15–17.) Cila është përgjegjësia jonë që të sigurohemi që asnjë gjë e papastër të mos hyjë në tempull? (Shih DeB 109:20–21. Ne duhet të sigurohemi që të jemi të pastër kur të shkojmë në tempull.)
- Çfarë bënë Ezekia dhe populli i Jerusalemit kur tempulli u pastrua? (Shih 2 Kronikave 29:20–21, 29–31, 36.) Cilin ftoi Ezekia që të vinte në shtëpinë e Zotit për festimin e Pashkës? (Shih 2 Kronikave 30:1, 6.) Si u prit kjo ftesë? (Shih 2 Kronikave 30:10–11.)
- Çfarë bekimi nuk pranoi populli i Izraelit duke refuzuar që të shkonte në tempull? (Shih 2 Kronikave 30:6–9. Shpjegoni se në kohën e mbretërimit të Ezekias, shumica e mbretërisë së Izraelit [Mbretëria Veriore] ishte zënë rob nga asirët. Ezekia u premtoi izraelitëve të mbetur që, nëse ata do të “kthehe[shin] te Zoti”, robërit do të liroheshin. Në vend të kësaj, shumica e njerëzve të Izraelit nuk e pranuan ftesën e Ezekias. Për shkak të ligësisë së njerëzve, pjesa e mbetur e mbretërisë së Izraelit u robërua disa vite më vonë [2 Mbretërve 18:10–12]. Izraelitët e robëruar u bënë dhjetë fiset e humbura.)



## 2. Asirët pushtojnë mbretërinë e Judës. Isaia dhe Ezekia luten për ndihmë dhe një engjëll i Zotit shkatërron shumicën e ushtrisë asirase.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Kronikave 32:1–23.

- Pasi mbretëria e Izraelit u çua në robëri, asirët filluan të sulmojnë mbretërinë e Judës (2 Kronikave 32:1). Çfarë bëri Ezekia kur pa ushtrinë e Senasheribit që planifikonte të sulmonte Jerusalemin? (Shih 2 Kronikave 32:2–5.) Pasi Ezekia kishte bërë përgatitje për luftë, çfarë i tha ai popullit të tij mbi sulmin e afërt? (Shih 2 Kronikave 32:6–8.) Çfarë mund të mësojmë nga Ezekia mbi marrëdhënien e duhur midis mirëbesimit në vetë përpjekjet tona dhe mirëbesimit te Zoti?
- Senasheribi dërgoi shërbëtorët e tij për t'i folur popullit në Jerusalemin. Çfarë thanë shërbëtorët? (Shih 2 Kronikave 32:9–17.) Përse i thanë ata këto gjëra? (Shih 2 Kronikave 32:18.) Në ç'mënyra Satani përpiqet të na bindë se Perëndia nuk mundet ose nuk do të na ndihmojë ne?
- Si reagan Ezekia dhe profeti Isaia ndaj fjalëve të shërbëtorëve të Senasheribit? (Shih 2 Kronikave 32:20; Isaia 37:14–20.) Si iu përgjigj Zoti lutjeve të Ezekias dhe të Isaias? (Shih 2 Kronikave 32:21–22; Isaia 37:33–38.)
- Ezekia dhe populli i tij morën mbrojtjen e Zotit për shkak të drejtësisë së tyre, që u tregua nga adhurimi i tyre në tempull. Në ç'mënyrë pjesëmarrja në tempull mund të jetë një mbrojtje për ne? (Shih DeB 109:24–28.) Çfarë mund të bëjmë që ta bëjmë denjësinë për në tempull dhe pjesëmarrjen atje një përparësi në jetën tonë?

Presidenti Hauard W. Hanter na nxiti:

“Le të jemi një popull që frekuentojmë tempullin. Frekuentojeni tempullin aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat personale. Mbani një figurë të një tempulli në shtëpi që fëmijët tuaj të mund ta shohin. Mësojuni atyre mbi qëllimet e shtëpisë së Zotit. Bëjini ata të planifikojnë, që nga vitet më të hershme, që të shkojnë atje dhe të mbeten të denjë për atë bekim.

Nëse afërsia tek një tempull nuk e lejon pjesëmarrjen e shpeshtë, merrni të dhëna në historinë e familjes suaj dhe përgatisni emra për ordinancat e shenjta që kryhen vetëm në tempull. Ky kërkim për familjen është thelbësor për punën e tempujve dhe sigurisht që do t'u vijë bekime atyre që e bëjnë atë punë” (në Conference Report, tetor 1994, f. 8; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 8).

## 3. Josia dhe populli i tij besëlidhin që t'i shërbejnë Zotit.

Jepni mësim dhe diskutoni për 2 Kronikave 34.

Ezekia u pasua si mbret nga biri i tij Manasi dhe nipi i tij Amoni (2 Kronikave 33). Manasi e sundoi Judën në ligësi, duke vendosur idhuj në tempull dhe duke e udhëhequr popullin në mëkat. Megjithatë, Manasi së fundi e përuli veten dhe u pendua përpara vdekjes së tij. Biri i Manasit, Amoni, gjithashtu sundoi në ligësi, duke adhuruar idhujt që kishte bërë ati i tij. Amoni nuk u pendua dhe u vra nga vetë shërbëtorët e tij. Biri i Amonit, Josia, u bë mbret i Judës kur ishte tetë vjeç. Ai u bë një mbret i drejtë që flaku mënyrat e liga të të atit dhe gjyshit të tij.

- Çfarë lloj njeriu ishte mbreti Josia? (Shih 2 Kronikave 34:1–2; 2 Mbretërve 23:25. Vini re se Davidi i përmendur te 2 Kronikave 34:2 është mbreti David, që ishte stërgjysh i Josias, jo babai i tij i drejtpërdrejtë.)

- Çfarë gjërash të mira bëri Josia që herët në sundimin e tij si mbret? (Shih 2 Kronikave 34:3–8. Ai kërkoi Perëndinë e vërtetë, shkatërroi idhujtarinë në mbretëri dhe dërgoi njerëzit që të riparonin tempullin. Vini në dukje se Josia ishte vetëm 15 ose 16 vjeç kur filloi të bënte këto ndryshime të rëndësishme.)
- Çfarë zbulimi të rëndësishëm bëri Hilkiahu, prifti i lartë, gjatë rinovimit të tempullit? (Shih 2 Kronikave 34:14. Ai gjeti librin e ligjit të Zotit, ose shkrimet e shenjta. Vini re se në këtë kohë në historinë e Judës, ligji i shkruar dukej se kishte humbur dhe ishte vërtetë i panjohur.) Si reagoi Josia kur libri i ligjit iu lexua atij? (Shih 2 Kronikave 34:19. Vini re se ishte zakon në Izraelin e lashtë që të copëtonin, ose grisnin rrobat për të treguar pikëllim ose hidhërim të madh.) Përse Josia qe kaq i pikëlluar kur dëgjoji atë që përmbante libri i ligjit? (Shih 2 Kronikave 34:21.)

- Çfarë tha profetesa Huldah se do t’i ndodhte Judës sepse populli nuk ia kishte dalë të mbante fjalën e Zotit dhe të bënte atë që dhanë mësim shkrimet e shenjta? (Shih 2 Kronikave 34:22–25.) Çfarë do të na ndodhë ne nëse lëmë pas dore leximin e shkrimeve të shenjta dhe zbatimin e mësimave të tyre?

Presidenti Ezra Taft Benson përshkroi rreziqet e shpërfilljes së njërit prej librave tanë të shkrimit të shenjtë, Librit të Mormonit:

“Në 1829-ën, Zoti i paralajmëroi shenjtorët se ata nuk duhet të luajnë me gjëra të shenjta (shih DeB 6:12). Sigurisht Libri i Mormonit është një gjë e shenjtë dhe përsëri shumë luajnë me të ose, me fjalë të tjera, e marrin lehtë atë, e trajtojnë si të ishte me pak rëndësi.

Në 1832-shin, kur disa misionarë të hershëm u kthyen nga fushat e tyre të punës, Zoti i qortoi ata se po e trajtonin me lehtësi Librin e Mormonit. Si rezultat i atij qëndrimi, tha Ai, mendjet e tyre qenë errësuar. Jo vetëm trajtimi i këtij libri të shenjtë me lehtësi solli një humbje të dritës te vetja e tyre, ai gjithashtu solli gjithë Kishën në ndëshkim, madje të gjithë fëmijët e Sionit. Dhe atëherë Zoti tha: ‘Dhe ata do të mbeten nën këtë dënim derisa të pendohen dhe të kujtojnë besëlidhjen e re, madje Librin e Mormonit’ (DeB 84:54–57). . . .

Nëse shenjtorët e hershëm u qortuan për trajtimin me lehtësi të Librit të Mormonit, a jemi ne nën dënim më të vogël nëse bëjmë të njëjtën gjë?” (në Conference Report, tetor 1986, f. 3–4; ose *Ensign*, nëntor 1986, f. 4–5).

- Çfarë tha Huldahu se do t’i ndodhte Josias? (Shih 2 Kronikave 34:26, 28. Përmbushja e këtij premtimi përshkruhet te 2 Kronikave 35:20–24.) Përse Zoti ia bëri këtë premtim Josias? (Shih 2 Kronikave 34:27.)
- Pasi Josia zbuloi se populli i tij do të dënohej sepse nuk kishte bërë siç udhëzojnë shkrimet e shenjta, ai i thirri të gjithë njerëzit në tempull dhe u lexoi atyre shkrimet e shenjta (2 Kronikave 34:29–30). Si mendoni ju, përse e bëri ai këtë? (Njerëzit nuk mund t’i zbatonin ligjet e Perëndisë nëse nuk i njihnin ato.) Në ç’mënyrë prindërit mund të ndjekin shembullin e Josias dhe t’u mësojnë fëmijëve të tyre ligjet e ungjillit? (Shih DeB 68:25, 28.)
- Si mund ta tregojmë vlerën që u japim shkrimeve të shenjta? Vini në dukje se ne kemi të disponueshme më shumë shkrime të shenjta se sa kishin izraelitët dhe shkrimet e shenjta sigurohen më lehtë prej nesh. Çfarë përgjegjësie kemi ne për shkak të këtyre bekimeve?

Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Zoti nuk po sillet lehtëshëm me ne kur na i jep këto gjëra, pasi ‘kujt iu dha shumë, do t’i kërkohet shumë’. (Lluka 12:48.) Qasja te këto gjëra do të thotë përgjegjësi për to. Ne duhet t’i studiojmë shkrimet e shenjta sipas urdhërimit të Zotit (shih 3 Nefi 23:1–5); dhe ne duhet t’i lëmë ato të na qeverisin jetën” (“How Rare a Possession—the Scriptures!” *Ensign*, shtator 1976, f. 5).

- Ndërsa Josia dhe populli i tij ishin në tempull, ata bënë një besëlidhje me Zotin. Çfarë besëlidhën të bënëin ata? (Shih 2 Kronikave 34:31–33.) Shpjegoni se në tempull ne bëjmë besëlidhje të shenjta me Zotin, përmbushja e të cilave do të na sjellë bekime tokësore dhe ekzaltim të përjetshëm. Si mund të përgatitemi për t’i bërë besëlidhjet e shenjta të tempullit? Pasi t’i kemi bërë këto besëlidhje, përse është e rëndësishme që të kthehemi në tempull sa më shpesh që të jetë e mundur?

#### Përfundim

Shpjegoni se njerëzit në mbretërinë e Judës përfundimisht u bënë kaq të ligj sa që Zoti lejoi që ata të ziheshin robër (2 Kronikave 36:14–21). Megjithatë, gjatë sundimeve të tyre, Ezekia dhe Josia kishin kërkuar t’i forconin njerëzit duke e kthyer vëmendjen e tyre te tempulli dhe shkrimet e shenjta. Dëshmoni se ndërsa e përqendrojmë vëmendjen tonë te bindja ndaj urdhërimeve të Zotit dhe te të qenit të denjë për të hyrë në tempull, do të bekohe mi me forcë shpirtërore dhe gëzim. Nxitini anëtarët e klasës që të gëzojnë bekimet e tempullit duke jetuar denjësisht dhe duke e frekuentuar sa më shpesh që të jetë e mundur.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

##### 1. “Një kartë krediti me Zotin”

Një javë përpara se të zhvillohet ky mësim, kërkojini një anëtar të klasës që të njihet me fragmentin në vijim nga një bisedë e Presidentit Gordon B. Hinkli dhe të përgatitet që ta ndajë atë me klasën:

“Unë mbaj para jush dy karta krediti. Shumica prej jush i njohin karta të tilla si këto.

E para është një kartë krediti bankare. Ajo më lejon të siguroj mallra me kredi dhe pastaj të paguaj njëherësh për blerjet e mia. Është një gjë me vlerë dhe diçka që duhet të ruhet. Nëse vidhet dhe përdoret pandershmërisht, do të mund të më shkaktonte humbje të madhe dhe ndoshta telash të konsiderueshëm. Kur e pranoj atë nga banka ime, unë hyj në një kontratë dhe lidhem nga detyrime e marrëveshje. Me pranimin e kartës, unë bie dakord të plotësoj kushtet sipas të cilave është lëshuar.

Ajo lëshohet për një vit dhe duhet të rilëshohet çdo vit nëse dëshiroj të gëzoj privilegjet që më jep ajo. Nuk është vërtet e imja. Pronësinë e ruan banka. Nëse unë dështoj në sjelljen e kërkuar, atëherë banka e ndërpret kredinë dhe e merr rishtas kartën.

Karta tjetër që kam, është ajo që e quajmë një rekomandim tempulli. Ai përfaqëson një kartë krediti me Zotin, duke bërë të disponueshme për mua shumë prej dhuratave të Tij më të mëdha. Karta e bankës ka të bëjë me gjërat e botës, rekomandimi me gjërat e Perëndisë.

Për të siguruar një rekomandim tempulli, marrësi duhet të ketë treguar gjithashtu përshtatshmërinë e tij dhe ajo përshtatshmëri bazohet mbi denjësinë personale. Pasi merret, ai nuk është i vlefshëm përgjithmonë por duhet të rilëshohet çdo vit. Për më tepër, ai mund të humbet ose të merret nëse mbajtësi bën ndonjë gjë që do ta përjashtonte atë nga privilegjet e tij.

Përshtatshmëria për një rekomandim tempulli nuk bazohet te vlera financiare. Ajo nuk ka fare të bëjë me të. Ajo bazohet në sjelljen e qëndrueshme personale, në mirësinë e jetës së dikujt. Nuk ka të bëjë me çështje monetare, por përkundrazi, me gjërat e përjetësisë.

Karta e bankës hap derën për kredi financiare. Rekomandimi i tempullit hap derën e Shtëpisë së Zotit. Ai ka të bëjë me hyrjen në vende të shenjta për të bërë punë të shenjtë dhe hyjnore. . . .

. . . Ky rekomandim që kam dhe që e keni kaq shumë prej jush, është një gjë e çmuar dhe e mrekullueshme. Ai i jep një njeriu të drejtën për një privilegj të veçantë dhe të mrekullueshëm – privilegjin e hyrjes në atë Shtëpi që ka të shkruar në murin e saj: 'Shenjtëri Zotit – Shtëpia e Zotit'. Jetoni të denjë për të shërbyer në atë shtëpi. Mbajeni atë të shenjtë. Bëni pjesën tuaj për të mos lejuar në shtëpinë e Zotit asnjë lloj ndikimi ose personi të papastër ose ndotës. Shijojeni bukurinë e saj. Shijojeni mrekullinë e gjërave që thuhet atje, bukurinë dhe bekimin e ordinancave që administrohen atje.

[Atyre] që nuk kanë qenë ende në tempull, më lejoni t'ju sugjeroj që të përfitoni nga mundësia e pagëzimit në emër të të vdekurve. Dhe pastaj lejoheni atë përvojë të shenjtë që të bëhet një spirancë në jetën tuaj, që ju të silleni në mënyrë të tillë në të gjitha kohët dhe në të gjitha rrethanat që, në kohën e përshtatshme, ju të mund të siguronin një kartë krediti të veçantë dhe të kufizuar me Zotin, madje një rekomandim për te shtëpia e Tij e shenjtë, që t'i gëzoni atje të gjitha bekimet dhe privilegjet e saj" (në Conference Report, prill 1990, f. 65, 69; ose *Ensign*, maj 1990, f. 49, 52).

## 2. Qëllimet e tempujve

Sillni figura të disa tempujve të ditëve të mëvonshme (në disa stile arkitekturore, po të jetë e mundur). Vini në dukje që, edhe pse këta tempuj mund të duken të ndryshëm nga jashtë, ordinancat e kryera dhe besëlidhjet e bëra brenda këtyre tempujve janë të njëjta.

Shpjegoni që edhe pse disa nga praktikat në tempullin e Izraelit të lashtë ishin të ndryshme nga ajo çfarë bëjmë ne në tempujt e ditëve të mëvonshme (për shembull, ne nuk sakrifikojmë kafshë ose të djegim qirinj dhe temjan në tempujt e ditëve të mëvonshme), qëllimet e tempujve të lashtë dhe të tempujve të ditëve të mëvonshme janë të njëjta: të na përgatisin që të vijmë në prani të Zotit dhe të bëhemi si Ai.

Ju mund të dëshironi të paraqisni "Tempujt e Lashtë", një fragment nëntëminutësh nga *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224), që përshkruan tabernakullin e Moisiut dhe disa nga aktivitetet që u zhvilluan atje.

### 3. Studimi i shkrimeve të shenjta

- Përse ne nganjëherë kemi vështirësi të studiojmë shkrimet e shenjta?

Renditini përgjigjet e anëtarëve të klasës në një kolonë në dërrasë. Pastaj diskutoni rreth mënyrave se si mund t'i kapërcejmë këto vështirësi. Për shembull, nëse nuk e kuptojmë atë që lexojmë, ne mund të lutemi për kuptueshmëri dhe të studiojmë atë që profetët dhe apostujt kanë thënë për shkrimet e shenjta që po lexojmë; nëse jemi tepër të përgjumur që të lexojmë shkrimet e shenjta natën, mund të gjejmë një kohë tjetër të ditës për të lexuar. Renditini këto zgjidhje në një kolonë tjetër në dërrasë.

Sfidojini anëtarët e klasës që të jenë më të përkushtuar në studimin e tyre të shkrimeve të shenjta.

# “Lum Ai Njeri që Ka Gjetur Diturinë”

*Fjalët e Urta dhe Predikuesit*

---

**Qëllimi** Të frymëzojë anëtarët e klasës që të jenë më shumë si Krishti duke zbatuar këshillën e urtë që gjendet në librat e Fjalëve të Urta dhe të Predikuesit.

---

**Përgatitja**

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta të diskutuara në skicën e mësimin dhe sa më shumë që të mundeni prej librave të Fjalëve të Urta dhe të Predikuesit.
2. Nëse përdorni aktivitetin e parë të vëmendjes, shkruani fjalitë vijuese në një afishe ose në dërrasë përpara orës mësimore:
  - a. Përpara shkatërrimit vjen \_\_\_\_\_.
  - b. Mësoji \_\_\_\_\_ rrugën që duhet të ndjekë.
  - c. Çdo gjë ka \_\_\_\_\_ e vet, çdo situatë ka një \_\_\_\_\_ nën qiell.
  - ç. Ki \_\_\_\_\_ tek Zoti me gjithë zemër.
  - d. \_\_\_\_\_ e fashit zemërimin.
  - dh. Sepse, ashtu si \_\_\_\_\_ në zemër të tij, ashtu është ai.

Nëse përdorni aktivitetin e dytë të vëmendjes, kërkojuni një ose dy prej anëtarëve të klasës që të përgatiten për të treguar një fragment të parapëlqyer nga Fjalët e Urta ose Predikuesit dhe që të thonë se përse është i rëndësishëm për ta.

3. Nëse është e disponueshme *Old Testament Video Presentations [Paraqitje me Video të Dhiatës së Vjetër]* (53224), ju mund të dëshironi të shfaqni “Trusting in the Lord” [“Mirëbesimi te Zoti”], një fragment pesëminutësh, si pjesë të mësimin.

---

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin** Aktivitet Vëmendjeje Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.

1. Drejtojini anëtarët e klasës te fjalitë që keni shkruar në një afishe ose në dërrasë (shih “Përgatitja” më sipër). Shpjegoni se këto janë shprehje shumë të njohura nga librat e Fjalëve të Urta dhe të Predikuesit dhe kërkojuni anëtarëve të klasës që të mbushin vendet bosh. Nëse është e nevojshme, jepni referencat vijuese që anëtarët e klasës të mund të kërkojnë te shkrimet e shenjta për të gjetur fjalët të cilat nuk i dinë.
  - a. Fjalët e Urta 16:18 (kryelartësia)
  - b. Fjalët e Urta 22:6 (fëmijës)
  - c. Predikuesit 3:1 (stinën, kohë)
  - ç. Fjalët e Urta 3:5 (besim)
  - d. Fjalët e Urta 15:1 (Përgjigja e ëmbël)
  - dh. Fjalët e Urta 23:7 (mendon)



2. Kërkojuni një ose dy anëtarëve të caktuar të klasës që të tregojnë një fragment të parapëlqyer nga Fjalët e Urta ose Predikuesit dhe që të thonë se përse është i rëndësishëm për ta.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë. Meqë do të jetë e vështirë të bëni çdo pyetje ose të trajtoni çdo pikë në mësim, përzgjidhni me lutje ato që do të plotësojnë më mirë nevojat e anëtarëve të klasës. Juve mund t'ju nevojitet t'i përshtasni disa pyetje që t'iu shkojnë për shtat rrethanave të anëtarëve të klasës.

Fjalët e Urta janë thënie të shkurtra që përgjithësisht japin këshillë mbi të jetuarin drejtësisht. Dhiata e Vjetër shënon se Salomoni “shqiptoi tre mijë proverba” (1 Mbretërve 4:32). Disa nga këto thënie të urta janë përfshirë në librin e Fjalëve të Urta. Edhe pse Salomoni dhe autorët e tjerë të këtij libri nuk ishin profetë, shumica e asaj që shkruan ishte e frymëzuar nga Zoti. Shkrimet e tyre në përgjithësi, pasqyrojnë një besim se urtësia e vërtetë vjen nga Perëndia.

Libri i Predikuesit gjithashtu përmban thënie të urta dhe disa njerëz besojnë se Salomoni është autori i tij. Mesazhi i Predikuesit është se jeta është kuptimplotë vetëm nëpërmjet Perëndisë.

Ky mësim është i ndarë në shtatë pjesë që përqendrohen në tema të rëndësishme nga Fjalët e Urta dhe Predikuesit. Në studimin tuaj personal, ju mund të gjeni tema të tjera që do të dëshironit t'i diskutoni në klasë.

### 1. Dituria

Jepni mësim dhe diskutoni për fragmentet vijuese nga Fjalët e Urta dhe Predikuesit.

- Librat e Fjalëve të Urta dhe të Predikuesit theksojnë rëndësinë e diturisë. Çfarë ndryshimi ka midis të qenit i mësuar dhe të qenit i ditur? (Shih Fjalët e Urta 1:7; 9:9–10; 2 Nefi 9:28–29. Vini në dukje se në gjuhën biblike, të kesh frikë Zotin do të thotë ta nderosh e t'i bindesh Atij. Shpjegoni se dituria është më shumë se njohuria; është zbatimi i duhur i njohurisë. Për izraelitët, dituria donte të thoshte bindje ndaj ligjeve të Perëndisë.)
- Çfarë mund të mësojmë nga Fjalët e Urta 2:2–6 mbi mënyrën se si ta marrim njohurinë e Perëndisë? Si mendoni ju, përse duhet ngulm për ta marrë këtë njohuri?
- Si krahasohet vlera e diturisë me vlerën e thesareve tokësore? (Shih Fjalët e Urta 3:13–18; Predikuesit 7:12. Vini re se fjalët *ajo* dhe *e saj* te Fjalët e Urta 3:15–18 i referohen diturisë.) Në ç'mënyrë dituria sjell lumturi dhe paqe?
- Fjalët e Urta 3:18 thotë se dituria “është një dru i jetës” për ata që e kanë atë. Çfarë mund të na mësojë ky simbol mbi vlerën e diturisë? (Shih 1 Nefi 11:8–11, 21–25, duke vënë re se pema e jetës është një simbol i dashurisë së Perëndisë.)
- Çfarë cilësish të njerëzve të ditur renditen te Fjalët e Urta 9:9–10 dhe Fjalët e Urta 15:31–33? Përse këto cilësi janë të nevojshme për të marrë dituri?

### 2. Mirëbesimi te Zoti

Jepni mësim dhe diskutoni për Fjalët e Urta 3:5–7.

- Çfarë këshille jepet te Fjalët e Urta 3:5–7? Në ç'mënyrë i drejton Zoti shtigjet tona? Çfarë përvojash ju kanë mësuar që t'i mirëbesoni Zotit?
- Çfarë do të thotë ta pranosh Perëndinë? (Shih Fjalët e Urta 3:6; Alma 34:38; DeB 59:21.) Si bekohemi ne kur e pranojmë Atë?

### 3. Fjalët që themi

Jepni mësim dhe diskutoni për fragmentet vijuese nga Fjalët e Urta.

- Fjalët e Urta 6:16–19 rendit shtatë gjëra që Zoti i urren. Tri prej këtyre gjërave – gënjeshttrat, dhënia e dëshmisë së rreme dhe shtirja e grindjes – zbatohen për fjalët që themi. Përse Zoti është kaq i shqetësuar për fjalët që themi? (Shih Fjalët e Urta 16:27–28; 18:8; 25:18; Mateu 12:36–37.) Si mund t'i kapërcejmë problemet e të gënjerit, thashethemeve, ose të folurit negativisht për të tjerët?
- Fjalët e Urta 16:24 thotë se “fjalët e ëmblla janë si një huall mjalti, ëmbëlsi për shpirtin”. Në ç'mënyrë është e vërtetë kjo? Cilat janë rezultatet e të folurit mirësisht? (Shih Fjalët e Urta 12:25; 15:1; 16:24.) Në ç'mënyrë fjalët e sjellshme të të tjerëve ju kanë ndihmuar ju?
- Cilat janë përfitimet e të folurit butësisht kur del një mosmarrëveshje? (Shih Fjalët e Urta 15:1.)

Plaku Gordon B. Hinkli tha: “Ne rrallë hyjmë në telashe kur flasim butësisht. Vetëm kur e ngremë zërin inati ndizet dhe gjërat e vogla bëhen shkak për grindje të mëdha” (në Conference Report, prill 1971, f. 82; ose *Ensign*, qershor 1971, f. 72).

### 4. Krenaria

Jepni mësim dhe diskutoni për Fjalët e Urta 8:13; 13:10; 16:18–19.

- Fjalët e Urta 8:13 pohon se Zoti e urren krenarinë. Përse krenaria është një mëkat kaq i rëndë?

Presidenti Ezra Taft Benson tha:

“Tipari qendror i krenarisë është armiqësia – armiqësia ndaj Perëndisë dhe armiqësia ndaj bashkënjerezve tanë. *Armiqësi* do të thotë ‘urrejtje ndaj, kundërshti ndaj, ose një gjendje kundërshtimi’. Është fuqia me anë të së cilës Satani dëshiron të sundojë mbi ne.

Krenaria në thelb është konkurreuese nga natyra. Ne e vendosim vullnetin tonë kundër atij të Perëndisë. Kur e drejtojmë krenarinë tonë kundrejt Perëndisë, kjo është në frymën e thënies ‘u bëftë vullneti im, jo yti’. Siç tha Pali, ata ‘kërkojnë interesin e vet dhe jo gjërat e Jezu Krishtit’ (Filipianëve 2:21).

Vullneti ynë në konkurrim me vullnetin e Perëndisë lejon që dëshirat, etjet dhe pasionet të vazhdojnë të pafrenuara (shih Alma 38:12; 3 Nefi 12:30).

Krenarët nuk mund ta pranojnë që autoriteti i Perëndisë t'i japë drejtim jetës së tyre (shih Helamani 12:6). Ata i vendosin perceptimet e tyre të së vërtetës kundër njohurisë së madhe të Perëndisë, aftësitë e tyre kundrejt fuqisë së priftërisë të Perëndisë, arritjet e tyre kundër veprave të Tij të fuqishme.

Armiqësia jonë kundrejt Perëndisë mund të marrë trajta të ndryshme, të tilla si rebelim, zemërngurtësi, kokëfortësi, mospendim, krekosje, fyerje me lehtësi dhe kërkim i shenjave. Krenarët dëshirojnë që Perëndia të bjerë dakord me ta.

Ata nuk janë të interesuar që të ndryshojnë mendimet e tyre për të rënë dakord me të Perëndisë. . . .

Krenaria është një mëkat mallkues me kuptimin e vërtetë të asaj fjale. Ajo kufizon ose ndalon përparimin (shih Alma 12:10–11). Krenarët nuk marrin mësim lehtë (shih 1 Nefi 15:3, 7–11). Ata nuk do ta ndryshojnë mendjen që të pranojnë të vërtetat, sepse bërja e kësaj nënkupton që ata e kishin gabim” (në Conference Report, prill 1989, f. 3–5; ose *Ensign*, maj 1989, f. 4, 6).

- Fjalët e Urta 13:10 dhe 16:18 jep mësim se krenaria çon në grindje dhe shkatërrim. Si mund ta bëjë këtë krenaria? Si ndikon krenaria te familjet tona?

Presidenti Ezra Taft Benson tha:

“Një aspekt tjetër i krenarisë është grindja. Debatet, zënkat, sundimi i padrejtë, moskomunikimi mes brezave, abuzimi me bashkëshorten/in, trazirat dhe rrëmuja, të gjitha përfshihen në këtë kategori të krenarisë.

Grindja në familjet tona e largon Shpirtin e Zotit. Ajo gjithashtu largon shumë prej pjesëtarëve të familjeve tona. . . .

Krenaria ndikon negativisht tek të gjitha marrëdhëniet tona – te marrëdhënia jonë me Perëndinë dhe shërbëtorët e Tij, mes bashkëshortit e bashkëshortes, mes prindit e fëmijës” (në Conference Report, prill 1989, f. 5; ose *Ensign*, maj 1989, f. 6).

- Si mund ta mposhtim krenarinë? (Shih Fjalët e Urta 16:19.) Çfarë mund të bëjmë që të jemi më të përgjithshëm në marrëdhëniet tona me pjesëtarët e familjeve tona dhe me Perëndinë?

## 5. Miqësia

Jepni mësim dhe diskutoni për fragmentet vijuese nga Fjalët e Urta dhe Predikuesit.

- Përse paralajmërohem për miqtë e padenjë? (Shih Fjalët e Urta 13:20; 22:24–25.)
- Cilat janë disa karakteristika të miqve të mirë? (Shih Fjalët e Urta 17:17; 27:9.) Si ju kanë ndihmuar miqtë e mirë nëpër kohë të vështira?
- Çfarë mund të bëjmë për të fituar miq të mirë? (Shih Fjalët e Urta 18:24. Vini në dukje se për të pasur miq të mirë ne duhet të jemi miq të mirë.)
- Si reagojnë miqtë e vërtetë kur bëjmë zgjedhje të pamatura? (Shih Predikuesit 4:9–10.)

Plaku Marvin J. Ashton tha:

“Dikush ka thënë: ‘Një mik është një njeri që është i gatshëm të më pranojë ashtu siç jam’. Duke e pranuar këtë si një përkufizim të fjalës, më lejoni të sugjeroj shpejt se ne jemi diçka më pak se një mik i vërtetë nëse e lëmë një njeri ashtu siç e gjetëm. . . .

Asnjë shpërblim më i madh nuk mund t’i jepet cilitdo prej nesh, teksa shërbejmë, sesa një vlerësim i sinqertë: ‘Faleminderit që je miku im’. Kur ata që kanë nevojë për ndihmë, e gjejnë udhën e tyre të kthimit nëpërmjet nesh dhe me ne, kjo është miqësi në veprim. Kur të dobët bëhen të fortë dhe të fortit edhe më të fortë nëpërmjet jetës sonë, miqësia është e vërtetë. Nëse një njeri

mund të gjykohet sipas miqve të tij, ai mund të gjykohet edhe sipas cilësive të mira shpirtërore të atyre miqve. . . .

Po, një mik është një njeri që është i gatshëm të më pranojë ashtu si jam, por që është i gatshëm dhe i aftë që të më lërë më të mirë nga sa më ka gjetur” (në Conference Report, tetor 1972, f. 32, 35; ose *Ensign*, janar 1973, f. 41, 43).

- Si mund ta forcojmë miqësinë mes pjesëtarëve të familjes?
- Jezu Krishti shpesh i quajti pasuesit e Tij miqtë e Tij (DeB 88:62; 93:45). Si e ka treguar Ai se është miku ynë? (Shih Gjoni 15:13.) Si e tregojmë ne se jemi miqtë e Tij? (Shih Gjoni 15:14.) Si e keni ndier ju miqësinë e Tij?

## 6. Rritja e fëmijëve

Jepni mësim dhe diskutoni për fragmentet vijuese nga Fjalët e Urta.

- Fjalët e Urta 22:6 thotë: “Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë”. Çfarë duhet të bëjnë prindërit që ta ndjekin këtë këshillë? (Shih DeB 68:25–28.) Si mund t’u japim mësim fëmijëve parimet e ungjillit dhe të ushqejmë dëshmitë e tyre më efektshëm?

Plaku Riçard G. Skot tha: “Ju duhet të jeni të gatshëm që të braktisni kënaqësinë personale dhe interesimin për veten në favor të aktiviteteve të përqendruara te familja dhe jo t’ia kaloni kishës, shkollës ose shoqërisë, rolin kryesor për të ndihmuar që fëmija të zhvillohet në të gjitha fushat e jetës. Nevojitet kohë, përpjekje e madhe dhe sakrificë e rëndësishme personale që t’i ‘mëso[sh] fëmijës rrugën që duhet të ndjekë’. Po ku mund të gjeni shpërblime më të mëdha për një punë të kryer mirë?” (në Conference Report, prill 1993, f. 43; ose *Ensign*, maj 1993, f. 34).

- Përse fëmijëve u nevojiten rregulla, kufij dhe korrigjim me dashuri? (Shih Fjalët e Urta 19:18; 29:17.) Si duhet të përgjigjen fëmijët ndaj këshillës së drejtë të prindërve të tyre? (Shih Fjalët e Urta 6:20–23.) Si duhet ta bëjnë prindërit korrigjimin? (Shih DeB 121:41–44.)

## 7. Lumturia dhe humori i mirë

Jepni mësim dhe diskutoni për Fjalët e Urta 15:13 dhe Fjalët e Urta 17:22.

- Përse është e rëndësishme që të zhvillohet një qëndrim i lumtur dhe një ndjesi e mirë humori? (Shih Fjalët e Urta 15:13; 17:22.)

Presidenti Hug B. Braun tha: “Do të dëshiroja që ju të buzëqeshnit sepse, në fund të fundit, ne duhet të mbajmë një ndjesi humori pavarësisht se çfarë ndodh. Mendoj se nga të gjithë njerëzit në botë, ne duhet të jemi më të lumturit. Ne kemi mesazhin më të shkëlqyer e më të gëzueshëm në botë. Mendoj se, kur të shkojmë në anën tjetër, dikush do të na presë me një buzëqeshje (përveç nëse shkojmë në vendin e gabuar dhe atëherë dikush do të ngërdheshet), kështu që le të jemi të lumtur. Por lumturia jonë le të jetë e çiltër – le të vijë nga brenda” (*The Abundant Life* [1965], f. 83).

- Çfarë mund të bëjmë që të nxitim humor lartësues në familjet tona? (Ju mund të dëshironi t’u kërkonin anëtarëve të klasës që të tregojnë për momente kur humori ka ndihmuar që familjet e tyre t’i zgjidhin problemet dhe të rrisin dashurinë për njëri-tjetrin.)

## Përfundim

Ndani ndjenjat tuaja për temat që keni diskutuar. Nxitini anëtarët e klasës që të kujtojnë dhe të ndjekin këshillat që gjenden te Fjalët e Urta dhe Predikuesit. Ju mund të dëshironi gjithashtu që t'i nxisni ata të mësojnë përmendësh një fragment të parapëlqyer nga njëri prej këtyre librave.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

**1. Aktivitet nga Fjalët e Urta**

Shkruani disa referenca nga libri i Fjalëve të Urta në rripa të veçantë letre dhe vendosini në një vazo. Vëri anëtarët e klasës që të zgjedhin me radhë nga një rrip letre nga vazoja, të lexojnë fragmentin e shkrimit të shenjtë të cituar në rripin e letrës dhe të shpjegojnë se si zbatohet ai fragment në jetën tonë.

**2. Zbatimi i shkrimit të shenjtë**

Vizatoni figurën e një trupi në dërrasë. Vëri anëtarët e klasës që të gjejnë vargjet vijuese dhe të shkruajnë referencat pranë secilës pjesë përkatëse të trupit. Lexojini vargjet së bashku dhe diskutoni për mënyrën se si zbatohen në jetën tonë.

- a. Fjalët e Urta 2:2 (veshin dhe zemrën)
- b. Fjalët e Urta 3:5 (zemër)
- c. Fjalët e Urta 3:7 (sytë)
- ç. Fjalët e Urta 3:27 (dorë)
- d. Fjalët e Urta 4:26–27 (këmbën)
- dh. Fjalët e Urta 8:7 (goja)
- e. Fjalët e Urta 10:4 (dorë)
- ë. Fjalët e Urta 12:15 (syve)

**3. “Një grua . . . [e] virtytshme” (Fjalët e Urta 31:10)**

Bëjini anëtarët e klasës që të këqyrin Fjalët e Urta 31:10–31 dhe të rendisin cilësitë e një gruaje të virtytshme. Vini në dukje se këto janë cilësi që të gjithë ne, meshkuj e femra, duhet të përpiqemi fort që t'i zhvillojmë. Ju mund të dëshironi t'i shkruani përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë. Përgjigjet mund të përfshijnë sa vijon:

Vargu	Cilësia
11	Mund t'i besohet
13	Punon me gatishmëri
20	Është e dhembshur
25	Është e fortë dhe e ndershme
26	Flet me dituri e me mirësi
28	Është një bashkëshorte dhe nënë e përkushtuar
30	I bindet Zotit

Ftoni disa anëtarë të klasës që të flasin për njerëz që njohin, të cilët i kanë këto cilësi.

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të zhvillojnë forcë për të përballur vështirësitë duke i mirëbesuar Zotit, duke ndërtuar dëshmitë e tyre për Të dhe duke ruajtur integritetin moral personal.
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Jobit 1–2. Jobi, një burrë i drejtë e besnik, provon sprovat të rënda. Ai i qëndron besnik Zotit megjithë humbjen e zotërimeve, fëmijëve dhe të shëndetit të tij.</li> <li>Jobit 13:13–16; 19:23–27. Jobi gjen forcë në mirëbesimin te Zoti dhe në dëshminë e tij për Shpëtimtarin.</li> <li>Jobit 27:2–6. Jobi gjen forcë në drejtësinë e tij dhe integritetin moral personal.</li> <li>Jobit 42:10–17. Pasi Jobi i ka duruar besnikërisht sprovat e tij, Zoti e bekon atë.</li> </ol> <p>2. Lexim shtesë: Kapituj të tjerë të Jobi; Doktrina e Besëlidhje 121:1–10.</p>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Tregojuni analogjinë në vijim anëtarëve të klasës (ose kërkoni një anëtar të klasës të përgatitet që ta tregojë atë):</p> <p>Plaku Jozef B. Uirthlin tregoi një herë për fermerët në shkretëtirën e nxehtë të Meksikës veriperëndimore të cilët “rrisin varietete të misrit dhe fasuleve që janë jashtëzakonisht të forta dhe të qëndrueshme ndaj thatësisë. Këto varietete mbijetojnë e lulëzojnë në një klimë të ashpër ku bimë të tjera do të vyshkeshin e do të thaheshin. Një prej këtyre bimëve është fasulja e bardhë tepari. Fara e saj do të mugullojë dhe bima do të rritet edhe kur bie shumë pak shi. Ajo i çon rrënjët deri rreth 180 centimetra thellë në terrenin shkëmbor ose ranor për të gjetur lagështinë që i nevojitet. Ajo mund të lulëzojë e të bëjë frut në temperaturat 46 gradë Celsius të shkretëtirës me vetëm një rënie shiu në vit. Gjethnaja e saj mbetet shumë e gjelbër, me pak ujitje, edhe në nxehtësinë e mesit të korrikut.”</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë mund të mësojmë nga kjo analogji që mund të na ndihmojë të durojmë vështirësitë?</li> </ul> <p>Plaku Uirthlin sugjeroi: “Ndoshta anëtarët e Kishës mund të ndjekin shembullin e këtyre bimëve të qëndrueshme e të forta. Ne duhet t’i çojmë rrënjët tona thellë në truallin e ungjillit. Ne duhet të rritemi, të lulëzojmë dhe të japim frut të mirë me bollëk me gjithë të ligën, tundimin ose kritikën që mund të hasim. Ne duhet të mësojmë të harlisemi në nxehtësinë e vështirësisë” (në Conference Report, prill 1989, f. 7; ose <i>Ensign</i>, maj 1989, f. 7).</p> <p>Shpjegoni se ky mësim i kushtohet Jobit, një burrë, besimi dhe drejtësia e të cilit e ndihmuan atë të duronte vështirësi të rënda.</p>



Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Jobi vihet në provë të rëndë.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jobin 1–2.

- Çfarë lloj njeriu ishte Jobi? Ju mund të dëshironi të rendisni disa nga karakteristikat vijuese në dërrasë. Shumë prej referencave korresponduese nuk janë në detyrën e leximit, kështu që ju mund të dëshironi t'u kërkonit anëtarëve të veçantë të klasës që t'i shohin ato dhe të tregojnë se çfarë karakteristike përshkruhet.
  - a. Ai ishte një njeri i mirë që kishte frikë nga Perëndia dhe i largohej së keqes (Jobit 1:1).
  - b. Ai ishte i pasur, por jo i dhënë pas pasurisë (Jobit 1:3, 21).
  - c. Ai kishte integritet moral (Jobit 2:3).
  - ç. Ai i forconte të dobët (Jobit 4:3–4).
  - d. Ai ecte në shtigjet e Zotit dhe vlerësonte fjalët e Zotit (Jobit 23:10–12).
  - dh. Ai ishte i dhembshur ndaj të vejave, të varfërve, të çalëve dhe të verbërve (Jobit 29:12–16).
  - e. Ai shqetësohej për armiqtë e tij dhe i fali ata (Jobit 31:29–30).
- Çfarë sprovash provoi Jobi? Ju mund të dëshironi t'i rendisni disa nga këto sprova në dërrasë. Shumë prej referencave korresponduese nuk janë në detyrën e leximit, kështu që ju mund të dëshironi t'u kërkonit anëtarëve të veçantë të klasës që t'i shohin ato dhe të tregojnë se çfarë sprove përshkruhet.
  - a. Humbje e shërbëtorve, pronave dhe të ardhurave (Jobit 1:13–17).
  - b. Humbje e fëmijëve (Jobit 1:18–19).
  - c. Sëmundje dhe dhembje fizike (Jobit 2:7; 7:5; 16:16).
  - ç. Gjumë i shqetësuar, i mbushur me makthe (Jobit 7:4, 13–14).
  - d. Akuza mizore dhe humbje e mbështetjes nga miqtë dhe familja (Jobit 2:9; 4:1, 7–8; 11:1–6; 19:13–22).
  - dh. Hutim mbi arsyen pse atij iu kërkua të kalonte nëpër këto sprova (Jobit 10:15).
  - e. Tallje prej atyre që u gëzuan nga shkatërrimi i tij (Jobit 16:10–11; 30:1, 8–10).
  - ë. Ndjenja se Perëndia e kishte harruar atë ose nuk e dëgjonte (Jobit 19:6–8; 23:3–4; vini re se fjala *e tij* te Jobit 23:3–4 i referohet Perëndisë).
- Në ç'mënyrë sprovat e Jobit krahasohen me sprovat që njerëzit provojnë në kohën tonë? (Sprovat janë të ngjashme: humbje e pronave, humbje e fëmijëve, humbje e shëndetit dhe humbje e dashurisë dhe e shoqërimit të miqve dhe familjes.)
- Çfarë pretendonte Satani se ishte arsyeja e drejtësisë së Jobit? (Shih Jobit 1:9–10.) Si parashikoi Satani se do të reagoonte Jobi kur t'i hiqeshin pasuria dhe bekimet e tjera? (Shih Jobit 1:11; 2:4–5.) Si reagoi Jobi kur kjo ndodhi? (Shih Jobit 1:20–22; 2:10.) Çfarë mund të mësojmë nga këto reagime?
- Megjithë vështirësinë e tij, Jobi “nuk mëkatoi dhe nuk paditi Perëndinë për ndonjë padrejtësi” (Jobit 1:22). Në ç'mënyrë disa njerëz e paditin Perëndinë për padrejtësi kur godasin hidhërimi, fati i keq ose tragjedia? (Ata mund t'ia vënë fajin Perëndisë ose të vënë në dyshim diturinë apo urtësinë e Tij, duke ndier se Ai nuk i kupton ose nuk i do ata. Disa madje mund të vënë në dyshim ekzistencën e Tij.)

## 2. Jobi gjen forcë te Zoti.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jobin 13:13–16; 19:23–27.

- Mirëbesimi i Jobit te Zoti ishte një burim i shkëlqyer force shpirtërore për të (Jobit 13:13–16). Çfarë do të thotë të mirëbesosh te Zoti? Si mund të zhvillojmë mirëbesim te Zoti se do të na mbështesë nëpër sprova? (Shih Romakëve 8:28; 2 Nefi 2:2, 11, 24; DeB 58:2–4; 122:5–9.) Dëshmoni se, meqë Zoti na do, Ai na ka siguruar që, kur jemi besnikë, të gjitha gjërat do të jenë për të mirën tonë dhe do të na ndihmojnë të rritemi.
- Te Jobit 19, Jobi përshkroi sprovat që i kishin ndodhur atij, pastaj dëshmoi për Shpëtimtarin. Në ç'mënyrë dëshmia e Jobit për Shpëtimtarin e ndihmoi atë të duronte sprovat e tij? (Shih Jobit 19:25–27.) Në ç'mënyrë një dëshmi për Shpëtimtarin mund të na japë forcë gjatë vështirësive?

Ju mund të dëshironi t'i vini të këndojnë anëtarët e klasës “E Di se Rron Shëlbuesi Im” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 38), ose mund të luani një regjistrim të këtij himni.

## 3. Jobi gjen forcë në drejtësinë e tij dhe integritetin moral personal.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jobin 27:2–6.

- Integriteti moral i Jobit ishte një tjetër burim i forcës shpirtërore gjatë hidhërimeve të tij (Jobit 27:2–6). Çfarë është integriteti moral? Si e forcoi Jobin gjatë sprovave të tij integriteti moral personal? Si mund të na ndihmojë ne integriteti moral personal gjatë kohëve të sprovës? (Kur e mbajmë integritetin tonë moral, mund të marrim forcë nga dija se drejtimi i jetës sonë është i kënaqshëm për Zotin.)

Plaku Jozef B. Uirthlin e përkufizoi *integritetin moral* si “bërja gjithmonë e asaj që është e drejtë dhe e mirë, pavarësisht nga pasojat e menjëhershme. Do të thotë të jemi të drejtë nga vetë thellësia e shpirtit tonë, jo vetëm në veprimet tona por, më e rëndësishmja, në mendimet tona dhe në zemrat tona. Integriteti moral personal përfshin besueshmëri dhe pakorruptueshmëri të tillë, saqë jemi të paaftë të mos jemi besnikë ndaj një mirëbesimi apo besëlidhjeje” (në Conference Report, prill 1990, f. 38; ose *Ensign*, maj 1990, f. 30).

## 4. Pasi Jobi i ka duruar besnikërisht sprovat e tij, Zoti e bekon atë.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jobin 42:10–17.

- Pasi Jobi i kishte duruar besnikërisht sprovat e tij, si e bekoji Zoti atë? (Shih Jobit 42:10–15; Jakobit [Bibël] 5:11.) Si na bekon Zoti kur ne i durojmë sprovat besnikërisht? (Shih Jobit 23:10; 3 Nefi 15:9. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja personale. Ju mund të dëshironi të vini në dukje se edhe pse Zoti e bekoji Jobin me “dyfishin e tërë atyre që kishte zotëruar”, bekimet shpirtërore që na jep Zoti kur durojmë besnikërisht, janë edhe më të mëdha se bekimet materiale.)

Plaku Orson F. Uitni tha: “Asnjë dhimbje që vuajmë, asnjë sprovë që provojmë, nuk shkon dëm. Ajo i shërben edukimit tonë, zhvillimit të cilësive të tilla si durimi, besimi, guximi dhe përlësia. Gjithçka që vuajmë dhe gjithçka që i qëndrojmë, veçanërisht nëse i qëndrojmë me durim, ndërton karakterin tonë, pastron zemrën tonë, zgjeron shpirtin tonë dhe na bën më të butë e më bamirës, më të denjë që të quhemi fëmijët e Perëndisë . . . dhe ndodh përmes hidhërimit

dhe vuajtjes, mundimit dhe fatkeqësisë, që ne e marrim atë edukim të cilin erdhëm që ta marrim këtu dhe që do të na bëjë më të ngjashëm me Atin e Nënëtonë në qiell” (cituar në Spencer W. Kimball, *Faith Precedes the Miracle*, f. 98).

Profeti Jozef Smith tha: “Unë jam si një gur gjigant, i palëmuar, që rrokulliset poshtë nga një mal i lartë; dhe e vetmja gdhendje që marr është kur ndonjë cep lëmohe duke ardhur në kontakt me diçka tjetër, . . . duke hequr një cep këtu e një cep atje. Kështu unë do të bëhem një shigjetë e lëmuar dhe e shkëlqyer në kukurën e të Plotfuqishmit” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përzgj. Joseph Fielding Smith [1976], f. 304).

## Përfundim

Përmbliidhni diskutimin tuaj të librit të Jobit, duke theksuar se ne mund të marrim forcë për të duruar sprovat tona duke mirëbesuar te Zoti, duke ndërtuar dëshmitë tona për Të dhe duke mbajtur integritetin tonë moral që të mund ta dimë se jeta jonë është e këndshme për Të. Ju mund të dëshironi t’iu tregoni anëtarëve të klasës për një kohë kur morët forcë gjatë vështirësisë. Sugjeroni që anëtarët e klasës të meditojnë rreth mënyrës se si mund t’i zbatojnë parimet e diskutuara në këtë mësim për t’i ndihmuar ata të durojnë vështirësitë.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Miqtë e Jobit

- Si e shpjeguan Elifazi dhe Bildadi, dy nga miqtë e Jobit, vuajtjen e tij? (Shih Jobit 4:7–8; 8:6. Ata menduan se vuajtja e Jobit qe një ndëshkim nga Perëndia për mëkatet që kishte kryer Jobi.) Cilat janë rreziqet e të besuarit se të gjitha vuajtjet vijnë si ndëshkim i Perëndisë për mëkatet tona?
- Çfarë mund të na mësojnë gabimet e miqve të Jobit mbi ndihmën për njerëzit që pësojnë vështirësi?

### 2. Pyetje për t’u bërë gjatë vështirësive

Plaku Riçard G. Skot tha: “Kur hasni vështirësi, ju mund të drejtoheni të bëni shumë pyetje. Disa i shërbejnë një qëllimi të dobishëm; të tjera jo. Të pyesësh: ‘Përse kjo duhet të më ndodhë mua? Përse më duhet ta vuaj këtë tani? Çfarë kam bërë që ta shkaktoj këtë?’ do t’ju drejtojë në qorrsohak. Vërtet që nuk bën dobi të bësh pyetje që pasqyrojnë kundërshtim ndaj vullnetit të Perëndisë. Në vend të kësaj pyesni: ‘Çfarë duhet të bëj unë? Çfarë duhet të mësoj nga kjo përvojë? Çfarë duhet të ndryshoj? Cilin duhet të ndihmoj? Si mund t’i kujtoj bekimet e mia të shumta në kohë sprove?’” (në Conference Report, tetor 1995, f. 18; ose *Ensign*, nëntor 1995, f. 17).

### 3. Mbajtja e këndvështrimit të përjetësisë gjatë vështirësisë

Presidenti Spenser W. Kimball tha:

“Nëse do ta konsiderojmë vdekshmërinë si tërësinë e ekzistencës, atëherë dhembja, hidhërimi, dështimi dhe jeta e shkurtër do të ishin një gjëmë. Por nëse e shohim jetën si një gjë të përjetshme që shtrihet larg në të shkuarën e paravdekshmërisë dhe në vazhdim në të ardhmen e përjetshme të pasvdekjes, atëherë të gjitha ngjarjet mund të vendosen në këndvështrimin e duhur.

. . . A nuk jemi të ekspozuar ndaj tundimeve që të testohet forca jonë, ndaj sëmundjes që të mund të mësojmë durimin, ndaj vdekjes që të mund të bëhemi të pavdekshëm e të përlevduar?

Nëse të gjithë të sëmurët për të cilët lutemi, të shëroheshin, nëse të gjithë të drejtët do të mbroheshin dhe të ligjtë do të shkatërroheshin, i gjithë plani i Atit do të anulohet dhe parimi bazë i ungjillit, liria e zgjedhjes, do të mbaronte. Asnjë njeriu nuk do t'i duhej të jetonte sipas besimit" (*Faith Precedes the Miracle* [1975], f. 97).

#### **4. Begatia e të ligjve e ka jetën e shkurtër**

- Nganjëherë duket sikur të ligjtë begatohen ndërsa të drejtët vuajnë. Çfarë na mëson libri i Jobit mbi begatinë në dukje të të ligjve? (Shih Jobit 21; 24.)

Jona 1–4; Mikea 2; 4–7

---

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të përmbushin përgjegjësitë e tyre si Izraeli i ditëve të mëvonshme për të dashur të gjithë njerëzit e botës dhe për të ndarë bekimet e ungjillit me ta.
<b>Përgatitja</b>	Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese: a. Jona 1–2. Zoti thërret Jonën që t’i predikojë pendim popullit të Ninives. Jona përpiqet të largohet nga Zoti me një anije, gëlltitet nga një peshk i madh, lutet dhe çlirohet nga barku i peshkut. b. Jona 3–4. Jona profetizon shkatërrimin e Ninives dhe zemërohet kur populli i Ninives pendohet dhe Zoti e kursen qytetin (Përkthimi prej Joseph Smith-it i Jonës 3:9–10 shpjegon se populli u pendua, jo Perëndia). Zoti përdor një bimë dhe një krimb për t’i mësuar Jonës se ai duhet t’i dojë të gjithë njerëzit. c. Mikea 2:12–13; 4:1–7, 11–13; 5:2–4, 7–8; 6:6–8; 7:18–20. Mikea profetizon për misionin e Izraelit në ditët e fundit.
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Për sa të rinj në Kishë Zoti dëshiron që të shërbejnë misione kohëplota? (Të gjithë të rinjtë e denjë e të aftë.) Përse është e rëndësishme që secili prej këtyre të rinjve t’i përgjigjet kësaj thirrjeje? Kush tjetër është i përshtatshëm për të shërbyer misione kohëplota? (Motrat e denja beqare 21 vjeçe e sipër ose çiftet më në moshë, përgjithësisht në pension, kur rrethanat e tyre e lejojnë.)</li></ul> <p>Në vitin 1979, Presidenti Spenser W. Kimball foli për nevojën për më shumë misionarë që do të mund t’iu predikonin ungjillin njerëzve në të gjitha anët e botës. Ai shpalli:</p> <p>“Unë besoj se Zoti mund të bëjë gjithçka Ai ndan mendjen të bëjë. Por unë nuk mund të shoh ndonjë arsye të mirë se përse Zoti do të hapte dyer në të cilat ne nuk jemi të përgatitur që të hyjmë” (“The Uttermost Parts of the Earth”, <i>Ensign</i>, korrik 1979, f. 9).</p> <p>Ky mësim do të diskutojë për mënyrën se si jeta dhe shkrimet e Jonës e të Mikeas mund të na ndihmojnë të kuptojmë përgjegjësinë tonë për të dashur të gjithë njerëzit e për të ndarë bekimet e ungjillit me ta.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.
	<b>1. Jona thirret të predikojë në Ninive, por ai largohet.</b> Jepni mësim dhe diskutoni për Jonën 1–2.

---

- Përse Zoti dëshironte që Jona të shkonte në Ninive? (Shih Jona 1:2.) Përse Jona mund të ketë qenë ngurrues që ta pranonte një thirrje për mision në Ninive? (Shih Nahum 3:1–5, ku përshkruhen ligësia dhe dhuna e madhe e Ninives. Njerëzit e Ninives, kryeqyteti i Asirisë, ishin armiq të Izraelit.)
- Përse Jona shkoi në Tarshish? (Shih Jona 1:3.) Në çfarë mënyrash ne përpiqemi nganjëherë të arratisemi nga prania e Zotit ose nga thirrje që na drejtohen nga përfaqësuesit e Tij? Cilat janë rezultatet e përpjekjeve të tilla?
- Në ç'mënyrë Zoti tregoi mëshirë dhe e ndihmoi Jonën që të pendohej? (Shih Jona 1:4–2:10.) Çfarë mësoi Jona kur qe brenda peshkut të madh? (Shih Jona 2:1–9.) Në ç'mënyrë Zoti na ndihmon të pendohemi dhe të kthehemi në udhët e Tij?
- Gjatë shërbesës së Tij tokësore, Shpëtimtari foli për “shenjë[n e] profetit Jona” (Mateu 12:39). Çfarë kuptimi kishte kjo shenjë? (Shih Mateu 12:39–41. Jona kaloi tri ditë e tri netë në barkun e peshkut të madh dhe pastaj u nxor i gjallë. Shpëtimtari do të kalonte tri ditë e netë i varrosur në tokë dhe pastaj do të dilte i ringjallur.)
- Nëpërmjet profetëve të Tij, Zoti ka urdhëruar vazhdimisht çdo të ri të denjë e të aftë që të shërbejë një mision kohëplotë. Ai i ka nxitur gjithashtu çiftet më në moshë që të shërbejnë si misionarë kohëplotë nëse janë të aftë. (Shih idetë për mësimdhënie shtesë.) Cilat janë disa arsye përse disa të rinj e çifte në moshë të aftë zgjedhin që të mos shërbejnë misione? (Mungesë zotimi e besimi, padënjësi, mosgatishmëri për të lënë rehatinë e shtëpisë e të familjes, frikë nga ajo që mund të pritët prej tyre.) Çfarë mund të mësojmë nga historia e Jonës që mund të na ndihmojë të jemi më trima në bindjen ndaj Zotit dhe ndarjen e ungjillit?

## 2. Njerëzit e Ninives iu përgjigjën mesazhit të Jonës dhe u penduan.

Jepni mësim dhe diskutoni për Jonën 3–4.

- Pasi Jona u pendua, Zoti e thirri atë sërish që t'i predikonte pendim popullit të Ninives. Si iu përgjigjën njerëzit e Ninives mesazhit të Jonës? (Shih Jona 3:5–9. Në kohët e lashta, njerëzit visheshin me pëlhura të ashpra, të quajtura pëlhurë thesi dhe uleshin mbi hi për të treguar se ishin të përlurur dhe të penduar.) Si iu përgjigj Perëndia ndryshimit të njerëzimit? (Shih Jona 3:10.)
- Jona kishte profetizuar shkatërrimin e Ninives (Jona 3:4). Si reagoi Jona kur Zoti e fali popullin e Ninives? (Shih Jona 4:1–3. Ai u inatos sepse Zoti qe i mëshirshëm me popullin.)
- Çfarë i mësoi Zoti Jonës nëpërmjet rritjes së bimës që dha hije e rehati dhe pastaj u tha? (Shih Jona 4:4–11. Perëndia i do të gjithë fëmijët e Tij. Pikërisht siç tregoi mëshirë për Jonën, Ai dëshironte të tregonte mëshirë për njerëzit e penduar të Ninives.) Çfarë mund të na mësojë përvoja e Jonës mbi dashurinë për njerëzit e tjerë?

## 3. Mikea profetizon për misionin e Izraelit të ditëve të mëvonshme.

Jepni mësim dhe diskutoni për fragmentet vijuese nga Mikea.

Profeti Mikea u bëri thirrje njerëzve të Izraelit që të pendoheshin për ligësinë e tyre dhe të ktheheshin te Zoti. Ai profetizoi për shkatërrimin e Jakobit (Izraelit)



dhe të Judës. Ai profetizoi gjithashtu se Izraeli i ditëve të mëvonshme (Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme) do t'i përmbushte qëllimet e Zotit me fuqi të madhe.

- Çfarë premtimesh dha Zoti te Mikea 2:12–13? (Ai premtoi se do ta mblidhte mbetjen e Izraelit, se ata do të bëheshin një mori e madhe dhe se Ai do t'i udhëhiqte ata.) Si po përmbushen këto premtime sot?
- Disa nga profecitë më të mëdha të Mikeas për ditët e mëvonshme janë shënuar te Mikea 4:1–7. Çfarë profetizoi Mikea për tempullin e ditëve të mëvonshme? (Shih vargjet 1–2.) Çfarë profetizoi ai për Mijëvjeçarin? (Shih vargjet 3–7.) Përse këto profeci janë të rëndësishme për ne?
- Çfarë mund të mësojmë nga Mikea 4:11–13 për fatin e Izraelit në ditët e mëvonshme? (Në botën e lashtë, qetë shpesh përdroreshin për të shirë grurin. Ata shkelnin mbi grurë, duke ndarë bykun nga kokrra. Byku flakej dhe kokrrat ruheshin. Kombet që i kundërvihen Sionit, do të mblidhen si duaj dhe pastaj do të shihen nga Izraeli.) Si mund të krahasohet kjo ndarje e bykut nga kokrrat me përgjegjësinë e Izraelit të ditëve të mëvonshme për të bërë punë misionare në mbarë botën? (Shih DeB 29:7; 33:5–7.)
- Për cilin profetizoi Mikea në Mikea 5:2–4? (Krahasojeni këtë profeci me regjistrimin e përmbushjes së saj te Mateu 2:4–6.)
- Me cilin krahasohen njerëzit e Zotit te Mikea 5:7? Në ç'mënyrë imazhi i vesës ose i shiut të dendur mbi bar mund të krahasohet me ndikimin e anëtarëve të Kishës të njerëzit në botë? Si mendoni ju, çfarë kuptonte Mikea duke thënë se këto shira nuk do të prisnin “nga bijtë e njerëzve”? (Pikërisht ashtu si të vdekshmit nuk mund ta pengojnë vesën që të formohet ose shirat që të bien, asgjë nuk mund ta ndalojë përparimin e punës së Zotit në mbarë botën.)
- Me cilin krahasohen njerëzit e Zotit te Mikea 5:8? Çfarë sugjeron ky përfytyrim mbi forcën dhe fuqinë e punës së Zotit? (Ashtu si një kope dhensh nuk ka fuqi ta ndalojë një luan të vogël, asnjë fuqi mbi tokë nuk do të jetë në gjendje të pengojë punën e Zotit.)

Në vitin 1842, Profeti Jozef Smith deklaroi: “Asnjë dorë mëkatore nuk mund ta ndalojë punën të përparojë; përndjekjet mund të egërsohen, turmat mund të bashkohen, armiqtë mund të mblidhen, shpifja mund të përgojë, por e vërteta e Perëndisë do të shkojë përpara me guxim, me fisnikëri dhe e pavarur derisa ajo të ketë përshkuar çdo kontinent, të ketë vizituar çdo rajon, të futet në çdo vend dhe të jetë dëgjuar nga çdo vesh, derisa qëllimet e Perëndisë të përmbushen dhe Jehova i Madh të thotë se puna u krye” (*History of the Church*, 4:540).

- Në ç'mënyrë Mikea 6:6–8 mund të na ndihmojë kur ndihemi të trullosur nga gjithçka pritet prej nesh?
- Pasi profetizoi për punën e Zotit në ditët e mëvonshme, në çfarë përfundimi arriti Mikea mbi natyrën e Perëndisë? (Shih Mikea 7:18–20.) Cilat fraza në këto vargje mund të zbatohen për sjelljen e Zotit me njerëzit e Ninives? Cilat nga këto fraza mund të zbatohen për sjelljen e Zotit me ne?

Jepni dëshmi se Zoti i do të gjithë fëmijët e Tij dhe se ne, si Izraeli i ditëve të mëvonshme, kemi përgjegjësinë e madhe që t'i ndajmë dashurinë e Tij dhe të vërtetat e ungjillit me të gjithë njerëzit. Kërkojuni anëtarëve të klasës që të ndajnë atë që kanë mësuar nga Jona dhe Mikea.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimit. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimit.

### 1. Çdo i ri i denjë e i aftë duhet të përgatitet për të shërbyer një mision

Diskutoni për thënien vijuese nga Presidenti Spenser W. Kimball:

“Kur kërkoj për më shumë misionarë, unë nuk po kërkoj për më shumë misionarë pa dëshmi ose të padenjë. Unë po kërkoj që ta nisim më herët dhe të trajnojmë misionarët tanë më mirë në çdo degë dhe çdo lagje në botë. Ka një sfidë tjetër – që të rinjtë ta kuptojnë se është një privilegj i madh të shkosh në një mision dhe se ata duhet të jenë mirë fizikisht, mirë mendërisht, mirë shpirtërisht dhe se ‘Zoti nuk mund të shikojë mëkatën as me lëshimin më të vogël’ . . .

Bëhet shpesh pyetja: A duhet që çdo i ri të përmbushë një mision? Dhe përgjigja është dhënë nga Zoti. Ajo është ‘Po’. Çdo i ri duhet të përmbushë një mision” (“When the World Will Be Converted”, *Ensign*, tetor 1974, f. 7–8).

### 2. Nevoja për çifte misionarë

Diskutoni për thënien vijuese nga Plaku Dejvid B. Hait:

“Në emër të Vëllezërve, kjo është një thirrje që çiftet në pension ta marrin parasysh seriozisht shërbimin në një mision. Ne kemi nevojë skajshëm për më shumë çifte që të ndihmojnë për të plotësuar nevojat tona. . . . Janë përmbushur më pak se 50 përqind e kërkesave për çifte misionare nga presidentët [tanë] të misioneve. . . .

Vëllezërit shpresojnë se shumë, shumë më tepër çifte do të bëhen të disponueshme për shërbim kohëplotë në Kishë. Nevoja është e madhe! Qindra mijëra anëtarë të rinj bashkohen me Kishën çdo vit dhe ata kanë nevojë të dëgjojnë një zë miqësor mbështetjeje e ngushëllimi nga anëtarë me përvojë.

Refreni ‘Do shkoj ku ti do që të shkoj o Zot’ (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, 1997, f. 46), duhet të jetë më shumë se një himn që e këndojmë të dielën. Duhet të jetë vetë lutja jonë e besimit ndërsa shërbejmë kudo ku Zoti ka nevojë për ne” (“Couple Missionaries: ‘A Wonderful Resource’”, *Ensign*, shkurt 1996, f. 7, 12).

# “Do të Fejohesh me Mua në Drejtësi”

Osea 1–3; 11; 13–14

---

## Qëllimi

Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë se Zoti është i dashur e i mëshirshëm dhe do të na falë kur pendohemi dhe kthehemi tek Ai.

---

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Osea 1–3. Duke përdorur shëmbëlltyrën e një bashkëshorti besnik dhe të një bashkëshorteje kurorëshkelëse, Osea përshkruan marrëdhënien midis Zotit dhe Izraelit.
  - b. Osea 11; 13–14. Për shkak të dashurisë për popullin e Tij, Zoti vazhdon ta ftojë Izraelin që të pendohet dhe të kthehet tek Ai.
2. Lexim shtesë: Pjesa tjetër e Oseas.
3. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, shkruani secilën prej frazave vijuese në copa të veçanta letrë përpara mësimin. Nëse klasa juaj është e vogël, përgatisni vetëm një copë letrë për secilin anëtar të klasës.

“Numri i bijve të Izraelit do të jetë si rëra e detit” (Osea 1:10)  
“Unë do ta derdh zemërimin tim mbi ta si uji” (Osea 5:10)  
“Zoti . . . do të na vijë si shiu” (Osea 6:3)  
“Armiku do të vërsulet . . . si një shqiponjë” (Osea 8:1)  
“Izraeli ishte një vresht i harlisur” (Osea 10:1)  
“Ndëshkimi lulëzon si kukuta në brazdat e arave” (Osea 10:4)  
“Do të jenë . . . si tymi që del nga oxhaku” (Osea 13:3)  
“Do t’i sulmoj si një arushë që ia kanë marrë këlyshët” (Osea 13:8)  
“Unë jam si një selvi përherë e blertë” (Osea 14:8)

---

## Sugjerime për

### Zhvillimin e Mësimin

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

### Aktivitet Vëmendjeje

Shpërndajuni letrat që keni përgatitur, anëtarëve të klasës (shih “Përgatitja” më sipër). Shpjegoni se secila prej këtyre frazave është një krahasim nga libri i Oseas. Bëjeni secilin anëtar të klasës që ka marrë një letër, ta lexojë frazën me zë të lartë dhe të sugjerojë një kuptim të mundshëm për krahasimin. Për shembull, të thuhet se dikush është “si luan” mund të tregojë forcë ose egërsi.

- Si mendoni ju, përse Osea dhe profetë të tjerë përdorën krahasimet? (Krahasimi i një ideje të ndërlikuar ose të panjohur me një që është më e thjeshtë ose më e njohur, e bën atë më të kuptueshme për njerëzit që po u jepet mësim. Krahasimet gjithashtu ndihmojnë për të dhënë shumë hollësi me vetëm disa fjalë.)

Shpjegoni se përveç këtyre krahasimeve më të vogla, Osea përdori gjithashtu krahasime të zgjeruara, që quhen metafora ose shëmbëlltyra (*shëmbëlltyrë* është fjala e përdorur në shkrimet e shenjta). Libri i Oseas përmban disa krahasime për të na ndihmuar të kuptojmë marrëdhënien midis Jezu Krishtit dhe popullit të Tij.

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Duke përdorur shëmbëlltyrën e një bashkëshorti besnik dhe të një bashkëshorteje kurorëshkelëse, Osea përshkruan marrëdhënien midis Zotit dhe Izraelit.

Jepni mësim dhe diskutoni për Osean 1–3. Nëse nuk e përdorët aktivitetin e vëmendjes, shpjegoni se çfarë është një shëmbëlltyrë përpara se të filloni diskutimin.

Një nga shëmbëlltyrat e përdorura më shpesh në shkrimet e shenjta e përshkruan Zotin si dhëndri (ose bashkëshorti) dhe popullin e Tij të besëlidhjes si nusja (ose bashkëshortja) e Tij. Osea 1–3 e përdor fuqishëm këtë shëmbëlltyrë, duke krahasuar adhurimin e idhujve prej Izraelit si shkelje kurore. Në këta kapituj, profeti Osea përfaqëson Zotin si bashkëshorti dhe Gomera përfaqëson Izraelin si bashkëshortja.

- Në librin e Oseas, marrëdhënia e Zotit me Izraelin (dhe me Kishën sot) krahasohet me marrëdhënien midis bashkëshortit dhe bashkëshortes. Çfarë na mëson ky krahasim mbi nivelin e zotimit dhe të devocionit që Zoti pret nga ne?
  - Në çfarë mënyre Izraeli i lashtë ishte i krahasueshëm me Gomerën, që përshkruhet si “grua . . . prostitutë”? (Shih Osea 1:2–3; 2:5, 13. Gomera e kishte lënë bashkëshortin për dashnorët e saj; Izraeli kishte harruar Zotin dhe ishte bërë i lig.)
  - Cilët ose çfarë ishin “dashnorët” e Izraelit – gjërat që kishin bërë që njerëzit të largoheshin nga Zoti? (Perëndi të tjera, të mira materiale dhe praktikat e botës.) Çfarë gjërash mund të na largojnë nga përkushtimi ynë për të ndjekur Shpëtimtarin?
  - Për cilët thoshte bashkëshortja kurorëshkelëse se i jepnin ushqimin dhe veshjen e saj? (Shih Osea 2:5.) Cilit ia atribuonin izraelitët tokën pjellore ku jetonin? (Shih Osea 2:5, 12; perëndive ose idhujve të tyre të rremë.) Në ç’ mënyrë njerëzit sot ua atribuojnë perëndive të rreme bekimet që marrin?
  - Në ç’ mënyrë bashkëshorti e kujtoi bashkëshorten e tij se ai – jo dashnorët e saj – i dhanë asaj ushqim, ujë dhe zotërime të tjera? (Shih Osea 2:8–9.) Në ç’ mënyrë Zoti ju ka siguruar juve bekime materiale dhe shpirtërore? Si mund ta tregojmë mirënjohjen tonë ndaj Zotit për bekimet që Ai na jep?
  - Cili ishte qëndrimi i bashkëshortit ndaj bashkëshortes së tij të pandershme tek Osea 2:6–13? Në ç’ mënyrë ky qëndrim ishte i ndryshëm në vargjet 14–23? (Vini në dukje se dhe pse bashkëshortja kishte qenë e pandershme, bashkëshorti ende e donte atë dhe dëshironte që ajo të kthehej tek ai. Po ashtu, Zoti ende i do njerëzit e Tij që janë larguar, dhe dëshiron që ata të kthehen sërish tek Ai.)
- Plaku Henri B. Ajring shpjegoi: “Kjo qe një histori dashurie. Kjo qe një histori e një besëlidhjeje martese e lidhur nëpërmjet dashurisë, dashurisë së palëkundur. . . . Zoti, me të cilin jam bekuar të kem bërë besëlidhje, më do mua dhe ju, . . . me një palëkundshmëri për të cilën vazhdimisht mrekullohem dhe që dëshiroj ta kem si shembull me gjithë zemrën time” (*Covenants and Sacrifice* [fjalim i mbajtur në Church Educational System Symposium, 15 gusht 1995], f. 2).
- Çfarë i premtoi bashkëshorti bashkëshortes së tij nëse ajo do të kthehej tek ai? (Shih Osea 2:19.) Çfarë u premtonte Zoti njerëzve të Tij nëse ata pendohen dhe kthehen tek Ai? (Shih Osea 2:20, 23.) Përse ky premtim është i rëndësishëm?

- Tek Osea 3:1–2, bashkëshorti e bleu bashkëshorten e tij nga dashnori i saj (ju mund të dëshironi të shpjegoni se në kulturat e Dhiatës së Vjetër, gratë shpesh konsideroheshin pronë dhe mund të bliheshin ose të shiteshin). Çfarë kërkoi bashkëshorti nga bashkëshortja e tij pasi e bleu atë? (Shih Osea 3:3.) Çfarë i premtoi ai asaj? Në çfarë kuptimi Jezu Krishti e ka “blerë” secilin prej nesh? (Shih 1 Pjetrit 1:18–19.) Çfarë kërkon Krishti nga ne si shkëmbim?

## 2. Për shkak të dashurisë për popullin e Tij, Zoti vazhdon ta ftojë Izraelin që të pendohet dhe të kthehet tek Ai.

Jepni mësim dhe diskutoni për Osean 11; 13–14.

Gjatë gjithë librit të Oseas, Zoti i qorton izraelitët për mëkatet e tyre të mëdha. Pasi Zoti, nëpërmjet Oseas, përshkruan robërinë dhe shkatërrimin që do të vijë si rezultat i ligësisë së Izraelit, Ai sërish e fton popullin e Tij që të pendohet e të vijë tek Ai.

- Një tjetër shëmbëlltje e përdorur shpesh në shkrimet e shenjta për të përshkruar marrëdhënien midis Zotit dhe popullit të Tij, është marrëdhënia zotërues-kafshë. Kjo shëmbëlltje përdoret shkurtimeisht tek Osea 11:4. Çfarë mësojmë mbi ndjenjat e Zotit për popullin e Tij nëpërmjet këtij krahasimi? (Shih Osea 11:7–9. Vini re se Përkthimi prej Joseph Smith-it i vargut 8 thotë se zemra e Zotit ishte kthyer ndaj Izraelit në vend të “zemra ime ngashërohet brenda meje”.)
- Disa herë Zoti i kujtoi izraelitët mbi mënyrën se si paraardhësit e tyre u çliruan nga robëria në Egjipt (Osea 11:1; 12:9, 13; 13:4–5). Shëmbëlltja e kujt mund të ishte kjo ngjarje? (Shih Osea 13:14. Ashtu si Zoti i çliroi fëmijët e Izraelit nga robëria në Egjipt, ashtu do t’i çlirojë ata – dhe të gjithë njerëzit që vijnë tek Ai – nga mëkati dhe vdekja.)
- Çfarë duhej të bënin izraelitët që të ktheheshin te Zoti dhe të merrnin çlirim? (Shih Osea 12:6; 14:2–3. Ata duhej të pendoheshin për mëkatet e tyre dhe të braktisnin perënditë e tjera që kishin adhuruar.) Çfarë premtoi të bënte Zoti nëse ata do të pendoheshin? (Shih Osea 14:4–7.) Çfarë premton Zoti se do të bëjë nëse ne pendohemi për mëkatet tona?
- Në ç’ mënyrë shëmbëlltyrat në librin e Oseas ju ndihmojnë që të kuptoni se si ndihet Shpëtimtari për ju?

### Përfundim

Dëshmoni që, ndërsa bekimet e Zotit janë rezervuar për ata që mbajnë urdhërimet e Tij, dashuria e Tij është e përhershme dhe për të gjithë. Edhe kur ne largohemi prej Tij nëpërmjet mëkatit, Zoti na do dhe dëshiron që ne të pendohemi dhe të kthehemi tek Ai. Nxitini anëtarët e klasës që të jenë besnikë ndaj Zotit.

### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

#### 1. “Unë dëshiroj mëshirë dhe jo flijimet” (Osea 6:6)

Tek Osea 6:6 Zoti i thotë Izraelit: “Unë dëshiroj mëshirë dhe jo flijimet, dhe njohjen e Perëndisë më shumë se olokaustet”. Gjatë shërbesës së Tij tokësore, Krishti iu referua dy herë këtij vargu për t’iu përgjigjur kritikave nga farisejtë (Mateu 9:13; 12:7). Pasi të shqyrtoni kontekstin e këtyre dy referencave (Mateu 9:10–13; 12:1–8), diskutoni se çfarë do të thotë ky varg.

## 2. “Ti je shkatërruar, o Izrael” (Osea 13:9)

Gjatë shërbesës së Oseas, Mbretëria Veriore (Izraeli) u sulmua nga asirët, që përfundimisht do ta shkatërronin mbretërinë dhe do t'i merrnin njerëzit robër. Në kuptim të drejtpërdrejtë, asirët qenë përgjegjës për shkatërrimin e Izraelit. Por Zoti tha: “Ti je shkatërruar, o Izrael” (Osea 13:9).

- Në çfarë kuptimi Izraeli e kishte shkatërruar veten? Cila ishte shpresa e vetme për shpëtim e Izraelit pas shkatërrimit të kombit të tij? (Shih Osea 13:9–10; 14:1.)

Në ç'mënyrë mund të na mbrojë ndjekja e Jezu Krishtit nga shkatërrimi material dhe shpirtëror?

## 3. Pendimi

Nëse është e disponueshme, ju mund të dëshironi të shfaqni “Repentance: It’s Never Too Late” [“Pendimi: Nuk Është Kurrë Tepër Vonë”], një fragment gjashtë minutësh nga *Family Home Evening Video Supplement (International)* (53736).



# Perëndia ua Tregon Sekretet Profetëve të Tij

Mësimi

# 35

Amos 3; 7–9; Joel 2–3

---

## Qëllimi

T'u japë mësim anëtarëve të klasës se në ditët e mëvonshme, Zoti ua zbulon sekretet profetëve të Tij dhe e derdh Shpirtin mbi të gjithë njerëzit.

---

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Amos 3:6–7. Amosi jep mësim se Zoti ua zbulon sekretet shërbëtorëve të Tij, profetëve.
  - b. Amos 7:10–17; 8:11–13; 9:8–15. Amosi thirret nga Perëndia që të jetë profet (7:10–15). Ai profetizon për robërinë dhe shpërndarjen e Izraelit (7:16–17; 9:8–10). Ai profetizon se do të ketë uri për të dëgjuar fjalën e Zotit (8:11–13). Ai profetizon se në ditët e fundit, Izraeli do të vendoset si një popull i madh e i begatë (9:11–15).
  - c. Joel 2; 3:16–17. Joeli profetizon për luftërat dhe katastrofat e ditëve të fundit (2:1–11). Ai u bën thirrje njerëzve që të pendohen (2:12–14; vini re se Përkthimi prej Joseph Smith-it i vargjeve 13 dhe 14 shpjegon se njerëzit, jo Zoti duhej të pendoheshin). Joeli profetizon se Perëndia do ta bekojë popullin e Tij në ditët e mëvonshme dhe do të derdhë Shpirtin e Tij mbi të (2:15–32; 3:16–17).
2. Lexim shtesë: Joseph Smith—Historia 1:41; Doktrina e Besëlidhje 1:14–28, 37–38.
3. Nëse përdorni aktivitetin e dytë të vëmendjes, ju mund të dëshironi të organizoni shoqërim muzikor për himnin. Ju mund të dëshironi gjithashtu të ftoni një anëtar të klasës që të tregojë shkurt ndonjë këshillë të kohëve të fundit nga profeti.
4. Nëse është e mundur, siguroni një fotografi të profetit të gjallë.

---

## Sugjerime për

### Zhvillimin e Mësimin

### Aktivitet Vëmendjeje

Ju mund të dëshironi të përdorni një prej aktiviteteve vijuese (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin. Përzgjidhni aktivitetin që do të jetë më i përshtatshmi për klasën.

1. Ndani historinë vijuese me anëtarët e klasës:

“Kur isha një bashkëshorte dhe nënë e re, bashkëshorti im kaloi dy vite në forcat ajrore të SHBA-së. Ne jetonim në banesa të ushtrisë në Long-Ajlënd në Nju-Jork. Ndërsa kujdesesha për fëmijët tanë të vegjël, shpesh takohesha me miqtë që kishin ardhur nga i gjithë vendi. Një ditë, kur një fqinjë dhe unë po flisnim për besimet tona, ajo u bë kureshtarë mbi atë se çfarë kishte ndryshe Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

I tregova asaj shkurtimisht për Rivendosjen dhe i shpjegova se Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit ka sot një profet të gjallë. Dukej se kjo vërtet i zgjoi interesimin dhe ajo dëshironte të dinte se çfarë kishte thënë profeti. Kur fillova t'i tregoj mbi Doktrinën e Besëlidhjen dhe zbulesën moderne, ajo tha: ‘Por çfarë ka thënë ai kohët e fundit?’ I tregova mbi konferencën e përgjithshme dhe se Kisha kishte një botim të përmuajshëm me një mesazh nga profeti. Atëherë ajo vërtet u interesua. Unë isha shumë e sikletosur kur pohova se nuk e kisha

lexuar mesazhin e fundit. Ajo e përfundoi bisedën tonë duke thënë: 'Do të thuash se keni një profet të gjallë dhe nuk e dini se çfarë ka thënë?' (Janette Hales Beckham, "Sustaining the Living Prophets", *Ensign*, maj 1996, f. 84).

- Nëse dikush do t'ju pyeste se çfarë ka thënë profeti i gjallë kohët e fundit, a do të ishit në gjendje t'i përgjigjeshit pyetjes?

Shpjegoni se ky mësim thekson rëndësinë e dëgjimit dhe ndjekjes së profetit të gjallë.

2. Kërkojuni anëtarëve të klasës që të këndojnë himnin "Të Falemi, Zot, për Profetin" (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 36). Shpjegoni se është e rëndësishme për ne që ta studiojmë këshillën e profetit tonë të gjallë. Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë disa këshilla që ai ka dhënë kohët e fundit. Ose ftoni një anëtar të caktuar të klasës që të këqyrë shkurt ndonjë këshillë të kohëve të fundit nga profeti.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Amosi qe një bari nga Tekoa, një qytezë e vogël në jug të Jerusalemit. Ai u shërbeu njerëzve të mbretërisë së Izraelit rreth viteve 800 deri në 750 PR. K. Shumica e këtyre njerëzve qenë në braktisje. Ata i donin pasuritë e i shtypnin të varfrit dhe ishin kaq të ngurtësuar, saqë madje, as zia e bukës ose murtaja nuk i përlulën. Ndërsa Amosi i ballafaqoi njerëzit me mëkatet e tyre, ai profetizoi dënime edhe më të rënda. Megjithatë, ai theksoi se Perëndia ishte i etur të pastronte cilindo që do të pendohej, duke paralajmëruar: "Kërkoni Zotin dhe do të rroni" (Amos 5:6). Amosi profetizoi gjithashtu për ditët e mëvonshme.

Profeti Joel u shërbeu njerëzve të mbretërisë së Judës. Nuk e dimë me saktësi se kur jetoi ai, por profecitë e tij kanë rëndësi të veçantë për ne sepse shumë prej tyre u përkasin ditëve të mëvonshme. Joeli përdori imazhin e fuqishëm të një ushtrie gllabëruese karkalecash për të simbolizuar shkatërrimin që ushtritë dhe gjykimet e Perëndisë do të sillnin në ditët e mëvonshme. Joeli profetizoi gjithashtu bekime të mëdha në ditët e mëvonshme, duke parashikuar se Zoti do të "përhap[ë] Frymën [e tij] mbi çdo mish" (Joel 2:28).

### 1. Amosi jep mësim se Zoti ua zbulon sekretet shërbëtorëve të Tij, profetëve.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Amos 3:6–7.

- Si e dëgjojmë fjalën e Zotit në kohën tonë? Çfarë jep mësim profeti Amos mbi rëndësinë e profetëve? (Shih Amos 3:7.) (Në Përkthimin prej Joseph Smith-it të Amos 3:6–7 fjala *di* përdoret në vend të fjalës *shkaktuar* dhe në vargun 7 fjala *derisa* përdoret në vend të fjalës *pa*.) Në ç'mënyrë këto ndryshime e sqarojnë kuptimin e fragmentit? Vini në dukje se vetë Përkthimi prej Joseph Smith-it është një shembull i sekreteve të Zotit që i bëhen të njohura një profeti për përfitimin tonë.
- Çfarë na mëson Doktrina e Besëlidhje 1:37–38 mbi respektin që duhet të kemi për mesazhet e profetëve? (Paraqitni fotografinë e profetit të gjallë.) Siç shënohet në Doktrina e Besëlidhje 21:4–5, çfarë këshille dhe urdhërimi u dha Zoti shenjtorëve në ditën që u organizua Kisha? Çfarë bekimesh premtoi Ai nëse

shenjtorët do ta bënin këtë? (Shih DeB 21:6.) Si e keni parë këtë premtim të përmbushet në vetë jetën tuaj ndërsa i jeni bindur këshillës së profetëve?

## 2. Amosi profetizon për Izraelin e lashtë dhe të ditëve të mëvonshme.

Jepni mësim dhe diskutoni për Amos 7:10–17; 8:11–13; 9:8–15.

- Përse Amatsiahu, një prift në mbretërinë e Izraelit, i kërkoi Amosit që të largohej nga vendi? (Shih Amos 7:10–17. Amosi kishte profetizuar se e liga do t'u vinte njerëzve dhe mbretit të tyre. Amatsiahu dhe njerëzit e tij nuk donin ta dëgjonin të vërtetën mbi veprimet e tyre të liga.) Çfarë na mësojnë vargjet 14 deri 17 mbi profetin Amos? (Ai kishte integritet moral dhe kurajë. Ai nuk do ta ndryshonte atë çfarë i kishte thënë Zoti që të thoshte, por vazhdoi të profetizonte se e liga do t'u vinte njerëzve nëse ata nuk do të pendoheshin.)
- Gjatë të gjithë periudhave të kohës, përse kaq shumë njerëz nuk i kanë pranuar ose i kanë shpërfillur mesazhet e profetëve? Çfarë profetizoi Amosi se do të ishte pasoja nëse Izraeli nuk do ta pranonte këshillën e profetëve? (Shih Amos 8:11–13. Do të vinte si rezultat uria shpirtërore, apo braktisja.) Cilat janë pasojat për ne personalisht nëse nuk e pranojmë këshillën e profetëve?

Profecia e Amosit për uri shpirtërore u përmbush mes fëmijëve të Izraelit pas kohës së Malakias, profetit të fundit të Dhiatës së Vjetër. Kjo periudhë mori fund afërsisht 400 vite më vonë kur Gjon Pagëzori u thirr për të përgatitur udhën për Jezu Krishtin. Profecia e Amosit zbatohet gjithashtu për Braktisjen e Madhe, shekujt e errësirës shpirtërore që vijuan pas vdekjes së Apostujve të Shpëtimtarit dhe që përfunduan me rivendosjen e ungjillit nëpërmjet Profetit Jozef Smith.

- Në çfarë mënyrash mungesa e fjalës së Zotit mund të krahasohet me një zi buke? Çfarë provash shihni se njerëzit sot enden “nga një det në tjetrin” duke kërkuar fjalën e Zotit? Në ç'mënyrë të pasurit e bekimeve të ungjillit të rivendosur mund të krahasohet me një banket?
- Me çfarë mesazhi shprehe mbyllet libri i Amosit? (Shih Amos 9:8–15. Fëmijët e Izraelit nuk do të shkatërroheshin plotësisht, ata do të shpërndaheshin mes gjithë kombeve dhe në ditët e fundit ata do të rivendoseshin si një popull i madh e i begatë. Vini re se në fund të vargut 9, Zoti e bën të qartë se ai interesohet për secilin anëtar të shtëpisë së Izraelit.)

## 3. Joeli profetizon se Perëndia do ta bekojë popullin e Tij në ditët e mëvonshme dhe do të derdhë Shpirtin e Tij mbi të.

Jepni mësim dhe diskutoni për Joelin 2; 3:16–17.

Profeti Joel përshkroi disa nga ngjarjet e ditëve të mëvonshme që do t'i paraprinin Ardhjes së Dytë. Ai përshkroi marshimin e një ushtrie të madhe që do të shkatëronte shkatërrim të madh për shkak të ligësisë së njerëzve (Joel 2:1–11). Ai i bëri thirrje Izraelit që të pendohet dhe t'i drejtohet Zotit, premtoi se Perëndia do të ishte mes tyre dhe përshkroi triumfin dhe shëlbimin përfundimtar të Izraelit (Joel 2:12–32).

- Shkruani në dërrasë *Joel 2:12–32* dhe *Joel 3:16–17*. Kërkojuni anëtarëve të klasës t'i këqyrin këto fragmente dhe të kërkojnë përgjigje për pyetjen vijuese: Çfarë ftesash u ka bërë Zoti atyre që jetojnë në ditët e mëvonshme?

Shkruani në dërrasë fjalën *Ftesa*. Ndërsa anëtarët e klasës përmendin fraza, shkruani në dërrasë fjalë kyç nga secila ftesë. Nxitini anëtarët e klasës që t'i shenjojnë këto fraza në shkrimet e tyre të shenjta. Sa vijon janë disa ftesa që mund të përmenden:

#### *Ftesa*

- a. "Kthehuni tek unë me gjithë zemrën tuaj" (Joel 2:12).
  - b. "Grisni zemrën tuaj" (Joel 2:13, që do të thotë zbutni zemrën ose jini të përrulur).
  - c. "Kthehuni tek Zoti, Perëndia juaj" (Joel 2:13).
  - ç. "Shenjtëroni kuvendin" (Joel 2:16).
  - d. "Mos kij frikë, o tokë, gëzohu, ngazëllohu" (Joel 2:21).
- Çfarë sugjerojnë këto ftesa mbi rëndësinë e kthimit te Zoti me gjithë zemrën tonë? Çfarë mund të bëjmë për të shenjtëruar veten që të jemi të denjë për bekimet e premtuara të Zotit?
  - Kërkojuni anëtarëve të klasës që të këqyrin sërish Joel 2:12–32 dhe Joel 3:16–17 duke kërkuar përgjigje për pyetjen në vijim: Çfarë bekimesh u ka premtuar Zoti atyre që e ndjekin Atë në ditët e mëvonshme?

Shkruani në dërrasë fjalën *Bekime*. Ndërsa anëtarët e klasës përmendin fraza, shkruani në dërrasë fjalë kyç nga secili bekim. Anëtarët e klasës mund të dëshirojnë gjithashtu që t'i shenjojnë këto fraza në shkrimet e tyre të shenjta. Sa vijon janë disa bekime që mund të përmenden:

#### *Bekime*

- a. Zoti është i dhembshur, i mëshirshëm dhe i ngadalshëm në zemërim; Ai ka shumë dashamirësi dhe do ta largojë të ligën nga ju (shih Joseph Smith Translation, Joel 2:13).
  - b. Zotit do t'i "[vijë] keq për popullin e tij" (Joel 2:18).
  - c. Zoti do ta largojë ushtrinë e veriut (përshkruar në vargjet 1–11) në një tokë të shkretë (Joel 2:20).
  - ç. "Ju do të hani me bollëk dhe do të ngopeni" (Joel 2:26).
  - d. "Unë jam në mes të Izraelit . . . ; popullin tim nuk do ta mbulojë më turpi" (Joel 2:27).
  - dh. "Unë do të përhap Frymën tim mbi çdo mish" (Joel 2:28; shih edhe vargun 29).
  - e. Të rinj e të moshuar do të profetizojnë, do të shohin ëndrra dhe do të kenë vegime (Joel 2:28).
  - ë. "Kushdo që do t'i drejtohet emrit të Zotit do të shpëtojë" (Joel 2:32).
  - f. "Zoti do të vrumbullojë nga Sioni dhe do të bëjë që t'i dëgjohet zëri nga Jerusalemi" (Joel 3:16).
  - g. "Zoti do të jetë një strehë për popullin e tij" (Joel 3:16).
  - gj. "Zoti do të jetë . . . një fortesë për bijtë e Izraelit" (Joel 3:16).
  - h. "Atëherë ju do të pranoni që unë jam Zoti, Perëndia juaj, që banon në Sion" (Joel 3:17).
- Çfarë na mësojnë këto bekime mbi zotimin e Zotit ndaj popullit të Tij të besëlidhur, mbi fuqinë e Tij në emër të shenjtorëve të Tij, mbi mëshirën dhe dashurinë e Tij, mbi mundësitë tona në ditët e fundit?

- Deklarata e Joelit se Zoti do ta derdhë Shpirtin e Tij mbi të gjithë njerëzit në ditët e mëvonshme (Joel 2:28–29) është në kundërshtim të theksuar me zinë e bukës që përshkroi Amosi (Amos 8:11–12). Engjëlli Moroni ia citoi profecinë e Joelit Jozef Smithit dhe i tha atij se nuk ishte përmbushur ende por se shpejt do të përmbushej (Joseph Smith—Historia 1:41). Çfarë shembujsh keni parë të kësaj përmbushjeje në jetën e të rinjve dhe të të rriturve sot?

## Përfundim

Theksoni se është një bekim i madh të jetojmë në ditët e mëvonshme, kur shumë profeci po përmbushen dhe kur kemi udhëheqjen e një profeti të gjallë. Nxitini anëtarët e klasës që të studiojnë me lutje fjalët e profetit të gjallë dhe ta zbatojnë këshillën e tij në jetën e tyre.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

## 1. Të bëhesh i shkujdesur në Sion

- Amosi i paralajmëroi njerëzit mbi të jetuarin “në bollëk në Sion” (Amos 6:1). Çfarë do të thotë të bëhesh i shkujdesur në Sion? (Shih 2 Nefi 28:19–24, 27, 29–30.)

Në çfarë mënyrash ne mund të bëhemi të shkujdesur në Sion sot? Si mund të mbrohemi kundrejt kësaj?

## 2. “Unë do të përhap Frymën tim mbi çdo mish” (Joel 2:28)

- Të gjitha shpikjet moderne të udhëtimit e të komunikimit kanë ardhur që kur ungjilli u rivendos. Në ç’ mënyrë këto zhvillime ndihmojnë në përmbushjen e profecisë së Joelit te Joeli 2:28–29? Në ç’ mënyrë këto zhvillime ndihmojnë për të çuar më tej punën e Zotit në kohën tonë?

Ju mund të dëshironi të lexoni thënien vijuese nga Plaku Jozef Filding Smith për të ndihmuar anëtarët e klasës që të kuptojnë dobinë e madhe të këtyre shpikjeve në kryerjen e punës së Zotit:

“Unë jam shumë i bindur se, po të mos kishte pasur rivendosje të ungjillit dhe organizim të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, nuk do të kishte pasur radio; nuk do të kishte pasur aeroplanë dhe nuk do të kishin qenë zbulimet e mrekullueshme në mjekësi, kimi, elektricitet dhe shumë gjëra të tjera që bota ka përfituar nga zbulime të tilla. Në kushte të tilla, këto bekime do të ishin mbajtur, sepse ato i përkasin Periudhës Ungjillore të Plotësisë së Kohëve, në të cilën rivendosja e ungjillit dhe organizimi i Kishës përbëjnë pikën qendrore, nga të cilat rrezaton Shpirti i Zotit në mbarë botën. Frymëzimi i Zotit ka dalë dhe ka ndikuar mendjet e njerëzve, edhe pse ata nuk e dinë, dhe ata drejtohen nga Zoti. Në këtë mënyrë Ai i sjell ata në shërbim të Tij që qëllimet dhe drejtësia e Tij, në kohën e duhur, të mund të jenë supreme në tokë.

. . . Unë nuk besoj për asnjë çast se këto zbulime kanë ardhur rastësisht, ose se ato kanë ardhur për shkak të inteligjencës më të lartë që zotërojnë njerëzit sot kundrejt atyre që kanë jetuar në epokat që kanë kaluar. Ato kanë ardhur dhe po vijnë sepse bota është gati, sepse Zoti e ka dashur atë dhe sepse Ai ka përhapur Frymën e Tij mbi çdo mish” (në Conference Report, tetor 1926, f. 117).

**Qëllimi** Të nxisë anëtarët e klasës që të shmangin të ligat e botës duke qëndruar në vende të shenjta dhe t'i ndihmojë ata të marrin forcë nga gatishmëria e Isaias për të shërbyer.

**Përgatitja** 1. Studiojini me lutje fragmentet nga Isaia 1–6 që diskutohen në këtë mësim.  
2. Lexim shtesë: 2 Nefi 11.

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje** Shpjegoni se Zoti shpesh e përsërit të njëjtën ide shumë herë gjatë gjithë shkrimeve të shenjta. Shkruani referencat vijuese në dërrasë dhe kërkojuni anëtarëve të klasës që të zbulojnë se çfarë këshille ka dhënë Zoti për të na ndihmuar të durojmë sprovat e ditëve të fundit:

Doktrina e Besëlidhje 45:32

Doktrina e Besëlidhje 87:8

Doktrina e Besëlidhje 101:22

Shkruani në dërrasë *“Qëndroni në vende të shenjta dhe mos lëvizni”*.

- Si mendoni, çfarë do të thotë kjo frazë? (Përgjigjet mund të përfshijnë të qenit i denjë në të gjitha kohët, dëshirën për të qenë shpesh në vende të shenjta, zgjedhjen për të mos shkuar në vende jo të shenjta, të pasurit e mirëbesimit se Perëndia do t’ju udhëheqë dhe mbrojtjen e së vërtetës dhe shenjtërisë.)

Shpjegoni se në këtë mësim, anëtarët e klasës do të zbulojnë se përse Zoti na ka urdhëruar që të qëndrojmë në vende të shenjta dhe cilat janë këto vende të shenjta.

**Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë**

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

*“Të mëdha janë fjalët e Isaias”,* shpalli Shpëtimtari kur i urdhëroi nefitët të kërkonin profecitë e Isaias (3 Nefi 23:1). Profecitë e Isaias janë cituar në Dhiatën e Re, Librin e Mormonit dhe Doktrinën e Besëlidhjet më shpesh se fjalët e cilitdo profeti tjetër. Ai profetizoi shumë gjëra mbi misionin tokësor të Shpëtimtarit, mbi shkatërrimin që do të vijonte pas ligësisë së Izraelit dhe mbi misionin dhe fatin e Izraelit të ditëve të mëvonshme.

### 1. Isaia përshkruan gjendjen e botës në ditët e fundit.

- Shumë prej paralajmërimeve dhe profecive të Isaias zbatohen si për kohën e tij, që ishte një kohë ligësie të madhe, ashtu dhe për kohën tonë. Në ç’mënyrë kushtet e përshkruara në shkrimet e shenjta vijuese janë të dukshme në botë



sot? (Ju mund të dëshironi t'i shkruani referencat në dërrasë dhe t'i bëni anëtarët e klasës që t'i gjejnë ato.)

- a. Isaia 1:3–5 (Rebelim kundër Zotit)
  - b. Isaia 1:11–15 (Ceremoni fetare pa kuptim ose besim)
  - c. Isaia 2:7–8 (Adhurim i gjërave të botës dhe i sigurisë ushtarake në vend të Zotit; vini re se kuajt dhe qerret përdorëshin si mjete lufte në kohë të lashta)
  - ç. Isaia 2:11–12 (Krenaria)
  - d. Isaia 3:5 (Shtypja e njerëzve të tjerë dhe mungesa e nderimit të njerëzve më të moshuar)
  - dh. Isaia 3:9 (Paturpësi për mëkatën)
  - e. Isaia 3:14–15 (Marrja nëpër këmbë e të varfërve dhe mungesa e kujdesit për ta)
  - ë. Isaia 3:16–24 (Theksimi i bukurisë së jashtme fizike pa vëmendje për drejtësinë dhe karakterin e mirë)
  - f. Isaia 5:8 (Dëshira lakmitare për të zotëruar gjithmonë e më shumë gjëra materiale)
  - g. Isaia 5:11–12 (Kërkimi i vazhdueshëm i kënaqësive të botës në vend të kërkimit të Zotit dhe të punës së Tij)
  - gj. Isaia 5:20 (Të thënit se gjërat e këqija janë të mira dhe gjërat e mira të këqija)
  - h. Isaia 5:21 (Mirëbesimi te vetja në vend se te Perëndia)
  - i. Isaia 5:24 (Përçmimi i urdhërimeve dhe i fjalës së Perëndisë)
- Si po përmbushen këto profeci sot? (Shih idenë e mësimdhënies shtesë për diskutim të mëtejshëm të disa prej këtyre profecive.)

## 2. Isaia i këshillon besnikët të qëndrojnë në vende të shenjta.

- Cilat vende ofrojnë siguri prej kushteve të botës të përmendura nga Isaia? Cilët janë tre vendet e shenjta të përmendura tek Isaia 4:5–6?
  - a. Çdo banesë e malit Sion (shtëpitë)
  - b. Kuvendet (kunjet, lagjet e degët; shih edhe DeB 115:5–6)
  - c. Tabernakujt (tempujt)
- Në ç'mënyrë një shtëpi mund të jetë një vend i shenjtë që ofron strehë nga ligësia e botës? Në ç'mënyrë kunjet, lagjet dhe degët mund të jenë vende të shenjta e streha? Në ç'mënyrë një tempull mund të jetë një vend i shenjtë e strehë? Në ç'mënyrë këto tre vende të shenjta kanë ndihmuar për të siguruar një mbrojtje për ju kundrejt të ligave të botës?

Ju mund të dëshironi të shkruani në dërrasë *Qëndroni në Vende të Shenjta* dhe pastaj shkruani ndën të 1. *Shtëpitë*; 2. *Kunjet, Lagjet e Degët*; dhe 3. *Tempujt*. Rendisni komentet e anëtarëve të klasës nën çdo pikë.

- Çfarë shprehjesh përdoren tek Isaia 4:5–6 për të përshkruar se si do të na mbrojnë këto vende të shenjta?
  - a. “Një çadër që do të shërbejë për të bërë hije kundër të nxehitit të ditës”
  - b. “Strehë”
  - c. “Mbrojtje [vend fshehjeje ose strehë] kundër furtunës dhe shiut”
- Shumë prej shkrimeve të Isaias janë përfshirë gjithashtu në Librin e Mormonit. Vëri anëtarët e klasës që të lexojnë 2 Nefi 14:5 për të zbuluar se çfarë fjalësh i janë shtuar Isaias 4:5. (Janë shtuar fjalët e *Sionit*.) Çfarë i shtojnë këto fjalë kuptueshmërisë sonë për këtë varg?

- Çfarë profecie mbi tempujt në ditët e fundit është përfshirë tek Isaia 2:2–3? (Shumë njerëz do të vijnë në shtëpinë e Perëndisë, që është tempulli, dhe do të dëshirojnë të mësojnë urdhërimet e Perëndisë e të ecin në udhët e Tij.) Si mendoni ju, përse Isaia e përshkroi tempullin si “malin e Zotit”? (Profetët e lashtë shpesh shkonin në male për të biseduar me Zotin dhe për të marrë këshillë prej Tij. Ai u zbulonte atyre gjëra atje. Ne mund të kemi përvoja të ngjashme në tempull sot.)

### 3. Isaia përshkruan mbledhjen e Izraelit në ditët e mëvonshme.

Në Isaia 5:26–29, Isaia përshkruan mbledhjen e Izraelit në ditët e mëvonshme. Flamuri që ngrihet është Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. T’u “fërshëllezë” është t’u thërrasë, që përfaqëson ftesën ndaj kombeve të tokës për t’u mbledhur në Kishë. Ky grumbullim do të jetë i shpejtë dhe i fuqishëm.

- Si po përmbushet sot profecia se kombet do të mbledhen në Kishë? (Misionarët po shkojnë në mbarë botën për t’u mësuar ungjillin dhe për t’i mbledhur njerëzit tek e vërteta.) Çfarë mund të bëjë secili prej nesh për të ndihmuar që të përmbushet kjo profeci?

### 4. Isaia iu përgjigj me gatishmëri thirrjes së tij për të qenë profet.

Zoti e thirri Isaian që të ishte profet nëpërmjet një vegimi në të cilin Isaia pa Zotin në lavdinë e Tij. Ky vegim është shënuar tek Isaia 6.

- Në ç’mënyrë e përshkruan Isaia lavdinë e Zotit? (Shih Isaia 6:1–4.) Cila ishte përgjigjja e Isaias kur ai pa Zotin? (Shih Isaia 6:5. Isaia u ndie i padenjë për të qenë në praninë e Zotit.) Në ç’mënyrë Zoti simbolikisht tregoi se Isaia ishte i pastër përpara Tij? (Shih Isaia 6:6–7.) Si u përgjigj Isaia kur Zoti e thirri atë që të ishte profet? (Shih Isaia 6:8.)
- Duke e pranuar thirrjen e tij, Isaia përdori të njëjtat fjalë si Shpëtimtari kur Ai pranoi përgjegjësinë për të kryer planin e Atit tonë në Qiell për shpëtimin e fëmijëve të Tij (Abraham 3:27). Cilat janë disa situata në të cilat neve gjithashtu mund të na nevojitet t’i përgjigjemi Zotit me fjalë të ngjashme? (Përgjigjet mund të përfshijnë kur thirremi për të shërbyer misionë, kur na kërkohet të shërbejmë në Kishë dhe kur na kërkohet të durojmë sprovat të vështira.)
- Shumë kapituj të Isaias janë shënuar në Librin e Mormonit, përfshirë kapitujt 2 deri 6. Çfarë arsyesh dha profeti Nefi për përfshirjen e shkrimeve të Isaias në analin e tij? (Shih 2 Nefi 11:8.)
- Cilat mesazhe nga këta kapituj nga Isaia ju bëjnë të gëzoheni? Cilat mesazhe të këtyre kapitujve i ndieni më të rëndësishmit për t’i përshtatur me veten?

#### Përfundim

Fjalët e Isaias na mësojnë shumë gjëra mbi ditët e mëvonshme. Duke studiuar këshillën e Isaias, ne mund të mësojmë se si të qëndrojmë në vende të shenjta dhe të shmangim të ligat e botës. Duke ndjekur shembullin e tij, ne mund të jemi shërbëtorë më të gatshëm të Atit tonë në Qiell.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimit. Ju mund të dëshironi ta përdorni atë si pjesë të mësimit.

## Diskutim i mëtejshëm për profecitë e Isaia në Isaia 1–6

### *Bërja e praktikave tona fetare të pranueshme për Zotin*

- Sipas Isaia 1:11, 16–17, përse flijimet e izraelitëve ishin të papranueshme për Zotin? (Edhe pse izraelitët përpiqeshin të ishin fetarë së jashtmi, zemrat e tyre ishin larg nga Perëndia. Shih edhe Mateu 5:23–24; Moroni 7:6–9.) Përse disa njerëz përpiqen të jenë fetarë së jashtmi edhe pse zemrat e tyre janë larg nga Perëndia? Përse kjo lloj hipokrizie e fyen Perëndinë?

### *Bekimet e faljes*

- Isaia dha dy ide të bukura që na ndihmojnë të kuptojmë se sa plotësisht Zoti do t'i falë ata që pendohen. Ai tha: “Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi” (Isaia 1:18). Në ç'mënyrë këto ide na ndihmojnë kur kemi mëkatuar dhe ndihemi larg nga Zoti? (Shih edhe DeB 58:42.)

### *Shmangia e natyrës materialiste në paraqitje*

- Plaku Jozef Filding Smith tha se profecia tek Isaia 3:16–24 u referohet anëtarëve të Kishës sot dhe “u takon si burrave ashtu edhe grave” (*Answers to Gospel Questions*, përmb. Joseph Fielding Smith Jr., 5 vëll. [1957–1966], 5:174). Si mundet mënyra jonë e veshjes të pasqyrojë ose ndikojë mirëqenien tonë shpirtërore? Çfarë do të thotë të vishesh me thjeshtësi? Cilët janë rreziqet e të bërit tepër i interesuar për veshjen dhe paraqitjen personale? (Shih Alma 31:27–28.) Si mund t'u mësojmë fëmijëve që të shmangin natyrën materialiste në paraqitje?

### *Quajtja e së keqes e mirë dhe e së mirës e keqe*

- Përse ishte dobësuar aftësia e Izraelit për të dalluar midis së mirës dhe së keqes? (Shih Isaia 5:20.) Në çfarë mënyrash njerëzit sot e quajnë të keqen të mirë dhe të mirën të keqe? Çfarë mund të bëjmë që të sigurohemi se e dallojmë ndryshimin midis të mirës dhe të keqes? (Shih 2 Nefi 32:5; DeB 45:57.)

### *“Të urtë në sytë e tyre”*

- Çfarë donte të thoshte Isaia kur i paralajmëroi njerëzit që të mos ishin “të urtë në sytë e tyre dhe të zgjuar para vetvetes”? (Isaia 5:21). Çfarë e shkakton këtë problem? Përse është i rrezikshëm? Si mund të ruhemi prej tij?

### *“Dora e tij rri e shtrirë”*

- Çfarë mesazhi theksoi Isaia tek Isaia 5:25, 9:12, 17, 21 dhe 10:4? Përse ky mesazh është i rëndësishëm? Si keni arritur të dini për të vërtetën e këtij mesazhi?

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të vijnë te Krishti duke dalluar disa nga gjërat e mrekullueshme që ka bërë Ai.
<b>Përgatitja</b>	<p>Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Isaia 22:22. Shpëtimtari hap derën për në praninë e Atit Qiellor.</li> <li>Isaia 24:21–22. Shpëtimtari tregon mëshirë për ata që janë në burgun shpirtëror.</li> <li>Isaia 25:1–4; 32:1–2. Shpëtimtari është një forcë dhe një strehë.</li> <li>Isaia 25:6–9. Shpëtimtari do të përgatisë një gosti dhe do të shkatërrojë “mbulesën”.</li> <li>Isaia 25:8. Shpëtimtari do t’i thajë lotët tanë.</li> <li>Isaia 26:19. Shpëtimtari do të sjellë Ringjalljen.</li> <li>Isaia 28:16. Shpëtimtari është themeli ynë i sigurt.</li> <li>Isaia 29:4, 9–14, 18, 24. Shpëtimtari do të rivendosë ungjillin në tokë.</li> <li>Isaia 30:19–21. Shpëtimtari i di sprovat tona dhe drejton shtigjet tona.</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	Tregojuni anëtarëve të klasës për një anëtar të familjes ose mik që ka bërë një gjë të mrekullueshme për ju. Ftojini anëtarët e klasës që të flasin për njerëz që kanë bërë gjëra të mrekullueshme për ata. Kërkojuni atyre të përshkruajnë shkurtimeisht ndjenjat e tyre kundrejt këtyre njerëzve. Shpjegoni se ky mësim do të theksojë disa nga gjërat e mrekullueshme që ka bërë Shpëtimtari.
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p>Shpjegoni se profeti Isaia, shumë prej mësimave të tij, i dha me një gjuhë simbolike. Kjo gjuhë nuk jep mësim drejtpërdrejt, prandaj duhet t’i shqyrtojmë dhe të meditojmë për fjalët e Isaias për të zbuluar të vërtetat që japin mësim ato.</p> <p>Një pjesë e shprehjeve më të bukura dhe thellësisht simbolike të Isaias janë për Shpëtimtarin, gjë që është qendra e këtij mësimi. Ju mund të dëshironi të shkruani në dërrasë “Do të quhet Këshilltar i admirueshëm” (Isaia 9:6). Ndërsa diskutoni për profecitë vijuese mbi Shpëtimtarin, përmbliidheni secilën prej tyre në dërrasë.</p> <p><b>1. Shpëtimtari hap derën për në praninë e Atit Qiellor.</b></p> <p>Diskutoni për Isaian 22:22.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Isaia 22:22 thotë se Mesia ka “çelësin e shtëpisë së Davidit”. Kjo është një mënyrë simbolike për të thënë se Shpëtimtari ka fuqinë ta pranojë ose përjashtojë cilindo njeri nga prania e Atit Qiellor. (Shih edhe Zbulesa 3:7–8; 2 Nefi 9:41.) Çfarë bëri Shpëtimtari për ta hapur këtë derë për ne? Çfarë duhet të bëjmë ne që të jemi në gjendje të hyjmë? (Shih 2 Nefi 9:45.)</li> </ul>

## 2. Shpëtimtari tregon mëshirë për ata që janë në burgun shpirtëror.

Diskutoni për Isaian 24:21–22.

- Cilit burg i referohet Isaia 24:21–22? (Burgu shpirtëror, vendi ku shkojnë shpirtat e disa njerëzve të vdekur, ndërsa presin Ringjalljen.) Përse shpirtat e disa njerëzve të vdekur janë në burgun shpirtëror? (Shih DeB 138:32. Disa prej tyre nuk e morën ungjillin në tokë dhe të tjerë nuk qenë të guximshëm në dëshmitë e tyre.)
- Çfarë bëri Shpëtimtari për shpirtat në burg? (Shih Isaia 42:5–7; DeB 138:29–37. Ai organizoi shpirtat të drejtë për t'u dhënë atyre mësim ungjillin.) Si e tregon kjo dashurinë dhe mëshirën e Shpëtimtarit? (Shih Isaia 49:9–10.)

## 3. Shpëtimtari është një forcë dhe një strehë.

Diskutoni për Isaian 25:1–4; 32:1–2.

- Isaia shkroi për Shpëtimtarin që na forcon gjatë stuhive, furtunës, shkretëtirës dhe të nxehtit të jetës sonë. Çfarë na mësojnë idetë vijuese mbi mënyrën se si na ndihmon Shpëtimtari kur përballemi me sfida të tilla?
  - a. Ai është një strehë kundër stuhisë (Isaia 25:4).
  - b. Ai është një hije kundër të nxehtit (Isaia 25:4).
  - c. Ai është një mbrojtje nga era (Isaia 32:2).
  - ç. Ai është një strehë nga uragani (Isaia 32:2).
  - d. Ai është rrëke uji në një vend të thatë (Isaia 32:2).
  - dh. Ai është hija e një shkëmbi të madh në një tokë të zhuritur (të etur) (Isaia 32:2).

## 4. Shpëtimtari do të përgatisë një gosti dhe do të shkatërrojë “mbulesën”.

Diskutoni për Isaian 25:6–9.

- Një interpretim për Isaian 25:6–7 është se mali është një simbol për tempullin (shih edhe Isaia 2:2; DeB 58:8–9). Çfarë është gostia e përmendur në Isaia 25:6? (Një gosti me fjalët dhe mësimet e Krishtit.) Në ç'mënyrë pjesëmarrja në tempull mund të jetë si një gosti?
- Një mbulesë është një mbështjellëse e hollë. Simbolikisht ajo shpesh përfaqëson mosbesimin që i pengon njerëzit të vijnë vërtet te Krishti (Moisiu 7:26). Në ç'mënyrë do të shkatërrohet “mbulesa” që është mbi tokë? (Shih Isaia 25:7–9.)

## 5. Shpëtimtari do t'i thajë lotët tanë.

Diskutoni për Isaian 25:8.

- Çfarë bëni kur dikush që doni, është duke qarë? Në ç'mënyrë Shpëtimtari “do t'i thajë lotët” tona? (Sugjeroni që anëtarët e klasës të përfytyrojnë një prind që than lotët në fytyrën e një fëmije. Ka një ndjesi afërsie në këtë veprim. Është një gjest i ëmbël që tregohet vetëm nga njerëz që e duan dhe i mirëbesojnë thëllësisht njëri-tjetrit.)
- Cilat janë kushtet e përmendura te Zbulesa 21:4 që shkaktojnë lot? Si do t'i thajë Shpëtimtari lotët që janë shkaktuar nga këto kushte?

## 6. Shpëtimtari do të sjellë Ringjalljen.

Diskutoni për Isaian 26:19.

- Isaia profetizoi që, kur të vinte Mesia, Ai do të vdiste dhe do të ringjallej (Isaia 25:8). Kush tjetër do të ringjallet? (Shih Isaia 26:19; 1 Korintasve 15:20–22; Alma 11:43–44. Të gjithë fëmijët e Perëndisë që kanë jetuar në tokë, do të ringjallen.) Çfarë sugjeron Isaia 26:19 mbi mënyrën se si do të ndihemi kur të ringjallemi? (Shih edhe DeB 138:12–16, 50.)

Profeti Jozef Smith tha: “Kur zëri të thërrasë që të vdekurit të ngrihen, . . . cili do të ishte gëzimi i parë i zemrës sime? Të takoj atin tim, nënën time, vëllain tim, motrën time; dhe kur ata të jenë pranë meje, unë t’i përqafoj ata dhe ata mua” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith*, përzgj. Joseph Fielding Smith [2009], f. 184).

## 7. Shpëtimtari është themeli ynë i sigurt.

Diskutoni për Isaian 28:16.

- Çfarë na thotë Isaia për Shpëtimtarin duke iu referuar atij si një “gur [i] provuar”? (Shih Mosia 3:17.) Në ç’mënyrë Jezu Krishti është “themel[i] ynë i sigurt”? (Shih Helamani 5:12.) Çfarë mund të bëjmë ne që të ndërtojmë mbi këtë themel? Çfarë premtion Zotit nëse ne ndërtojmë mbi këtë themel? (Shih DeB 50:44.)

## 8. Shpëtimtari do të rivendosë ungjillin në tokë.

Diskutoni për Isaian 29:4, 9–14, 18, 24.

- Çfarë parashikoi Isaia mbi rivendosjen e ditëve të mëvonshme të ungjillit? (Shih Isaia 29:4, 9–14. Ai parashikoi se do të vinte në një kohë errësire shpirtërore. Ai parashikoi gjithashtu daljen në dritë të Librit të Mormonit.)

Krahasoni vargjet vijuese tek Isaia 29 me fragmentet korresponduese tek Libri i Mormonit, Perla me Vlerë të Madhe dhe Doktrina e Besëlidhje për të parë se si janë përmbushur disa nga profecitë e Isaias:

a. Isaia 29:4	Moroni 10:27
b. Isaia 29:9–10, 13	Joseph Smith – Historia 1:18–19
c. Isaia 29:11–12	Joseph Smith – Historia 1:63–65
ç. Isaia 29:14	Doktrina e Besëlidhje 4:1; 6:1

- Isaia tregoi për njerëzit që i afrohen Zotit me gojën e tyre ndërsa zemra e tyre është larg prej Tij (Isaia 29:13). Si mund të sigurohemi se jemi pranë Zotit në mendimet dhe në veprimet tona si edhe në fjalët tona?
- Isaia tha se Libri i Mormonit do t’i ndihmonte të shurdhrit e të verbrit shpirtërisht që të dëgjojnë e të shohin (Isaia 29:18, 24). Si është përmbushur kjo profeci? Në ç’mënyrë Libri i Mormonit ju ka ndihmuar që të shihni e të dëgjoni më mirë shpirtërisht?

## 9. Shpëtimtari i di sprovat tona dhe drejton shtigjet tona.

Diskutoni për Isaian 30:19–21.

- Çfarë jep mësim Isaia 30:19–21 mbi vështirësitë? Çfarë na mësojnë këto vargje mbi atë që do të bëjë Shpëtimtari për ne kur vijnë vështirësitë? (Shih Alma 37:37.)



**Përfundim** Jepni dëshminë tuaj për Shpëtimtarin, duke shprehur mirënjohje për gjërat e mrekullueshme që Ai ka bërë për ne. Ftojini anëtarët e klasës që të këqyrin listën në dërrasë dhe të shprehin se si ndihen kur mendojnë për këto gjëra. Diskutoni se çfarë mund të bëjmë ne si këmbim. (Shih Isaia 35:3–4 për disa sugjerime.) Ju mund të dëshironi gjithashtu t'i vini anëtarët e klasës të këndojnë “Qëndroj Plot Habi” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 22).

**Ide Mësimdhënieje Shtesë** Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimit. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimit.

### **1. Objekte që përfaqësojnë disa nga idetë e Isaias.**

Paraqisni objekte ose figura të ndryshme që përfaqësojnë disa nga idetë e Isaias, të tilla si një çelës, një gur, ose figurën e një strehe në shkretëtirë, ndërsa diskutoni për këto ide.

### **2. Muzikë nga pjesa *Mesia* e Handelit**

Luani një regjistrim të “Sepse na Ka Lindur një Fëmijë”, interpretimi muzikor i Isaias 9:6 nga pjesa *Mesia* e Xhorxh Friderik Handelit.

### **3. “Prekja e Dorës së Mjeshtrit”**

Nëse është e disponueshme *Family Home Evening Video Supplement (International)* (53736), ju mund të dëshironi të shfaqni “The Touch of the Master’s Hand” [“Prekja e Dorës së Mjeshtrit”], një fragment 18-minutësh, si pjesë të mësimit.

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë se Jezu Krishti është i pashoq në devocionin ndaj njerëzve të Tij dhe se Ai ka një punë të madhe për ta bërë ata.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Studiojini me lutje fragmentet nga Isaia 40–49 që diskutohen në këtë mësim.</li> <li>Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, shkruajini citimet vijuese në një afishe ose në dërrasë përpara orës mësimore:             <ol style="list-style-type: none"> <li>“Ç’u duket juve për Krishtin?” (Mateu 22:42.)</li> <li>“Çfarë lloj njerëzish duhet të jeni?” (3 Nefi 27:27.)</li> <li>“Kush thonë njerëzit se jam unë, i Biri i njeriut? . . . Po ju, kush thoni se jam unë?” (Mateu 16:13, 15.)</li> <li>“Kushdo që është me Zotin” (Eksodi 32:26).</li> <li>“A keni marrë shëmbëlltyrën e tij në pamjen tuaj?” (Alma 5:14.)</li> </ol> </li> <li>Nëse është e disponueshme <i>Family Home Evening Video Supplement (International)</i> (53736), ju mund të dëshironi të shfaqni fragmentin pesëminutësh “What Think Ye of Christ?” [“Ç’u Duket Juve për Krishtin?”], si pjesë të mësimin.</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Drejtojini anëtarët e klasës të citatet që keni shkruar në një afishe ose në dërrasë (shih “Përgatitja” më sipër). Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çfarë kanë të përbashkët këto citate? (Të gjitha ato janë pyetje nga shkrimet e shenjta që na ndihmojnë të vlerësojmë dëshminë tonë për Shpëtimtarin dhe zotimin tonë për të qenë dishepujt e Tij.) Si mendoni ju, përse ka kaq shumë pyetje si këto në shkrimet e shenjta?</li> </ul> <p>Shpjegoni se një pjesë e këtij mësimi përqendrohet te pyetjet nga shkrimet e shenjta që theksojnë madhësinë e Shpëtimtarit.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja personale që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Isaia jep mësim se Shpëtimtari është i pashoq.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nëpërmjet Isaias, Zoti e bëri vazhdimisht një pyetje të caktuar në mënyra të ndryshme. Çfarë pyetje bëhet në secilin prej vargjeve vijuese?             <ol style="list-style-type: none"> <li>Isaia 40:18 (“Kujt dëshironi t’i përngjajë Perëndia?”)</li> <li>Isaia 44:8 (“A ka vallë një Perëndi përveç meje?”)</li> <li>Isaia 46:5 (“Me cilin doni të më barazoni, me cilin doni të më krahasoni që mund të jemi të njëjlojtë?”)</li> </ol> </li> </ul>

- Çfarë është e ngjashme në pyetjet paraprirëse? (Të gjitha ato na mësojnë se Shpëtimtari është më i madh se cilido njeri apo send me të cilin mund ta krahasojmë.) Si do t' u përgjigjeshit këtyre pyetjeve? Si marrin përgjigje ato në librin e Isaia? (Shih vargjet e renditura më poshtë, duke vënë re se në secilin rast, Zoti po u fliste njerëzve idhujtarë që kishin prodhuar perënditë e tyre të rreme prej argjendi dhe ari.)
  - a. Isaia 43:11 ("Përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.")
  - b. Isaia 44:6 ("Përveç meje nuk ka Perëndi.")
  - c. Isaia 45:5 ("Jashtë meje nuk ka Perëndi"; shih edhe vargjet 6, 14, 18, 21–22.)
  - ç. Isaia 46:9 ("Jam Perëndia dhe askush nuk më ngjet mua.")
- Si mendoni ju, përse këto pyetje dhe përgjigje janë përsëritur kaq shumë herë në librin e Isaia? Në ç'mënyrë këto pyetje dhe përgjigje janë të përshtatshme për kohën tonë?

## 2. Isaia përshkruan cilësitë e pashoqe të Shpëtimtarit.

- Profeti Jozef Smith dha mësim se na duhet "një ide e saktë e karakterit, përsosmërisë dhe tipareve [të Perëndisë]" me qëllim që të kemi besim tek Ai (*Lectures on Faith* [1985], f. 38). Isaia jep shumë përshkrime të bukura të karakterit dhe tipareve të Shpëtimtarit. Vëriani anëtarët e klasës që të lexojnë disa nga fragmentet e renditura më poshtë dhe të diskutojnë pyetjet vijuese: Çfarë tipari i Shpëtimtarit është përmendur në fragment? Në ç'mënyrë dija për këtë tipar ndihmon që të rritet besimi ynë te Shpëtimtari? Ju mund të dëshironi t'i rendisni këto tipare në dërrasë.
  - a. Isaia 40:13–14 (Askush nuk e këshillon ose udhëzon Atë.)
  - b. Isaia 40:28–31 (Ai nuk lodhet kurrë; Ai na forcon ne.)
  - c. Isaia 40:12, 21–22, 26; 45:12, 18 (Ai e planifikoi dhe e krijoi universin si dhe njeh çdo pjesë të tij.)
  - ç. Isaia 41:17–18 (Ai na dëgjon kur jemi në telashe dhe na bekon me tepri.)
  - d. Isaia 42:1, 4 (Ai nuk do të dështojë apo të shkurajohet derisa qëllimet e Tij të përmbushen.)
  - dh. Isaia 42:16 (Ai e ndriçon dhe e drejton udhën për njerëzit e Tij që kanë humbur.)
  - e. Isaia 43:1–4 (Ai do t'i ndihmojë njerëzit e Tij nëpër sprovat e tyre.)
  - ë. Isaia 43:25–26; 44:21–23 (Ai i fshin mëkatet tona dhe nuk i kujton më.)
  - f. Isaia 44:2–4 (Ai derdh Shpirtin e Tij mbi familjet tona si ujin mbi tokën e thatë.)
  - g. Isaia 46:3–4 (Ai i mban njerëzit e Tij që nga lindja deri në moshë të shkuar.)
  - gj. Isaia 49:14–16 (Ai nuk do të na harrojë kurrë. Ne jemi "gdhendur" në pëllëmbët e duarve të Tij.)

Ftojini anëtarët e klasës për të treguar përvoja që kanë forcuar dëshmitë e tyre për cilindo prej këtyre tipareve të Shpëtimtarit.

## 3. Bota (Babilonia) konkurron me Shpëtimtarin për devocionin tonë.

- Kujt i drejtohet Isaia 47? (Shih Isaia 47 vargu 1. Babilonia ishte një qytet i fuqishëm në botën e lashtë dhe u shkatërrua për ligësinë e saj. Në shkrimet e shenjta, Babilonia përdoret shpesh gjithashtu si një simbol për ligësinë e botës.)

- Në Isaia 47, Isaia paralajmëroi se Babilonia do të shkatërrohej për shkak të ligësisë së saj. Këto paralajmërime mund të zbatohen gjithashtu për shkatërrimin përfundimtar të botës dhe ligësisë së saj. Çfarë japin mësim fragmentet vijuese mbi rezultatet e dhënies pas mënyrave të liga të botës?
  - a. Isaia 47:1, 5 (Bota do të zbritet në pluhur dhe do të bëhet e heshtur dhe e errët.)
  - b. Isaia 47:7–9 (Me gjithë mendimet e botës se është e pamposhtur, ajo do të shkatërrohet dhe do të humbasë gjërat me vlerën më të madhe, që simbolizohen nga humbja e bashkëshortit dhe e fëmijëve.)
  - c. Isaia 47:10–11 (Për shkak se bota deklaroi se është më e madhe se Perëndia, shkretimi do të vijë mbi të.)
- Tek Isaia 47:8, 10, çfarë kërkesë bëri Babilonia (bota) që është njëlloj si deklarata e Shpëtimtarit për veten? (“Unë, dhe asnjë tjetër!”) Çfarë mund të ofrojë bota në krahasim me atë çfarë ofron Shpëtimtari? Përse kaq shumë njerëz ia japin devocionin e tyre botës në vend të Shpëtimtarit? Si mund t’i ndihmojmë të tjerët të shohin atë çfarë ofron Shpëtimtari?
- Tek Isaia 48:17–18, Zoti premtoi bekime të mëdha për ata që e kërkojnë Atë në vend të botës. Si ju bëjnë të ndiheni këto premtime për ndjekjen e Shpëtimtarit me të gjithë zemrën tuaj?

#### 4. Isaia përshkruan misionin e Izraelit të ditëve të mëvonshme.

- Isaia 49 përmban shumë profeci mbi misionin e Izraelit të ditëve të mëvonshme. Këto profeci mund të na ndihmojnë të kuptojmë punën e rëndësishme që ka Zoti për ta bërë secili prej nesh. Vërimi anëtarët e klasës që të lexojnë disa nga fragmentet e renditura më poshtë dhe të diskutojnë pyetjen vijuese: Çfarë na mëson ky fragment mbi përgjegjësitë tona në këto ditë të mëvonshme? (Vini re se shumë prej profecive zbatohen si për punën e Shpëtimtarit ashtu dhe për punën e shërbëtorëve të Tij, shtëpisë së Izraelit [Isaia 49:3].)
  - a. Isaia 49:1, 5. “Zoti më ka thirrur që kur isha në bark të nënës.” (Ne jemi thirrur që nga lindja që të përmbushim punën e Zotit në ditët e fundit; shih edhe Jeremia 1:5.)
  - b. Isaia 49:2. “Ma bëri gojën si një shpatë të mprehtë.” (Kjo ide sugjeron të folurit e fjalëve të fuqishme të së vërtetës – fjalët e Zotit; shih edhe DeB 6:2.)
  - c. Isaia 49:2. “Më ka fshehur në hijen e dorës së tij.” (Zoti na ka mbrojtur dhe përgatitur për përgjegjësitë tona të mëdha; shih edhe DeB 86:9.)
  - ç. Isaia 49:2. “M[ë] bëri . . . një shigjetë me majë.” (Shigjetat me majë do të fluturojnë drejt dhe saktë. Ne jemi lustruar dhe përgatitur nga Zoti që të fluturojmë drejt e saktë kudo që Ai na dërgon.)
  - d. Isaia 49:6. “Me qëllim që të jesh Shpëtimi im deri në skajet e tokës.” (Zoti u ka kërkuar shërbëtorëve të Tij që të ngrihen dhe të rivendosin mbetjen e Izraelit dhe të jenë një dritë për Johebrenjtë. Në këtë mënyrë ne mund të ndihmojmë për t’u sjellë shpëtim skajeve të tokës; shih edhe DeB 86:8–11.)

#### Përfundim

Dëshmoni se shkrimet e Isaia mund të na ndihmojnë të zhvillojmë dashuri më të madhe për Shpëtimtarin dhe kuptueshmëri më të madhe për punën që Ai dëshiron që ta bëjmë ne. Ju mund të dëshironi të ftoni anëtarët e klasës ose një grup të vogël që të këndojnë “Sa i Madh Je Ti” (*Hymns*, nr. 86) ose “Sa i Fortë një Themel” (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 6).

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

### 1. Simbole të përdorura nga Isaia

- Isaia e përdori vazhdimisht verbërinë si një simbol të ligësisë dhe të injorancës shpirtërore (Isaia 29:10, 18; 32:3; 42:6–7, 16–18; 43:8; 44:9). Ndërsa meditoni për këto vargje, kujtoni se Shpëtimtari shpesh shpalli se Ai ishte Drita e Botës (Gjoni 8:12). Si mund t'i hapim sytë tanë shpirtërorë më plotësisht ndaj Dritës së Botës?
- Isaia i përdori vazhdimisht figurat e ujit (Isaia 12:3; 32:2; 41:17–18; 43:19–20; 44:3–4; 48:18, 21; 49:10). Në ç'mënyrë mësimi i Shpëtimtarit se Ai është burimi i ujit të gjallë, ju ndihmon t'i kuptoni këto fragmente? (Shih Gjoni 4:7–14.)

### 2. Shpresimi te Zoti

- Çfarë do të thotë të “shpresoj[m]ë te Zoti”? (Isaia 40:31). Në çfarë mënyrash Zoti u përtërin forcën atyre që shpresojnë tek Ai? (Shih Isaia 41:10.) Ftojini anëtarët e klasës që të ndajnë përvoja mbi përtëritjen prej Zotit të forcës shpirtërore ose fizike të një personi.

### 3. “Por ti nuk më ke kërkuar”

- Përse disa prej nesh herë pas here ndiejnë se Zoti na ka braktisur? Nëse ne ndiejmë se Zoti është tërhequr prej nesh, cili ka gjasa të jetë shkaku? (Shih Isaia 43:22–26; Mosia 5:13.) Çfarë mund të bëjmë që të ndihemi pranë Tij sërish?

Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Unë shoh se, kur bëhem rastësor në marrëdhëniet e mia me hyjninë dhe kur duket se asnjë vesh hyjnor nuk po dëgjon e asnjë zë hyjnor nuk po flet, jam shumë shumë larg. Nëse zhytem në shkrimet e shenjta, largësia shkurtohet dhe shpirtshmëria kthehet” (*The Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball [1982], f. 135).

<b>Qëllimi</b>	Të forcojë dëshminë e çdo anëtari të klasës për Shlyerjen e Jezu Krishtit.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje fragmentet nga Isaia 50–53 që diskutohen në këtë mësim. Ato përqendrohen te sakrifica shlyese e Shpëtimtarit.</li> <li>2. Lexim shtesë: Mosia 14–15.</li> <li>3. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, caktoni dy ose tre anëtarë të klasës që të zgjedhin një himn të parapëlqyer për dashurinë dhe sakrificën e Shpëtimtarit dhe të përgatiten t’i tregojnë klasës mbi mesazhin e himnit dhe se si ai ka ndikuar tek ata. Ju mund të dëshironi të tregoni për një prej himneve tuaja të parapëlqyera për Shpëtimtarin.</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Shpjegoni se shumë himne të Kishës na ndihmojnë të kuptojmë dashurinë që tregoi Shpëtimtari për ne nëpërmjet sakrificës së Tij shlyese. Ftojini secilin prej anëtarëve të caktuar të klasës që të tregojë për një himn të parapëlqyer mbi dashurinë dhe sakrificën e Shpëtimtarit. Meqë muzika mund të ndihmojë për të ftuar Shpirtin e Zotit në klasë, ju mund të dëshironi t’u kërkonin anëtarëve të klasës që të këndojnë një prej himneve që u diskutua.</p> <p>Shpjegoni se ky mësim do të diskutojë për disa prej profecive të Isaias mbi jetën dhe misionin e Shpëtimtarit.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Isaia flet për lajmëtarët që sjellin lajme të bukura.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tek Isaia 52:7, Isaia poetikisht përshkruan njerëz që sjellin një mesazh të shkëlqyer. Si mendoni ju, përse Isaia iu referua këmbëve të lajmëtarëve? (Në botën e lashtë, përpara se të ishin të disponueshme komunikimet elektronike, lajmet e rëndësishme shpesh silleshin nga vrapues që udhëtonin në këmbë. Isaia përdor këmbët e lajmëtarëve për të simbolizuar vetë lajmëtarët.) Çfarë ndiente Isaia për këta lajmëtarë?</li> <li>• Si e përshkroi Isaia mesazhin që po shpërndahej? (Është një mesazh lajmesh të bukura, një mesazh paqeje dhe shpëtimi.) Profeti Abinadi i Librit të Mormonit shpjegoi se lajmëtarët e përshkruar nga Isaia përfshijnë profetët dhe gjithashtu vetë Zotin (Mosia 15:13–18). Çfarë mesazhi të shkëlqyer të paqes dhe shpëtimit kanë sjellë këta lajmëtarë? (Shih 2 Nefi 2:6–8.)</li> </ul>



- Kush tjetër e sjell mesazhin e ungjillit në botë? Ju mund të dëshironi t’u kërkonti anëtarëve të klasës që të tregojnë për përvoja që kanë pasur ata me ndarjen e mesazhit të ungjillit. Ju gjithashtu mund të dëshironi t’u kërkonti anëtarëve të klasës që të tregojnë se si ndihen për ata që ua sollën mesazhin atyre.

## 2. Isaia profetizon për sakrificën shlyese të Shpëtimtarit.

Diskutoni për profecitë vijuese mbi sakrificën shlyese të Shpëtimtarit dhe bekimet që na siguron ne.

- Isaia 50:5–7. Çfarë na mëson ky fragment mbi qëndrimin e Shpëtimtarit kundrejt sakrificës së madhe që do të bënte në interesin tonë? Çfarë na mësojnë Mateu 26:39 dhe Filipianëve 2:8 mbi qëndrimin e Shpëtimtarit kur Ai u përball me vuajtje të madhe?
- Isaia 51:6. Çfarë krahasimi është bërë në këtë varg? Sa do të zgjasin pasojat e Shlyerjes? (Shih edhe Mosia 16:9; Alma 34:10, 14.)
- Isaia 51:22. Për kë lutet Shpëtimtari? Në ç’mënyrë Shlyerja e lejon Atë të jetë Avokati ynë? (Shih DeB 45:3–5.) Çfarë është “kupa e hutimit” që Jezusi e ka pirë për ne? (Shih DeB 19:15–20.) Çfarë duhet të bëjmë ne për të marrë bekimet e plota që ofrohen nëpërmjet Shlyerjes?
- Isaia 52:3. Çfarë do të thotë “do të shpengoheni pa para”? (Shih 2 Nefi 26:27–28; Isaia 55:1–3.)
- Isaia 53:2–4. Çfarë na tregojnë këto vargje mbi jetën e Shpëtimtarit? Përse Ai mund t’i kuptojë dhimbjet dhe brengat tona? (Shih Alma 7:11–13; Hebrejve 2:16–18; 4:15.) Si e keni ndier ju se Ai i kupton dhimbjet dhe brengat tuaja?
- Isaia 53:5. Përse Shpëtimtari që i gatshëm të vuante dhembjen prej të qenit i plagosur, i mavijosur dhe i fshikulluar? (Shih 1 Nefi 19:9.)
- Isaia 53:6–7. Çfarë cilësish të karakterit tregoi Shpëtimtari kur u shtyp, u keq-trajtua dhe mbi të ranë paudhësitë tona? Në ç’mënyrë ne nganjëherë “[ndjekim] rrugën [tonë]” në vend që t’i nënshtrohemi vullnetit të Atit Qiellor? Në ç’mënyrë shembulli i Shpëtimtarit mund të na ndihmojë që t’i nënshtrohemi vullnetit të Atit Qiellor?
- Isaia 53:10. Çfarë nënkuptonte Isaia kur tha se “i pëlqeu Zotit ta rrihte” Shpëtimtarin? Çfarë mësojmë nga ky fragment për dashurinë e Atit Qiellor për ne? (Shih edhe Gjoni 3:16–17.)
- Isaia 53:8–11. Shpjegoni se profeti Abinadi i Librit të Mormonit bëri një koment të fuqishëm për këto vargje kur po u fliste priftërinjve të ligj të mbretit Noe (Mosia 15:10–13). Sipas Abinadit, cilët do të jenë fara e Shpëtimtarit? (Shih edhe Mosia 5:7–8.)
- Isaia 53:12. Shpjegoni se në fund të një beteje, udhëheqësi i ushtrisë fitimtare ndan frytet e fitores mes ndjekësve të tij. Cilat janë frytet e fitores së Krishtit mbi mëkatin dhe vdekjen që Ai është i gatshëm t’i ndajë me ne? (Shih Romakëve 8:16–17; 2 Timoteut 4:7–8.)

### 3. Isaia përshkruan disa nga përgjegjësitë tona.

- Siç shënohet tek Isaia 51 dhe Isaia 52, çfarë përgjegjësisë kemi ne si ata që e kanë pranuar Shlyerjen e Shpëtimtarit?
  - a. Isaia 51:1, 4, 7. Ta dëgjojmë e t'i bindemi Zotit; të mos kemi frikë nga fyerjet e njerëzve.
  - b. Isaia 51:12–13. Ta kujtojmë Zotin, që është Krijuesi. Të mos ta kemi frikë Satanin.
  - c. Isaia 52:1–2. Të zgjohemi dhe të veshim forcën e priftërisë (shih DeB 113:7–8). Të veshim rrobat e bukura të drejtësisë (shih Zbulesa 19:7–8). “Zgjidhi zinxhirët që ke në qafë” (shih DeB 113:9–10).
  - ç. Isaia 52:11. Të largohemi nga ligësia e botës. Të mos prekim gjëra të papastrat; të jemi të pastër.
- Si mund ta përmbushim më mirë secilën prej këtyre përgjegjësisë?

#### Përfundim

Këqyrni Mosia 15:18, në të cilin profeti Abinadi e përshkruan Shpëtimtarin si një lajmëtar, këmbët e të cilit janë të bukura mbi malet. Shpjegoni se një arsye pse këmbët e Tij janë të bukura është se ato mbajnë gjurmët e gozhdëve, shenjat e dashurisë së Tij shlyese. Jepni dëshmi se si mësimet e Isaia kanë forcuar dashurinë tuaj për Shpëtimtarin dhe dëshirën tuaj për të qenë i denjë për bekimet e sakrificës së Tij shlyese. Kërkojuni anëtarëve të klasës që të tregojnë se si dëshmitë e tyre janë forcuar gjithashtu.

#### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

##### 1. Ecja në dritë

Këqyrni Isaia 50:10–11 dhe vini në dukje zgjidhjen që Isaia na jep në këto vargje. Nëse zgjedhim ta kemi frikë Zotin, t'i bindemi zërit të shërbëtorëve të Tij dhe t'i mirëbesojmë Atij, ne do ta kemi dritën e Tij që të na udhëheqë dhe nuk do të ecim në errësirë (Gjoni 8:12; 12:46). Nëse zgjedhim të ecim në vetë dritën tonë, që krahasohet me dritën e flakëve, Zoti na paralajmëron se “do të lëngo[jmë] në vuajtje”.

##### 2. Puna misionare


Nëse është e disponueshme *Family Home Evening Video Supplement (International)* (53736), ju mund të dëshironi të shfaqni “Missionary Work: Our Greatest Duty” [“Puna Misionare: Detyra Jonë më e Madhe”], një fragment pesëminutësh si pjesë të mësimi.

Isaia 54–56; 63–65

---

Qëllimi	Të nxisë anëtarët e klasës që të forcojnë kunjet e Sionit dhe të përgatiten për Ardhjen e Dytë dhe Mijëvjeçarin.
Përgatitja	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Studiojini me lutje fragmentet nga Isaia 54–56 dhe 63–65 që diskutohen në këtë mësim.</li><li>2. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni një kunj çadre.</li><li>3. Nëse është e disponueshme figura Jezu Krishti i Ringjallur, ju mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë mësimin (62187; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 239).</li></ol>
Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	Vizatoni në dërrasë një figurë çadre si ajo që tregohet më poshtë. Pastaj paraqitni një kunj çadre dhe bëni pyetjet vijuese.

---



- Përse kjo çadër ka nevojë për kunj? Çfarë do të ndodhte nëse çadra nuk do të mbështetej nga kunjat?
- Çfarë përfaqëson çadra e përmendur tek Isaia 54:2? (Kishën e Jezu Krishtit.) Çfarë përfaqësojnë kunjat e çadrës?

Presidenti Ezra Taft Benson tha:

“Termi *kunj* është një shprehje simbolike. Përfytyroni në mendjen tuaj një çadër të madhe që mbahet nga litarë të zgjatur të shumë kunjat, të cilët janë siguruar fort në tokë.

Profetët e krahasuan Sionin e ditëve të mëvonshme me një çadër të madhe që qarkon tokën. Ajo çadër mbështetej nga litarë të mbërthyer në kunjat. Ata kunjat, sigurisht, janë organizatat e ndryshme gjeografike të shpërndarë në mbarë tokën. Tani, Izraeli po mblidhet në kunjat e ndryshme të Sionit” (“Strengthen Thy Stakes”, *Ensign*, janar 1991, f. 2).

Tregojini klasës se kunjët e para të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme u organizuan në Kirtland të Ohajos dhe në Kontenë Klej të Misurit në vitin 1834. Ndërsa Kisha u rrit, u shtuan kunjët të tjera siç u urdhërua nga Zoti (DeB 101:20–21). Sot ka qindra kunjët të vendosura në mbarë botën.

Shpjegoni se ky mësim do të diskutojë rreth mënyrës se si ne mund t'i forcojmë kunjët e Sionit. Ai do të diskutojë gjithashtu mësimet e fuqishme të Isaia mbi Ardhjen e Dytë dhe Mijëvjeçarit.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. “Zgjati litarët e tu dhe përforco kunjat e tu” (Isaia 54:2).

- Si mendoni ju, cili është kuptimi i frazës “zgjero vendin e çadrës sate”? (Isaia 54:2.) (Zoti dëshiron që anëtarët e Kishës ta ndajnë ungjillin me shumë njerëz që ai të mund të mbulojë tokën. Isaia profetizoi që, në ditët e mëvonshme, Kisha do të rritej shpejt dhe shumë njerëz në mbarë botën do të ktheheshin në besim tek e vërteta [Isaia 54:3]).
- Çfarë këshille tjetër jepet tek Isaia 54:3 në lidhje me çadrën, apo Kishën? Si mund ta ndjekim këtë këshillë? Ju mund të dëshironi ta përmbledhni diskutimin në dërrasë, siç ilustron më poshtë.

Këshilla e Isaia	Ajo që Mund të Bëjmë Ne
Të shtrihen fletët e çadrës dhe të zgjaten litarët.	Të shërbejmë si misionarë kohëplotë; të ndajmë ungjillin me miq e fqinjë.
Të përforcohen kunjat e çadrës.	Të forcojmë kunjët tona vendore.

- Çfarë mund të bëjmë që të forcojmë kunjët ku jetojmë? (Përgjigjet mund të përfshijnë sa vijon: Të zhvillojmë forcë shpirtërore personale, të ndikojmë te familjet dhe miqtë tanë që të bëjnë të njëjtën gjë, t'u shërbejmë fqinjëve tanë anëtarë dhe joanëtarë dhe të pranojmë thirrje nga udhëheqësit e priftërisë për të shërbyer në Kishë.)
- Në ç'mënyrë kunjët mund të bekojnë jetën e njerëzve? (Shih DeB 115:5–6.) Në ç'mënyrë kunjët e Sionit janë vende mbrojtjeje dhe strehimi për ne?

### 2. “Me dhembshuri të pamasë do të të mbledh” (Isaia 54:7).

- Edhe pse Izraeli ishte shpërndarë për shumë vite, Zoti premtoi se do ta mbledhte atë në Kishën e vërtetë në ditët e fundit (Isaia 54:4–10). Çfarë mund të mësojmë mbi Zotin tek Isaia 54:4–10? Çfarë bekimesh të veçanta u premton Zoti shërbëtorëve të Tij të drejtë? (Shih Isaia 54:13–14, 17.) Përse këto premtime janë të rëndësishme?

- Kush ftohet të gjejë strehë duke u mbledhur me shenjtorët? (Të gjithë fëmijët e Atit Qiellor.) Këqyrni fragmentet nga Isaia që përshkruajnë grupe njerëzish për të cilët Zoti dëshiron që të vijnë tek Ai dhe të gjejnë siguri në ungjill:
  - a. Isaia 55:1–3. (Të gjithë që kanë etje.) Çfarë lloj etjeje i referohet në këto vargje? Çfarë ndodh kur përpiqemi të shuajmë etjen shpirtërore duke shpenzuar para dhe përpjekje për gjëra materiale? Si mund të shuhet vërtet etja jonë shpirtërore? (Shih 2 Nefi 9:50–51; 3 Nefi 20:8.)
  - b. Isaia 55:6–7. (Të liqtë që do të pendohen.) Çfarë premtimi u drejtohet atyre që pendohen?
  - c. Isaia 56:3, 5–8. (Të huajt që nuk e njohin Zotin.) Çfarë duhet të bëjnë të huajt që të pranohen nga Zoti?
- Çfarë na mësojnë këto fragmente mbi mëshirën e Zotit? Çfarë japin mësim ato mbi mënyrën se si duhet t'i konsiderojmë të gjithë fëmijët e Atit Qiellor?
- Isaia shkroi se fjala e Perëndisë mund t'i ushqejë shpirtat tanë po ashtu si shiu dhe bora ushqejnë farat (Isaia 55:10–13). Në ç'mënyrë fjala e Perëndisë i ushqen shpirtat tanë? (Shih Alma 32:28, 41.)

### 3. Mijëvjeçari do të jetë një kohë paqeje dhe gëzimi.

- Në mbarë shkrimet e tij, Isaia dëshmoi se edhe pse do të kishte beteja, tundime dhe vuajtje në këtë botë, e mira do ta mposhtë të ligën në fund dhe, për të drejtët, e ardhmja do të jetë plot gëzim. Isaia u lut me zjarr për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit, që do të sjellë ndëshkim për të ligjtë dhe gëzim të madh për të drejtët (Isaia 64). Çfarë mesazhi shprese dhe gëzimi përmbahet tek Isaia 64:1–4? Në ç'mënyrë ky mesazh e rrit dëshirën tuaj për të duruar deri në fund në shërbim të Zotit?
- Kapitujt përmbyllës të analit të Isaias paraqesin një pamje të bukur të Mijëvjeçarit, periudhës një mijë vjeçare të paqes që do të paraprihet nga Ardhja e Dytë e Shpëtimtarit. Siç shënohet tek Isaia 65:17–25, çfarë kushtesh do të ekzistojnë gjatë Mijëvjeçarit? (Ju mund të dëshironi t'i rendisni këto kushte në dërrasë; shih edhe Isaia 11:6–9.)
  - a. Zoti do të krijojë qiej të rinj dhe një tokë të re (Isaia 65:17).
  - b. Do të ketë gëzim të madh dhe jo më vajtim për njerëzit e Zotit (Isaia 65:18–19).
  - c. Njerëzit nuk do të vdesin të rinj; ata do të jetojnë 100 vjet (Isaia 65:20).
  - ç. Njerëzit do të gëzojnë frytet e vetë punëve të tyre (Isaia 65:21–23).
  - d. Njerëzit do të marrin përgjigje menjëherë (Isaia 65:24).
  - dh. Nuk do të ketë më armiqësi mes bishave (Isaia 65:25).
- Çfarë jep mësim Isaia 63:7–9 mbi mirësinë dhe dashurinë e pafundme të Zotit? (Kërkojuni anëtarëve të klasës që të sugjerojnë fjalë dhe fraza nga këto vargje, të cilat tregojnë dashurinë e Shpëtimtarit për ne. Ju mund të dëshironi t'i shkruani ato në dërrasë.) Në ç'mënyra Shpëtimtari ju ka shfaqur “dashamirësi[në e] tij të madhe”?

#### Përfundim

Dëshmoni se kur forcojmë kunjet e Sionit dhe ndajmë ungjillin me botën, na presin pasuritë e përjetësisë. Ne mund të presim me gëzim Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit dhe paqen e gëzimit që do të ekzistojnë gjatë Mijëvjeçarit. Profecitë e Isaias na nxisin të kujtojmë se është një privilegj që t'i shërbesh Zotit dhe se Ai i bekon dishepujt e Tij.

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimit. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimit.

### 1. Ligji i vërtetë i agjërimit (Isaia 58:3–12)

- Çfarë mund të mësojmë nga Isaia 58 mbi agjërimit? Cilët janë elementet e agjërimit të vërtetë? (Shih Isaia 58:3–7.)

Një element i agjërimit të vërtetë është dhënia e një oferte agjërimit bujare. Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Mendoj se kur jemi të begatë, ashtu siç janë shumë prej nesh, se ne duhet të jemi shumë, shumë bujarë . . . dhe të japim, në vend të sasisë së kursyer nga dy vaktet tona të agjërimit, ndoshta shumë, shumë më tepër – dhjetë herë më tepër kur jemi në gjendje ta bëjmë këtë” (në Conference Report, prill 1974, f. 184).

- Çfarë bekimesh prej të jetuarit të ligjit të agjërimit premtohen tek Isaia 58?

- a. Ne bëhemi më të fortë në qëndresën ndaj tundimit (Isaia 58:6).
- b. Barrët tona lehtësohen (Isaia 58:6).
- c. Shëndeti ynë fizik e shpirtëror përmirësohet (Isaia 58:8).
- ç. Ne bëhemi të përlurur dhe të përgatitur për të komunikuar me Zotin (Isaia 58:9).
- d. Ne ndihmojmë të varfrit dhe nevojtarët (Isaia 58:10).
- dh. Ne marrim udhëheqje të vazhdueshme nga Zoti (Isaia 58:11).
- e. Ne i kemi shpirtrat të ngopur në vendet e thata dhe bëhemi “si një burim uji, ujërat e të cilit nuk shterojnë” (Isaia 58:11).

Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë shembuj nga shkrimet e shenjta, historia e Kishës, ose përvoja personale që tregojnë bekimet e të jetuarit të ligjit të agjërimit. (Shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Agjëroj, Agjërim”.)

- Si mund të bëhemi më të zellshëm në të jetuarin e ligjit të agjërimit?

### 2. Përshkrim i shërbesës së Shpëtimtarit

- Isaia 61:1–3 është një deklaram i thirrjes dhe shërbesës së Shpëtimtarit. Qysh herët në shërbesën e Tij në Nazaret, Shpëtimtari i citoi këto vargje dhe u tha njerëzve: “Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaja” (Lluka 4:14–21). Çfarë na mësojnë këto vargje për karakterin dhe misionin e Jezu Krishtit?

### 3. Ardhja e Dytë e Krishtit (Isaia 63:1–6)

- Ardhja e Dytë e Shpëtimtarit përshkruhet tek Isaia 63:1–6. Çfarë ngjyre do të jetë manteli i Shpëtimtarit kur të vijë në lavdinë e Tij? (Shih Isaia 63:2; Zbulesa 19:11–13; DeB 133:46–48.) Çfarë simbolizon ngjyra e kuqe? (Gjakun që Ai derdhi kur vuajti për mëkatet tona në Gjetseman dhe në kryq.)



# “Sot po të Bëj . . . një Shtyllë të Hekurt”

Jeremia 1–2; 15; 20; 26; 36–38

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të mbeten besnikë në kohë kundërshtie dhe vështirësie.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje fragmentet nga Jeremia që diskutohen në këtë mësim. Ky mësim përqendrohet tek kuraja dhe zotimi i Jeremias ndërsa ai u përball me kundërshtime nga të gjithë njerëzit rreth tij.</li> <li>2. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, sillni në klasë një shufër metalike.</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimit</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Paraqisni një shufër metalike dhe ftojini anëtarët e klasës që të përpiqen ta thyejnë atë. Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse ky objekt do të përfaqësonte karakteristikat e një njeriu, çfarë do të sugjeroni rreth tij apo asaj?</li> <li>• Kërkojuni anëtarëve të lexojnë Jeremian 1:17–19. Çfarë frazash përdor Zoti në vargun 18 për të përshkruar Jeremian? Çfarë sugjerojnë këto fraza mbi llojin e njeriut që ishte Jeremia? Si do të ndiheshit nëse këto fjalë do të përdreshin për t’ju përshkruar ju ndërsa filloni të përmbushni një thirrje ose detyrë nga Zoti?</li> </ul> <p>Shpjegoni se mbretërit, princërit, priftërinjtë dhe të gjithë njerëzit e vendit iu kundërvunë Jeremias në misionin e tij, por ai bëri me guxim ashtu si urdhëroi Zoti. Referojuni shufrës metalike dhe shpjegoni se Jeremia që një “shtyllë [e] hekurt”, që pati forcë të madhe në kohë vështirësish dhe nuk u përkul apo u thye.</p>
<b>Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë</b>	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p>Jeremia shërbeu gjatë mbretërimit të pesë mbretërve, nga Josia te Zedekia (626 deri 586 <small>PR. K.</small>). Me Josian, ai u përpoq t’i largonte njerëzit nga idhujtaria dhe imoraliteti. Por mbretërit pas Josias sunduan në ligësi dhe njerëzit qenë në braktisje të plotë. Misioni i Jeremias që që të ngrinte një zë paralajmërues për këta njerëz dhe denoncimet prej tij të ligësisë së tyre janë ndër më të fuqishmet në të gjithë shkrimin e shenjtë. Zëri i tij që një prej zërave të fundit paralajmërues përpara se Juda të pushtohej nga babilonasit.</p> <p>Jeta e Jeremias që plot me hidhërim, por përgjigjja e tij ndaj sprovave mund të na japë mësim e të na frymëzojë. Atë e rrahën dhe e burgosën sepse profetizoi kundër mbretërisë së Judës. Jeta e tij u kërcënua vazhdimisht. Por gjatë të gjitha vështirësive dhe kundërshtimit, Jeremia që si një “shtyllë [e] hekurt” (Jeremia 1:18). Libri i Jeremias jep një anal vetjak, besimnxitës, të përgjigjes së profetit ndaj hidhërimit dhe mërziqëve të jetës së tij.</p>

## 1. Jeremia thirret nga Perëndia që të jetë profet.

Këqyrni rrëfimin e thirrjes së Jeremias për të qenë profet siç shënohet te Jeremia 1:4–10.

- Çfarë na mëson thirrja e Jeremias mbi doktrinën e parashugurimit? (Shih Jeremia 1:5.) Si mendoni ju se e ndihmoi Jereminë dija se në ekzistencën para lindjes ai ishte parashuguruar që të ishte profet?

Profeti Jozef Smith tha: “Çdo njeri që ka një thirrje për t’u shërbyer banorëve të botës, u shugurua tamam për atë qëllim në Këshillin e Lartë të qiellit përpara se të ishte kjo botë” (*History of the Church*, 6:364).

- Çfarë bëri Zoti kur Jeremia u ndie i papërshtatshëm për ta përmbushur thirrjen e tij? (Shih Jeremia 1:6–10.) Si jeni risiguruar ju nga Zoti kur jeni ndier i papërshtatshëm?

## 2. Shumë njerëz iu kundërvunë Jeremias dhe u përpoqën ta pengojnë që të përmbushte misionin e tij.

Përdorni shkrimet e shenjta në vijim për të diskutuar mbi kundërshtinë me të cilën u përball Jeremia ndërsa përmbushi misionin që i kishte dhënë Zoti:

- a. Jeremia 20:1–6. I pakënaqur nga profecitë e Jeremias, Pashhuri, shef i kryeintendentëve në tempull, e rrahu Jeremian dhe e futi në burg. Jeremia profetizoi se Pashhuri, familja e tij dhe miqtë e tij do të ziheshin robër nga babilonasit dhe do të vdisnin në Babiloni.
  - b. Jeremia 26:7–15. Shumica e njerëzve në vend, përfshirë priftërinjtë, iu kundërvunë Jeremias dhe mesazhit të tij (26:7–11). Megjithatë, Jeremia me kurajë dha mesazhin që Zoti e kishte urdhëruar të jepte (26:12–15). Jeremian madje e kundërshtuan dhe e urryen fqinjët dhe të afërmit e tij (11:19–21; 12:6; vini re se Jeremia qe nga qyteti i Anathothit).
  - c. Jeremia 36:1–6, 20–32. Fjalët e profecive të Jeremias u shkruan dhe iu lexuan njerëzve (36:1–6). Mbreti i dogji ato fjalë dhe Zoti e urdhëroi Jeremian që t’i regjistronte sërish (36:20–32).
  - ç. Jeremia 37:12–15; 38:4–13. Jeremian e akuzuan padrejtësisht dhe e futën në burg (37:12–15). Më vonë atë e hodhën në një sternë, ku ai u zhyt në baltë (38:4–6). Me urdhër të mbretit Zedekia, Jeremia u lirua nga sterna dhe e futën sërish në burg (38:7–13).
- Çfarë na zbulon Jeremia 20:14–18 mbi mënyrën se si ndihej Jeremia ndërsa duroi një kundërshtim kaq tronditës? Çfarë mund të mësojmë nga Jeremia për të na ndihmuar kur përjetojmë vështirësi? (Përgjigjet mund të përfshijnë se Jeremia vazhdoi t’i bindej Zotit dhe ta përmbushte thirrjen e tij edhe kur u përdoq dhe u shkrajua; shih Jeremia 26:12–15.)
  - Te Jeremia 2:13, cilat ishin dy të këqijat që tha Zoti se kishin kryer njerëzit e Tij? (Ata e kishin braktisur Atë, burimin e ujit të gjallë. Dhe ata kishin bërë për vete sterna të prishura, që nuk mund ta mbanin ujin e gjallë të Zotit, që do të thotë se ata kishin kërkuar përmbushje dhe siguri në gjërat e botës.) Përse njerëzit me këto karakteristika do të kishin vështirësi për t’i pranuar fjalët e Jeremias? Përse ata do të ishin të paaftë t’u përgjigjeshin vështirësive ashtu si Jeremia? Në ç’mënyrë ne nganjëherë krijojmë “sterna të prishura” që nuk mund ta mbajnë ujin e gjallë të Shpëtimtarit?

Plaku Marion D. Hanks tha:

“Synimet materialiste marrin me tepri nga vëmendja jonë. Beteja për atë që na nevojitet, ose për më tepër sesa na nevojitet, shteron kohën dhe energjinë tonë. Ne ndjekim kënaqësinë ose zbavitjen, ose përfshihemi tepër në shoqata apo çështje të komunitetit. Sigurisht, njerëzit kanë nevojë për çlodhje, kanë nevojë për arritje, kanë nevojë të japin kontribut; por nëse kostoja që të ndodhin ato është miqësia me Krishtin, çmimi është tepër i lartë.

‘Sepse populli im ka kryer dy të këqija’, i tha Zoti Izraelit; ‘më ka braktisur mua, burimin e ujit që rrjedh, për të hapur sterna, sterna të prishura, që nuk e mbajnë ujin.’ (Jeremia 2:13.)

Zëvendësimet që bëjmë për të zënë vendin e Perëndisë në jetën tonë, vërtet që nuk e mbajnë ujin. Në atë masë që ne e refuzojmë kështu ‘ujin e gjallë’, ne humbasim gëzimin që do të mund të kishim pasur” (në Conference Report, prill 1972, f. 127; ose *Ensign*, korrik 1972, f. 105).

Profecitë e Jeremias se babilonasit do ta shkatërronin Jerusalemin, u përmbushën siç shënohet te Jeremia 39–40. Jeremia kishte qenë në burg gjatë rrethimit por, më vonë, babilonasit e liruan dhe e lejuan atë dhe një mbetje të judenjve që të qëndronin në tokën e Judës. Johanani, udhëheqësi i atyre që mbetën, i kërkoi Jeremias që të kërkonte vullnetin e Zotit për ta dhe premtoi t’i bindej atij (Jeremia 42:1–6). Nëpërmjet Jeremias, Zoti u tha njerëzve që të qëndronin në tokën e Judës dhe premtoi t’i bekonte ata nëse do ta bënë këtë (Jeremia 42:9–22). Por Johanani i udhëhoqi njerëzit për në Egjipt, ku shumica prej tyre vazhduan në ligësinë e tyre (Jeremia 43–44).

### 3. Jeremia forcohet në vështirësi nga dashuria e tij për fjalën e Perëndisë.

Diskutoni mbi shkrimet e shenjta vijuese, që tregojnë se si fjala e Perëndisë e ndihmoi Jeremian të qëndronte i fortë në kohë vështirësie.

- Siç shënohet te Jeremia 1:9, çfarë vendosi Zoti në gojën e Jeremias? Siç shënohet te Jeremia 15:16, çfarë bëri Jeremia me fjalët e Zotit? (Ai i përpiu ato, që është shprehje poetike me kuptimin se fjala e Perëndisë u bë pjesë e tij.) Si u ndie Jeremia për fjalët e Zotit?
- Si mundemi ne që t’i përpijmë fjalët e Zotit siç bëri Jeremia? (Duke studiuar shkrimet e shenjta dhe këshillën e profetëve të ditëve të mëvonshme.) Profeti Nefi i Librit të Mormonit tha të “ushqeh[emi] me bollëk me fjalët e Krishtit” (2 Nefi 32:3). Në ç’mënyrë na forcon ushqyerja me bollëk me fjalët e Zotit?
- Te Jeremia 20:9, si e përshkruan Jeremia fjalën e Zotit brenda tij? Si mendoni ju, çfarë do të thotë ta keni fjalën e Zotit si një zjarr flakërues në kockat tuaja? Si mendoni ju, përse Jeremia nuk mund të përmbahej nga dhënia mësim e fjalës së Zotit?

#### Përfundim

Shprehni ndjenjat tuaja mbi shembullin e Jeremias dhe nevojën për të qenë besnikë në kohë vështirësish. Nxitini anëtarët e klasës që t’i kërkojnë e të meditojnë për fjalët e Zotit derisa këto fjalë të bëhen zjarr në kockat e tyre, duke i forcur kur bëjnë punën e Zotit. Nëse përdorët aktivitetin e vëmendjes, paraqisni shufrën metalike dhe ftojini anëtarët e klasës që, ashtu si Jeremia, të bëhen një shtyllë e hekurt për Zotin.

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. “Argjila në duart e poçarit” (Jeremia 18:6)

- Këqyrni rrëfimin e vizitës së Jeremias te poçari, shënuar te Jeremia 18:1–4. Çfarë u mësoi Zoti njerëzve të Tij nëpërmjet përvojës së Jeremias? (Shih Jeremia 18:5–10. Zoti u tregoi atyre që, nëse do të pendoheshin, Ai do t’u jepte formë në diçka më të mirë, pikërisht ashtu si poçari i dha formë të re poçit të prishur. Ai gjithashtu u kujtoi se kishte fuqi t’i shkatërronte ata nëse nuk pendoheshin.)
- Si zbatohet ky krahasim për ne sot? Si mund të bëhemi argjilë më e mirë në duart e Zotit? (Duke qenë të përlurur – duke u bindur, duke u penduar, duke i mirëbesuar Zotit dhe duke kërkuar vullnetin e Tij. Ftoni anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja të cilat tregojnë se si Zoti i ka formuar dhe i ka përgatitur njerëzit për të përmbushur qëllimet e Tij.) Çfarë ndodh kur ne i rezistojmë marrjes formë nga Zoti?

Presidenti Hiber C. Kimball dha idetë vijuese për krahasimin te Jeremia 18:1–10:

“Të gjithë [ata që] përpunohen në duart e Perëndisë dhe janë të bindur ndaj urdhërimeve të Tij, janë enë nderimi dhe Perëndia do t’i marrë ata” (*History of the Church*, 4:478).

Ka shumë enë që do të shkatërrohen pasi të jenë modeluar e të kenë marrë formë. Përse? Sepse ata nuk janë të kënaqur me formën që poçari u ka dhënë atyre, por menjëherë e vendosin veten në një formë që t’i pëlqejë vetvetes; si pasojë, ata janë përtej kuptueshmërisë së asaj që ka hartuar Perëndia dhe e shkatërrojnë veten me anë të fuqisë së vetë lirisë së tyre për të zgjedhur. [Këtyre njerëzve] iu duhet të kalojnë përmes shumë modelimeve e formave, pastaj . . . iu duhet të zmaltohen e të piquen; dhe madje edhe në pjekje, disa enë plasariten” (në Stanley B. Kimball, *Heber C. Kimball: Mormon Patriarch and Pioneer* [1981], f. 270).

### 2. Jeremia predikoi në të njëjtën kohë me profetin Lehi të Librit të Mormonit

Profeti Jeremia po u jepte mësim dhe po i paralajmëronte njerëzit e Judës në kohën që Lehi u largua nga Jerusalemi. Që të dy, edhe Jeremia edhe Lehi profetizuan se Jerusalemi do të shkatërrohej.

- Ku ishte Jeremia kur Lehi dhe familja e tij u larguan nga Jerusalemi? (Shih Jeremia 37:15–16; 1 Nefi 7:14.)
- Jeremia kaloi shumë kohë duke këshilluar Zedekian, mbretin e Judës, por Zedekia refuzoi t’u bindej fjalëve të Zotit që u dhanë nga Jeremia. Çfarë i ndodhi Zedekias si rezultat i mosbindjes së tij? (Shih Jeremia 39:4–7.)
- Nga Libri i Mormonit ne e dimë se një prej bijve të Zedekias nuk u vra nga babilonasit. Si quhej ai? (Shih Helamani 8:20–21.) Ku shkoi ai? (Shih Omni 1:15.)

*Jeremia 16; 23; 29; 31*

---

**Qëllimi** Të nxisë anëtarët e klasës që të marrin pjesë në punën e mrekullueshme të ditëve të mëvonshme të Perëndisë dhe ta kenë ligjin e Tij të shkruar mbi zemrat e tyre.

---

**Përgatitja**

1. Studioni plot lutje Jeremia 16; 23; 29; dhe 31.
2. Lexim shtesë: Jeremia 3–9; 13; 30; 32:37–42; 33; 35.

---

**Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi** Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

**Aktivitet Vëmendjeje**

- Nëse do të mund të kishit qenë dëshmitarë ose të kishit marrë pjesë në ndonjë histori ose ngjarje në Dhiatën e Vjetër, cilën do të zgjidhni? (Ju mund të dëshironi t’i shkruani përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë.)
- Përse do t’ju pëlqente të kishit qenë dëshmitarë ose pjesëmarrës në këtë ngjarje?
- Çfarë po ndodh në Kishë sot që mund të jetë e krahasueshme me disa nga ngjarjet që keni zgjedhur?

Shpjegoni se edhe pse Jeremia kishte pak mesazhe shprese për njerëzit e kohës së tij, ai parashikoi një kohë shprese gjatë mbledhjes së ditëve të mëvonshme të Izraelit. Ky mësim diskuton profecitë e Jeremias për mbledhjen e mrekullueshme të ditëve të mëvonshme në të cilën ne po marrim pjesë sot.

---

**Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë** Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

## 1. Jeremia parashikon mbledhjen e ditëve të mëvonshme të Izraelit.

Nëse historia e eksodit të Izraelit nga Egjipti nuk u përmend në aktivitetin e vëmendjes, shpjegoni se ajo është një nga ngjarjet më të mrekullueshme në Dhiatën e Vjetër. Ajo përmendet në librin e Jeremias dhe në libra të tjerë të Dhiatës së Vjetër, si edhe në Librin e Mormonit.

- Si u ndie Moisiu mbi rëndësinë e Eksodit? (Shih Ligji i Përtërirë 4:32–35.) Si mendoni ju, si do të kishte qenë të ishte pjesë e Eksodit të Izraelit nga Egjipti?
- Shumë breza më vonë, Jeremia pa vegime të një ngjarjeje të ditëve të mëvonshme që Zoti tha se do të ishte po aq e mrekullueshme sa Eksodi (Jeremia 16:14–16; 23:3–8). Cila ngjarje përshkruhet te Jeremia 16:15 dhe 23:3? (Mbledhja e Izraelit dhe rritja e Kishës.) Cilët janë barinjët për të cilët flitet te Jeremia 23:4? (Udhëheqësit e Priftërisë dhe udhëheqës të tjerë të Kishës.) Cili është Mbreti për të cilin flitet te Jeremia 23:5–6? (Jezu Krishti.) Si mendoni ju, përse këto ngjarje janë po aq të mrekullueshme sa Eksodi?

- Plaku LeGrand Riçards tha se peshkatarët dhe gjahtarët e përshkruar te Jeremia 16:16 janë misionarët e Kishës (në Conference Report, prill 1971, f. 143; ose *Ensign*, qershor 1971, f. 98–99). Çfarë kanë të përbashkët peshkatarët dhe gjahtarët me misionarët? (Shih Mateu 4:18–19.) Si mund të jemi misionarë më të efektshëm?

## 2. Perëndia do ta shkruajë ligjin e Tij mbi zemrat e njerëzve të Tij.

- Fëmijët e Izraelit u mbështetën te Moisiu për të marrë zbulësë për ta gjatë udhëtimin të tyre në shkretëtirë. Çfarë dëshirimi të madh shprehu Moisiu te Numrat 11:29? (Ai dëshironte që njerëzit të mësonin ligjin e Perëndisë dhe të mësonin ta dëgjonin Shpirtin për veten e tyre.)
- Siç shënohet te Jeremia 31:31–34, çfarë premtoi të bënte Zoti në ditët e mëvonshme? (Shih edhe Ezekieli 11:17–20; 36:24–28; 2 Korintasve 3:2–3.) Çfarë do të thotë ta kemi ligjin e Perëndisë të shkruar në zemrat tona? Çfarë duhet të bëjmë që ta kemi ligjin e Perëndisë të shkruar në zemrat tona?
- Si ndikohet sjellja jonë kur e kemi ligjin e Perëndisë të shkruar në zemrat tona? Ju mund të dëshironi të diskutoni për mënyrën se si kjo na ndihmon t’u bindemi urdhërimeve të veçanta të tilla si:
  - a. Dashuria për fqinjët tanë.
  - b. Nderimi i prindërve tanë.
  - c. Të qenit moralisht të pastër.
  - ç. Mbajtja e shenjtë e ditës së Shabatit.
  - d. Zgjedhja e filmave, programeve televizive, librave dhe revistave të përshtatshme.
  - dh. Mbajtja e veshjeve të thjeshta.
  - e. Përzgjedhja e muzikës së përshtatshme.
- Jozef Smithin e pyetën një herë se si i qeveriste me sukses kaq shumë njerëz. Ai tha: “Unë u mësoj njerëzve parimet e sakta dhe ata qeverisen vetë” (cituar nga John Taylor, në *Journal of Discourses*, 10:57–58). Si lidhet ky deklaram me të pasurin e ligjit të Perëndisë të shkruar në zemrat tona?
- Jeremia profetizoi se 70 vite pasi njerëzit e Judës do të merreshin robër në Babiloni, ata do të ktheheshin në atdheun e tyre dhe, edhe një herë, do të jetonin në harmoni me Perëndinë (Jeremia 29:10–14; përmbushja e kësaj profecie diskutohet në mësimin 47). Sipas Jeremias 29:12–14, çfarë mund të bëjmë ne për t’iu afruar Perëndisë? Çfarë nënkuptojnë fjalët *më kërkoni* dhe *më luteni* mbi qëndrimin që duhet të kemi ndërsa përpiqemi fort t’i afrohem Perëndisë? Ftojini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që kanë pasur ata ndërsa janë përpjekur t’i afrohen Perëndisë.

### Përfundim

Jepni dëshmi se ne jetojmë në një kohë që Jeremia dhe shumë profetë të tjerë e kanë pritur me kënaqësi. Nxitini anëtarët e klasës që të marrin pjesë në mbledhjen e Izraelit dhe që ta kenë ligjin e Perëndisë të shkruar në zemrat e tyre.

### Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.



## 1. Tani është koha që të pendohemi

Mëshira e Zotit iu zgjatet gjithmonë atyre që pendohen. Megjithatë, njerëzit që e shtyjnë pendimin mund ta gjejnë gjithmonë e më të vështirë që të pendohen.

Presidenti Jozef F. Smith dha mësim: “Njeriut me gabime ose mëkate të shkuara, për të cilat nuk është penduar dhe nuk ka marrë falje, mund t’i duket e pamundur ta shmangë ose t’i largohet së keqes dhe situatën e tij në botë të pashpresë; dhe ai që pakujdesshëm e bën të pamundur ta shmangë ose t’i largohet së keqes sepse nuk ia ka dalë të pendohet për gabime ose mëkate të shkuara, është më i pafati. Praktika e përditshme, atëherë, e kërimit të mëshirës dhe faljes hyjnore ndërsa shkojmë më tej, na jep fuqinë t’u shpëtojmë të ligave” (*Gospel Doctrine*, bot. 5-të [1939], f. 374).

- Çfarë na mësojnë fragmentet vijuese mbi rëndësinë e të dëgjuarit të fjalës së Zotit dhe pendimit sakaq?

Jeremia 5:1–5, 21–25

Jeremia 6:10–17

Jeremia 7:23–28

Jeremia 8:6–12, 20

Jeremia 13:11, 23

Jeremia 17:23

## 2. Vënia e veshit ndaj fjalës së profetëve

- Jeremia shënoi shpesh se njerëzit nuk ua vunë veshin fjalëve të tij (Jeremia 7:13; 25:3–4; 26:2–5; 32:33). Cilat fjalë të profetëve të ditëve të mëvonshme mund të kemi nevojë që t’i ndjekim më me zell?

## 3. Përsëritja e mëkateve të brezave të mëparshëm

- Jeremia i paralajmëroi judenjtë e kohës së tij se mëkatet që kryen ata, ishin të njëjtat mëkate për të cilat brezat e shkuar ishin ndëshkuar rëndë (Jeremia 11:1–12). Si mendoni ju, përse brezi i Jeremias nuk do të mësonte nga mëkatet e paraardhësve të tij, veçanërisht kur ndëshkimi për ato mëkate ishte dokumentuar kaq qartë? Si mund të përfitojmë më plotësisht nga mësimet e nxjerra nga brezat e mëparshëm të njerëzve të besëlidhur të Perëndisë?

## 4. Rëndësia e mirëbesimit të Perëndia

- Te Jeremia 17:5–8, çfarë krahasimesh janë bërë midis njerëzve që mirëbesojnë te njeriu dhe njerëzve që mirëbesojnë te Perëndia? Si e keni parë ju se këto krahasime janë të sakta? Si mund ta tregojmë mirëbesimin tonë te Perëndia?

## 5. Profetët e rremë

- Zedekia ishte një mbret i cili dëshironte që profetët t’i thoshin atij atë që ai donte të dëgjonte. Si rrjedhim, shumë profetë të rremë premtuan se Jerusalemi nuk do të binte (Jeremia 28:1–4; 37:19). Sot, shumë profetë të rremë vijnë “duke u shtënë si dele” (Mateu 7:15). Çfarë provash ka se profetët e rremë janë mes nesh sot? Cilat janë disa nga mesazhet e profetëve të rremë të sotëm? Si mund ta shmangim udhëheqjen në rrugë të gabuar nga profetët e rremë?

*Ezekiel 18; 34; 37*

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të përmbushin përgjegjësitë e tyre si “barinjtë e Izraelit” (Ezekiel 34:2).
<b>Përgatitja</b>	<p>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ezekiel 34. Zoti i qorton ata barinj që nuk e ushqejnë kopenë. Ai do t’i kërkojë të gjitha delet e humbura dhe do të jetë Bariu i tyre.</li> <li>Ezekiel 18:21–32. Ezekieli jep mësim se të ligjtë që pendohen, do të shpëtohen dhe të drejtët që do t’i drejtohen ligësisë, do të dëbohen.</li> <li>Ezekiel 37:1–14. Ezekieli sheh një vegim në të cilin shumë kockave të thata iu jepet jetë.</li> <li>Ezekiel 37:15–28. Ezekieli profetizon se shkopi i Judës dhe shkopi i Jozefit do të bëhen një në dorën e Zotit.</li> </ol> <p>2. Lexim shtesë: Ezekiel 2.</p>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>Lexoni (ose shkruani në dërrasë) pyetjen vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si ndryshon një bari nga një bari rrogëtar?</li> </ul> <p>Kërkojuni anëtarëve të klasës që të dëgjojnë përgjigjet për këtë pyetje në citatin vijues nga Presidenti Ezra Taft Benson (ju mund të dëshironi që ta vini një anëtar të klasës që ta lexojë citatin):</p> <p>“Në kohën e Jezusit, bariu i Palestinës shquhej për mbrojtjen për delet e tij. Ndryshe nga barinjtë rrogëtarë modernë, bariu gjithmonë ecte në krye të kopesë së tij. Ai e udhëhiqte atë. Bariu e njihte secilën dele dhe zakonisht kishte një emër për secilën. Delet e njihnin zërin e tij dhe e besonin, si dhe nuk do të ndiqnin një të huaj. Prandaj, kur i thërriste, delet do të vinin tek ai. (Shih Gjoni 10:14, 16.)</p> <p>Natën barinjtë do t’i sillnin delet e tyre te një vend i rrethuar që quhej vathë. Mure të larta rrethonin vathën dhe në majë të atyre mureve viheshin gjemba për të penguar kafshët e egra dhe vjedhësit që të ngjiteshin mbi to.</p> <p>Nganjëherë, megjithatë, një kafshë e egër, e shtyrë nga uria, do të kërcente mbi muret e do të shkonte mes deleve, duke i frikësuar ato. Një situatë e tillë do ta ndante bariun e vërtetë – atë që i donte delet e tij – nga rrogëtari – që punonte vetëm për pagesë dhe detyrë.</p> <p>Bariu i vërtetë ishte i gatshëm që të jepte jetën e tij për delet. Ai do të shkonte në mes të deleve dhe do të luftonte për mirëqenien e tyre. Rrogëtari, nga ana tjetër, e vlerësonte sigurinë e vet personale mbi delet dhe zakonisht do t’ia mbathte nga rreziku” (në Conference Report, prill 1983, f. 61; ose <i>Ensign</i>, maj 1983, f. 43).</p>

Pasi të lexoni citatin, kërkoni anëtarëve të klasës që të përmbledhin ndryshimet mes një bariu dhe një rrogëtar. Përdorni pyetjet vijuese po të jetë e nevojshme dhe renditini përgjigjet në dërrasë:

- Si ecën bariu në lidhje me delet e tij? Si ecën bariu rrogëtar? (Bariu ecën përpara deleve dhe i udhëheq ato; citati nënkupton se bariu rrogëtar ecën pas deleve dhe i shtyn ato.)
- Cila është marrëdhënia e bariut me secilën prej deleve? Cila është marrëdhënia e bariut rrogëtar me secilën prej deleve?
- Si përgjigjet bariu kur delet janë në rrezik? Si përgjigjet bariu rrogëtar?

Shpjegoni se një pjesë e këtij mësimi diskuton përgjegjësitë tona si barinj shpirtërorë.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja personale që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

Në vitin 597 Pr. κ., mbreti Nebukadnetsar i Babilonisë i çoi në robëri shumë njerëz nga mbretëria e Judës. Mes këtyre robërve qe Ezekieli, të cilin Zoti e thirri si profet pesë vite më vonë. Në vitin 587 Pr. κ., babilonasit e shkatërruan Jerusalem dhe morën shumë robër. Ezekieli i shërbeu popullit të tij të mërguar deri në vitin 570 Pr. κ.

Shkrimet e Ezekielit përfshijnë qortime të ashpra dhe premtime të lavdishme që zbatohen jo vetëm për mbretërinë e lashtë të Judës, por për të gjithë Izraelin, përfshirë anëtarët e Kishës sot. Edhe pse Jerusalemi ishte shkatërruar, Ezekieli parashikoi një ditë kur Izraeli do të mbledhej dhe rivendosej. Kjo ngjarje simbolizohet në vegimin e tij të luginës me kocka të thata dhe në profecinë e tij për copat e drurit të Judës dhe Jozefit.

### 1. Barinj të Izraelit

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 34. Në këtë kapitull Zoti qortoi barinj të Izraelit që kullotnin veten dhe që nuk kishin ushqyer kopenë. Ai pastaj, e përshkroi veten si Bariu i Mirë që do ta mbledhte kopenë e Tij në ditët e mëvonshme dhe do ta udhëhiqte atë gjatë Mijëvjeçarit.

- Cilët janë “barinj të Izraelit” për të cilët flitet tek Ezekieli 34? (Udhëheqësit fetarë të kohës së Ezekielit.) Përse Zoti ishte i pakënaqur me ta? (Shih Ezekiel 34:2–4.) Çfarë u ndodhi deleve kur barinj të i lanë pas dore ato? (Shih Ezekiel 34:5–6.)
- Në çfarë mënyrash secili prej nesh mund të konsiderohet një bari i Izraelit? (Ne duhet të vëzhgojmë dhe ta forcojmë njëri-tjetrin si pjesëtarë të familjeve, anëtarë të Kishës, fqinjë, mësues të shtëpisë dhe mësuese vizitore, si edhe si anëtarë të kuorumeve e të klasave.)

Plaku Brus R. Mek-Konki tha: “Cilido që shërben në çfarëdolloj pozite në Kishë, në të cilën është përgjegjës për mirëqenien shpirtërore ose materiale të cilitdo prej fëmijëve të Zotit, është një bari për ato dele. Zoti i mban përgjegjës barinj të Tij për sigurinë (shpëtimin) e deleve të Tij” (*Mormon Doctrine*, bot. 2-të [1966], f. 710).

- Zoti ishte i pakënaqur me disa nga barinj të sepse kullotnin vetveten në vend që të kullotnin kopetë (Ezekiel 34:2–3, 8). Në ç'mënyrë disa prej nesh e bëjnë këtë gabim sot?
- Sipas Ezekielit 34:11–16, çfarë bëjnë barinj të e vërtetë për delet e tyre? (Vini re foljet *kërkoj, kujdesem, heq, mbledh, kullot, lidh plagën dhe forcoj*.) Si mund të ndihmojmë që t'i parandalojmë të tjerët që të humbasin apo të shpërndahen? Si mund të ndihmojmë për të mbledhur ata që kanë humbur? Si mundemi ne t'i ushqejmë e t'i forcojmë kopetë e Zotit? Si jeni bekuar ju nga barinj të e vërtetë që i kanë bërë këto gjëra?

Presidenti Ezra Taft Benson tha: "Ne ju kërkojmë të punoni më fort me përkushtim të përtërirë. . . . Ne dëshirojmë që ju t'i vëzhgoni, t'i ushqeni, t'i ruani e të kujdeseni për kopenë dhe, në rastin kur disa mund të humbasin përkohësisht, ne ju sfidojmë t'i gjeni ata" (në Conference Report, prill 1983, f. 64; ose *Ensign*, maj 1983, f. 45).

- Në ç'mënyrë Shpëtimtari është si një bari për ne? (Shih Ezekiel 34:11–16; Psalmi 23; Isaia 40:11; Gjoni 10:11–15.) Ju mund të dëshironi të diskutoni për mënyrën se si Shpëtimtari e ka bërë secilën prej këtyre gjërave të përshkuara në këto shkrime të shenjta. Jepni dëshmi për Shpëtimtarin siç të ndiheni të nxitur nga Shpirti.

## 2. Pendimi dhe falja

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 18:21–32.

- Çfarë na mëson ky fragment mbi pendimin dhe faljen? (Shih Ezekiel 18:21–22, 27–28.) Çfarë do të thotë "bëjini . . . një zemër të re dhe një shpirt të ri"? (Ezekiel 18:31). Përse është e rëndësishme ta kuptojmë se pendimi përfshin edhe largimin nga mëkati edhe të pasurit e një ndryshimi të zemrës? Si mund ta provojmë këtë ndryshim të zemrës? (Shih Alma 5:7–14.)
- Çfarë na mëson ky fragment për njerëzit që largohen nga drejtësia dhe nuk pendohen? (Shih Ezekiel 18:24, 26.)
- Çfarë na mëson ky fragment mbi ndjenjat e Zotit kur dënon të ligjtë? (Shih Ezekiel 18:23, 32.)
- Çfarë na mëson ky fragment mbi drejtësinë dhe mëshirën e Zotit? (Shih Ezekiel 18:25, 29–32.) Përse është e rëndësishme ta dimë se Zoti është i drejtë dhe i mëshirshëm?

## 3. Vegimi i Ezekielit për luginën e kockave

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 37:1–14. Shpjegoni se vegimi i Ezekielit për luginën me kocka simbolizon edhe Ringjalljen edhe rivendosjen e fëmijëve të Izraelit në tokën e tyre të premtuar.

- Si simbolizohet Ringjallja në vegimin e Ezekielit? (Kockat iu afruan njëra-tjetrës, u mbuluan me mish e lëkurë dhe iu dha jetë; shih Ezekiel 37:1–10; shih edhe Alma 11:42–44; 40:23.)
- Si simbolizohet në vegimin e Ezekielit rivendosja e fëmijëve të Izraelit në tokën e tyre të premtuar? (Shih Ezekiel 37:11–14. Ringjallja përdoret për të simbolizuar këtë rivendosje.)

- Vegimi i Ezekielit mund të lexohet gjithashtu si një ngjashmëri që përshkruan përtëritjen e “shpresës” së Izraelit (Ezekiel 37:11). Edhe pse shpresa e Izraelit mund të jetë po aq e vdekur sa “ushtria e madhe” e kockave që pa Ezekieli, Shpëtimtari mund ta rikthejë atë në gjallëri dhe në jetë. Në ç’mënyrë e ka përtërirë Shpëtimtari shpresën tuaj? (Ju mund të dëshironi të lexoni Moroni 7:41 ndërsa diskutoni mbi këtë pyetje.)
- Kockat në vegimin e Ezekielit filluan të marrin jetë pasi Ezekieli u tha atyre: “Dëgjoni fjalën e Zotit” (Ezekiel 37:4). Në ç’mënyrë fjala e Zotit na jep jetë?

#### 4. Copa e drurit të Judës dhe copa e drurit të Jozefit

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 37:15–28. Shpjegoni se profecia e Ezekielit për dy copat e drurit të Judës dhe të Jozefit, ka kuptim të dyfishtë. Ajo i referohet ndërthurjes së ditëve të mëvonshme të anave të shkrimit të shenjtë të Judës dhe të Jozefit (Izraelit). Ajo gjithashtu, i referohet ribashkimit të ditëve të mëvonshme të mbretërive të Judës dhe të Jozefit (Izraelit).

- Si është përmbushur profecia tek Ezekiel 37:15–20? (Shih 1 Nefi 5:14; 2 Nefi 3:12; DeB 27:5. Shpjegoni se fjala *copa e drurit* në këto vargje i referohet një lloj tabeleje shkrimi prej druri që përdorej gjerësisht në kohën e Ezekielit. Copa e drurit të Judës simbolizon Biblën dhe copa e drurit të Jozefit simbolizon Librin e Mormonit.)

Plaku Bojd K. Paker tha: “Copa e drurit e Judës – Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re – dhe copa e drurit ose anali i Efraimit – Libri i Mormonit, që është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit – tani janë thurur së bashku në mënyrë të tillë që, ndërsa ju studioni me zell njërin, tërhiqeni tek tjetri; ndërsa mësoni nga njëri, ndriçoheni nga tjetri. Ato janë vërtet një në duart tona. Profecia e Ezekielit tani qëndron e përmbushur” (në Conference Report, tetor 1982, f. 75; ose *Ensign*, nëntor 1982, f. 53).

- Çfarë bekimesh kanë ardhur nga që kemi Librin e Mormonit përveç Biblës? (Shih 1 Nefi 13:39–40; 2 Nefi 3:12.) Si ju ka ndihmuar Libri i Mormonit që ta kuptoni më mirë Biblën? Si jua ka forcuar ai dëshminë e Biblës për Zotin Jezu Krisht?
- Çfarë tha Ezekieli se do të ndodhte pasi të dy copat e drurit do të bashkoheshin?
  - a. Fëmijët e Izraelit do të mblidheshin së bashku dhe do të bashkoheshin në një mbretëri me Shpëtimtarin si Mbret (Ezekiel 37:21–22).
  - b. Njerëzit do të pastroheshin dhe do të dëlireshin (Ezekiel 37:23).
  - c. Njerëzit do të respektonin statutet e Zotit (Ezekiel 37:24).
  - ç. Njerëzit do të banonin në një tokë të premtuar (Ezekiel 37:25).
- Çfarë bekimesh të tjera premtoi Zoti tek Ezekieli 37:26–28? (Një bekim i rëndësishëm është rivendosja e shenjtërores së Zotit, apo tabernakullit, që do të thotë tempulli. Mësimi tjetër diskuton me më shumë hollësi për bekimet e tempullit.)

#### Përfundim

Mësimet e Ezekielit na ndihmojnë të kuptojmë se sa shumë na do dhe përkujdeset Shpëtimtari për secilin prej nesh. Ai është Bariu ynë. Ai është i etur që të falë. Ai e bëri të mundur që ne të ringjallemi. Ai po drejton mbledhjen e ditëve të mëvonshme të Izraelit. Dhe ai nxori në dritë Librin e Mormonit si një dëshmi tjetër për Të. Ftojini anëtarët e klasës që të ndajnë dëshmitë e tyre për këto të vërteta.

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimimit. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimimit.

### 1. Të mësuarit për të qenë një bari i mirë

Ndërsa diskutoni rreth përgjegjësive tona si barinj, ju mund të dëshironi të lexoni ose të tregoni historinë vijuese nga Presidenti Xhejms E. Faust:

“Kur isha djalë shumë i vogël, babai im gjeti një qengj krejt të vetëm në shkretëtirë. Tufa e deleve, së cilës i përkiste e ëma, ishte larguar dhe, në një farë mënyre, qengji u nda nga nëna e tij dhe barinjtë nuk duhet ta kenë ditur se kishte humbur. Meqë nuk do të kishte mundur të mbijetonte i vetëm në shkretëtirë, babai im e mori dhe e solli në shtëpi. Ta lije qengjin atje do të thoshte vdekje e sigurt, ose duke rënë pre e kjojotëve ose nga uria, sepse ishte aq i vogël sa ende i duhej qumësht. . . . Babai im ma dha qengjin mua dhe unë u bëra bari i tij.

Për disa javë, unë ngroha qumësht lope në një shishe biberoni dhe e ushqeva qengjin. Shpejt ne u bëmë miq. . . . Ai filloi të rritej. Qengji im dhe unë do të luanim në lëndinë. Nganjëherë ne do të shtriheshim së bashku në bar dhe unë do ta vija kokën mbi brinjën e tij të butë e të leshtë dhe do të shihja qiellin e kaltër dhe retë e bardha dallgëzuese. Unë nuk e kycja qengjin tim gjatë ditës. Ai nuk ikte. Shpejt mësoi të hante bar. Unë mund ta thërrisja qengjin tim nga çfarëdo lloj vendi në vathë thjesht duke imituar sa më mirë që mundja blegërimën e një deleje. . . .

Një natë erdhi një stuhi e tmerrshme. Unë harrova ta fusja qengjin tim në ahur atë natë siç duhej të kisha bërë. Unë shkova në shtrat. Miku im i vogël kishte frikë në stuhi dhe mund ta dëgjoja të blegërinte. E dija se duhej ta ndihmoja manarin tim, por doja të qëndroja i sigurt, i ngrohtë e i thatë në shtratin tim. Unë nuk u ngrita siç duhej të kisha bërë. Mëngjesin tjetër dola dhe e gjeta qengjin tim të ngordhur. Një qen gjithashtu e kishte dëgjuar thirrjen e tij me blegërimë dhe e kishte vlarë. Zemra m’u copëtua. Unë nuk kisha qenë një bari ose kujdestar i mirë i asaj që babai im më kishte besuar mua. Babai im tha: ‘Bir, a nuk mund të të besoj as sa të kujdesesh thjesht për një qengj?’ Vërejtja e babait tim më lëndoi më shumë sesa humbja e mikut tim me qime. Unë vendosa atë ditë, kur isha djalë i vogël, se asnjëherë nuk do ta shpërfillja më kujdestarinë time si bari nëse do të vihesh në atë pozicion sërish.

Jo shumë vite pas kësaj, u thirra si shoku më i ri i një mësuesi shtëpie. Kishte kohë kur moti ishte tepër i ftohtë ose me stuhi dhe unë dëshiroja të rrija në shtëpi e të isha rehat, por me veshët e mendjes mund ta dëgjoja qengjin tim të vogël që blegërinte dhe e dija se duhej të isha një bari i mirë e të shkoja me shokun tim më të vjetër. Në të gjitha ato vite të shumta, kurdoherë që kam pasur dëshirë t’u bishtnoja detyrave të mia, do të më vinte kujtimi se sa i brengosur qeshë atë natë shumë vite më parë kur nuk kisha qenë një bari i mirë” (në Conference Report, prill 1995, f. 62–63; ose *Ensign*, maj 1995, f. 46).

### 2. Roje për të ngritur një zë paralajmërimi

- Kur e thirri Ezekielin si profet, Zoti tha: “Të kam caktuar si roje për shtëpinë e Izraelit” (Ezekiel 3:17). Në ç’mënyrë detyrat e Ezekielit si profet ishin si ato të një rojeje? (Shih Ezekiel 3:17–21; 33:1–9. Në kohën e Ezekielit, një roje në një kullë do të lajmëronte njerëzit për rrezik të afërt nga ushtritë armike. Ezekieli i paralajmëroi njerëzit e tij për armiq të tij që do t’i rrezikonin ata shpirtërisht.)



- Cilët janë rojet tona në ditët e mëvonshme? Përse është e rëndësishme që t'i kemi këto roje? Cila është përgjegjësia jonë për të qenë roje? (Shih DeB 88:81. Pjesë e kësaj përgjegjësie është t'u mësojmë ungjillin atyre që nuk e kanë marrë atë.)

Për të dhënë mësim mbi rëndësinë e vënies së veshit ndaj paralajmërimeve të profetëve – dhe paralajmërimit të fqinjëve tanë duke u mësuar atyre ungjillin – Plaku Bojd K. Paker, tregoi për një përmbytje rrënuese që u shkaktua nga çarja e digës Teton në Ajdaho në vitin 1976. Në shtegun e drejtpërdrejtë të ujërave të përmbytjes, që lëviznin me shpejtësi, ishin 7.800 vetë. Ndërsa përmbytja u derdh në luginë, ajo shkatërroi 790 shtëpi dhe dëmtoi keqas edhe 800 shtëpi, kisha, shkolla dhe biznese të tjera. Duke marrë parasysh sasinë e ujit, shpejtësinë e tij dhe popullatën në zonë, një ekspert vlerësoi se 5.300 vetë duhet të ishin vrarë. Në mënyrë të pabesueshme, vetëm 6 vetë u mbytën.

Plaku Paker pyeti:

“Si mund të ndodhte një shkatërrim kaq i tmerrshëm me kaq pak humbje jetësh? . . . Sepse ata ishin paralajmëruar! Ata nuk patën shumë kohë, por ata u paralajmëruan; dhe çdo njeri që u paralajmërua, paralajmëroi fqinjin e tij. . . .

Po për ata gjashtë që u mbytën? Një prej tyre qe fiks poshtë digës dhe nuk kishte rrugëdalje. Dy prej tyre nuk e besuan paralajmërimin, derisa qe tepër vonë. Më vonë ata i gjetën që të dy në makinën e tyre, por ata nuk ia kishin vënë veshin paralajmërimit. Tre prej tyre u kthyen që të merrnin disa zotërime materiale dhe humbën jetën.

Por qe një mrekulli me përmasa të jashtëzakonshme. Si shenjtorë të ditëve të mëvonshme, ne mësojmë t'ua vëmë veshin paralajmërimeve. . . .

Tani, unë shoh një ngjashmëri shumë të madhe me atë që po ndodh në botë, një valë e madhe baticë të së keqes dhe ligësisë në botë. Ajo thjesht vjen rreth nesh dhe bëhet gjithmonë e më e thellë. Jetët tona janë në rrezik. Prona jonë është në rrezik. Liria jonë është në rrezik dhe ne, ende shkujdesur, shkojmë në punën tonë të paaftë që ta kuptojmë se duhet që kushdo që është paralajmëruar, të paralajmërojë të afërmin e tij. . . .

[Ne jemi] paralajmëruar nga një profet. A do t'ia vëmë veshin paralajmërimit, apo do të jemi si ata të gjashtë në Ajdaho që menduan se paralajmërimi nuk ishte për ta?” (*That All May Be Edified* [1982], f. 220–221, 223).

# “Çdo Qenie e Gjallë do të Jetojë Kudo që Arrin Lumi”

*Ezekiel 43–44; 47*

<b>Qëllimi</b>	Të nxisë anëtarët e klasës që të marrin nga fuqitë jetëdhënëse e shëruese që janë të disponueshme në tempull.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese: <ol style="list-style-type: none"> <li>Ezekiel 43:1–12; 44:6–9, 23. Ezekielit i tregohet një vegim i tempullit të Jerusalemit.</li> <li>Ezekiel 47:1, 6–12. Ezekieli sheh një lumë që rrjedh nga tempulli dhe i jep jetë shkretëtirës e shëron Detin e Vdekur.</li> <li>Ezekiel 47:2–5. Ezekieli mat thellësinë e lumit dhe zbulon se uji bëhet më i thellë çdo herë që kalon në të.</li> </ol> </li> <li>Vizatoni hartën e faqes 208 në një afishe ose në dërrasë përpara se të fillojë mësimi.</li> <li>Lexim shtesë: Ezekiel 40–42; Joel 3:18; Zakaria 14:8; Zbulesa 22:1–3; 1 Nefi 8:10–11; 11:25; Doktrina e Besëlidhje 97:8–20.</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimi</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
<b>Aktivitet Vëmendjeje</b>	<p>U bëni anëtarëve të klasës pyetje të ngjashme me vijueset:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A jeni emocionuar ndonjëherë duke parë një aktivitet sportiv ose ndonjë lloj tjetër zbavitjeje?</li> <li>A jeni emocionuar ndonjëherë në një ngjarje të tillë sa që u ngritët në këmbë dhe thërritët ose brohoritët?</li> <li>A mendoni për ngjarje të shenjta që janë shoqëruar ose do të shoqërohen me shprehje entuziaste gëzimi dhe mirënjohjeje? Disa nga këto ngjarje përfshijnë: <ol style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i tokës (Jobit 38:4–7).</li> <li>Hyrja triumfuese e Jezusit në Jerusalem (Gjoni 12:12–16).</li> <li>Ardhja e Dytë e Krishtit dhe Ringjallja (1 Thesalonikasve 4:16).</li> </ol> </li> <li>Në ç’mënyrë emocionimi në aktivitete sportive ose zbavitje të tjera krahasohet me gëzimin e këtyre ngjarjeve të shenjta? (Ndërkohë që emocionimi në aktivitete sportive ose zbavitje të tjera është i përkohshëm, gëzimi i shoqëruar me ngjarje të shenjta është i përjetshëm.)</li> <li>Cila është një ngjarje e shenjtë në Kishë ku pjesëmarrësit e tregojnë gëzimin dhe mirënjohjen e tyre duke u ngritur në këmbë, duke brohoritur dhe duke tundur duart? (Gjatë përkushtimit të një tempulli, kongregacioni merr pjesë në një shprehje të shkëlqyer gëzimi që quhet Thirrja Hosana.)  <p>“Thirrja Hosana bëhet me gjithë shpirt, që jepet deri në kufirin e fundit të forcës së njeriut. Kongregacioni ngrihet në këmbë dhe me një zë thërret fjalët: ‘Hosana, Hosana, Hosana Perëndisë dhe Qengjit. Amen, Amen dhe Amen’,</p> </li> </ul>

duke i përsëritur tri herë. Kjo zakonisht, shoqërohet me valëvitje ritmike të shamive të bardha me duar të ngritura. Epiteti 'Qengji' lidhet me denjimin dhe shlyerjen e Jezu Krishtit" (në Daniel H. Ludlow, red., *Encyclopedia of Mormonism*, 5 vëll. [1992], 2:659).

Shpjegoni se ky mësim do t'i ndihmojë anëtarët e klasës që të kuptojnë disa nga mënyrat e shumta se si tempulli sjell gëzim.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Ezekielit i tregohet një vegim i tempullit në Jerusalem.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 43:1–12; 44:6–9, 23.

- Vëri anëtarët e klasës që të lexojnë Ezekiel 43:1–12 dhe Ezekiel 44:6–9, 23. Çfarë mund të mësojmë mbi tempullin nga këto vargje?


Ju mund të dëshironi t'i rendisni përgjigjet e anëtarëve të klasës në dërrasë dhe të diskutoni mbi kuptimin e tyre. Përgjigjet mund të përfshijnë sa vijon:

- Lavdia e Zotit mbush tempullin (Ezekiel 43:2, 4–5).
- Tempulli është "vendi i fronit" të Zotit në tokë (Ezekiel 43:7).
- Zoti ecën në tempull, duke e quajtur atë "vendi ku vë këmbët e mia" (Ezekiel 43:7).
- Tempulli është vendi ku Zoti mund "të banoj[ë] në mes" njerëzve të Tij (Ezekiel 43:7).
- Ne mësojmë mbi ligjet e Zotit në tempull (Ezekiel 43:11).
- Këto janë ordinancat që Zoti dëshiron që ne t'i kryejmë në tempull (Ezekiel 43:11).
- Madje dhe territori që rrethon tempullin "do të jetë shumë i shenjtë" (Ezekiel 43:12).
- Vetëm ata që janë të denjë duhet të hyjnë në tempull (Ezekiel 44:6–9).
- Në tempull ne mësojmë ndryshimin midis të shenjtës dhe profanes dhe midis të pastërës dhe të papastërës (Ezekiel 44:23).

### 2. Ezekieli sheh një lumë që rrjedh nga tempulli dhe i jep jetë shkretëtirës e shëron Detin e Vdekur.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 47:1, 6–12.

- Çfarë pa Ezekieli të dilte nga dyert lindore të tempullit në Jerusalem? (Shih Ezekiel 47:1.) Ku shkuan ujërat? (Shih Ezekiel 47:8. Tregoni në hartë që shkretëtira e Judës dhe Deti i Vdekur janë në lindje të Jerusalemit.)



- Shkretëtira e Judës është një shkretëtirë shterpe dhe Deti i Vdekur është tepër i kripur saqë nuk mund të ketë qenie të gjalla. Sipas vegimit të Ezekielit, çfarë ndryshimesh do të ndodhin në shkretëtirën e Judës dhe Detin e Vdekur për shkak të lumit që rridhte nga tempulli? (Shih Ezekiel 47:6–12.)
- Në një vegim të ngjashëm me vegimin e Ezekielit për tempullin, Gjonit të Dashur iu tregua fronti i Perëndisë (Zbulesa 22:1–3; vini re se tek Ezekieli 43:7, Zoti e quan tempullin “vendi i fronit tim”). Çfarë rridhte nga fronti i Perëndisë në vegimin e Gjonit? (Shih Zbulesa 22:1.) Cili është “uji [i] jetës”? (Doktrinat e ungjillit; shih aktivitetin e vëmendjes në mësimin 30.) Si ngjasojmë ne me shkretëtirën e Judës dhe Detin e Vdekur nëse nuk marrim nga uji i jetës?
- Në ç’ mënyrë uji i jetës, që gjendet në tempull, shëron dhe u jep jetë martesave, familjeve, paraardhësve tanë, Kishës? Çfarë tjetër rrjedh nga tempulli që jep jetë shpirtërore dhe shërim? (Te përgjigjet mund të përfshihen e vërteta, urtësia, zbulesa dhe besëlidhja.)
- Ezekiel 47:12 përshkruan pemët që rriten përgjatë brigjeve të lumit në vegimin e Ezekielit. Çfarë kishin të përbashkët pemët me ujërat e lumit? (Ato kishin fuqi shëruese dhe jetëdhënëse.)
- Çfarë rritej përgjatë brigjeve të lumit në vegimin e Gjonit? (Shih Zbulesa 22:2.) Në ç’ vend tjetër në shkrimet e shenjta profetëve iu tregohet pema e jetës? (Shih 1 Nefi 8:10–11; 11:25.) Në ëndrrën që iu dha Lehit dhe Nefit, çfarë përfaqësonte pema e jetës? (Shih 1 Nefi 11:25.)
- Në ç’ mënyrë dashuria e Perëndisë shëron dhe jep jetë? Çfarë plagësh shpirtërore dhe fizike do të shërojë dashuria e Perëndisë?

### 3. Ezekieli mat thellësinë e lumit.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezekielin 47:2–5.

- Sa i thellë ishte lumi herën e parë që Ezekieli e kapërceu atë? (Shih Ezekiel 47:2–3.) Sa i thellë ishte ai herën e dytë, të tretë dhe të katërt që shkoi atje? (Shih Ezekiel 47:4–5.) Çfarë të vërtete sugjerojnë këto vargje rreth tempullit? (Fuqia e tempullit rritet në jetën tonë sa më shpesh që ta frekuentojmë.)
- Të vërteta të mrekullueshme jepen mësim në tempull, shumë nëpërmjet simboleve. Nëse në fillim kuptueshmëria jonë për këto të vërteta apo ordianca tempulli është vetëm “deri te kyçet e këmbëve”, çfarë duhet të bëjmë? (Shih

Ezekiel 47:2–5. Ne duhet të shkojmë te “lumi” sërish e sërish – ose, me fjalë të tjera, ta frekuentojmë tempullin sa më shpesh të jetë e mundur.)

## Përfundim

Thuajuni anëtarëve të klasës se Zoti e ka quajtur tempullin “një vend për falënderim” (DeB 97:13). Shprehni falënderimet tuaja për bekimet që vijnë për shkak të tempullit dhe ftojini anëtarët e klasës që të ndajnë ndjenjat e tyre të mirënjohjes për tempullin. Dëshmoni se pikërisht ashtu si ujërat nga tempulli i shëruan shkretëtirën e Judës dhe Detin e Vdekur në vegimin e Ezekielit, ungjilli i Jezu Krishtit do të na shërojë e pastrojë nëse do të marrim prej tij.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimi. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimi.

**1. “Unë e dua selinë e shtëpisë sate” (Psalmeve 26:8)**

Shumë prej psalmeve përmendin bekimet që marrim nga frekuentimi i tempullit, dhe shprehin ndjenja të bukura dashurie dhe mirënjohjeje për tempullin. Ju mund të dëshironi t’u kërkonte disa anëtarëve të klasës që të shprehin ndjenjat e tyre të mirënjohjes për tempullin ndërsa diskutoni për psalmet vijuese:

Psalmeve 24:3–4

Psalmeve 26:6–8

Psalmeve 27:1, 4–6

Psalmeve 65:4

Psalmeve 84

Psalmeve 122

Psalmeve 134

**2. “Simboli i Shkëlqyer i Anëtarësisë [Sonë]”**

Presidenti Hauard W. Hanter tha: “Unë i ftoj shenjtorët e ditëve të mëvonshme që ta shohin tempullin e Zotit si simbolin e shkëlqyer të anëtarësisë së tyre. Është dëshira më e thellë e zemrës sime ta kishim çdo anëtar të Kishës të denjë për të hyrë në tempull. Zotit do t’i jepte kënaqësi nëse çdo anëtar i rritur do të ishte i denjë për ta pasur – dhe do ta mbante – një rekomandim tempulli aktual. Gjërat që duhet të bëjmë dhe të mos bëjmë për të qenë të denjë për një rekomandim tempulli janë pikërisht ato gjëra që na sigurojnë se do të jemi të lumtur si individë dhe si familje” (në Conference Report, tetor 1994, f. 8; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 8).

- Si mund ta bëjmë tempullin “simbolin e shkëlqyer të anëtarësisë [sonë]” në Kishë? Në ç’mënyrë ndikon shikimi në këtë mënyrë drejt tempullit te botë-kuptimi ynë mbi jetën dhe te përkushtimi ynë ndaj punës së Zotit?

# “Në Qoftë se Duhet të Vdes, do të Vdes”

*Daniel 1; 3; 6; Esterit 3–5; 7–8*

<b>Qëllimi</b>	Të ndihmojë anëtarët e klasës që të kenë guxim për të jetuar sipas standardeve të ungjillit.
<b>Përgatitja</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Daniel 1. Danieli dhe miqtë e tij nuk pranojnë të ndyhen duke ngrënë ushqimin e mbretit Nebukadnetsar (1:1–16). Zoti e bekon Danielin dhe miqtë e tij me shëndet të mirë dhe urtësi (1:17–21).</li> <li>b. Daniel 3. Shadraku, Meshaku dhe Abed-negoja nuk pranojnë të adhurojnë idhullin e mbretit Nebukadnetsar (3:1–12). Mbreti Nebukadnetsar i hedh ata në një furrë të zjarrtë dhe Zoti i shpëton nga vdekja (3:13–30).</li> <li>c. Daniel 6. Njerëzit e mbretit Dar ia mbushin mendjen mbretit të firmosë një dekret që për 30 ditë, të gjitha kërkesat duhej t’i drejtoheshin vetëm atij dhe asnjë njeriu tjetër apo Perëndie (6:1–9). Me gjithë dekretin e mbretit, Danieli i lutet Perëndisë (6:10–13). Si ndëshkim për mosbindjen ndaj dekretit, Danielin e hedhin në gropën e luanëve (6:14–17). Zoti dërgon një engjëll që ta mbrojë Danielin (6:18–23).</li> <li>ç. Esterit 3–5; 7–8. Mardokeu nuk pranon t’i përkulet Hamanit (3:1–4). Hamani ia mbush mendjen mbretit Asuero të përgatisë një dekret që kërkon vdekjen e të gjithë judenjve në mbretëri (3:5–14). Esteri mëson për planin e Hamanit për ta vrarë popullin e saj dhe rrezikon jetën duke iu drejtuar mbretit për ndihmë (4:1–17). Mbreti e pret Esterin dhe ia plotëson dëshirën që të vijë me Hamanin në një banket (5:1–8). Në banket Esteri zbulon komplotin e Hamanit që të vrasë judenjtë (7:1–6). Mbreti e var Hamanin (7:7–10). Mbreti nderon Mardokeun dhe e pranon kërkesën e Esterit për të shfuqizuar dekretin e Hamanit (8:1–17).</li> </ol> </li> <li>2. Lexim shtesë: Daniel 5; Esteri 1–2; 6; 9–10.</li> <li>3. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, kërkoni dy anëtarëve të klasës që të përgatiten për të treguar shkurt rreth një momenti kur atyre ose dikujt që ata e njohin, iu desh të tregonte guxim për t’iu bindur Zotit.</li> <li>4. Nëse figurat vijuese janë të disponueshme, ju mund të dëshironi t’i përdorni disa prej tyre gjatë mësimin: Danieli Refuzon Mishin dhe Verën e Mbretit (62094; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 114); Tre Burra në Furrën e Zjarrtë (62093; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 116); dhe Danieli në Gropën e Luanëve (62096; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 117).</li> </ol>
<b>Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin</b>	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	Kërkoni anëtarëve të caktuar të klasës që të tregojnë shkurt rreth një momenti kur atyre ose dikujt që ata e njohin, iu desh të tregonte guxim për t’iu bindur Zotit.



Pasi anëtarët e klasës të kenë treguar përvojat e tyre, shpjegoni se ky mësim është rreth gjashtë njerëzve në Dhiatën e Vjetër që treguan guxim të madh në bindjen ndaj Zotit.

Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Danieli dhe miqtë e tij nuk pranojnë të hanë ushqimin e mbretit Nebukadnetsar; ata bekohen me shëndet të mirë dhe urtësi.

Jepni mësim dhe diskutoni për Danielin 1.

Kur qe djalosh i ri, Danielin e çuan rob nga Jerusalemi në Babiloni. Atë si dhe të rinj të tjerë premtues hebrej – përfshirë miqtë e tij Shadrakun, Meshakun dhe Abed-negon – i stërvitën në oborrin e mbretit Nebukadnetsar.

- Çfarë propozuan Danieli dhe miqtë e tij kur atyre iu dha mishi dhe vera e mbretit? (Shih Daniel 1:8–14.) Çfarë bekimesh morën ata sepse iu bindën ligjit të Zotit për shëndetin? (Shih Daniel 1:15, 17, 20.) Në ç’ mënyrë bekimet që ata morën, janë të ngjashme me premtimet e Zotit për ne nëse i bindemi Fjalës së Urtësisë? (Shih DeB 89:18–20.)

Plaku Bojd K. Paker dha mësim: “Kam arritur të dija . . . se një qëllim themelor i Fjalës së Urtësisë ka të bëjë me zbulesën. Që nga koha kur jeni shumë të vegjël, ne ju mësojmë të shmangni çajin, kafënë, alkoolin, duhanin, lëndët narkotike dhe çfarëdolloj gjëje tjetër që çrregullon shëndetin tuaj. . . . Nëse dikush ‘nën efekt’ mezi mund të dëgjojë bisedën e thjeshtë, si mundet t’u përgjigjet nxitjeve shpirtërore që prekin ndjenjat e tij më delikate? Aq e vlefshme sa është Fjala e Urtësisë si një ligj shëndeti, ajo mund të jetë shumë më me vlerë për ju shpirtërisht sesa është fizikisht” (në Conference Report, tetor 1979, f. 28–29; ose *Ensign*, nëntor 1979, f. 20).

- Çfarë na mëson kjo histori mbi mënyrën se si të përgjigjemi kur ndiejmë shtytje për të bërë diçka që nuk duhet ta bëjmë? (Shih Daniel 1:5, 8.) Cilat situata sot kërkojnë guxim prej nesh që t’u bindemi urdhërimeve të Zotit? Si mund ta zhvillojmë guximin e nevojshëm për t’u bindur në situata të tilla?

### 2. Zoti i shpëton Shadrakun, Meshakun dhe Abed-negon nga vdekja në furrën e zjarrtë.

Jepni mësim dhe diskutoni për Danielin 3.

- Mbreti Nabukadnetsar nxori një dekret se cilido që nuk do ta adhuronte idhullin e tij, do të hidhej në një furrë të zjarrtë (Daniel 3:1–6). Si iu përgjigjën dekretit Shadraku, Meshaku dhe Abed-negoja? (Shih Daniel 3:12.) Çfarë bëri Nabukadnetsari kur zbuloi se ata nuk do ta adhuronin idhullin e tij? (Shih Daniel 3:13–15, 19–20.)
- Çfarë thanë Shadraku, Meshaku dhe Abed-negoja kur mbreti i kërcënoi t’i hidhte në furrë? (Shih Daniel 3:16–18.)

Plaku Nil A. Maksuell tha: “Ne [nuk] do të shpëtohem gjithmonë nga problemet që përjetojmë, por do të shpëtohem nga vdekja e përhershme! Ndërkohë, shpresa bazë e bën të mundur të themi po ato tri fjalë të përdorura shekuj më parë nga tre djemtë guximtarë. Ata e dinin se Perëndia mund t’i shpëtonte ata

nga furra e zjarrtë nëse zgjidhte ta bënte atë. 'Por edhe sikur të mos e bënte', thanë ata, prapëseprapë ata ende do t'i shërbenin Atij!' (në Conference Report, tetor 1994, f. 45; ose *Ensign*, nëntor 1994, f. 35).

- Çfarë mund të na mësojë përgjigjja e Shadrakut, Meshakut dhe Abed-negos mbi bindjen ndaj urdhërimeve të Zotit? (Shadraku, Meshaku dhe Abed-negoja ishin të gatshëm t'i bindeshin Zotit qoftë nëse Ai do t'i mbronte ata ose jo. Bindja jonë nuk duhet të kushtëzohet nga fakti nëse Zoti na jep ose jo si këmbim një bekim të pritur në një kohë të pritur.) Cilat janë rreziqet e bindjes ndaj Zotit vetëm sepse ne presim që Ai të na japë një bekim të caktuar si këmbim?
- Çfarë ndodhi kur Shadrakun, Meshakun dhe Abed-negon i hodhën në furrë? (Shih Daniel 3:21–27.) Cili ishte në furrë me ta? (Shih Daniel 3:25.) Si na ndihmon Shpëtimtari kur i drejtohem Atij gjatë sprovave tona?
- Çfarë ndikimi pati guximi i Shadrakut, Meshakut dhe Abed-negos tek Nebukadnetsari? (Shih Daniel 3:28–30.) Si ndikojnë veprimet tona te qëndrimet e fqinjëve tanë kundrejt Kishës?

### 3. Danieli lutet pavarësisht dekretit të mbretit dhe e hedhin në gropën e luanëve. Zoti dërgon një engjëll që ta mbrojë Danielin.

Jepni mësim dhe diskutoni për Danielin 6.

Mbreti Nebukadnetsar u pasua nga i biri i tij, Belshatsari. Kur u vra Belshatsari, "Dari, Medasi, mori mbretërinë" (Daniel 5:31) dhe Danieli u ngrit në një pozitë me rëndësi të madhe. (Vini re: Dari, Medasi, nuk është i njëjti mbret Dar që sundoi Perandorinë Perse pas Kirit dhe të cilit iu lutën judenjtë ndërsa po rindërtonte tempullin. Shih Ezdras 4–6; mësimin 47; dhe Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta, "Dar", faqe 24.)

- Përse prefektët dhe princat e mbretit donin t'i gjenin faj Danielit? (Shih Daniel 6:1–5. Ata ishin xhelozë që mbreti parapëlqente Danielin dhe ishin të shqetësuar se mbreti mund t'i jepte më shumë pushtet atij.) Për çfarë dekreti këta burra ia mbushën mendjen mbretit që ta firmoste? (Shih Daniel 6:6–9. Duke e ditur se Danieli lutej rregullisht, ata ia mbushën mendjen mbretit Dar për të firmosur një dekret që, për 30 ditë, të gjitha kërkesat duhej t'i drejtoheshin vetëm atij dhe asnjë njeriu tjetër apo Perëndie. Ata që nuk do t'i bindeshin dekretit, do të hidheshin në gropën e luanëve.)
- Si iu përgjigj Danieli dekretit të mbretit? (Shih Daniel 6:10.) Çfarë mund të mësojmë nga Danieli mbi rëndësinë e lutjes? (Lutja ishte kaq e rëndësishme për Danielin saqë ai vazhdoi të lutej edhe kur i kërcënohej jeta nga bërja e kësaj.) Ftojini anëtarët e klasës për të medituar mbi vlerën që i japim privilegjit që i lutemi Atit tonë Qiellor.
- Si u ndie mbreti Dar kur njerëzit e tij i raportuan se e kishin parë Danielin duke u lutur? (Shih Daniel 6:12–15.) Si e tregoi mbreti besimin e tij te Perëndia? (Shih Daniel 6:16, 18.)
- Si e bekoji Zoti Danielin në gropën e luanëve? (Shih Daniel 6:19–23.) Çfarë ndikimi patën besimi dhe guximi i Danielit te mbreti Dar dhe njerëzit e mbretërisë? (Shih Daniel 6:24–28.)

Plaku L. Tom Peri tha: "Jo vetëm që shërbimi i Danielit që në dobi të mbretit, por për shkak të besimit që pati Danieli tek Zoti, ai besim ndikoi te një vend

i tërë. Mbreti dërgoi një shpallje që të gjithë njerëzit e mbretërisë duhej të adhuronin Perëndinë e vërtetë e të gjallë, Perëndinë që adhuronte Danieli. Sa e fuqishme që fuqia e shërbimit të një njeriu të drejtë, që ndikoi kaq shumë njerëz, ndërsa shërbeu ‘në botë[n]’ ku jetonte! Sa të efektshme do të jenë rezultatet e shërbimit tonë nëse do të vazhdojmë të shërbejmë në mënyrën tonë personale ‘në botë[n]’ ku *ne* jetojmë!” (në Conference Report, prill 1988, f. 16; ose *Ensign*, maj 1988, f. 15).

#### 4. Esteri rrezikon jetën që të shpëtojë popullin e saj.

Jepni mësim dhe diskutoni për vargjet Esteri 3–5; 7–8.

Esteri që një grua judease që jetoi pak kohë pas Danielit. Pasi i vdiqën prindërit, atë e rriti kushëriri i saj Mardokeu. Esteri që shumë e bukur dhe Asueroja, mbreti i Persisë dhe Medisë, që kaq i kënaqur nga bukuria e saj, saqë e bëri mbretëreshën e tij.

- Mbreti Asuero e gradoi Hamanin të ishte princ i rangut më të lartë (Esterit 3:1). Si tregoi guxim Mardokeu kur mbreti e urdhëroi atë dhe shërbëtorët e tjerë që t’i përkuleshin Hamanit? (Shih Esterit 3:2–4.) Cili që reagimi i Hamanit? (Shih Esterit 3:5–14. Ai u zemërua dhe ia mbushi mendjen mbretit që të urdhëronte shkatërrimin e “një popull[i]” të caktuar – të gjithë judenjtë në mbretëri.)
- Kur Esteri mësoi për vajtmin mes judenjve, ajo dërgoi një lajmëtar që ta pyeste Mardokeun se çfarë problemi kishte (Esteri 4:1–6). Çfarë i kërkoi Mardokeu Esterit? (Shih Esterit 4:7–9.) Përse që e rrezikshme për Esterin që të shkonte e të fliste me mbretin? (Shih Esterit 4:10–11. Ligji e lejonte mbretin që të vriste cilindro që i qasej pa u ftuar.)
- Çfarë mesazhi i dërgoi Mardokeu Esterit kur mësoi për shqetësimet e saj ndaj qasjes te mbreti? (Shih Esterit 4:13–14.) Si mendoni ju se u ndie Esteri ndërsa përsiati mundësinë nëse ajo “pikërisht për një kohë të tillë . . . [kishte] arritur në pozitë mbretërore”? (Esterit 4:14). Si mund ta marrim sigurimin se jeta jonë ka qëllim? Si mund të na ndihmojë ky sigurim?
- Çfarë u kërkoi Esteri vajzave të veta shoqëruese dhe judenjve të vendit ndërsa u përgatit që t’i qasej mbretit? (Shih Esterit 4:16.) Në ç’mënyrë na ndihmojnë agjërimi dhe lutjet e bashkuara të shumë njerëzve?
- Duke deklaruar qëllimin e saj që t’i qasej mbretit, Esteri tha: “Në qoftë se duhet të vdes, do të vdes” (Esterit 4:16). Në ç’mënyrë ky deklaram ngjasonte me deklaramin e Shadrakut, Meshakut dhe Abed-negos përpara se t’i hidhnin në furrë? (Shih Daniel 3:17–18.) Në ç’mënyrë ky deklaram tregonte devocionin e Esterit ndaj popullit të saj dhe ndaj Perëndisë?
- Kur Esteri iu qas mbretit, ai e pranoi atë dhe i tha se do t’i jepte gjithçka që kërkonte (Esterit 5:1–3). Ajo kërkoi që mbreti dhe Hamani të vinin në një banket (Esterit 5:4–8). Në ditën e dytë të banketit, çfarë kërkoi Esteri nga mbreti? (Shih Esterit 7:3–4.) Çfarë bëri mbreti kur mësoi se populli, për të cilin po komplotonte që ta shkatërronte Hamani, ishin judenjtë? (Shih Esterit 7:5–10.)
- Hamanin e varën, por dekreti për të vvarë të gjithë judenjtë ishte shpërndarë tashmë në mbarë mbretërinë. Çfarë i kërkoi Esteri mbretit që ta bënte? (Shih Esterit 8:5–6.) Çfarë bekimesh morën judenjtë për shkak të guximit dhe besimit të Esterit? (Shih Esterit 8:16–17.) Çfarë bekimesh keni marrë ju për shkak të guximit dhe besimit të të tjerëve?

- Me çfarë sfidash, që kërkojnë guxim si të Esterit, përballemi sot? Çfarë beki-mesh do të marrim kur përpiqemi të bëjmë atë çfarë është e drejtë edhe kur përballemi me pasoja të vështira?

Përfundim

Dëshmoni se Zoti do të na bekojë kur të kemi guximin që të mbështesim të vërtetën. Nxitini anëtarët e klasës që të ndjekin shembujt e Danielit, Shadrakut, Meshakut, Abed-negos, Esterit dhe Mardokeut.

Ide Mësimdhënieje  
Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Bekimet përfundimtare të bindjes me guxim

- Çfarë kishin të përbashkët Danieli, Shadraku, Meshaku, Abed-negoja, Esteri dhe Mardokeu? (Të gjithë ata patën guximin që të bënin çfarë ishte e drejtë, edhe kur bërja e kësaj iu vuri jetën në rrezik.) Çfarë situatash keni përballur kur ju është dashur të vendosni nëse do ta mbështesnit ose jo atë që e dini se është e drejtë?

Dëshmoni se ndërsa përpiqemi t'i mbajmë urdhërimet, Zoti do të na bekojë. Megjithatë, bekimet që marrim nuk janë të dukshme menjëherë. Për ta ilustruar këtë, ju mund të dëshironi të diskutoni mbi sprovat që duruan njerëzit në vijim:

- a. Sara nuk mundi të kishte fëmijë derisa qe 90 vjeçe (Zanafilla 17:15–17; 21:1–2).
  - b. Jozefin e shitën vëllezërit dhe më vonë e burgosën për një krim që nuk e kishte kryer (Zanafilla 37:27–28; 39:7–20).
  - c. Shpëtimtarin e tradhëtoi një mik, e gjykuan në mënyrë të paligjshme dhe e kryqëzuan (Gjoni 18–19).
  - ç. Nefin e rrahën dhe më vonë e lidhën me litarë vëllezërit e tij (1 Nefi 3:28; 18:10–11).
  - d. Almën dhe Amulekun i detyruan të vështronin ndërsa gratë dhe fëmijët po i digjinin për besimet e tyre (Alma 14:8–11).
  - dh. Jozef Smithin e burgosën dhe e martirizuan (DeB 135).
- Si mendoni ju, përse Zoti i lejoi këta njerëz që t'i duronin sprovat të tilla? Si mendoni ju, përse këta njerëz qenë në gjendje t'i duronin këto sprovat? Çfarë mund të mësojmë nga shembulli i tyre?

### 2. Mbështetja e së vërtetës

Vërin anëtarët e klasës që të luajnë me role situata të ndryshme në të cilat do t'u duhej të mbështesnin atë që e dinë se është e drejtë. Mendoni për rrethana që do të zbatoheshin për anëtarët e klasës. Sugjerimet vijuese mund të jenë të dobishme:

- a. Një mik ia ul vlerat dikujt dhe ju nxit të bëni të njëjtën gjë.
- b. Dikush sugjeron që të dëgjoni muzikë që e dini se është e papërshtatshme.
- c. Dikush ju kërkon të shkoni në një restorant të dielën pas kishës.
- ç. Dikush ju ofron pije alkoolike ose ndonjë lëndë tjetër në kundërshtim me Fjalën e Urtësisë.

# “Një Mbretëri, që nuk do të Shkatërrohet Kurrë”

Daniel 2

## Qëllimi

Të forcojë dëshmitë e anëtarëve të klasës për Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit dhe t'i nxisë ata për të ndihmuar në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në tokë.

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:
  - a. Daniel 2:1–23. Mbreti Nebukadnetsar sheh një ëndërr dhe i urdhëron këshilltarët e tij që ta përshkruajnë dhe ta interpretojnë atë (2:1–13). Danieli lutet me miqtë e tij dhe Perëndia ia zbulon atij ëndrrën dhe interpretimin e saj (2:14–23).
  - b. Daniel 2:24–49. Danieli zbulon se ëndrra e mbretit Nebukadnetsar parashikon ngritjen dhe rënien e mbretërive të mëdha të tokës dhe triumfin e ditëve të mëvonshme të mbretërisë së Perëndisë mbi të gjitha mbretëritë e tjera.
2. Lexim shtesë: Doktrina e Besëlidhje 65.
3. Ftoni dy ose tre anëtarë të klasës që të përgatiten për të dhënë dëshmi të shkurtra mbi vërtetësinë e Kishës.
4. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, vizatoni tabelën që gjendet në fund të kësaj faqeje, në një afishe ose në dërrasë përpara se të fillojë mësimi.
5. Nëse përdorni skicën “Ëndrra e Nebukadnetsarit” (shih faqen 217), vizatoni atë në një afishe ose në dërrasë përpara mësimi. Mos i shkruani emrat e mbretërive të veçanta derisa të diskutoni për skicën në klasë.
6. Nëse është e disponueshme figura Danieli Interpreton Ëndrrën e Nebukadnetsarit, ju mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë mësimi (62531; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 115).

## Sugjerime për

### Zhvillimin e Mësimi

Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.

### Aktivitet Vëmendjeje

Drejtojeni vëmendjen e anëtarëve të klasës te tabela që keni vizatuar në një afishe ose në dërrasë:

	6 Prill 1830	1880	1930	1980	1995	2000
	6	133.628	670.017	4.639.822	9.340.898	Mbi 11.000.000
	1	10	16	44	88	100
	0	23	104	1.218	2.150	2.581
	0	10	30	188	307	334
	0	1	7	19	47	102

- Si mendoni ju, çfarë përfaqësojnë këta numra?

Jepuni anëtarëve të klasës disa minuta për të sugjeruar përgjigje për këtë pyetje. Pastaj plotësojeni tabelën siç tregohet më poshtë:

	6 Prill 1830	1880	1930	1980	1995	2000
Anëtarë të Kishës	6	133.628	670.017	4.639.822	9.340.898	Mbi 11.000.000
Gjuhë me botime të Librit të Mormonit	1	10	16	44	88 (39 për- kthime të plota dhe 49 të pjesshme)	100 (61 për- kthime të plota dhe 39 të pjesshme)
Kunje	0	23	104	1.218	2.150	2.581
Misione	0	10	30	188	307	334
Tempuj në funksio- nim	0	1	7	19	47	102

(Statistikat aktuale mund të gjenden në botimet më të fundit të Kishës. Ju mund të dëshironi të shtoni një kolonë në tabelë për t'i përfshirë ato statistika.)

Ftojini anëtarët e klasës që të komentojnë mbi rritjen e shpejtë të Kishës. Shpjegoni se ky mësim flet për Danielin, një profet të lashtë që parashikoi triumfin e mbretërisë së Perëndisë në tokë – të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Diskutimi dhe  
Zbatimi i Shkrimit  
të Shenjtë

Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.

### 1. Danieli merr një zbuluesë në të cilën i tregohet ëndrra e mbretit Nebukadnetsar dhe i jepet interpretimi i saj.

Jepni mësim dhe diskutoni për Danielin 2:1–23.

Mbreti Nebukadnetsar pa një ëndërr shqetësuese një natë. Ai i vuri në provë këshilltarët e tij duke u thënë se e kishte harruar dhe duke i urdhëruar t'ia zbulonin atë dhe interpretimin e saj (Daniel 2:2–5). Kur ata thanë se nuk mund ta përshkruanin ëndrrën, Nebukadnetsari urdhëroi vdekjen e të gjithë të diturve të Babilonisë, përfshirë Danielin dhe miqtë e tij (Daniel 2:10–13). Kur komandanti i rojeve të mbretit erdhi ta merrte Danielin që ta vriste, Danieli shkoi te mbreti dhe i kërkoi kohë për ta interpretuar ëndrrën (Daniel 2:14–16).

- Si u përgatit Danieli për ta interpretuar ëndrrën e mbretit? (Shih Daniel 2:17–18. Ai u kërkoi miqve të tij që të luteshin me të.) Si ju kanë ndihmuar ju lutjet e pjesëtarëve të familjes ose të miqve?
- Si morën përgjigje lutjet e Danielit dhe të miqve të tij? (Shih Daniel 2:19, 27–28.) Çfarë bëri Danieli menjëherë pasi mori vegimin e ëndrrës së mbretit? (Shih Daniel 2:20–23.) Çfarë zbulojnë fjalët e tij për ndjenjat e tij kundrejt Perëndisë? Përse është e rëndësishme që të tregojmë mirënjohje ndaj Zotit? Si mund t'ia tregojmë mirënjohjen tonë Atij?
- Krahasoni burimet të cilave iu drejtuan Danieli dhe Nebukadnetsari kur kërkuan përgjigje për pyetjet. (Shih Daniel 2:2, 19–23, 28.) Cilave burime të diskutueshme iu drejtohen njerëzit sot kur kanë nevojë për ndihmë që t'u përgjigjen pyetjeve të




vështira ose që të marrin vendime? Çfarë i pengon shumë njerëz që të kërkojnë udhëheqjen e Perëndisë në situata të tilla?

## 2. Danieli përshkruan dhe interpreton ëndrrën e Nebukadnetsarit.

Jepni mësim dhe diskutoni për Danielin 2:24–49.

- Si e përshkroi Danieli figurën e madhe që kishte parë mbreti në ëndrrën e tij? (Shih Daniel 2:31–33. Referojuni figurës Danieli Interpreton Ëndrrën e Nebukadnetsarit ose vizatimit tuaj të skicës së paraqitur më poshtë.)



- Çfarë përfaqësonin pjesët e ndryshme të figurës? (Shih Daniel 2:36–43. Pjesët përfaqësonin mbretëritë e ndryshme që do të vijonin njëra pas tjetrës si fuqi të botës.)

Shkruani emrat e mbretërive në skicë ndërsa këqyrni interpretimin në vijim nga Presidenti Spenser W. Kimball:

- Koka e artë përfaqësonte Nebukadnetsarin dhe mbretërinë e tij të Babilonisë.
  - Gjoksi dhe krahët prej argjendi përfaqësonin Kirin dhe mbretërinë e tij të Medisë dhe Persisë.
  - Barku dhe kofshët prej bronzi përfaqësonin Filipin e Aleksandrin dhe mbretërinë greke ose maqedonase.
  - Këmbët prej hekuri përfaqësonin Perandorinë Romake.
  - Këmbët prej hekuri dhe argjile përfaqësonin një grup kombesh europiane. (Në Conference Report, prill 1976, f. 10; ose *Ensign*, maj 1976, f. 8.)
- Në ëndrrën e Nebukadnetsarit, çfarë e shkatërroi figurën që përfaqësonte mbretëritë tokësore? (Shih Daniel 2:34–35.) Çfarë përfaqëson “gur[i] i shkëputur”, por jo nga dora e njeriut”? (Shih Daniel 2:44–45; DeB 65:2.)

Presidenti Kimball dha mësim: “Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme u rivendos në vitin 1830. . . . Kjo është mbretëria, e ngritur nga Perëndia i qiellit, që nuk do të shkatërrohet as zëvendësohet kurrë, dhe guri i shkëputur nga mali jo nga dora e njeriut që do të bëhet një mal i madh dhe do të mbushë tërë tokën” (në Conference Report, prill 1976, f. 10; ose *Ensign*, maj 1976, f. 8–9).

- Çfarë profetizoi Danieli në lidhje me Kishën në ditët e mëvonshme? (Shih Daniel 2:34–35, 44.)

Ju mund të dëshironi t’i rendisni në dërrasë profecitë në vijim. Danieli profetizoi se Kisha:

- a. Do të “shkëput[ej], por jo nga dora e njeriut” (Daniel 2:34)
- b. Do të bëhej “një mal i madh, që [do të mbushte] tërë tokën” (Daniel 2:35).
- c. “Nuk do të shkatërrohet kurrë” (Daniel 2:44).
- ç. “Nuk do t’i lihet një populli tjetër” (Daniel 2:44).
- d. “Do të asgjësojë tërë këto mbretëri” të tjera (Daniel 2:44).
- dh. “Do të ekzistojë përjetë” (Daniel 2:44).

- Çfarë do të thoshte se guri do të “shkëput[ej], por jo nga dora e njeriut”? (Shih Daniel 2:34. Nuk do të krijohej nga njeriu.) Në ç’mënyrë Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit është si një gur i shkëputur jo nga dora e njeriut?

Plaku Jozef B. Uirthlin tha: “Zoti dhe Shpëtimtari ynë qëndron në krye të kësaj Kise dhe e drejton atë nëpërmjet shërbëtorëve të Tij. Kjo është Kisha e Zotit; nuk është një kishë e njerëzve” (në Conference Report, tetor 1993, f. 4; ose *Ensign*, nëntor 1993, f. 5).

- Në ç’mënyrë profecia e Danielit se Kisha do të “mbush[ë] tërë tokën” dhe “nuk do të shkatërrohet kurrë” po përmbushet sot? (Ju mund të dëshironi t’i referoheni tabelës së dytë në aktivitetin e vëmendjes.)

Presidenti Gordon B. Hinkli dëshmoi: “Kjo Kishë është e vërtetë. Ajo do ta përballojë çdo stuhi që godet kundër saj. Do të rrojë më gjatë se cilido kritik që ngrihet për ta tallur atë. Ajo u vendos nga Perëndia, Ati ynë i Përjetshëm për bekimin e bijve e bijave të Tij të të gjithë brezave. Ajo mbart emrin e Atij që qëndron si kreu i saj, madje Zoti Jezu Krisht, Shpëtimtari i botës. Ajo qeveriset dhe vihet në lëvizje nga fuqia e priftërisë. Ajo i çon botës një dëshmi tjetër të karakterit hyjnor të Zotit. Jini besnikë, miqtë e mi. Jini të vërtetë. Jini besnikë ndaj gjërave të mëdha të Perëndisë që janë zbuluar në këtë periudhë ungjillore” (“Keep the Faith”, *Ensign*, shtator 1985, f. 6).

- Çfarë mund të bëjmë që të marrim pjesë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në shtëpitë tona, në komunitetet tona dhe në mbarë botën?

Ftojini anëtarët e caktuar të klasës që të japin dëshmi të shkurtër mbi vërtetësinë e Kishës.

## Përfundim

Dëshmoni se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është mbretëria e Perëndisë në tokë dhe se Jezu Krishti e udhëheq atë. Nxitini anëtarët e klasës që të marrin pjesë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në tokë.

# “Të Ngrihemi dhe t’i Vihemi Ndërtimit”

Mësimi

# 47

*Ezdras 1–8; Nehemias 1–2; 4; 6; 8*

---

## Qëllimi

Të nxisë anëtarët e klasës që të ndihmojnë për të ndërtuar Sionin dhe të tregojnë dashuri si të Krishtit ndaj atyre që i kundërvihen punës së Zotit.

---

## Përgatitja

1. Studiojini me lutje shkrimet e shenjta vijuese:

- a. Ezdras 1–6. Mbreti Kir lexon emrin e tij në profecitë e Isaia dhe mbushet me dëshirë që të bëjë vullnetin e Zotit. Ai i liron judenjtë që ishin robër në Babiloni, dhe i fton ata të kthehen në Jerusalem e të rindërtojnë tempullin (Ezdras 1). Zorobabeli dhe Jeshua udhëheqin rreth 50.000 vetë gjatë kthimit për në Jerusalem dhe ata fillojnë të rindërtojnë tempullin (Ezdras 2–3). Samaritanët ofrohen që të ndihmojnë për punën në tempull, oferta e tyre nuk pranohet dhe ata përpiqen ta ndalojnë punën; rindërtimi ndërpritet (Ezdras 4). Disa vite më vonë, profetët Hagai dhe Zakaria i nxisin judenjtë që të mbarojnë tempullin; samaritanët vazhdojnë ta kundërshtojnë këtë (Ezdras 5; shih edhe Hagai 1). Mbreti Dar e ripërtërin dekretin e Kirit për të rindërtuar tempullin dhe ai përfundohet e përkushtohet rreth vitit 515 P.R. K. (Ezdras 6).
  - b. Ezdras 7–8. Më shumë se 50 vjet pas përkushtimit të tempullit, Ezdra merr leje nga mbreti Artakserks i Persisë për të udhëhequr një tjetër grup judenjsh në kthim për në Jerusalem. Ezdra dhe njerëzit e tij agjërojnë e luten dhe Zoti i mbron ata në udhëtimin e tyre.
  - c. Nehemias 1–2; 4; 6. Pasi mësoi se judenjtë që ishin kthyer në Jerusalem, ishin “në një varfëri të madhe dhe me faqe të zezë”, Nehemia merr leje nga mbreti Artakserks që të shkonte në Jerusalem për të rindërtuar muret e qytetit (Nehemias 1–2). Armiqtë e judenjve u munduan t’i pengonin ata për rindërtimin e mureve. Nehemia i armatos punëtorët dhe e çon punën përpara derisa muret mbarohen (Nehemias 4; 6).
  - ç. Nehemias 8. Pasi muret rindërtohen rreth Jerusalemit, Ezdra u lexon njerëzve shkrimet e shenjta. Kur dëgjojnë fjalët e ligjit, njerëzit qajnë dhe dëshirojnë t’iu binden atyre.
2. Lexim shtesë: Hagai 1; “Ezdra”, Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, faqe 43; “Nehemia”, Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, faqe 131.
  3. Ju mund të dëshironi të ftoni një anëtar të klasës që të përgatitet për të dhënë një përmbledhje të shkurtër të sfondit historik që jepet në fillim të tregimit të parë nga shkrimi i shenjtë.
  4. Nëse është e disponueshme figura Tempulli i Përdorur në Lashtësi, ju mund të dëshironi ta përdorni atë gjatë mësimit (62300; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 118).

Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	<p>Vini një anëtar të klasës që të lexojë citimin vijues nga Plaku Dallin H. Ouks:</p> <p>“Neve mund . . . të na duket se një varg i veçantë i shkrimit të shenjtë, që është thënë për një qëllim krejt të ndryshëm në një epokë tërësisht të ndryshme, nën ndikimin interpretues të Frymës së Shenjtë, do të na japë një mesazh shumë personal të përshtatur për nevojat tona personale sot. . . . Nëse do të përpiqemi t’i përshtasim shkrimet e shenjta për vetë rrethanat tona, ‘që ato të mund të jenë për përfitimin dhe mësimin tonë’ (1 Nefi 19:23), një Atë i dashur në qiell mund t’i përdorë ato për të na bekuar në mënyra shumë individuale” (<i>Studying the Scriptures</i> [takim shpirtëror mbajtur në Tabernakullin e Salt Lake-ut, 24 nëntor 1985]).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• A keni qenë ndonjëherë duke lexuar shkrimet e shenjta dhe të keni ndier se një fragment i veçantë fliste drejtpërsëdrejti për ju? (Ftoni anëtarët e klasës që të ndajnë përvojat e tyre.) Si kanë ndihmuar shkrimet e shenjta për të dhënë drejtim veçanërisht për jetën tuaj?</li> </ul>
Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë	<p>Shpjegoni se ngjarjet e diskutuara në këtë mësim u vunë në lëvizje nga një burrë që zbuloi se një fragment shkrimi të shenjtë, i shkruar 150 vjet përpara lindjes së tij, i foli atij personalisht – në fakt, e përmendte atë me emër.</p>
Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Mbreti Kir i lejoi judenjtë që të ktheheshin në Jerusalem për të rindërtuar tempullin.</b></p> <p>Jepni mësim dhe diskutoni për Ezdran 1–6.</p> <p>Paraqisni (ose bëni një anëtar të caktuar të klasës që ta paraqesë) një përmbledhje të shkurtër të informacionit vijues historik:</p> <p>Në vitin 721 PR. K., kur mbretëria e Izraelit (Mbretëria Veriore, ose dhjetë fiset) u robërua nga Asiria, perandoria e Asirisë ishte më e madhja në botë. Megjithatë, deri në vitin 612 PR. K., perandoria e Asirisë ishte shkatërruar nga babilonasit. Nën mbretin Nebukadnetsar, Babilonia sundoi mbi shumicën e vendeve që kishin qenë pushtuar nga asirianët. Pushtimi prej babilonasve i mbretërisë së Judës (Mbretëria Jugore) zgjati nga rreth vitit 605 PR. K., kur ata morën robër shumë judenj, deri në vitin 587 PR. K., kur ata shkatërruan Jerusalemin.</p> <p>Pasi Nebukadnetsari vdiq në vitin 562 PR. K., fuqia e Babilonisë u zvogëluar me shpejtësi. Në vitin 539 PR. K., Babilonia ra nën sundimin e medianëve dhe persëve, të bashkuar nën udhëheqjen e Kirit. Ndryshe nga Nebukadnetsari, që i trajtonte mizorisht ata që pushtonte, Kiri qe një sundues mirëdashës. Duke i trajtuar popujt e pushtuar me mirësi dhe duke respektuar fetë e tyre, Kiri fitoi besnikërinë e atyre që sundonte.</p> <p>Pas pushtimit të Babilonisë, Kiri nxori një dekret që tempulli në Jerusalem duhej të rindërtohej. Ai i ftoi judenjtë në perandorinë e tij që të ktheheshin në Jerusalem e të rindërtonin tempullin, dhe ai ktheu mjetet prej ari dhe argjendi që trupat e Nebukadnetsarit kishin grabitur nga tempulli. (Shih 2 Kronikave</p>

36:22–23; Ezdras 1:1–3, 7. Profecia e Jeremias së cilës i referohen këto vargje, është se judenjtë do të ktheheshin në Jerusalem pas 70 viteve robërie babilonase; shih Jeremia 25:11–12; 29:10.)

- Përse Kiri nxori një dekret që një tempull duhej të ndërtohej sërish në Jerusalem? (Shih Ezdras 1:1–2.) Si e dinte Kiri që Zoti donte që ai ta bënte këtë? Fjalët e Kirit, që janë shënuar tek Ezdras 1:2, i referohen një profecie tek Isaia 44:28 që e përmendte Kirin me emër (shih edhe Isaia 45:1–5; shpjegoni se edhe pse historia e Kirit vjen përpara librit të Isaias në Dhiatën e Vjetër, Isaia jetoi rreth 150 vjet përpara se Kiri të lindte). Historiani i lashtë jude Flavius Jozefus raportoi se Kiri e lexoi emrin e tij në profecitë e Isaias, u prek nga Shpirti i Zotit dhe dëshiroi të përmbushte atë që ishte shkruar (*The Works of Flavius Josephus, Antiquities of the Jews*, përkth. William Whiston [pa datë], lib. 11, kap. 1, paragraf. 1–2).
- Si do të ndiheshit nëse do të ishit duke lexuar shkrimet e shenjta dhe do të lexonit një profeci që do të jepte emrin tuaj dhe do të përshkruante gjëra të veçanta që duhet të bënit?

Kur Zorobabeli dhe Jeshua udhëhoqën grupin e parë të judenjve për t'u kthyer në Jerusalem, ata gjetën atje samaritanë. Ju mund të dëshironi të shpjegoni se samaritanët ishin pasardhës të izraelitëve që kishin shpëtuar në kohën e robërimit dhe ishin lidhur me martesë me kolonistë asirianë e babilonas, të cilët mbretërit i kishin çuar për të zënë tokën.

- Çfarë kërkuan samaritanët nga judenjtë e kthyer? (Shih Ezdras 4:1–2.) Si u përgjigjën judenjtë kërkesës së samaritanëve? (Shih Ezdras 4:3. Judenjtë nuk pranuan t'i linin samaritanët që të ndihmonin për të rindërtuar tempullin sepse ndienin se samaritanët nuk ishin izraelitë të vërtetë.) Çfarë bënë samaritanët kur judenjtë nuk pranuan t'i linin që të ndihmonin? (Shih Ezdras 4:4–7, 11–24. Ata u përpoqën ta ndalonin rindërtimin e tempullit duke u ankuar te mbretërit që pasuan Kirin.)
- Puna në tempull përfundimisht u ndërpre. Çfarë i nxiti judenjtë që ta rifillonin punën disa vite më vonë? (Shih Ezdras 5:1–2; Hagai 1. Profetët Hagai dhe Zakaria dhanë drejtim të frymëzuar.) Çfarë u tha Zoti, nëpërmjet Hagait, judenjve në Jerusalem për tempullin? (Shih Hagai 1:3–4, 7–8.) Çfarë qëndrimi mes judenjve po e pengonte rindërtimin e tempullit? (Shih Hagai 1:2.) Çfarë qëndrimesh na pengojnë ne nga adhurimi dhe shërbimi i rregullt në tempull?
- Samaritanët u përpoqën sërish që ta ndalonin rindërtimin e tempullit kur puna ndërtoese rifilloi. Por judenjtë iu shpjeguan dekretin e mbretit Kir dhe mbreti Dar lejoi që puna të vazhdonte (Ezdras 5–6). Çfarë bënë judenjtë kur tempulli u përfundua? (Shih Ezdras 6:15–22.)

## 2. Ezdra udhëheq një tjetër grup judenjsh në kthim për në Jerusalem.

Jepni mësim dhe diskutoni për Ezdran 7–8.

- Pikërisht ashtu si Zoti e kishte prekur më herët zemrën e mbretit Kir për të liruar judenjtë, ai preku zemrën e mbretit Artakserks për të lejuar grupin e judenjve të Ezdras që të kthehej në Jerusalem (Ezdras 7:27–28; shih edhe vargjet 11–26). Cilët janë disa shembuj të Zotit që zbut zemrat e udhëheqësve qeverisës ndaj Kishës në ditët e mëvonshme? (Shih për shembull, Thomas S. Monson, në Conference

Report, prill 1989, f. 65–69; ose *Ensign*, maj 1989, f. 50–53.) Çfarë mund të bëjmë ne që të nxisim zemrat e udhëheqësve qeverisës që të zbuten ndaj Kishës? (Përgjigjet mund të përfshijnë bindjen ndaj ligjeve të vendit, bërjen e gjërave të mira, përgatitjen për t'i dhënë mësim ungjillin të gjithë botës si dhe lutjen ndaj Zotit që të zbusë zemrat e udhëheqësve. Shih DeB 58:21, 27; 98:4–6.)

- Çfarë bëri Ezdra që të sigurohej se grupi i judenjve që ai po çonte në Jerusalemin, të ishte i mbrojtur? (Shih Ezdras 8:21–23, 31.) Si jeni bekuar ju, familja juaj ose të tjerë që njihni, me anë të agjërimit?

### 3. Nehemia shkon në Jerusalem dhe udhëheq njerëzit në rindërtimin e mureve për të mbrojtur qytetin.

Jepni mësim dhe diskutoni për Nehemian 1–2; 4; 6. Ju mund të dëshironi të vini në dukje se Nehemia qe kupëmbajtësi i mbretit Artakserks të Persisë. Ky qe një pozicion me mirëbesim dhe përgjegjësi të madhe, i cili kërkonte që Nehemia të siguronte se ushqimi e pija e mbretit ishin të sigurta. Edhe pse Nehemia qe në një pozicion të rëndësishëm në Persi, ai u kujdes për njerëzit e tij në Jerusalem dhe u përpoq t'i ndihmonte ata kur dëgjoji për vështirësitë e tyre.

- Çfarë bëri Nehemia kur dëgjoji për vështirësitë e njerëzve të tij në Jerusalem? (Shih Nehemias 1:4–11; 2:1–5.) Si iu përgjigj mbreti Artakserks kërkesës së Nehemias? (Shih Nehemias 2:6–8. Mbreti ia dha Nehemias lejen për të shkuar, i dha atij roje dhe trupë përcjellëse për siguri, si dhe e autorizoi të përdorte lëndë druri nga pylli për të rindërtuar muret e qytetit.) Çfarë mund të mësojmë nga Nehemia që mund të na udhëheqë kur jemi të shqetësuar nga vuajtjet e të tjerëve?
- Në ç'mënyrë i nxiti Nehemia njerëzit për të rindërtuar muret rreth qytetit? (Shih Nehemias 2:17–18.) Si mendoni ju, përse dhënia e dëshmisë për të vërtetën dhe ndarja e përvojave shpirtërore ka fuqi të tillë që të frymëzojë të tjerët për të bërë mirë? Si ju kanë frymëzuar ju dëshmitë dhe përvojat shpirtërore të të tjerëve?
- Sanballati ishte guvernator i Samarisë dhe ai e njerëzit e tij ishin armiq të judenjve që ishin kthyer me Zorobabelin. Si reagoi Sanballati ndaj planeve për të rindërtuar muret e qytetit? (Shih Nehemias 2:10, 19; 4:1–3, 7–8, 11.) Si iu përgjigjën judenjtë këtyre përpjekjeve për të ndaluar ndërtimin e mureve? (Shih Nehemias 4:9, 13–15.)
- Çfarë bëri Nehemia kur Sanballati i kërkoi të ndalonte punën dhe të takohej me të? (Shih Nehemias 6:1–4.) Në ç'mënyrë disa njerëz përpiqen sot t'ua tërheqin vëmendjen nga puna e Zotit anëtarëve të Kishës? Si duhet t'u përgjigjemi ne këtyre gjërave që tërheqin vëmendjen?

Plaku Marvin J. Ashton këshilloi: “Disa njerëz dhe organizata po përpiqen të na provokojnë për të shkuar në grindje me përgojime, aluzione ose klasifikime të rreme. Sa të pamatur jemi ne në shoqërinë e sotme që të lejojmë që të nxelemi, të trazohemi, ose të fyhemi, sepse njerëzve të tjerë duket se u pëlqen të bëjnë deklarime të rreme lidhur me pozicionin ose përfshirjen tonë. Parimet ose standardet tona nuk do të jenë të ndryshme nga ç'janë për shkak të deklarimeve



të grindavecëve. Është detyra jonë të shpjegojmë pozicionin tonë nëpërmjet arsyes, bindjes miqësore dhe fakteve të sakta. Është detyra jonë të qëndrojmë të palëkundur e të paepur për çështjet morale të kohës dhe parimet e përjetshme të ungjillit, por jo që të debatojmë me ndonjë njeri ose organizatë. . . . Është detyra jonë që të dëgjohemi dhe të japim mësim. Është detyra jonë jo vetëm që të shmangim grindjen, por që të kujdesemi që gjëra të tilla të hiqen” (në Conference Report, prill 1978, f. 10; ose *Ensign*, maj 1978, f. 8).

#### 4. Njerëzit gëzohen kur Ezdra iu lexon atyre shkrimet e shenjta.

Jepni mësim dhe diskutoni për Nehemian 8.

- Pasi njerëzit kishin mbaruar rindërtimin e mureve të qytetit, çfarë i kërkuan ata Ezdras? (Shih Nehemias 8:1–2. Vini re se shumica e judenjve kishin qenë në robëri për një kohë kaq të gjatë, saqë ata nuk i kishin dëgjuar ose lexuar kurrë shkrimet e shenjta.)
- Për sa kohë u lexoi Ezdra njerëzve? (Shih Nehemias 8:3, 17–18.) Si u përgjigjën njerëzit? (Shih Nehemias 8:3, 6, 9, 12.) Si mund të jemi më të vëmendshëm kur lexojmë shkrimet e shenjta? (Diskutoni për mënyrën se si të jemi më të vëmendshëm ndaj vetë shkrimeve të shenjta dhe ndaj pëshpëritjeve të Shpirtit që vijnë ndërsa lexojmë shkrimet e shenjta.) Si mund ta zhvillojmë atë lloj gëzimi për shkrimet e shenjta që patën ata njerëz?
- Çfarë bëri Ezdra për t’i ndihmuar njerëzit e tij që të kuptonin shkrimet e shenjta? (Shih Nehemias 8:8.) Çfarë ju ka ndihmuar ju në përpjekjet tuaja për të kuptuar shkrimet e shenjta dhe për ta ndihmuar familjen tuaj që t’i kuptoni ato? (Ju mund të dëshironi t’i ftoni anëtarët e klasës që të tregojnë gjëra të veçanta që kanë bërë për të përmirësuar studimin e tyre personal dhe familjar të shkrimit të shenjtë.)
- Çfarë thanë Ezdra dhe udhëheqësit e tjerë kur njerëzit filluan të qajnë ndërsa dëgjuan shkrimet e shenjta? (Shih Nehemias 8:9–11.) Si ju kanë bërë të gëzoheni shkrimet e shenjta?

#### Përfundim

“Energjia, aftësia, patriotizmi bujar dhe integriteti moral personal i Nehemias sollën sërish në jetë një mbretëri të re dhe energjike të Judës. Kishte filluar rivendosja e Jerusalemit, që ishte dërgur në rrënoja për një shekull e gjysmë. Ezdra, një prift i drejtë dhe i përkushtuar, u bashkua me Nehemian në këtë vepër dhe, së bashku, ata ia dolën të përtërinin edhe një herë një komunitet judenjsh në Jerusalem” (*Old Testament Student Manual: 1 Kings–Malachi* [1982], f. 314).

Shpjegoni se ashtu si judenjët kishin përgjegjësinë që të rindërtonin Jerusalemin, shenjtorët e ditëve të mëvonshme kanë përgjegjësinë që të ndërtojnë Sionin në mbarë botën. Për të na ndihmuar që ta bëjmë këtë, ne duhet të ndjekim mësimet në shkrimet e shenjta dhe të marrim pjesë në punën në tempull. Dëshmoni për vërtetësinë e shkrimeve të shenjta dhe rëndësinë e punës në tempull.

Kujtojini anëtarët e klasës se disa njerëz do të përpiqen të ndalojnë punën e Zotit. Ne duhet të tregojmë dashuri si të Krishtit ndaj tyre, por të mos i lejojmë që të na shpërqendrojnë nga përpjekjet tona për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë.

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimit. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimit.

**1. “Puna është e madhe dhe e shtrirë, dhe ne jemi të shpërndarë” (Nehemias 4:19)**

Ndërsa po rindërtonin murin rreth Jerusalemit, judenjtë u shpërndanë që të mund të punonin njëkohësisht në pjesë të ndryshme të murit (Nehemias 3; 4:19). Nganjëherë ata ishin shumë larg, por ata po punonin së bashku drejt të njëjtit synim dhe, duke punuar së bashku, ata qenë në gjendje që ta përfundonin murin. Kujtojini anëtarët e klasës se Kisha është e ndarë në njësi të ndryshme (të tilla si familje, lagje, degë, kunjë, distrikte dhe kuorume) në mbarë botën. Nganjëherë një njësi mund të duket larg njërive të tjera. Por të gjithë shenjtorët po punojnë drejt të njëjtave synime dhe, nëse secili individ dhe secila njësi punon me zell, e gjithë Kisha do të vazhdojë të rritet.

**2. “Tempujt Janë për Besëlidhje të Përjetshme”**

Nëse është e disponueshme *Family Home Evening Video Supplement (International)* (53736), ju mund të dëshironi të shfaqni “Temples Are for Eternal Covenants” [“Tempujt Janë për Besëlidhje të Përjetshme”], një fragment gjashtëminutësh si pjesë të një diskutimi mbi rëndësinë e tempujve.

# “Dita e Madhe dhe e Llahtarshme e Zotit”

Zakaria 10–14; Malakia

Qëllimi	Të nxisë anëtarët e klasës që 1) të përgatiten për Ardhjen e Dytë të Zotit Jezu Krisht, 2) të paguajnë një të dhjetë të ndershme e oferta bujare dhe 3) të provojë bekimet që vijnë për shkak të fuqisë vulosëse të priftërisë.
Përgatitja	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studiojini me lutje fragmentet nga Zakaria 10–14 dhe Malakia që diskutohen në këtë mësim.</li> <li>2. Lexim shtesë: Doktrina e Besëlidhje 45.</li> <li>3. Ju mund të dëshironi të shkruani disa nga referencat e shkrimit të shenjtë nga pjesa e parë e mësimin në pjesë të veçanta letre për t’ua shpërndarë anëtarëve të klasës.</li> <li>4. Nëse përdorni aktivitetin e vëmendjes, siguroni figurën Ardhja e Dytë (62562; Paketa e Fotografive Artistike të Ungjillit 238).</li> <li>5. Siguroni një kopje të <i>New Testament Class Member Study Guide [Udhëzuesit Studimor për Anëtarin e Klasës së Dhiatës së Re]</i> (35682) për secilin person në klasën tuaj. (Lagjja duhet t’i ketë porositur këta udhëzues studimi si pjesë të porosisë së programit mësimor vjetor; një anëtar i peshkopatës duhet t’ia japë ato presidencës së Shkollës të së Dielës.)</li> </ol>
Sugjerime për Zhvillimin e Mësimin	Ju mund të dëshironi të përdorni aktivitetin vijues (ose një aktivitet tuajin) për të filluar mësimin.
Aktivitet Vëmendjeje	<p>Paraqisni figurën Ardhja e Dytë. Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë ndjenjash keni kur dëgjoni fjalë si <i>Ardhja e Dytë, ditët e fundit, ose shenjat e kohëve</i>? Shkrimet e shenjta i referohen Ardhjes së Dytë si “dita e madhe dhe e llahtarshme” (Malakia 4:5). Si mundet të jetë si këto të dyja?</li> </ul> <p>Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Ardhja [e Shpëtimtarit] do të jetë edhe e lavdishme edhe e tmerrshme, në varësi të gjendjes shpirtërore të atyre që mbeten” (“Prepare Yourself for the Great Day of the Lord”, <i>New Era</i>, maj 1982, f. 49).</p> <p>Shpjegoni se ky mësim përfshin diskutime mbi 1) profecitë që bënë Zakaria dhe Malakia për ditët e fundit dhe 2) përgatitjen tonë për Ardhjen e Dytë.</p>
Diskutimi dhe Zbatimi i Shkrimit të Shenjtë	<p>Ndërsa jepni mësim fragmentet vijuese të shkrimit të shenjtë, diskutoni për mënyrën se si zbatohen ato në jetën e përditshme. Nxitini anëtarët e klasës që të tregojnë përvoja që lidhen me parimet e shkrimit të shenjtë.</p> <p><b>1. Zakaria dhe Malakia profetizojnë për shumë ngjarje të ditëve të fundit.</b></p> <p>Diskutoni për disa nga profecitë vijuese nga Zakaria dhe Malakia, që përshkruajnë ngjarjet e ditëve të fundit. Nëse keni përgatitur copa letre me referencat e shkrimit të shenjtë shkruar në to, shpërndajuni anëtarëve të klasës. Vëri anëtarët e klasës që të lexojnë çdo fragment dhe të thonë se çfarë japin mësim</p>

ata. Nëse fragmenti jep informacion që mund të na ndihmojë të përgatitemi për Ardhjen e Dytë, diskutoni për mënyrën se si mund ta zbatojmë atë.

*Profecitë që janë përmbushur gjatë përgatitjes për Ardhjen e Dytë.*

- a. Malakia 3:1. Malakia profetizoi se një lajmëtar do të përgatiste udhën për ardhjen e Zotit. Gjon Pagëzori përgatiti udhën për shërbesën në vdekshmëri të Zotit dhe Jozef Smithi është lajmëtari që përgatiti udhën për Ardhjen e Dytë (shih Mateu 11:10; Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. [1954–1956], 1:193–195, 3:10–14).
  - b. Malakia 4:5–6. Malakia profetizoi se profeti Elija do të kthehej përpara Ardhjes së Dytë për t'i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe zemrat e fëmijëve tek etërit e tyre. Kjo profeci u përmbush kur Elija iu shfaq Jozef Smithit në Tempullin e Kirtlandit, duke rivendosur çelësat e fuqisë vulosëse (DeB 110:13–16). *Zbatim i mundshëm*: Ne duhet të kërkojmë emrat e paraardhësve tanë dhe të kryejmë ordinancat për ta në tempull (për këtë diskutohet më vonë në mësim me më shumë hollësi).
- Përse është e dobishme ta dimë se disa nga profecitë e Ardhjes së Dytë janë përmbushur tashmë?

*Profecitë që ende duhet të përmbushen përpara se të vijë Shpëtimtari*

- a. Zakaria 10:6–8. Njerëzit e Judës dhe të Jozefit do të mblidhen dhe njerëzit e Efraimit do të bëhen të fuqishëm. Zoti do të “fishkëllej”, ose do t'i thërrasë njerëzit e Tij dhe do t'i mbledhë ata. *Zbatim i mundshëm*: Ne mund të ndihmojmë në këtë mbledhje duke ndarë ungjillin me të tjerët.
  - b. Zakaria 12:2–3, 8–9. Një luftë e madhe do të zhvillohet në dhe rreth Jerusalemit, por Zoti do të ndërhyjë dhe do t'i shpëtojë banorët e Jerusalemit nga shkatërrimi. *Zbatim i mundshëm*: Ne duhet të mirëbesojmë Perëndinë se do t'i mbrojë njerëzit e Tij gjatë vështirësive të ditëve të fundit.
  - c. Zakaria 14:8. Ujëra të gjalla do të rrjedhin nga tempulli në Jerusalem dhe do të shërojnë Detin e Vdekur dhe shkretëtirën e Judës (shih edhe Ezekiel 47:1, 8–9).
- Shumë nga profecitë e ditëve të fundit përfshijnë tragjedi të tilla si luftë, katastrofa natyrore dhe ligësi të përhapura gjerësisht. Si mund ta mbajmë shpresën kur dëgjojmë për këto profeci dhe jemi dëshmitarë të përmbushjes së tyre? (Shih DeB 38:28–30.)

*Profecitë që do të përmbushen kur të vijë Shpëtimtari*

- a. Zakaria 14:3–4. Shpëtimtari do të qëndrojë në malin e Ullinjve dhe mali do të çahet më dysh (shih edhe DeB 45:48).
- b. Zakaria 12:10; 13:6. Judenjtë që do të jetojnë në kohën e çlirimit të Jerusalemit, do ta shohin Jezu Krishtin dhe do të vajtojnë sepse ata, si popull, nuk e kanë pranuar atë si Mesian (shih edhe DeB 45:51–53).
- c. Zakaria 13:2. Idhujt e rremë, shpirtrat e papastër dhe profetët e rremë do të shkatërrohen.
- ç. Zakaria 14:5. Të drejtët që janë të gjallë në tokë, do të rrëmbehen për ta takuar Shpëtimtarin. Të drejtët që kanë vdekur, do të ringjallen dhe gjithashtu do të rrëmbehen për ta takuar Atë (shih edhe DeB 88:96–98).
- d. Zakaria 14:9. Zoti do të jetë mbret mbi të gjithë tokën dhe do të sundojë gjatë Mijëvjeçarit.
- dh. Zakaria 14:12–13; Malakia 3:13–18; 4:1–3. Të ligjtë do të shkatërrohen dhe të drejtët do të kursehen (shih edhe 1 Nefi 22:15–17, 19).

- Si mendoni ju, përse Zoti i ka zbuluar këto profeci për ditët e mëvonshme, Ardhjen e Dytë dhe Mijëvjeçarin? (Shih DeB 45:34–44.) Si mund të përgatitemi ne për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit? (Shih DeB 45:56–57.)

Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Ndërsa i jetojmë urdhërimet e Perëndisë, ne mund të shpresojmë me pritje të gëzueshme për ardhjen e dytë të Zotit Jezhu Krisht dhe ta dimë se, nëpërmjet përpjekjeve tona, ne jemi të denjë, bashkë me të dashurit tanë, që të banojmë në praninë e Tij për të gjithë përjetësinë. Sigurisht, asgjë që na kërkohet të bëjmë apo të durojmë, nuk është tepër e vështirë për të arritur këtë synim të shkëlqyer. Ne nuk mund të pushojmë për asnjë çast. Ne duhet të vërtetojmë, çdo ditë të jetës sonë, se jemi të gatshëm të bëjmë vullnetin e Zotit – të përhapim ungjillin e rivendosur, t’i japim dëshmi botës, ta ndajmë ungjillin me të tjerët” (*The Teachings of Ezra Taft Benson* [1988], f. 341).

- Si ju ndihmon dituria se drejtësia do të triumfojë së fundi mbi ligësinë?

## 2. Malakia jep mësim mbi bekimet që u vijnë atyre që paguajnë të dhjetat dhe ofertat.

Jepni mësim dhe diskutoni për Malakian 3:8–12.

- Në ç’mënyrë njerëzit “vjedh[in] Perëndinë” duke mos paguar të dhjetat dhe ofertat?
- Çfarë do të thotë të paguash një të dhjetë të plotë?

Presidenca e Parë ka deklaruar: “Deklarata më e thjeshtë që dimë, është deklarata e vetë Zotit, që do të thotë, se anëtarët e Kishës duhet të paguajnë ‘një të dhjetën e gjithë interesit të tyre çdo vit’, që duhet kuptuar se do të thotë e ardhura. Asnjë nuk justifikohet duke bërë një deklaram të ndryshëm nga ky” (First Presidency letter, 19 mars 1970; shih edhe DeB 119:1–4).

- Çfarë bekimesh na ka premtuar Zoti nëse paguajmë të dhjetën? (Shih Malakia 3:10–12.) Si ju ka bekuar Zoti ndërsa keni paguar të dhjeta dhe oferta?
- Cila duhet të jetë arsyeja jonë për pagimin e të dhjetave dhe ofertave?

Pasi iu referua bekimeve që Zoti iu jep paguesve të së dhjetës, Presidenti Gordon B. Hinkli tha:

“Tani, mos më keqkuptoni. Unë nuk jam këtu për të thënë që, nëse paguani një të dhjetë të ndershme, ju do të realizoni ëndrrën tuaj për një shtëpi të shkëlqyer, një makinë rolls rojs dhe një shtëpi për pushime në Havai. *Zoti do të hapë pragjet e qiellit sipas nevojave tona dhe jo sipas lakmisë sonë.* Nëse po e paguajmë të dhjetën për t’u pasuruar, ne po e bëjmë atë për arsyen e gabuar. Qëllimi bazë për të dhjetën është që t’i sigurojë Kishës mjetet e nevojshme për ta çuar më tej punën e Tij” (në Conference Report, prill 1982, f. 60; ose *Ensign*, maj 1982, f. 40).

- Përse nganjëherë është një sfidë t’i bindemi ligjit të së dhjetës? Çfarë mund të bëhet që ta kapërcejmë atë sfidë?

## 3. Malakia profetizon për kthimin e Elijas në tokë për të rivendosur çelësat e fuqisë vulosëse.

Jepni mësim dhe diskutoni për Malakian 4:5–6.

- Malakia profetizoi se profeti Elija do të vinte në tokë përpara Ardhjes së Dytë të Zotit (Malakia 4:6). Si u përmbush kjo profeci? (Shih DeB 110:13–16. Elija u

shfaq në Tempullin e Kirtlandit dhe ia rivendosi Jozef Smithit çelësat e fuqisë vulosëse.) Çfarë do të thotë “për t’i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe [zemrat e] fëmijëve tek etërit [e tyre]”? (Do të thotë të jemi të vulosur tek të gjithë paraardhësit tanë – “etërit” tanë – dhe tek të gjithë pasardhësit tanë – “fëmijët” tanë – përgjithmonë. Për shkak të fuqisë vulosëse të priftërisë dhe të ordinancave të tempullit për të gjallët dhe të vdekurit, familjet mund të lidhen së bashku për përjetësinë.)

- Si e keni ndier zemrën tuaj t’iu kthehet paraardhësve tuaj ndërsa keni bërë punë për historinë familjare dhe në tempull për ata? Në ç’mënyrë premtimet e besëlidhjeve të tempullit kthejnë zemrën tuaj te prindërit, bashkëshorti/tja dhe fëmijët tuaj?
- Mesazhi te Malakia 4:5–6 jepet mësim në secilën prej veprave standarde (Lluka 1:17; 3 Nefi 25:5–6; DeB 2:1–3; Joseph Smith—Historia 1:37–39). Si mendoni ju, përse ky mesazh përsëritet kaq shpesh?

## Përfundim

Jepni dëshmi për gjërat që keni zgjedhur të diskutoni në mësim. Si përfundim për kursin e studimit për këtë vit, ju mund të dëshironi gjithashtu që të shprehni mirënjohjen tuaj për mësimet në Dhiatën e Vjetër.

Jepini secilit anëtar të klasës një kopje të *New Testament Class Member Study Guide [Udhëzuesit Studimor për Anëtarin e Klasës së Dhiatës së Re]* (35682; shih “Përgatitja”, faqe 225). Shpjegoni se kursi i studimit i vitit të ardhshëm është Dhiata e Re. Nxitini anëtarët të fillojnë ta përdorin udhëzuesin e studimit që të përgatiten për mësimin e javës së ardhshme dhe të studiojnë Dhiatën e Re me familjet e tyre.

## Ide Mësimdhënieje Shtesë

Materiali i mëposhtëm i shtohet planit të sugjeruar të mësimin. Ju mund të dëshironi të përdorni një ose më shumë nga këto ide si pjesë të mësimin.

### 1. Shfaqjet e profetizuara të Shpëtimtarit

- Në shkrimet e shenjta janë parashikuar të paktën shtatë shfaqje të Shpëtimtarit në ditët e mëvonshme. Sa prej tyre mund të dalloni?

Informacioni vijues do të ndihmojë për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje:

- a. Profetit Jozef Smith në Vegimin e Parë (Veprat e Apostujve 3:19–21; Joseph Smith—Historia 1:15–17).
- b. Në tempujt e Tij të ditëve të mëvonshme (Malakia 3:1; DeB 133:1–2).
- c. Në luginën e Adam-on-di-Ahmanit (DeB 116; Daniel 7:13–14, 22; shih edhe DeB 107:53–56, që përshkruan një takim të shkuar në Adam-on-di-Ahman i cili është i ngjashëm me takimin që do të ndodhë atje).
- ç. Në Jerusalem gjatë një konflikti mbarë botëror të njohur si beteja e Armagedonit (Ezekiel 38–39; Zakaria 12–14; Zbulesa 11; DeB 45:47–53).
- d. Në qytetin e Jerusalemit të Ri në Indipendensë të Misurit (3 Nefi 21:24–26).
- dh. Të drejtëve në kohën e Ardhjes së Tij të Dytë (Zakaria 14:5; 1 Thesalonikasve 4:16–17; DeB 88:96–98).
- e. Të ligjve (DeB 133:42–51).

### 2. Kur do të ndodhë Ardhja e Dytë?

Zoti e ka bërë të qartë se, ndërkohë që Ai me siguri do të vijë sërish, asnjë njeri nuk e di kohën e saktë (DeB 39:20–21; 49:7).



Plaku Riçard L. Evans tha: “Disa nga vëllezërit . . . iu qasën [Presidentit Uillford Udraf] dhe . . . e pyetën atë se kur e ndiente ai se do të ishte fundi – kur do të ishte ardhja e Mësuesit? Këto, mendoj, nuk janë fjalët e tij të sakta, por ato përçojnë frymën e përgjigjes së raportuar të tij: ‘Unë do të jetoja sikur të ishte nesër – por ende po mbjell pemë qershie!’ Mendoj se do të bënim mirë ta pranonim këtë deklaratë dhe ta zbatonim në jetën tonë, dhe të jetonim sikur fundi të mund të ishte nesër – dhe ende të mbillnim pemë qershie! Duke u shqetësuar për gjëra që nuk mund t’i bëjmë, ne nuk duhet të mos t’i vëmë re mundësitë tona me vetë familjet e miqtë tanë; duke u shqetësuar për ngjarje të mundshme ne nuk duhet të shpërfillim gjërat që duhen bërë këtu dhe tani, dhe që ne mund t’i bëjmë” (në Conference Report, prill 1950, f. 105–106).

